

Xheladin Gosturani

BIBLIOTEKA

80

966

**Historia
e
Albanologjisë**

alpin

80
966

Xheladin Gosturani

Historia e Albanologjisë



albin

HISTORIA E ALBANOLOGJISË
Xheladin Gosturani

RECENSENTË
Prof. Mahir Domi
Prof.,Dr. Seit Mansaku

ART&GRAFIK
Albert Sakaj

KOPERTINA
Albert Sakaj

© AUTORI

SHTYPUR
M.N.S

ISBN: 99927 - 32 - 19 - 9

Për botimin e këtij libri ndihmoi dhe financoi Fondacioni "Soros", si pjesë e programit të tij "Libri për një shoqëri të hapur"

albin, Tiranë 1999

Profesor MAHIR DOMIT
Ndihma e të cilit ka qenë e pakursyer.

PARATHËNIE

Vepra Historia e Albanologjisë përbëhet nga dy pjesë.

Në Pjesën e Parë Gjuha shqipe gjatë shekujve jepet një pamje e plotë, por shumë e përmblëdhur, e tërë zhvillimit historik të gjuhës shqipe që në lashtësi, duke e parë atë si gjuhë indoeuropjane e duke i caktuar edhe vendin përkatës në Familjen indoeuropjane. Më tej flitet për shqipen si pasardhëse e ilirishtes, duke sjellë për këtë qëllim argumente gjuhësore, historike, arkeologjike, gjeografike; bëhet fjalë për tiparet thelbësore të shqipes, të cilat nuk janë trashëgim indoeuropjan, por paraqiten si zhvillim i brendshëm i saj; shtjellohet mirë ndeshja e shqipes me gjuhët ballkanike, ndeshje e cila çoi në formimin e Njesisë gjuhësore ballkanike, në Afrinë Kulturore ballkanike, në Ballkanizmat.

Me këtë rast trajtohen qart marrëdhëniet sllavo-shqiptare, greko-shqiptare dhe rumuno-shqiptare.

Më tutje gjithashtu ravijëzohet një pamje e plotë e dy kryedialekteve të shqipes, afritë dhe dallimet e tyre, theksohet Njësia e gjuhës shqipe, vihet në dukje lëvrimi dhe pasurimi i saj gjatë Rilindjes sonë Kombëtare, si edhe formimi dhe konsolidimi i gjuhës letrare kombëtare pas Luftës së dytë Botërore.

Në Pjesën e dytë është trajtuar, përsa dihet gjer më sot, gjithë mendimi shkencor që është shprehur qoftë nga vendasit, qoftë nga të huajt për origjinën e gjuhës shqipe, për strukturën gramatikore të saj dhe për prejardhjen e popullit shqiptar.

Për ta dhënë pamjen sa më të plotë e sa më të saktë, studimi i gjuhës shqipe është ndarë në katër periudha.

Për çdo Periudhë janë vënë në dukje, me një analizë përmblëdhëse, veprat, studimet, punimet, artikujt e autorëve vendas, arbëreshë, të huaj, duke i grupuar veçantë secilët por duke i nxjerrë

në pah mendimet dhe vlerësimet e tyre për origjinën e gjuhës shqipe e të shqiptarëve, si edhe vëzhgimet e tyre për strukturën e shqipes.

Në *Periudhën* e fundit, pas Luftës së dytë Botërore, janë theksuar arritjet e gjuhësisë shqiptare në këtë lëmë, si edhe janë përmendur **Qendrat albanologjike** me studiuesit e tyre më të rëndësishëm sot nëpër Botë.

Vepra që po paraqesim ka vlera të mëdha dhe është shumë e nevojshme për studentët e viteve të katërta të Degëve të gjuhës shqipe në Universitetet e Tiranës, Shkodrës, Elbasanit, Gjirokastrës, për studentët që vazhdojnë me korrespondencë në këto Degë, si edhe për studentët shqiptarë në Kosovë, Maqedoni dhe në Mal të Zi.

Ky botim do të jetë i dobishëm dhe me interes për t'u pajisur me kulturë albanologjike edhe masa e gjërë e intelektualëve të sferave të ndryshme, punonjësit e ndryshëm, të cilët duan të dinë e të njohin historinë e Albanologjisë.

Ky Libër është shkruar me një gjuhë të thjeshtë për t'u kuptuar nga të gjithë; ai është rezultat i studimeve dhe konspektiveve të veprave, punimeve kushtuar gjuhës shqipe; është rezultat edhe i studimit të disa veprave përgjithësuese të vëna si Bibliografi në fund, të cilat kanë shërbyer si bazë.

Do të theksoj se si themel të kësaj Vepre kanë shërbyer Studimet e pavdekshme të **profesor Eqrem Çabejt** dhe mendimet e **profesor Mahir Domit**, të cilëve u detyrohem shumë.

Krejt Vepra është koncentrim i mendimeve të shprehura për gjuhën shqipe dhe popullin shqiptar gjatë shekujve, prandaj edhe nuk do të ketë citime, por vetëm një Bibliografi në fund.

Patjetër, me daljen e një dokumentacioni të ri, me zbulimin dhe me njohjen e fakteve dhe të dhënave të reja gjuhësore e historike, do të lind nevoja e një Botimi tjetër dhe më të plotë, çka do të mirëpritet përzemërsisht.

Autori

Pjesa e Parë
Gjuha Shqipe gjatë shekujve

Gjuha Shqipe gjatë shekujve

Në veprën tonë **Historia e Gjuhësisë Botërore gjatë Shekujve dhe disa Çështje Teorike të saj**; ky Kapitull, i cili iu bashkangjiti nga fundi, është trajtuar shkurt, ndërsa në këtë Botim atë do ta shtjellojmë shumë më gjërë, duke sjell fakte, argumente, konsiderata të tjera për të ndriçuar sa më mirë problematikën në shqyrtim.

Gjuhët janë të lidhura në popujt, me njerëzit që i flasin, prandaj historia e gjuhëve në thelb është pasqyrë e historisë së popujve.


Gjuha sjell materiale me interes për të kaluarën e popullit, plotëson dhe saktëson shumë herë të dhënat e burimeve të tjera, sidomos për periudha e aspekte të padokumentuara të së kaluarës.


Historia e një gjuhe, ashtu sikurse edhe historia e popullit që e flet atë gjuhë, është një varg i pashkëputur, një vijimsi.

Do të ishte diçka ideale që të njihej historia e një gjuhe në tërë fillin e zhvillimit të saj, nga fillimi deri në fund, mirëpo kjo nuk arrihet kurrë sepse asnjë gjuhë nuk njihet që nga fillimi.


Gjuha shqipe bën pjesë në Familjen e Gjuhëve Indoeuropjane dhe formon një Degë më vete në këtë Familje; ajo nuk rrjedh prej asnjërës nga gjuhët e sotme të saj.

Karakterin indoeuropjan të shqipes e vuri në dukje për herë të parë **Rasmus Rasku** në vitin 1824, e theksoi Ksilanderi më 1835, dhe e vërtetoi përfundimisht **Franc Bopi** më 1854 me veprën e pavdekshme: **Ueber das Albanesische in Seinen Ver-**





Familja e Gjuhëve Indoeuropiane



në formën e drurit, në formën e bimës.

Wandtschaftlichen Beziehungen (Mbi shqipen dhe lidhjet e saj farefisnore).

Familja e gjuhëve indoeuropjane, e cila dallohet nga Familjet e gjuhëve të tjera , si, p.sh, nga Familja e gjuhëve Semite (arabe), turanike (turke) etj, përfshin një varg gjuhësh, të gjalla e të vdekuara, që kanë afri dhe bashkëpërkime të shumta midis tyre në sistemin fonetik, në strukturën gramatikore dhe në leksik.

Gjuhët indoeuropjane, të cilat që në kohët e hershme parahistorike janë folë në trevat që nga India, në Evropë deri në Skoci, gjatë zhvillimit të tyre historik në shekuj kanë pësuar ndryshime të mëdha në të gjitha sistemet dhe nënsistemet e tyre dhe, si rrjedhim, janë larguar shumë njëra nga tjetra. Patjetër këto gjuhë rrjedhin nga një **Trung** i përbashkët, kanë lidhje birërie, dikur ishin dialekte të një gjuhe që, më vonë, në rrjedhë të kohëve, u formuan gjuhë më vete.

E gjithë kjo u zbulua dhe u vërtetua që në shekullin e **XVIII**, kur u pa se Sanskritishtja (gjuha letrare e indianëve të vjetër) kishite afri me disa gjuhë të Evropës si: latinishten, greqishten e vjetër, persishten e vjetër, gotishten, keltishten, sllavishten.

U pohua me të drejtë se kjo afri nuk është e rastit por se të gjitha këto gjuhë kanë një burim të përbashkët.

Kur flasim për karakterin indoeuropjan të shqipes kemi parasysh ruajtjen e disa fakteve dhe' tipareve të rëndësishme gjuhësore që shqipja i ka trashëguar nga një fazë e hershme indoeuropjane, patjetër me ndryshimet që ato kanë pësuar gjatë evolucionit të tyre historik. Prandaj për krahasim përdoren vetëm ato fjalë që janë të përbashkëta për disa gjuhë, por që me kalimin e kohës mund të kenë pësuar ndryshime.

Hyjnë në radhë të parë fjalë që tregojnë lidhje gjaku si: **at, ëmë, vëlla, motër, bir, bij**, fjalë të tjera të cilat gjejnë paralele në disa gjuhë e nuk mund të trajtohen si huazime: **njeri, ari, ujk, dimër, natë, gji, elb, i bardh, i zi, i madh, bie, djeg**; numërorët e thjeshtë deri më dhjetë, disa përemra etj.

Marrim shembull fjalën **ëmë**; latinisht: **mater** -greqishte e vjetër **metér**, sanskritisht: **matár** lituanisht: **mate**, rusisht: **mat**, gjermanisht: **mutter**, anglisht: **madhër** (mother), persishte e vjetër: **ba-matar**, shqip **motër** (ka ndryshuar kuptimin, sepse dikur kishte kuptimin **nënë, ëmë**).

Sjellim një shembull tjetër; shqip: **ulk, ujk**, sanskritisht: **vr-kah**, latinisht: **lupus**, greqisht e vjetër: **lykos**, rusisht: **volk**, gjermanisht: **Wolf**, gotisht: **Wulfs**, anglisht: **Wolf** (Wulf).

Fjala **dimër** (**dimën** ka korrespondencat e veta në gjuhët e tjera indoeuropjane; latinisht: **hiems**, greqishte e vjetër: **heimón, khe-imon**, sanskritisht **hima** (krahaso: Himalaja), sllavisht: **zima**).

Krahasimit mund t'i nënshtrohen edhe format gramatikore, edhe kuptimet e fjalëve që me kalimin e kohës mund të ndryshojnë, prandaj nuk është nevoja që të përputhen plotësisht. Kështu fjala **djath** ka përgjegjësen e vet fjalën e sanskritishtes (indishtes së vjetër) **dad^hi** (me kuptimin kos) dhe fjalën e persishtes së vjetër **dadan** (me kuptimin qumësht).

Të gjitha gjuhët indoeuropjane, duke u mbështetur në mënyrën se si i reflektojnë bashkëtingëllorët grykorë (tektale) qiellzore **k' g' g'h** proces që mendohet se është kryer në mijëvjeçarin e dytë p.e.r., ndahen në dy grupe të mëdha:

- a) Satem (Lindje).
- b) Kentum (Perëndim).

Në këtë ndarje të madhe shqipja bën pjesë në gjuhët **Satem** (Lindje) bashkë me gjuhët indoiranike, balto-sllave, armenishte (këtu hyn edhe trakishtja) sepse grykorët qiellzorë **k' g' (q,gj), g'h**, janë reflektuar në ndërdhëmborë: **K**, në **th, g'** në **dh** por edhe në **d**; latinisht **acidus** (shqipto: akidus) - **i athët** (shqip); latinisht, greqisht **lego**, shqip: (**mbë**) **ledh, (zgë) ledh, zgjedh**; latinisht **gener**, shqip **dhendër**; latinisht: **hiems**, shqip: **dimër; dorë**, e ardhur nga një bazë indoeuropjane **g'herá**.

Në gjuhën shqipe ka edhe raste kur ruhet karakteri mbylltor i grykoreve qiellzore, çka tregon se shqipja i përket një zone kal-

imtare të arealit indoeuropjan qëndror, sikurse edhe gjuhët balto-sllave dhe armenishtja.

Në grupin **Kentum** (Perëndim) përfshihen latinishtja (me bijat e saj), greqishtja, keltishtja, gjuhët gjermanike, tokarishtja, hetitishjtja, ndonëse këto dy të fundit gjenden në Lindje (në Azinë e Vogël).

Ilirishten disa studiues e kanë futur në **Satem**, kurse disa të tjerë në **Kentum**.

Gjuhët indoeuropjane janë ndarë në **dy grupe kryesore** sipas mënyrës së reflektimit të bashkëtingëlloreve mbylltore të zëshme të aspiruara: **b^h, d^h**.

a) Një grup gjuhësh si sanskritishtja, latinishtja, greqishtja e vjetër etj, karakterizohen nga ruajtja e shqiptimit të aspiruar.

b) Në një grup tjetër hyjnë gjuhët indoeuropjane në të cilat bashkëtingëlloret **mbylltore të zëshme të aspiruara**, e kanë humbur prej kohësh shqiptimin e aspiruar, duke u shndërruar në bashkëtingëllore **mbylltore të thjeshta**. Shqipja hyn në këtë grup bashkë me gjuhët gjermanike, keltike, baltike, sllave, me armenishten, iranishten, hetitishten, tokarishten, si edhe me gjuhët e vjetra, të vdekur të Gadishullit të Ballkanit: ilirishten, makedonishten, trakofrigishten.

Shqipja në këtë rast **f^{se}** latine dhe **ph^{se}** greke, i përgjigjet në fjalët e së njëjtës gurrë me një **b**, ose mbylltorët e zëshme të aspiruara **b^h, d^h**, kanë dhënë në shqip mbylltore të thjeshta **b, d**: shqip: **bie**, e krahasuar me një bazë indoeuropjane **b^{hero}**; sanskritisht: **bharati**, greqisht: **phero**, latinisht: **fero**, gotisht: **baira**; sllavishtja e vjetër: **bera, brat**; armenisht: **berem**.

Shqip **di**, e krahasuar me sanskritishten **d^{hi}** “mendim, dije”.

Në disa dukuri të tjera të hershme fonetike, siç është dukuria e kthimit të **O^{se}** së shkurtër indoeuropjane në **a**, shqipja shkon me gjuhët indoeuropjane Veriore (gjuhët gjermanike, balto-sllave), duke u larguar nga gjuhët indoeuropjane **Jugore** (latinisht, greqisht), sepse në shqip, sikurse në grupin verior, ajo është reflektuar

në **-a**: shqip: **natë**, e krahasueshme me një bazë indoeuropjane **+noct**, sanskritisht: **nakti**, lituanisht: **naktis**, gjermanisht: **nacht**; latinisht: **nox-noctis**; greqishte e vjetër: **nyks**. Shqip: **asht-i**, e krahasuar me një bazë indoeuropjane **+ost**; sanskritisht: **asthi**, latinisht: **os-osis**; greqishtja e vjetër: **osteon**.

———— * ————

Shqiptarët janë pasardhës të ilirëve dhe shqipja pasardhëse e ilirishtes, e vërtetuar mirë nga ana historike dhe gjuhësore. Ja argumentet kryesore:

1. Shqipja flitet sot në një pjesë të trojeve ku në periudhën anti-ke flitej ilirishtja. Trojet ku flitet sot shqipja në krahasim me trojet e dikurshme të saj janë rezultat rrudhjeje për arsye historike.

2. Ato pak elemente gjuhësore që janë njohur si ilire gjejnë shpjegim me anë të gjuhës shqipe.

3. Format e toponimeve të lashta antike, të krahasuara me format përgjegjëse të sotme, provojnë se ato janë zhvilluar në përputhje me rregullat e fonetikës historike të shqipes.

4. Marrëdhëniet e shqipes me greqishten e vjetër dhe me latinishten tregojnë se shqipja është formuar si gjuhë në një periudhë të hershme në fqinjësi me këto gjuhë.

5. Të dhënat e arkeologjisë dhe të dhënat e tjera të kulturës materiale e shpirtërore të popullit tonë dëshmojnë se ka vijimi kulturë nga Ilirët të Shqiptarët.

Le t'i shkoqitim më tepër argumentet gjuhësore, pasi këto janë objekt i studimit tonë.

Përgjithësisht historia e një gjuhe nis që nga koha kur ajo është shkruar. Kështu historia e shqipes duhet të fillonte në kohën që kur e gjejmë të shkruar për të parën herë, pra në vitin 1555, viti i botimit të Mesharit të Gjon Buzukut.

Faktikisht dëshmitë shkrimore i kemi edhe pak më përpara që tashmë dihen:

1. Formula e Pagëzimit

Ndër udhëzimet që jep kryepeshkopi i Durrësit Pal Engjëlli,

mik i Skëndërbeut, në Qarkoren e tij latinisht, dërguar në Kryepeshkopatën e tij dhe në Peshkopatën e Lezhës, datë 8 nëntor 1462, porosit priftërinjtë që fëmijtë e lindur të pagëzohen nga vetë familjet kur nuk mund të dërgohen në Kishë e kur nuk mund të shkojë prifti te ata, duke e shkruar shqip Formulën që duhet përdorur për pagëzim:

Unte paghesont preemnit Atit et birit et spertit senit (Unë të pagëzoj për emër të Atit, të birit e të shpirtit të shenjtë). Është shkruar gegërisht dhe me alfabet latin.

2. Perikopéja e Ungjillit

Këtu kemi dy pjesë të vogla shqip që ndodhen brenda një Dorëshkrimi greqisht. Fragmentet shqip nuk kanë të bëjnë me Dorëshkrimin greqisht; mendohet që të jenë të gjysmës së dytë të shekullit XV.

Ky Dokument shqip është përkthim i disa radhëve të Ungjillit të Shën Mateut (kreu XXVIII) dhe mbaron me një përsëritje shqip në njërin faqe, ndërsa në faqen tjetër ka një Këngë pashkësh, ku, bashkë me tekstin greqisht, jepet edhe teksti shqip. Përdoret alfabeti grek dhe dialekti toskërisht.

3. Frazja e mallkimit

Dramburi te clofto gogle: E trembur të kloftë golje (T'u trembtë, t'u dridhtë goja).

Është kjo një frazë që gjendet në një komedi latinisht me titull **Epirota**, botuar në Venetik më 1483 nga Tommaso de Mezzo.

Në këtë Komedi, një këngëtar epirot (d.m.th. shqiptar), me emrin Damasken shan një hanxhi sepse nuk ia pëlqen këngën, duke e mallkuar në gjuhën e vet **Dramburi te clofto gogle** (T'u dridhtë goja), çka u ngjan shumë sot sharjeve që përdoren në gjuhën shqipe; **T'u mbylltë goja**, **T'u thaftë goja**, **T'u dridhtë zëri**, **Të humbtë zëri** etj.

4. Fjalorthi i Arnold fon Harff-it

Kalorsi, udhëtari dhe shkrimtari gjerman Arnold fon Harff-i (1471-1505), i lindur në një familje fisnikësh në Rinin e Poshtëm,

në vjeshtën e vitit 1496 u nis për një udhëtim në Vendet e Shenjta.

Gjatë udhëtimit ai mblodhi materiale për gjuhët që ndeshi në vendet e ndryshme: greke, kroate, hungareze, bretone, baske, turke, arabe, hebraike etj.

Në bregdetin shqiptar ai bëri një ndalesë në Ulqin, Durrës, Szan.

Në një ndalesë në Portin e Durrësit në pranverën e vitit 1497, kur po udhëtonte me një anije tregtare me vela, nga Venetiku për në Aleksandri, ai shënoi: 26 fjalë, 8 shprehje dhe 12 numërorë shqip, duke u vënë edhe përkthimin gjermanisht: **boicke** (bukë), **oie** (ujë), **groua** (grua), **misch** (mish), **poylle** (pulë), **krup** (kripë), **myr** (mirë), **kale** (kalë), **elbe** (elb), **pyske** (peshk), **dua** (dy), **jast** (gjashtë), **state** (shtatë), **nante** (nëntë), **pijneto** (pije).

Ka mundësi që fjalët nuk janë marrë ashtu siç duhet dhe nuk janë transkriptuar (shënuar) mirë.

Me të mbërritur në Durrës ai shkruan: “Nga Ulqini për në Durrës lundruam me një erë shumë të fortë. Ky është një qytet i madh, i rrënuar nga turqit e që tani është nën sundimin e Venetikut. Ky qytet shtrihet në Shqipëri ku banorët kanë edhe gjuhën e tyre, e cila **nuk mund të shkruhet mirë, me që në këtë vend ata nuk kanë alfabetin e vet.** (nënvizimi im - Xh. G.). Kam hedhur në letër disa fjalë të kësaj gjuhe, të cilat po i jap më poshtë me alfabetin tonë.(d.m.th. gjerman - Xh.G.).

Duke vështruar gjuhën shqipe, të bien në sy dy gjëra të kundërta: nga njëra anë një gjuhë e dëshmuar me shkrim mjaft vonë, në anën tjetër një popull i lashtë, autokton (vendas) në këto vise të Ballkanit që në kohët e mugëta të prehistorisë.

Periodha pesëqindvjeçare e shqipes së shkruar nuk është veçse një pjesë e vogël nga Historia e Gjuhës - faza më e re e zhvillimit të saj historik. Prandaj rëndësia e të dhënave dhe e argumenteve gjuhësore është veçanërisht e madhe, për historinë e popullit tonë, pasi disa shekuj me radhë (nga shekulli V, deri në shekullin XI), thuajse mungojnë burimet e shkruara historike.

Mirë thoshte gjuhëtari i shquar danez, studiuesi dhe përshkruesi i 150 gjuhëve **Rasmus Rask** (1787-1832), se “Asnjë tjetër mjet për të njohur prejardhjen e popujve dhe lidhjet e tyre me lash-tësinë e hershme, ku i la historia, nuk është aq i rëndësishëm se sa gjuha”.

Pikërisht për këtë arsye gjuha e gjallë e popullit është arkiv i madh i së kaluarës, depozitë e paçmuar materiali dokumentar, pasqyra më e vjetër, më besnike e rrugës historike të një kombi apo të një bashkësie.

Gjuha shqipe hyn në këtë kuadër, pasi si e tillë përmendet për herë të parë në vitin 1285 në një Dokument që gjendet në Arkivat e Dubrovnikut (Raguzës).

Në hetimin e një grabitjeje në shtëpinë e Petro del Volcios nga Belena (më vonë Prati), një farë Mateu, biri i Markut të Mançës, që del se ka qënë dëshmitar i krimit, thotë: **Audivi unam vocem clamantem in monte in lingua albanesca** (Dëgjova një zë që thërriste në mal në gjuhën shqipe).

Në vitin 1308 ndeshim një përshkrim të Shqipërisë në të ashtuquajturin **Anonymi Descriptio Europae Orientalis** (Përshkrim i Evropës Lindore prej një Anonimi).

Autori i veprës mendohet të ketë qënë një klerik freng ose ndonjë murg polak, i shkolluar në Francë, i dërguar nga Kisha në Serbi e në vendet e tjera të Ballkanit në rrugën drejt Lindjes (Tokave të Shenjta). Përveç pjesës që pasqyron rajone të ndryshme të Greqisë Bizantine, Bullgarisë, Serbisë, Hungarisë, Polonisë, Bohemisë etj, ai përmban edhe një pjesë për Shqipërinë, ku ndër të tjera thotë: **Habent enim Albani prefati linguam distinctam a latinis, grecis et slavibus ita quod in nullo se intelligunt cum aliis nationibus** (Shqiptarët e sipërpërmendur kanë një gjuhë që dallohet nga ajo e latinëve, grekëve dhe sllavëve, kështu që kurrsesi nuk mund të merren vesh me popujt e tjerë). Pastaj Autori e përshkruan Arbërinë si një krahinë “të gjerë e të madhe”, përmes së cilës kalojnë rrugët “më të mira, të lehta e të sigurta” për në Lindje.

Duket se autori ka hyrë në trevat shqiptare nga Verilindja pasi thotë: **Terra est fortilis in Carnibus, Caseis et lacte; in pane et in vino non multum abundant** (Toka është e fuqishme në mish, djath dhe qumësht kurse në bukë dhe në verë nuk është shumë e bollshme).

Thekson se popullsia përbëhet nga barinj, duke nënvizuar tiparet primitive të jetës së tyre, flet për karakterin luftarak, duke pohuar se vendasit janë shigjetar e heshtëtar të mirë, me flokë bjond e me sy të kaltërt. Bën fjalë për qytetin e Durrësit, njeh princat e vendit si sundimtar të pavarur që nuk i nënshtrohen askujt; vetëm me vullnetin e tyre mund të mbahet Mbreti Anzhuin si kryezot i vendit.

Vepra ka interes për historinë mesjetare të trevave shqiptare.

Më 1322 dy Pelegrin (Udhëtarë) anglo-irlandez për në Vendet e Shenjta **Symon Semeonis** (Simon Simoni) dhe **Hugo Illuminator** (Hugo Ndrëqyesi) u ndalën në Shqipëri gjatë udhëtimit të tyre dhe i pari bëri një **Përshkrim** se çfarë pa në pikat e ndalimit: Pula, Zarë, Dubrovnik, Ulqin, Durrës, Korfuz. Përshkrimet e udhëtimit të Simonit, të njohura si **Itinerarium Symonis Semeonis ab Hibernia ad Terram Sanctam** (Udhëtimi i Simonit nga Irlanda në Tokën e Shenjtë), përveç të dhënave për çështje të ndryshme, shënojnë edhe këto: **Albanya est provincia inter Slavoniam et Romanyam per se linguam habens** (Shqipëria është një provincë midis Sllavonisë (sllavëve) dhe Romanisë (Bizantit) me një gjuhë të veten). Për qytetin e Durrësit ai shkruan: **Inhabitatur enim Latinus, grecis, judeis perfidis et barbaris Albanensibus** (Me të vërtetë ai është i banuar nga latinë, grekë, çifutë të pabesë dhe shqiptarë barbarë).

Në Dubrovnik ai vërejti se **In eadem dominantur Veneti et ad eam confluant Scavi, Barbari, Paterini et alii. Scismatici negatiatores qui sunt gestu, habitu et lingua latinis in omnibus difformes** (Venedikasit mbizotërojnë në të, ndërkohë e vizitojnë shpesh sllavët, barbarët, paterinët dhe tregtarët e tjerë përçarës, të

cilët ndryshojnë krejtësisht nga latinët në zakone, veshje dhe gjuhë).

Pak më vonë, më 1332, Arqipeshkvi i Tivarit **Gulielm Ade ose Adam** (Guillaume Adae ose Adam: 1270-1341), klerik francez, me prejardhje nga Provanca e Francës por që shërbeu në Tivar gjatë viteve 1324-1341, i quajtur gabimisht edhe murgu Brokardus, harton një **Relacion**, latinisht, dërguar Filipit VI Valua, mbret i Francës, me këtë titull: **Directorium ad passagium faciendum ad Terram sanctam** (Udhëzim për të bërë udhëtimin në Tokën e Shenjtë).

Kjo vepër ka rëndësi të madhe për kombin tonë sepse na jep dëshminë e parë që njihet gjer më sot për një traditë letrare në gjuhën shqipe, para shekullit XIV; në mes tjerash, ai shkruan: **Licet Albanenses aliam omnino linguama a latina habeant et diversam, tamen literam latinam habent it uso et in omnibus suis libris** (Sado që shqiptarët kanë një gjuhë krejt të ndryshme nga latinishtja, prapëseprapë ata kanë në përdorim dhe **në të gjitha librat e tyre** shkronjat latine (nënvizimi im, - Xh.G.).

Kjo dëshmon se shkrimi i gjuhës amtare ka një traditë mjaft të vjetër në Shqipëri dhe se shqipja ka qënë shkruar shumë herët me shkronja latine.

Vepra e lartëpërmendur ka vlera edhe për historinë e Shqipërisë Veriore të shekullit XIV sepse jep të dhëna për qytete të tilla si: Shkodra, Tivari, Ulqini, Drishti për disa Seli peshkopale dhe për popullsinë e tyre.


Kuptohet pra se do të ishte një ndërmarrje jo e plotë po ta nisnim historinë e shqipes vetëm me dokumentet e shkruara, sepse këto dokumente nuk paraqesin të vetmin burim për historinë e gjuhës.

Gurrë e gjallë për këtë qëllim është vetë gjuha shqipe me dialektet e saj, e cila ndihmon për zgjidhjen e problemeve të rëndësishme të gjenezës së popullit shqiptar.

Të dhënat e dialekteve të sotme të shqipes, ruajnë, ku më shumë

56480

17



e ku më pak, elemente fonetike, trajta morfologjike, ndërtime sintaksore, fjalë e frazeologjizma edhe më të lashta se ato që mund të ruajë më i vjetri dokument i shkruar.

Burim tjetër për historinë e gjuhës, për gjenezën e popullit, janë emrat e vendeve që janë quajtur “Fosilet e historisë”, emrat e personave, dokumentet historike, si edhe marrëdhëniet e huazimit.

———— * ————

Shqipja - bijë e ilirishtes, **shqiptarët** - bijtë e Ilirëve.

Ky fakt duhet kuptuar qart e mirë, të cilin e saktëson në mënyrë të mrekullueshëm. A. Buda në referatin e tij në Konferencën Kombëtare për Formimin e Popullit Shqiptar, të Gjuhës dhe të Kulturës së tij (1982) ku shkruan: “Nga etnosi ilir me atë shtrirjen e tij territoriale aq të gjërë nga Sava deri në Epir, një grup i këtij etnosi të madh - Ilirët e Jugut - filluan të dallohen si një bashkësi etnokulturore më vete, me tipare të përbashkëta - ata që në burimet e kohës cilësoheshin si “Ilirët e Mirëfilltë” (Illyrii proprie dicti).

Në këtë kohë Ilirët Jugorë u kristalizuan në një bashkësi etnike unitare, të përbërë prej një grupi fisesh me në krye Albanët në Shqipërinë Qëndrore”.

“Kjo bashkësi etnike - vijon prof. A. Buda - qëndroi kompakte, me tiparet e saj kryesore dalluese përtej antikitetit, edhe pse kaloi nëpër ndikimin gjuhësor - kulturor të Perandorisë Osmane dhe Bizantine, si edhe nëpër marrëdhëniet me fqinjët sllavë”.

Në rrënjët e saj të lashta, por me përmbajtje të re shoqërore, ajo vazhdoi në popullin e Arbërve mesjetar.

Këtu na duket me vend që të sjellim provat bindëse të Çabejt, Demirajt e të tjerëve për emërtimet: **Arbër/Arbën; Arbëresh/Arbënesh; Arbënor/ Arbëror; Arbëni/Arbëri; Arbërisht/Arbënisht; Shqip, Shqiptar, Shqipëri/Shqipni.**

Përgjithësisht emri i një gjuhe është i lidhur me emrin etnik të popullit që e flet atë, si edhe me emrin e vendit ku ajo flitet. Në shumë raste për emërtimin e gjuhës dhe të popullit përkatës për-

doret e njëjta fjalë, herë në funksion mbiemëror, herë në funksion emëror ose edhe në funksion ndajfoljor:

The english language (gjuha angleze), **the english** (anglishtja), **the english people** (populli anglez), **the english** (anglezët).

Gjuha shqipe ka ndjekur një rrugë disi të ndryshme; ajo dallon përdorimin ndajfoljor nga përdorimi mbiemëror; bile edhe në funksion emëror përdor zakonisht një temë të prejardhur që përmban prapashtesën - (i)sht, veçori kjo për ndajfoljet:

gjuha italiane - italisht - italishtja.

Në gjuhën shqipe kjo vlen edhe për dialektet dhe të folmet: **E folmja gege** (mbiemër) - **gegërisht** (ndajfolje) - **gegërishtja** (emër); **E folmja çame** - **çamërisht** - **çamërishtja** etj.

Në një fazë të hershme parashkrimore të shqipes emërtimi i këtij vendi dhe i këtij populli, si edhe i kësaj gjuhe është bërë me fjalët: **Arbër/Arbën, Arbëri/Arbëni, Arbërisht/Arbënisht, Arbëresh/Arbënesh, Arbërishtja/Arbënishtja.**

Të gjithë autorët e vjetër i përdorin këto fjalë.

Emri **Arbën/Arbër** është i gjallë edhe sot e gjithë ditën në tërë truallin e shqipes.

Fjala **Arbën/Arbër** është e lidhur me emrin e fisit ilir **Albanëve** (më saktë të Arbanëve), të cilët Ptolemeu i Aleksandrisë, në shekullin e dytë të erës së re, i përmend si fis me emrin **Albanoi** dhe me qytet **Albanopolis** (qytet i albanëve), diku në mes të Durrësit dhe Dibrës, që Hani, me të drejt e lokalizon me **Zgërdheshin** e sotëm në Juglindje të Krujës. **Pra u zhvillua nga një emër fisi a kra-hine në emër nacional të popullit.**

Për të shënuar banorin e dheut të Arbërit është krijuar prej kohësh fjala e prejardhur **Arbënesh, Arbëresh**, formuar me prapashtesën **-esh**, ndërsa për të emërtuar gjuhën është krijuar fjala **Arbënisht/Arbërisht**, me ndihmën e prapashtesës **isht**, sikurse ndajfoljet e tjera.

Emrat e vjetër janë ruajtur mirë në diasporën shqiptare, por edhe në vetë truallin e Shqipërisë, në disa vise të izoluara, në to-

ponomastikë dhe në disa përdorime të caktuara.

Ka rëndësi fakti se te fjalët **Arbën/Arbër**, vazhdon të rrojë i pashkëputur **Albanoi** i Ptolemeut.

Të mosshfaqurit e emrit gjatë periudhës nga Ptolemeu gjer në shekullin e X, shpjegohet me faktin se fiset shqiptare gjatë asaj kohe nuk kishin arritur në një formim shtetëror e përgjithësisht në një rëndësi politike të shënueshme - thekson E.Çabej.

Mundet që emri **Arbër/Arbën**, nga emër banori me kohë është shndërruar në një etnonim, duke shënuar kështu fisin e Arbërit dhe më vonë ka shënuar edhe trevat ku banonte fisi i Arbërit.

Është pohuar me të drejtë se etnonimi **Alban** ka qënë fjalë e prejardhur, e formuar nga fjala e parme **Alb** dhe nga prapashtesa trajtëformuese **-an**.

Edhe fjala **Arbën/Arbër** ka qënë dikur një fjalë e prejardhur, e formuar nga tema e hershme **Arb**.

Lind pyetja: Nga këto dy tema të hershme **Alb:Arb**, cila është primare, e parë?

Mendimi më bindës dhe më i pranuar ka qënë ai i Mayerit, Pedersenit dhe i Çabejt se primar, i parë ka qënë tema **Arb**.

E.Çabej trajtën **Arb** e ka çuar te një formë bazë **Arv** e kohës antike, të vjetër, me betacizëm **rv:rb**, sikurse te fjala **Corvum** e latinishtes që dha në shqip **korb**.

Betacizmi, ndërrimi **v:b** në grupin **rv**, konstatohet edhe në emra visesh antike të trevave në Veri të Shqipërisë.

Dijetari në fjalë trajtën **Arv** e afron me latinishten **arvum** "arë, tokë e punuar, fushë".

Në Kurbin shprehja **Mal e Arbën** me kuptimin **Mal e Fushë**, tregon se **Arbën** mund të ketë kuptimin e Rrafshit dhe të Fushës, të cilin e ka ruajtur që në vjetërsi, çka e përforcon dhe e vërteton fakti se me këtë kuptim përdoret në ato anë për Fushën midis Matit dhe Erzenit, bile gjer në Tiranë; edhe malësorët e Lezhës kur uleshin në këto fusha thonin: **Vemi në Arbni**.

Pra emri **Arbën/Arbër** ka qënë dikur një fjalë e prejardhur, e

formuar nga tema e hershme **Arb**, e cila nga ana e saj mund të jetë zhvilluar nga një trajtë më e vjetër **Arv**.

Trajtat **Arëbanas, Arbanas, Rabënë** (< Arbënë) janë përdorur nga sllavët që në shekullin e X dhe në këtë të fundit kemi një metatezë **ar>ra**.

Trajtat me rotacizëm **Arbërë, Arbëresh, Arbërisht** (që gjenden edhe te Arbëreshët e Italisë e të Greqisë) janë përfutur në viset jugore në një periudhë kur Rotacizmi, kjo dukuri fonetike e kthimit të **n^{si}** ndërzanore në **r**, karakteristikë e të folmeve të Shqipërisë Jugore, ishte akoma e gjallë, d.m.th, para shekullit VIII sepse në këtë shekull pothuajse ka pushuar se vepruari ky fenomen.

Te grekët në kohën Bizantine (aty nga shekulli X) del trajta **Arvanon** dhe **Arbanon**; sot **Arvanitas**.

Në gjuhën turke (në Turqi) del **Arnavut** (shqiptar), **Arnavutçe** (shqip), **Arnavutluk** (Shqipëri).

Në Dokumentet më të hershme në gjuhën latine emri i banorëve të këtij vendi dhe i Shqipërisë del me rrokjen mistore **Al** ose **Ar**: **Albanensis, Albanise, Arbaniam**.

Në shekullin e VII del **Albaniae**; më 1166 e gjejmë në trajtën **Albanensis**; më 1250 **Arbaniam**.

Emrat **Shqip, Shqiptar, Shqiptari, Shqipëri, Shqipni** janë të rinj sepse lindën dhe u përgjithësuan pas shpërnguljeve të Arbëreshëve në Greqi dhe Itali, d.m.th, në shekullin e XIV e XV, meqënëse atje ata njihen edhe sot e kësaj dite me emrin **Arbëresh**.

Zhdukja dhe zëvendësimi me emrin **shqip**, mbase ka lidhje me zbërthimet etnike që u kryen me ardhjen e osmanëve - thotë E.Çabej.

Fjalët **Shqip, Shqiptar, Shqipëri/Shqipni** janë krejt të reja; më së pari del fjala **shqip** te Buzuku në përdorim ndajfoljor:

që vjenë me thashunë shqip.

Te autorët e mëvonshëm shtohet përdorimi i tyre, por duke u përdorur prapë gjerësisht ndajfolja e prejardhur **Arbërisht/Arbënisht** e cila gjendet në të gjitha rastet te Arbëreshët e Greqisë

dhe të Italisë. Me kohë prapashtesa **-esh** (arbëresh) erdhi e u zëvendësua me prapashtesën **-tar**, duke iu shtuar temës **shqip** (shqiptar), prapashtesë shumë prodhimtare në gjuhën shqipe.

Me gjallërimin e fjalëve **Shqip, Shqiptar**, u hap rruga edhe për formimin e fjalëve të tjera, sipas modeleve ekzistuese, duke u formuar fjalët e prejardhura **Shqiptari, Shqipëri**, të cilat i zëvendësuan plotësisht fjalët e mëparshme **Arbër/Arbën, Arbëresh/Arbënesh**.

Realisht fjalët **Shqip, Shqiptar, Shqipëri/Shqipni**, prej nga ka dalë edhe **Shqipëroj**, mbeten me burim të pashpjegueshëm.

Mendimi që të ketë dalë fjala **Shqip** nga emri i shpendit **shqipe/shqype** nuk është pranuar, pasi edhe te autorët e vjetër shkruhen dallueshëm të dy fjalët: **Shqip** në këtë trajtë, ndërsa **Shqype**, emri i shpendit, çka tregon se kemi të bëjmë me dy fjalë të ndryshme.

Nuk ka gjetur mbështetje as mendimi i Falmerajerit, për të cilin do të flasim më poshtë, që fjalën **Shqiptar** e nxjerr nga fjala **shkëmb, shkëp, shkip** me prapashtesën **-tar** (shkiptar, shqiptar), çka do të thotë “banor i një vendi shkëmbor”.

I pabazë mbetet edhe shpjegimi tjetër i këtij emri prej greqishtes së re **Skipetto(n)** “pushkë, pushkatar” (e kjo prej italishtes Schiopetto), fjalë që dëshmohet për greqishten së pari në shekullin XVI-XVII.

E pabesueshme mbetet gjithashtu prejardhja e fjalës **shqip** nga latinishtja **excipio** “marr, pranoj, vë mënjanë”.

Edhe mendimi që emri **Shqiptar** të ketë ekzistuar në Shqipërinë Veriore që në shekullin e XIV e të ketë dalë nga një emër familjar të Drishtit afër Shkodrës me trajtat **Schivipudar, Schepudar, Schapudar, Schapuder** çka përmenden rreth viteve 1368-1402, në Arkivat e Raguzës, nuk është bindës.

Me sa duket fjala e parme **shqip**, në zanafillë (shumë vonë, bile edhe te Buzuku) ka pasur kuptim si diçka **qart, hapur, troç: Ma tha shqip, Po ta them shqip** (d.m.th: shkoqur, qart, hapur,

troç), çka nuk ndodh në gjuhët e tjera (francezi nuk i thotë dot francezit: **po ta them frëngjisht**; as italiani nuk i thotë në asnjë mënyrë italianit: **po ta them italisht**; as rusi, as anglezi, as gjermani, as një komb në gjuhën e vet, nuk e bën një gjë të tillë).

Nga fjalashqip, siç e theksuam, janë formuar fjalët e prejardhura **Shqiptar, Shqiptari, Shqipëri, Shqipëroj**.

Fjala **Shqiptar** del një herë te Kuvendi i Arbërit i vitit 1703; edhe H.Tunman në vitin 1774 e përmend fjalën **shqiptar** kur thotë: “**Albanët e quajnë vetën Scipatar.**”, çka tregon se në shekullin e XVIII fjala **Shqiptar** ishte në përdorim në truallin tonë, ndërsa fjala **Shqipëri** është krijim i mëvonshëm, mbase i fundit të shekullit XVIII ose i fillimit të shekullit XIX; ajo gjendet edhe te një vjershë e Hasan Zyko Kamberit.

Deri tani folëm për prejardhjen e **emrit** të këtij populli, të gjuhës dhe të vendit të tij, çka ishte e domosdoshme, por, para se të hyjmë në thelbin e çështjes sonë, në çështjen se pasardhës i kujt është ky popull, do të ishte mirë dhe me shumë interes që t’i hedhim një vështrim Ballkanit gjatë shekujve.

Emërtimi **Ballkan** është fjalë turke, e cila do të thotë **Male**.

Që në lashtësi, që në thellësitë e shekujve, kjo zonë ka qënë banuar, por në të herëpashere ka pasur edhe lëvizje të dhunshme ose paqësore popujsh me prejardhje të ndryshme.

Një përzierje popujsh, shumë herë shkrirje, por edhe mosp-ranime dhe largime, solli lindjen e sotme të Ballkanit. Megjithatë, popujt e Ballkanit janë bartës të një kulture mijëravjeçare, duke u formuar kështu edhe një strukturë solide njerëzore me disa tipare të veçanta për Gadishullin, në të cilin padyshim u shtua kontributi i ri i Pushtuesve ose edhe i Kolonëve të Epokës historike.

Dihet se në vitin 395 të erës sonë Perandori **Teodos** e ndau Perandorinë Romake në dy pjesë: **Lindje** dhe **Perëndim**, duke ua lënë trashëgim të dy bijëve të tij.

Gjithë Gadishulli i Ballkanit iu dha Lindjes, me Kryeqytet Konstandinopojën, me përjashtim të Dalmacisë iliriane, e cila i

mbeti Romës. Më vonë, më 16 korrik 1054 u ndanë edhe Kishat në **Dy**; pas kësaj date përballë Kishës latine me Papën e Romës, u formua një Kishë e Lindjes me Patriarkun e Konstandinopojës, brenda Perandorisë Bizantine, e quajtur kështu Perandoria e lindjes nga qyteti Bizant.

Kisha e Lindjes, e cila mbron ortodoksizmin, do të vazhdojë edhe gjatë gjithë kohës së Perandorisë turke me qendër në Stamboll.

Në vitin 476 të erës sonë Perandoria Romake e Perëndimit u shkatërrua plotësisht, sidomos nga dyndjet e Fiseve të Gotëve, Vandalëve, Hunëve etj, të cilat përshkuan edhe Ilirinë.

Në vitin 445 të erës sonë Atila, mbreti i Hunëve, mbloodhi të gjitha fiset e Hunëve nga Vollga deri në Danub (fise me prejardhje turanike) dhe mësyni gjithë Ballkanin dhe territore të tjera, duke vrarë e shkatërruar çdo gjë që i dilte përpara; u quajt **Shuplaka e Zotit**, aq shumë rrënime bëri.

Në vitin 453 Atila vdiq, i helmuar nga e shoqja **Idelkua** sepse i kishte vrarë e rrënuar fisin e saj.

Ballkanasit më të vjetër padyshim janë **Grekërit** dhe **Ilirro-Shiptarët**.

Grekërit lëvizën nga Veriu drejt Jugut, duke u vendosur ku janë sot, aty nga mesi i mijëvjeçarit të dytë para erës së re me ç' rast u përziën me Autoktonët e qytetëruar nga Kreta për të krijuar më vonë qytetërimin Mikenas (1600-1100 p.e.r) e më pas atë të Athinës klasike.

Patjetër edhe **Ilirët** e lashtë, për të cilët do të flasim më poshtë, zbritën rreth dy mijë vjet para erës së re nga Pellgu i Danubit në Brigjet e Adriatikut.

Rumunët e sotëm u referohen të parëve të tyre **Dakëve**, fis i popujve trakë.

Trakët, të cilët do t'i vështrojmë më tutje në kapitullin përkatës, ishin një popullsi e madhe në Lindje të ilirëve, të asimiluar nga popujt e tjerë të ardhur, sidomos nga sllavët.

Dakët, të romanizuar nga pushtimi romak që zgjati një shekull e gjysmë, nga Trajani deri te Aureliani (106-271 pas Krishtit), ruajtën një gjuhë të prejardhur nga latinishtja, por që ka pësuar një ndikim nga gotët e sidomos nga sllavët.

Degë e Rumunëve janë **Vllehët** të cilët e cilësojnë veten si Arumunë dhe gjenden me emra të ndryshëm: **Cincarë** në Greqinë e Veriut; **Vlleh** në Serbinë Lindore dhe në Bosnjë; **Morlakë** në bregdetin Dalmat dhe në Istria; **Çoban** te Shqiptarët.

Në fakt edhe këta, si rumunët, janë trakë të romanizuar, të cilët kurrë nuk patën shtet të tyre. Lidhja e tyre e vetme me Rumunët është arumunçja, një gjuhë e Degës latine që kufizohet në të folmet e barinjve.

Maqedonët e vjetër, me sa duket, përbënin një Etnitet të veçantë që më vonë u asimiluan plotësisht nga sllavët.

Sllavët - të prejardhur nga zona midis Oderit dhe Dhjeprit - kaluan Karpatët në drejtim të jugut që në shekullin e VI pas Krishtit, duke depërtuar gjatë Korridorit të Moravisë e të fushës së Moldavisë.

Në kohën e perandorëve bizantinë Justini i parë (sundoj: 518-527) dhe Justiniani (sundoj: 527-565), sllavët kaluan Danubin, duke vrarë e shkatërruar deri në Adriatik, në gjirin e Korintit e deri në bregdetin e Egjeut, duke sulmuar qytete e duke rrezikuar Salonën (afër Splitit) dhe Durrësin, e më pas tërhiqen përsëri në veri të Lumit.

Më vonë, të nënshtruar nga **Avarët**, të ardhur nga Altai të cilët kishin krijuar një Perandori në fushën e Panonisë (Hungari e sotme) u stepën duke u vendosur në territorin bizantin në numër gjithnjë e më të madh.

Në shekujt e mëvonshëm sllavët e shqetësuan së tepërmi deri në tronditje Perandorinë Bizantine, me valë të ngjeshura dhe të herëpasëherëshme, me ç' rast i mbytën Provincat që nga Istria deri në Peloponez dhe Kretë.

Në vitin 626 rrethuan pa sukses Bizantin, me ç' rast perandori

Herakliu (sundoi 610-641) i dërmoi plotësisht.

Më vonë formuan një Perandori të fuqishme (1166-1389), e cila u shkatërrua përfundimisht nga Osmanët.

Edhe sot tërë Gadishulli i Ballkanit ruan toponiminë e tyre, sepse, ndryshe nga zotërit e tyre Avarët, sllavët nuk u kufizuan vetëm në qytete, por pushtuan edhe fshatëra duke jetuar në to, pasi ishin bujq të mirë; ata punonin tokën në bashkësitë e tyre familjare, të grupuar në Klane e Fise.

Fiset sllave të Lindjes gjatë gjysmës së dytë të shekullit VII u nënshtruan nga një popull turanik, i afërt me Turqit - **Protobullgarët**, të cilët qenë aq të zotët sa e detyruan Bizantin që të njohë shtetin e tyre që në vitin 681.

Protobullgarët pushtuan provincën e vjetër të Mezisë (midis Danubit dhe vargmaleve Ballkan), të udhëhequr nga Khani Asparuk. Mezia ishte e banuar në këtë kohë nga sllavët.

Lindi kështu një shtet Bullgaro - Sllav, ashtu sikurse në Gali kishte lindur një shtet Franko - Galo - Romak.

Protobullgarët turanik përbënin një shtresë ushtarake aristokratike që mbretëronin mbi popullsi sllave. Por ishte kjo popullsi sllave, e cila brenda dy shekujve, i asimiloi pushtuesit, duke mbeetur vetëm emri i tyre që e mori populli (Bullgar) dhe vendi (Bullgari).

Në shekullin e IX Portobullgarët ishin sllavizuar.

Shënojmë se edhe disa fise sllave në Greqi që në shekullin e IX pësuan një helenizim fetar e kulturor, çka çoi në zhdukjen e tipareve të tyre origjinale.

Më vonë në zonën e Ballkanit, sikurse edhe në zona të tjera të Evropës Qëndrore dhe Lindore, u dukën edhe popullsi të tjera si: **Çerkezët** e Kaukazit në Moldavi; **Tartarët** e Krimesë që u vendosën në rrafshnaltën bullgare; **Peçenegët**, popull turanik; **Gaugazët**, pasardhës të Peçenegëve që u konvertuan në krishtërim e që mund të ndeshen rreth Varnës; **Komanët**, me prejardhje turanike, të cilët u dukën në Evropën Lindore në vitin 1077, me çç' rast

qëndruan edhe në Ballkan deri në vitin 1241, duke u shpërndarë në tërë Ballkanin (edhe në Shqipëri) e disa prej tyre duke ikur nga kishin ardhur, pasi qëndruan 150 vjet.

Nuk duhet lënë pa përmendur as **Armenët** që u përhapën edhe në Ballkan që nga shekulli XVI; **Ciganët**, endacakë të përjetshëm, të ardhur nga India që në shekullin XV; **Magjypët, Romët. Çifutët** në mes të cilëve Sefardimët e dëbuar nga Spanja në vitin 1492.

Turqit, të cilët pushtuan të gjithë Ballkanin që në shekullin e XIV, përbëjnë një tërësi popujsh aziatik, të bashkuar nga një gjuhë e grupit Uralo-Altaik.

Që në mijëvjeçarin e dytë para erës së re, si nomadë, u vendosën në territorin e sotëm të Mongolisë dhe të Turkestanit kinez; më vonë u diferencuan në tri Degë:

Mongolët - TungusMançurianët - Turqit.

Nga fundi i shekullit X të erës sonë, Turqit, pasi ishin konvertuar në myslimanë, të njohur nga emri i një eponimi **Selxhuk** (Eponim = që i jep emrin dikujt ose që e merr emrin nga dikush; p.sh, Athina mori emrin nga perëndesha Athinaja), ishin në bregun jugor të Detit të Aralit. Më vonë filloi Epoka e Selxhukëve të Mëdhenj (1055-1092), të cilët patën pushtuar Armeninë dhe terri-tore të tëra të Azisë së Vogël e të Bizantit.

Kronikat zyrtare shkojnë deri te një Sulejman, kryetar i fisit **Oguz** të Kajive, i cili qeveriste në shekullin e XII krahinën e vogël të Mahanit në veriperëndim të Persisë.

Shënojmë se fisi Oguz ishte një nga popujt turq, të cilët në shekullin X ishin nomadë në jug të Detit Aral prej nga e kishin prejardhjen edhe Selxhukasit, pra ishin një popullsi, një etnitet, por të ndarë në fise.

Sulejmani i shtyrë nga Mongolët, u tërhoq drejt perëndimit, por u mbyt në ujë, duke kaluar Eufратin. I biri i tij **Ertogruli** e udhëhoqi fisin drejt Rrafshnaltës së Anadollit.

Rreth vitit 1250 Ertogruli është titullar pranë Sogutit (rreth 237

km larg Stambollit, në rrugën për në Ankara).

Në vitin 1288 vdiq Ertogruli, por la tre djem; i treti **Osmani**, i lindur më 1258, mori pushtetin me ç'rast sundoi gjatë viteve 1288-1326.

Është Osmani që themeloi një Dinasti - **Dinastia e Osmanëve** - e cila do të vazhdojë deri në shekullin e XX.

Osmani kishte një djalë me emrin **Orhan** i cili, pas vdekjes së të atit, sundoi gjatë viteve 1326-1362. Është Orhani që mori **Brusën** dhe e bëri Kryeqytetin e parë të tyre; është Orhani që vendosi në Traki turkomanët e Anadollit rreth vitit 1356, për t'i penguar princërit e krishterë që të mos e dëbonin nga bregu perëndimor i Bosforit.

Kjo është ndërhyrja e parë e Osmanëve në Ballkan.

Pas vdekjes së Orhanit, biri i tij i dytë **Murati i parë** që mori titullin Sulltan (i gjithëpushtetshëm), i pari Sulltan osman, i cili sundoi gjatë viteve 1362-1389, e zhvendosi më 1365 Kryeqytetin nga Brusa në Adrianopojë, nga ku nisi pushtimin sistematik të Ballkanit. Është pushtuesi i parë i vërtetë i Ballkanit.

Në Betejën e Kosovës në qershor të vitit 1389 Aleatët ballkanik, të drejtuar nga princ **Llazari** i Serbisë, u thyen plotësisht nga ushtria turke me ç'rast mbeti vetë Sulltan Murati i parë i vrarë, nga dora e një **Millesh Obiliçi** për të cilin thuhet se ishte ose malazez ose shqiptar.

Edhe sot e kësaj dite gjendet tyrbja e Muratit të parë pranë Prishtinës, në vendin ku u vra.

Është kjo një nga Betejat e mëdha të historisë, ku mbetën të vrarë 10.000 nga njëra anë e 60.000 nga ana tjetër, duke i kthyer shifrat sipas burimeve osmane ose kristiane.

Me disfatën e Aleatëve në këtë betejë, nis pushtimi i vërtetë i Ballkanit.

Ishte **Mehmeti i dytë** që sundoi gjatë viteve 1451-1481, i cili u quajt Fatih (Fitimtari), ndër Sulltanët më të zotë që ka nxjerrë Turqia, ai që pushtoi në verën e vitit 1453 Konstandinopojën, kryeqy-

tetin Bizantin, duke i dhënë fund njëherë e mirë kësaj Perandorie të Lindjes, me ç' rast i dha emtrin **Stamboll** dhe e bëri Kryeqytet.

Është ky Sulltan që e thelloi edhe më tej futjen e turqve në Ballkan dhe pushtimin e plotë të tij, duke e mbajtur Ballkanin për shekuj nën pushtimin osman.

Më vonë rajone të tëra si Dobruzha, Brigjet e Danubit, Brigjet Bullgare, Maqedonia, të shpopulluara nga luftrat dhe epidemitë në një pjesë të madhe të tyre, gjithashtu u kolonizuan.

Patjetër të gjitha këto luftra dhe pushtime, të gjitha këto lëvizje popullore, kanë ndikuar edhe në jetën materiale, kulturore e gjuhësore të vetë popujve më të vjetër, vendas, autokton të ballkanit.

Pasi dhamë një pamje historike të shkurtër të Ballkanit gjatë shekujve, mund të fillojmë me problematikën tonë, me çështjen aq të rrahur në literaturën shkencore botërore se Shqiptarët e sotëm pasardhës të kujt janë.

Mendimi shkencor më i pranueshëm, më i gjërë, më i përhapur, më i shëndosh është ky:

Shqiptarët janë pasardhës të Ilirëve.

Lind pyetja tjetër: Kush janë Ilirët? Ku shtriheshin?. Ku banojnë ata?

Për kohën **prehistorike**, për periudhën e Bronxit, dijetarët mendojnë se Ilirët dalin një nga popujt e mëdhenj të Europës: zotërues të pjesës perëndimore të Ballkanit, banues të një pjese të Evropës Lindore dhe Qëndrore, banorë të brigjeve Lindore të Italisë, të disa trevave të Alpeve dhe mbase edhe të disa viseve të Evropës Perëndimore.

Në epokën **greko-romake** Ilirët kanë banuar në të gjithë trevën në Lindje të Adriatikut, veçse kufijtë e tyre etnik nuk dihen më saktësi.

Sipas gjeografit grek Straboni, ata shtriheshin që nga Istria e deri te kufijtë e Adriatikut me Detin Jonik. Në Lindje shkonin gjer te lumenjtë Vardar dhe Morava, ku takoheshin me Trakasit. por në ato anë ka pasur fise që disa autorë të vjetër i merrnin për ilirë e

disa për trakë.

Edhe më të pacaktuar kanë qënë kufijtë verior të Ilirëve. Me sa duket ata kanë zotëruar më të madhen pjesë të krahinave në Jug të Danubit si **Norikumin** në Austri, **Panoninë** në Austri dhe Hungari. Pra në kohën antike popullsia ilire përfshinte jugun e Austrisë, një pjesë të Hungarisë, Malin e Zi, territore të Bosnje-Hercegovinës, të Sllovenisë e të Kroacisë, Shqipërinë e sotme (me Kosovën), si edhe një pjesë të Greqisë Veriore.

Epiri me 13 fiset e tij, nga shumica e studiuesve me argumente shkencore mbetet me përbërje ilire, duke u futur kështu në Iliri.

Përsa u përket Ilirëve të Italisë, mbetet e dyshimtë në se **Venetët** e Italisë Verilindore kanë bërë pjesë në botën ilire apo jo. Disa dijetarë i konsiderojnë ilirë, kurse ca të tjerë ua mohojnë karakterin ilir. Përkundrazi **Mesapët** dhe **Japigët** e Apulisë në Italinë Jugore, nga mbishkrimet e tyre, shihet se bëjnë pjesë në botën ilire. Prandaj një përhapje kaq e madhe e Ilirëve dha shkas për lindjen e termit **Panilirizëm** që në gjysmën e dytë të shekullit XIX.

Me të drejtë dijetari i shquar Eqrem Çabej shtron pyetjen: Ç' duhet të kuptojmë me Ilirë dhe Ilirishte?; A njësi apo shumësi etnike?; A një popull ilir me fise të ndryshme, një gjuhë ilire me dialekte të saj apo popuj të ndryshëm që mbajnë këtë emër me më shumë e me më pak të drejtë?

Burimet antike nuk japin një përgjigje të prerë e të saktë.

I madhi Çabe mendon se tezat që përpiqen të vërtetojnë një **shumësi** popujsh në trevat ilire të kohës antike nuk arrijnë në shkallën e një argumentimi shkencor; pra, sipas tij, nuk kemi të bëjmë me popuj të ndryshëm, por me një popullsi, duke e vërtetuar me të dhëna gjuhësore, historike, etnografike dhe arkeologjike. Ai arrin në përfundimin lapidar të ekzistencës së **Elementeve të një Njësie përbrenda ndryshimeve territoriale**, të ekzistencës së **tipareve të përbashkëta**, sidomos në karakterin specifik të emërtimeve (toponimi, antroponimi, onomastikë).

Ilirët përbëheshin nga shumë fise që kurrë nuk u bashkuan në një shtet. Pushtimi romak ndodhi në shekullin e II-I para erës së re; më konkretisht në vitin 168 p.e.r.

Emri i përbashkët **Ilir** del në shekullin V p.e.r. si përgjithësim i emrit të një Fisi që banonte diku afër Durrësit, ku u krijua bërthama e parë e një shteti ilir.

Prej ilirishtes nuk kemi tekste të lidhura në formë mbishkrimesh, sikurse kemi për latinishten dhe greqishten e vjetër, por kemi të dhëna të thërmuara, të përbëra kryesisht nga emra vendesh, njerëzish, fisesh, banorësh, perëndish (rreth njëmijë) që përbëjnë një fond me vlerë në dobi të vërtetimit të vijimsisë së shqiptarëve nga ilirët dhe të shqipes nga ilirishtja.

Këtyre u shtohen edhe materialet e mesapishtes.

Pra kemi dy madhësi: shqipen dhe ilirishten që e njohim pak a shumë vetëm me anë të thërmijave që na kanë mbetur. Por për t'iu afruar zgjidhjes së problemit, për të provuar lidhjen, vijimsinë iliro-shqiptare mund të sillen edhe argumente të tjera.

Kështu, përveç argumenteve gjeografike, territoriale, fakti që populli shqiptar banon në një trevë që bën pjesë në vendbanimet e popullsisë ilire, si edhe dëshmisë së marrëdhënieve dhe përkimeve gjuhësore me greqishten e vjetër dhe latinishten, mund të theksohet edhe fakti tjetër se në asnjë nga burimet historike nuk flitet për ndonjë ardhje të shqiptarëve nga viset e tjera në vendbanimin e tyre të sotëm, siç mendojnë disa studiues.

Të gjitha faktet historike, gjuhësore dhe arkeologjike e kanë hedur poshtë këtë pretendim. Ja se çfarë shkruan kollosi i albanologjisë, shkencëtar i madh, burri i ndritur me të gjitha virtytet dhe vlerat njerëzore **Eqrem Çabej**: “Do të ishte një dukuri përjashtimore që një shpërngulje e ngulim i një populli të tërë, i kryer brenda sferës së botës romake e greke e në dritë të plotë të historisë, të ketë ndodhur pa u vënë re prej historianëve.”

“Mendimi se kemi të bëjmë aty me një popull barinjsh shtegtar, lëvizjet e të cilëve, si të tillë që ishin, nuk tërhoqën vëmendjen

e bashkëkohësve - nënvizon Çabej - nuk pajton me faktet historiko - kulturore e sociale konkrete. Gjuha e vendit na jep të tilla dëshmi për historinë e popullit që do të gjendemi më afër realitetit historik kur të pranojmë pranë barinjve edhe bujq që mësonin tokën, pranë fshatarëve edhe zejtarë. Që ka pasur një jetë qytetare mjafton të kujtojmë se ndikimi latin, nga dëshmitë e gjuhës ka pasur më fort një karakter urban (qytetar) se sa rural (fshatar)" - përfundon E.Çabej.

Edhe zbulimet arkeologjike kanë dhënë prova të pakontestueshme të vijimsisë etno-kulturore ilire në të gjitha trevat shqiptare.

Vetë Kultura e Komanit të çon te Ilirët. Aty nuk ka elementë të kulturës sllave apo të ndonjë kulture tjetër. Bartësit e saj janë arbërit mesjetar - pasardhësit e drejtëpërdrejtë të popullsisë së lashtë ilire.

Kultura e Komanit lulëzoi aty nga fundi i shekullit VI-VIII të erës së re, në një kohë kur kishte nisur të zhvillohej procesi i formimit të popullit shqiptar.

Duhet theksuar edhe fakti se lindja dhe zhvillimi i qyteteve ka qenë lidhur me popullsinë autoktone. Në këto qytete ka ekzistuar gjithmonë një shtresë e fuqishme etnike, e cila ka ushtruar një ndikim të fortë në të gjithë zhvillimin ekonomik e politik të vendit. Një varg qytetesh, monumentesh kulture, nekropolesh ruajnë dëshmi të vazhdimsisë së tipareve të popullsisë së lashtë ilire.

Sidomos studiuesit shqiptarë gjithnjë e kanë pasur parasysh atë mendimin e drejtë se në studimin e kulturës së banorëve autoktonë, duhej shkëputur nga ai mendim i gabuar që si "kulturë" njih vetëm atë të shtresave të larta, "kulturën perandorake" të trevave të Ilirisë.

Në Kulturën materiale po aq sa edhe në atë shpirtërore e artistike, në veshjet, ornamentet, vallet, muzikën, në institucionet e së drejtës popullore etj, - në të gjitha këto dallohet trashëgimi i vjetër ilir, i diferencuar dhe i mbushur me përmbajtje të re.

Le t'u sillemi tani fakteve gjuhësore.

Emrat e vendeve, më autoktonë, më të qëndrueshëm, e më të lidhur me hapësirën e me truallin se sa emrat e personave që janë më të lëvizshëm e më të ndikuar ndaj modës së kohëve, paraqesin një gjendje gjuhësore shumë të vjetër, të cilët ndihmojnë në rindërtimin e situatave të mëparme.

Në Shqipëri, sikurse në Gadishullin e Ballkanit në përgjithësi, si zonë e përshkuar gati kurdoherë prej luftërash, ngulimet fshatare janë jetëshkurtëra e, për rrjedhim, emrat e tyre nuk janë edhe aq të vjetër.

Në këtë vështrim marrin vlerë më të madhe emrat e qyteteve, lumenjve, maleve, të trevave që nga Raguza gjer në Çamëri, që nga Shtipi, Nishi, Shari, Shkupi e gjer në Brigjet e Adriatikut dhe Jonikut, të cilët dihen që nga koha antike dhe që, me trajtën që kanë sot në gjuhën shqipe, dëshmojnë për një Vijimsi ilire për një vazhdimsi të pandërprerë.

Këta emra paraqesin një zhvillim gjuhësor nga trajta e lashtë në të renë në pajtim me ligjet fonetike të shqipes dhe me një mënyrë të atillë që trajta e tyre e sotme nuk mund të shpjegohet veçse me mjetet e gjuhës shqipe. Ato tregojnë se kanë mbetur pa ndërprerje në gojën e shqiptarëve, në gojën e së njëjtës popullsi shqipfolëse që nga lashtësia.

Emra të tillë, që janë zhvilluar sipas ligjeve fonetike të shqipes, i gjejmë në të gjithë Trevat shqiptare: Në **Dardani** (Kosova e sotme) e në një pjesë të **Maqedonisë: Naissus - Nish, Scardus - Shar, Scupi - Shkup.**

Në **Shqipërinë Verilindore: Drinus - Dri, Mathis - Mat.**

Në **Shqipërinë Veriperëndimore: Scodra - Shkodër, Ulcinium - Ulqin, Lissus - Lesh, Lezhë.**

Në **Shqipëri të Mesme: Dyrrachium - Durrës, Isamnus - Ishëm, Scampis, Scampinus - Shkumbin, Albanoi - Arbër.**

Në **Shqipëri Jugore: Aulona - Valona - Vlona - Vlora, Thyamus - Çam, Çamëri.**

Në **Veri Qafa e Prushit**, në mes të Kukësit e Kosovës, është

vijim i emrit të **Pirustëve**, fis ilir që banonte në Mirditë dhe në Mat, pra lidhte **Dardanët** me **Pirustët**. Mbase emri mban përkthimin latin të emrit të Dardanëve: **Dard** (ilirisht) - **Dardhë**. **Pirus** (latinisht) - **Dardhë** (shqip); mbase administrata latine e përktheu emrin ilirisht **Dard** në gjuhën e tyre **Pirus** (dardhë).

Emri i një fshati sot në rrethin e Kukësit **Shikaj** mund të jetë vijim i emrit të një fisi ilir **Sículo** që gjendej, sipas Shuflajt, po në atë trevë.

Pastaj do shënuar, çka do ta shohim edhe më poshtë, se disa emra visesh e zonash ilire gjejnë shpjegim në leksikun e shqipes e në toponiminë e saj: **Delmatae, Delmatia** (Straboni e quan fushë dhënushqyes) është krahasuar me shqipen **Delme, Dele; Dardani** - vend Dardhash (**Dard** ilirisht - shqip Dardhë); **Ulcinium - Ulk, Ujk; Dimalum** (emri i një qyteti ilir të Partinëve që në botimet greke përmendet si Dimale), është krahasuar me shqipen **Di-Dy Male; Tergeste** (emri romak i Trieshtit) - është krahasuar me shqipen **Treg; Lugeon** (emri i një Ligate në Istria që përmend Straboni) - është përqasur me shqipen **Ligatë; Vendum** është afruar me shqipen **Vend**.

Në Dardani (Kosovë) përmenden kështjellat **Gurason, Gurbikon** si stacione në rrugën drejt Shkupit. Si rrënjë e përbashkët e tyre del fjala **Gurë**.

Edhe në emrat e personave, megjithë ndryshimet e mëdha që kanë ndodhur në antroponiminë e të gjitha vendeve, sidomos me përhapjen e krishtëritimit e të myslimanizmit, prapë analogjitë nuk mungojnë. Kështu **Bardus** është afruar me shqipen **Bardh; Bardylis** është krahasuar me shqipen **Bardhyl; Bato**, është përqasur me shqipen **Bato**, emër njeriu i përdorur edhe sot (Batushe ka në rrënjë fjalën Bato); **Dasius**, është krahasuar me shqipen **Dash; Teuta - Teuta; Marica - Marika**.

Për prejardhjen e shqipes nga ilirishtja, për të vërtetuar se gjuha shqipe është bijë e ilirishtes dhe shqiptarët bijë të ilirëve, ndihmojnë edhe disa fjalë që gjenden në dy gjuhët e vjetra klasike:

latinisht e greqisht, fjalë që nuk gjejnë shpjegim në atë gjuhë, por që gjuhësisht hyjnë në sistemin e ilirishtes dhe që shpjegohen me anë të gjuhës shqipe.

Kështu në latinisht **equas bardias** (kali mbarsë), pjesa e dytë **bardias** është shpjeguar me shqipen **mbarsë** “me barrë”; fjala latine **brisa** (me kuptim bërsi) është afruar me shqipen **bërsi** (mbe-turinat e farërave të disa perimeve dhe frutave).

Edhe në greqishten e vjetër ka disa fjalë që mbeten të pashpjegueshme me mjetet e asaj gjuhe, por që gjejnë shpjegimin e tyre në gjuhën shqipe.

E.Çabej fjalën **diza** (me kuptim dhi) e afron me shqipen **dhiz-keç**, por edhe **dhi**; **laros**, në greqishten e vjetër **pulëbardhë** e lidh me shqipen **larë-a** (njollë e bardhë mbi lëkurë të shtazës); **rhinos** është afruar me shqipen **re**.

Huazimet latine e greke të shqipes, me karakterin e tyre arkaik, tregojnë se kanë hyrë, depërtuar herët në këtë gjuhë, fakt që pro-von praninë e shqiptarëve që në lashtësi në vendin e tyre të sotëm. Ato kanë shkuar plotësisht në hullinë e ligjeve fonetike të shqipes; latinisht **castellum - kështjellë** (shqip); **piscis** (latinisht) - **peshk** (shqip); **publica** (latinisht) - **Pukë** (shqip).

I madhi Çabe theksonte se elementët greke e latine në gjuhën shqipe tregojnë se historia e vjetër e saj është zhvilluar në sferën e pandërmjetme të rrethit kulturor greko-romak e të ndikimit gjuhësor të tij.

Nuk mund të lihet mënjane këtu edhe qenia e një terminologjie të vjetër detare, vendase në lundrim dhe në peshkim, si edhe emërtime vendase në florë dha faunë çka dëshmojnë për banimin e shqiptarëve që në kohët më të vjetra qoftë në bregdet, qoftë në thellësi të vendit: **det**, **va**, **gji**, **grykë**, (deti), **shkulm**, **anije** (e cila shkon me **anë**, **enë**; shumësi i emrit **enë** është **anë**), **pëlhurë** e shumë emra **peshqish**.

Edhe emri i **Albanoi-ve** antik, i përmendur nga Plotemeu në shekullin e dytë të erës sonë, për të cilin folëm edhe më lart, rron

edhe sot si emër nacional i popullit dhe i vendit në truall të shqipes e në ngulimet shqiptare: në Itali e Greqi, çka përforcon faktin se jemi pasardhësit e ilirëve.

Argumenti gjuhësor më i sigurtë do të ishte një krahasim i gjith-anshëm i sistemit të shqipes me atë të ilirishtes, por që për mungesë të dhënash nga ana ilire nuk mund të kryhet ashtu siç duhet. Megjithatë me thërmijat që na kanë mbetur, prapë mund të veprojmë. Kështu në fleksionin e emrit, në lakimin e tij, mbaresa me trajtën dyfishe **a, i**, që është element i shquarësisë (ara, mali) është shumë e vjetër sepse na shfaqet në emra të lashtë ilir: **Scodra**, **Scupi**, fakt që tregon vijimsi.

Përkime në mes të ilirishtes dhe shqipes, dëshmi se shqipja është bijë e ilirishtes ka edhe në Fjalëformim, sidomos në prapash-tësim.

M.Domi i ka kushtuar një studim të mirë kësaj çështjeje. Prapashtesa ilire -**inium** që formonte emra vendesh (Ulcinium, Delminium), i përgjigjet nga ana e shqipes -**inj** në shumësin e disa emrave (kopshtij, kërmij). Prapashtesa ilire **este, esta**, që tregon vend (Tergeste) është afruar me prapashtesën shqipe (**ë**)sht (kopsht, vnesht, vresht).

Me prapashtesën ilire -**onia** në disa emra njerëzish (Lassonia, Mallonia), është afruar prapashtesa e sotme shqipe **onj** (ulkonjë, shqiponjë). Prapashtesa e sotme -**ik** (jetik, korrik) është shikuar si vijim i prapashtesës ilire -**ica** (ika) në emra personash dhe vendesh (Ditica, Cardica). Po kështu ka paralelizëm në mes emrave ilirë të vendeve me prapashtesën -**ia** (Dalmatia, Bantia) dhe shtresës më të vjetër të emrave me -**i** që gjenden sot në gjuhën shqipe (Arbëri, Gegëri, Toskëri, Labëri).

Ka edhe dhjetëra prapashtesa të tjera që tregojnë se në Fjalëformim midis ilirishtes dhe shqipes ka përkime e paralelizma të shumta në mënyrat, mjetet e formimit, si edhe në zhvillimet kuptimore.

Këto fakte përforcojnë argumentet historike dhe arkeologjike

që mbështesin tezën e prejardhjes ilire të popullit shqiptar.

Shumë djersë është derdhur edhe për deshifrimin e **mesapish-tes**.

Mesapët qenë fise ilire që patën kaluar Adriatikon dhe qenë vendosur në Bregdetin e Përtejme, kryesisht në Italinë Jugore.

Nga mesapishtja kemi rreth treqind mbishkrime, të cilat i përkasin mesit të mijëvjeçarit të fundit para erës së re. Ato janë mbledhur, sistemuar dhe botuar nga dijetarë të njohur. **Fr.Ribezo** (1875-1952), gjuhëtar italian, në vitin 1907 në studimin **La lingua degli antichi mesapii** (Gjuha e mesapëve të vjetër), i mbledhi mbishkrimet mesape në veprën *Corpus inscriptionum messapicarum*.

Studiuesi amerikan **Joshua Uotmau** (Whatmough), në vitin 1933, i botoi mbishkrimet ilire të Italisë: **Pre-italic dialects of Italy** (Dialektet para italike të Italisë).

O.Has, dijetar gjerman, në vitin 1960 botoi **Le iscrizione messapiche** (Mbishkrime mesapike).

J.Unterman më 1964 botoi **Die messapischen Personennamen** (Emrat mesap të personave).

Karlo de Simone, gjuhëtar italian, ka botuar **Die messapischen Inschriften** (Mbishkrimet mesape).

Të gjitha Mbishkrimet mesapike janë shkruar me një alfabet të veçantë që rrjedh nga alfabeti grek, por dëshifrimi i tyre, megjithë përpjekjet e mëdha të shumë dijetarëve, nuk ka qënë i kënaqshëm.

Janë vënë në dukje elemente të përbashkëta të mesapishtes dhe të ilirishtes, duke u përqasur me shqipen e sotme. Kështu u krahasuan fjalët mesape **aram**, **bilja**, me fjalët shqipe **arë**, **bijë** (bilë). Po kështu edhe emra njerëzish: **Dassius** (ilirisht), **Dazimas** (mesapisht), **Dash** (shqip).

Pra dëshmitë gjuhësore vërtetojnë se kombi shqiptar dhe gjuha e tij janë formuar në territorin e sotëm, në brigjet e Detit Adriatik dhe të Detit Jon.

Dardania (Kosova e sotme) bashkë në viset kufitare të Maqedonisë bëjnë pjesë në territorin e formimit të shqipes. Këtë të vërtetë

e përforcojnë emrat e vendeve që rrjedhin nga koha greko-romake, që një krahasim i trajtave të tyre të kryhershme me trajtat e vendit që janë sot në përdorim, tregon, siç u shtjellua më lart, një zhvillim në harmoni të plotë me rregullat e zhvillimit fonetik të shqipes dhe që e lidhin qart këtë vatrë formimi etnogjenetik me Bregdetin.

Gjuha shqipe, doli fitimtare në ndeshjen e fortë dhe të gjatë me latinishten.

Ajo ruajti mirë veçoritë e veta dhe individualitetin e saj, por në të hynë mjaft elemente leksikore latine (gështenjë, qen, pulë, qepë). Mosdepërtimi i latinishtes në Strukturën gramatikore të shqipes, ruajtja prej kësaj e origjinalitetit të një gjuhe të mëvetësishëm indoeuropjan, hedhin poshtë mendimin pa baza shkencore se Ilirët u romanizuan tërësisht.

Si përfundim mund të pohojmë se vetë analiza e trashëgimit të lashtë të leksikut të shqipes dhe të elementëve të saj, të huazuara nga latinishtja dhe greqishtja e vjetër, së bashku me të dhënat e rëndësishme të arkeologjisë, të historisë, të paleoetnografisë, tregojnë se kemi të bëjmë me një popullsi ab antique (që në lashtësi) në një mjedis urban që bën një jetë të zhvilluar qytetare, zejtare dhe bujqësore-blegtorale.

Dija e sotme e ka vërtetuar autoktoninë e popullit shqiptar që nga antikiteti, prejardhjen e tij përgjithësisht nga Ilirët në trojet e sotme dhe të gjuhës shqipe përgjithësisht nga ilirishtja.

Që në gjysmën e dytë të shekullit XIX lindi një hipotezë tjetër, sipas së cilës Shqiptarët janë pasardhës të **Trakasve** të vjetër dhe shqipja bijë e **trakishtes**, e përkrahur siç do ta shtjellojmë edhe më poshtë në vendet përkatëse, nga K.Paul, H.Hirt, H.Bariç, G.Vajgand, D.Deçev, V.Georgiev etj.

Trakasit ishin një popull i madh, të cilët kurrë nuk u bashkuan në një njësi të vetme politike, ashtu siç nuk u bashkuan as Ilirët. Edhe trakasit përbëheshin nga disa fise: Dakët, Getët, Mizët, Besët, Karpët, Peonët etj.

Ata shtriheshin prej Karpatëve e deri në Detin Egje, prej Vard-

arit e Moravës e deri në Detin e Zi.

Kishin Ilirët në Perëndim, Grekët në jug, Iranasit në Lindje, kurse Keltët, Baltët, Sllavët dhe popujt gjermanik në Veri.

Disa fise trake dhe ilire, siç duket, përziheshin, bile autorë grekë të vjetërsisë ca fise si Dardanët, Peonët (në Maqedoninë e sotme), Tribalët (në Bullgarinë e sotme), Istrët herë i emërtojnë ilirë e herë trakas.

Pra, siç rezulton, përzierje fisesh ilire e trake ka pasur në lash-tësi, se shumë fise shkëmbeheshin njëri me tjetrin sa edhe përziheshin, se elemente trakas arrinin deri në brigjet e Detit Adriatik, se vetëvetiu lind pyetja a kemi shtegtim fisesh trake për në Perëndim në trevat e Adriatikut a me shpërngulje fisesh ilire deri në Traki apo trakishtja dhe ilirishtja kanë qenë gjuhë mjaftë të afërta.

Trakasit, në të vërtetë, banonin në Bullgarinë dhe në Rumaninë e sotme. Por **trakasit** e vërtetë, të mirëfilltë jetonin në jug të Danubit, ndërsa në Veri të këtij lumi banonin Mizët dhe më në Veri, në pjesën Lindore të Rumanisë ishin Getët e në Perëndim të tyre jetonin Dakët.

Disa dijetarë mendojnë se të gjithë ishin trakas, ndërsa studiues të tjerë Dakët, Getët, Mizët i trajtojnë si Etnos tjetër, duke menduar se flisnin gjuhë tjetër.

Edhe **Frigasit**, të cilët në kohën greko-romake banonin në pjesën Veriperëndimore të Azisë së Vogël, nga mbeturinat gjuhësore që kanë mbetur, mund të vështrohen si degë e kombësisë trake. Ata kaluan prej Evropë në Azi aty nga shekulli VIII pra erës së re, duke i dhënë fund mbretërisë **Hetite**.

Ndoshta Frigas kanë qenë Trojanët e Iliadës së Homerit dhe Lufta Trojane një luftë midis Frigasve dhe Fiseve greke.

Që në shekullin e kaluar u vu re se disa fjalë nga gjuha trake, të dokumentuara mirë historikisht, gjejnë shpjegim me shqipen.

Nga trakishtja kemi disa Mbishkrime, të zbuluara kryesisht në Bullgari, të cilat janë shkruar me alfabetin grek. Ato lexohen mirë, por nuk përkthehen, sepse janë gjuhë e panjohur dhe se janë Scrip-

tio Continua (shkrim i vazhduar, i pashkëputur, nuk ndahen fjalët njëra nga tjetra).

Nga trakishtja, përveç një sasi emrash visesh e personash, kemi edhe disa emra bimësh mjekësore që i mblodhi në shekullin e parë të erës së re mjeku grek Dioskorides te Fisi i Dakëve. Vepra që paraqet gjendjen e sotme më të mirë të dijes në këtë fushë është libri i D.Deçev-it: **Die thrakischen Sprachreste** - 1957 (Mbeturit nat e gjuhës Trake).

Që në shekullin e kaluar A.Poti vuri re se fjala trake, **mantia**, **manteia** “ferrëmanzë” afrohet me shqipen **man**. Është për t’u theksuar se në disa të folme të Moravës (Gilan) edhe sot e gjithë ditën shqiptohet **amantia** fruti i manit.

W.Tomashek në veprën **Die alten thraker** (Trakasit e vjetër), botuar në vitin 1893-4, fjalën **amalusta** “kamomil” të trakishtes, të mbledhur nga Dioskorides, e lidhi me shqipen **i ëmbël**; po kështu ky dijetar fjalën trakishte **skiare** “gjëmbaç”, e afroi me shqipen **shkjerr**, **shqerr** “shqyej” dhe fjalën **pinon** (në trakisht **pije**) e krahasoi me shqipen **pije**; greqishte e vjetër **pino**, sllavisht **piti**.

Fjala **Mal** piqet me ilirishten Dimalum (dy male) por piqet edhe me trakishten **Maluensis**, pasi na del emri i provincës romake **Daccia Maluensis** në brigjet e Detit të Zi në kohën e perandorit Mark Aurelit. Më vonë në kohën e perandorit Dioklecian, **Maluensis**, u përkthye në latinisht **Daccia Ripensis** çka tregon se fjala trakisht **Maluensis** (mal) ka pasur kuptimin e fjalës latine **Ripa** “breg, anë lumi, deti”.

Ky kuptim ruhet edhe sot në rumanisht në vendin e Dakëve (Trakëve), pasi **Mal** në rumanisht do të thotë: breg, anë lumi. Emrat e qyteteve trake na dalin si kompozita me pjesën e dytë **dava**, **deva**, **para**, ku **dava**, **deva**, ka pasur kuptimin **kështjellë**, **qytezë**, ndërsa **para**, mendohet se ka pasur kuptimin: **vend**, **kalim**, **va**.

Ndeshen në ato anë: **Besapara**, **Drizupara**, **Thermidava**, **Buridava**.

Kështu në fjalët **Besapara**, **Drizupara** pjesët paraprijëse janë

afruar me fjalët e shqipes **besë, drizë, pra vendi i besëve, “fis trak”, vend drizash** “vend kaçubesh”.

M. Vasmer fisin trak **Buroi**, me qytezën **Buridava** dhe emrin e njeriut **Buris** - të gjitha i afroi me shqipen **Burrë**; po kështu edhe emrin e burrave ndër trakas **Drenis** e krahasoi me shqipen **Dre**.

Emra njerëzish nga emrat e kafshëve janë të shpeshtë ndër shqiptarët.

Është shpjeguar edhe emri i një mbreti trakas **Burebista** “bur-rë bisht, burrë i vogël”, me shqipen **burrë** dhe **bisht**, si edhe mbreti tjetër **Decebalus** “Dakiball, balli i Dakëve” me fjalën shqipe **ballë**.

Vasmeri dhe emrin e **Karpateve** (te Ptolemeu Karpates oros “mali Karpat”) e afroi me shqipen **Karpë** “shkrep, shkëmb”.

Me emrin e **Karpateve** shkon edhe emri i fisit trak **Karpai** e, në anën tjetër, - shton E.Çabej - edhe emri i ishullit **Karpathos** në detin Egje.

Kështu historiani me famë evropiane H.Tunman, për të cilin do të flasim në këtë vepër në vendin përkatës, që në shekullin e XVIII, arrin në përfundimin gjenial se “Ilirët e Trakasit kanë qenë vërtetë dy popuj të ndryshëm se të tillë i bien edhe autorët e vjetër, por kanë qenë edhe afër njëri me tjetrin, sa edhe fiset e tyre shkëmbeshin, sa edhe janë përzier njëri me tjetrin, se **shqiptarët janë pasardhësit e Ilirëve, por në formimin e tyre ka edhe komponent trak** (nënvizimi im - Xh.G.).

Një mendim ky gjenial, me të cilin bashkohet edhe autori i këtyre radhëve.

Kolloso ynë i Albanologjisë Eqrem Çabej konkludon se “Kur të merren parasysh më tej edhe huazimet e lashta prej iranishtes, si edhe takimet e moçme me disa nga gjuhët Finoungrike dhe të peshohen më anë tjetër që dy Vargmalet e Evropës Qëndrore - Lindore, Karpitet dhe Beskidët, gjejnë shpjegimin e emërimit të tyre me anë të shqipes dhe vetëm me të, ndër gjithë gjuhët e gjalla indoeuropjane (Karpë “shkrep, shkëmb, Beskide “bjeshkë” - kjo e

fundit me diftongim më vonë të e-^{sc} në ie), atëherë nuk do të shkelet, mendojmë, në dërrasë të kalbët, po të thuhet që Djepi i shkallës parabolkanike të shqipes në periodën evropiane të gjuhëve indoeuropiane ka qënë në një zonë diku në Veri të Gadishullit të Ballkanit”.

Më vonë, në shekullin e XX, lindi teza **Iliro-Trake** e prejardhjes së gjuhës dhe e popullit shqiptar, me përfaqësues kryesisht **N.Joklin** dhe me pasues Vasmer, Ribezzo, Taliavin, Paç, Nopça etj, për çka do të flasim në kapitujt përkatës.

* ————— *

Si çdo gjuhë tjetër edhe shqipja nuk ka dalë nga shkalla e përparme e saj si një madhësi e kryer dhe statike. Tiparet e strukturës së saj që e kanë bërë atë që është sot, sigurisht nuk u përfatuan të gjitha njëkohësisht, por në kohë të ndryshme.

Faza e kalimit nga ilirishtja në shqipe dhe e “ngjizjes” së shqipes së hershme, është faza e parë e karakterizuar nga ndeshja e Ilirishtes me Latinishten, ku Ilirishtja doli fitimtare si gjuhë e mëvetësishme, me strukturën e saj gramatikore si vijim i strukturës së mëparëshme.

Kjo fazë fillon që në shekullin e parë të erës sonë e shkon gjer në shekullin e shtatë. Patjetër në të u integruan një shumicë fjalësh latine si: **qen, pulë, furk, pyll, qepë, qiell, gështenjë, limë, luftë, ndrikull, mik, kullostën, vaj, ulli, shpatull, mur, lepur, mashkull, femër**. Më pas gjuha shqipe u formua nëpërmjet evolucionit gradual të “nënës” saj, Ilirishtes, d.m.th., të një a disa dialekteve të Ilirishtes së Jugut (Illyrii proprie dicti “Ilirët e mirëfilltë”).

Është fjala për shndërrime të tilla që kanë shënuar kalimin përfundimtar nga një gjendje gjuhësore në një gjendje gjuhësore të re, ashtu siç ndodhi me **latinishten vulgare** në gjuhët romane, me **gotishten e vjetër** në gjuhët gjermanike, me **sllavishten e vjetër** në gjuhët sllave.

Si tipare thelbësore të sistemit të gjuhës shqipe, të cilat e përcaktojnë cilësisht atë dhe që janë një zhvillim i brendshëm i saj,

por që nuk janë trashëguar nga një fazë e hershme indoeuropiane, sepse janë zhvillime të reja e ndonjë prej tyre është përfutur nga evolucioni i elementeve të trashëguara prej nënës saj, Ilirishtes, Sh.Demiraj, në mes të tjerash, përmend: Ngulitja e theksit në një rrokje të caktuar të temës, Metafonia. Riorganizimi i sistemit të mbaresave. Zhvillimi i sistemit nyjor. Riorganizimi i lakimit emëror me krijimin e lakimit binar (i shquar - i pashquar). Dobësimi i gjinisë asnjane. Krijimi i temës së shumësit dhe i formanteve kryesore të këtij numri. Krijimi i dy klasave mbiemrash (të nyjshëm dhe të panyjshëm). Prapavendosja e përcaktorëve të pavetëmjaftueshëm. Riorganizimi i zgjedhimit të foljeve. Përzjerja e së kryerës së herëshme sintetike me aoristin. Krijimi i së kryerës analitike të tipit **kam punuar** etj.

Nga pikëpamja tipologjike, gjuha shqipe, si rrjedhim i evolucionit të saj historik, sikurse edhe gjuhët e tjera indoeuropiane, është **Gjuhë Sintetike - Analitike**, duke u larguar kështu nga tipi i hershëm indoeuropiane. Në një fazë të hershme gjuhët indoeuropiane kanë qënë Sintetike, d.m.th., kuptimet Gramatikore dhe lidhjet Sintaksore midis gjymtyrëve të fjalisë shpreheshin me anë formash gramatikore sintetike të cilat ndërtoheshin me anë të mbaresave (rasore ose vetore), me anë të ndërrimeve morfologjike dhe me supletivizëm.

Me zhvillimin e pandërprerë të shoqërisë njerëzore, format e lartpërmendura sintetike erdhën e u bënë gjithnjë e më të pamjaftueshme për të shprehur lidhjet sintaksore midis gjymtyrëve të fjalive që gjithnjë bëhen më të ndërlikuara. Prandaj u krijuan në gjuhët indoeuropiane (po ashtu edhe në shqipen) Fjalët shërbyese (parafjalë, lidhëza), forma gramatikore analitike, bile edhe në sistemin foljor (do të bëj, kam bërë) etj.

Gjuha shqipe sot ka një sistem fonologjik origjinal, të përbërë prej shtatë fonemash zanore dhe 29 fonema bashtingëllore, ka një sistem të larmishëm formash gramatikore, ruan mirë sistemin rasor (pesë rasa), ka sistem tri gjinish (maskullore, femërore, as-

janëse - kjo e fundit është rudhur në një grup të kufizuar emrash); sistemi emëror ka trajtën i shquar - i pashquar, ka nyje të përparme; sistemi foljor dhe emëror njih fleksionin e brendshëm (dal-del, dash-desh), ka dy tipa strukturorë mbiemrash (të nyjshëm e të panyjshëm); te numërorët, krahas sistemit **decimal** (dhjetë, tridhjetë), bashkëjeton edhe sistemi **vigesimal** (njëzetë, dyzetë); sistemi foljor ka një larmi formash mënyrore e kohore; koha e ardhshme është e ndërtuar në mënyrën analitike me dy forma: **do+lidhore, kam+paskajore**.

———— * ————

Një fazë e re nis me ndeshjen e **shqipes** me **sllavishten**. Në shekullin e VII në Ballkan dynden sllavët të cilët zënë vend në Shqipëri.

Sundimi politik - ushtarak sllav për periudha të gjata, presioni i gjuhëve sllave si gjuhë shtetërore, bënë që të krijohet një toponimi sllave dhe të depërtojnë në gjuhën shqipe një shtresë fjalësh sllave, duke lindur kështu një varg huazimesh sllave në përbërjen e saj leksikore. Që nga ajo kohë ka mbetur toponimia sllave, krahas së cilës shpesh herë gjendet edhe toponimia vendase:

Dobrovoda - Ujëmirë

Zagoria - Tejmali

Zadrima - Përtejdrini etj.

Në fund të fazës së dytë (shek XI) gjuha shqipe është tipar dallues i një njësie etnike jo të vogël; i shërben tani si mjet shprehjeje një kombësie - kombësie shqiptare.

Në shekullin e XII shqiptarët do ta kenë edhe shtetin e tyre - shtetin e Arbërit, që shënon një etapë të re në historinë e popullit tonë.

Në fazën e dytë të zhvillimit të gjuhës shqipe pushojnë së vepruari disa ligje fonetike të vjetër si: rotacizmi (kthimi i bashkëtingëllores ndërzanore **n** në **r**: **vena - vera, zāni - zëri**), nazalizmi (hundësia) - veçori e gegërishtes (**nāna - nëna,**

hāna - hēna). Por më të vjetrat huazime sllave i janë nënshtruar

ar edhe rotacizmit edhe nazalizmit.

Gjuha shqipe, si gjuhë indoeuropiane, është një gjuhë ballkanike sepse në bashkëjetesën e gjatë të shqiptarëve me të tjerë popuj të Gadishullit Ballkanik, shqipja zhvilloi bashkë me gjuhët e këtyre popujve, disa tipare të reja e të përbashkëta të rendit Ballkanik.

Nga këto dukuri të përbashkëta, të cilët quhen **Ballkanizma** ose **Afri gjuhësore ballkanike**, ndër kryesoret do të përmendim:

1. Prapavendosja e nyjes shquese: **shqip, rumanisht, bullgarisht, maqedonisht**

2. Formimi i kohës së ardhme me ndihmën e foljes **dua: shqip, greqisht, bullgarisht, maqedonisht, rumanisht, serbokroatisht.**

3. Njësimi formal i rasave gjinore e dhanore: **shqip, rumanisht, greqisht.**

4. Zëvendësimi i paskajores nga lidhorja: **shqip, greqisht, bullgarisht, maqedonisht, rumanisht** e pjesërisht **serbokroatisht.**

5. Rimarrja e kundrinave me anë të formave të patheksuara të përremrave vetorë: **shqip, rumanisht, maqedonisht, bullgarisht, dhe greqisht.**

Ballkanizma ndeshen edhe në Fjalorë dhe në shprehje frazeologjike; ato nuk kanë të njëjtën përhapje në gjuhët e Gadishullit Ballkanik.

Në këto Ballkanizma ka edhe ndonjë dukuri që ndeshet edhe jashtë Ballkanit, të cilat, në të vërtetë janë zhvillime paralele krejt të pavarura e të rastësishme. Prapavendosja e nyjes shquese, p.sh., në gjuhët e Ballkanit dhe në gjuhët Skandinave. Formimi i kohës së ardhshme me foljen ndihmëse **dua** në gjuhët e Ballkanit dhe në anglisht s'kanë asnjë lidhje, as historike, as gjenetike.

Në formimin dhe zhvillimin e mëtejshëm të afrisë së gjuhëve ballkanike, shqipja zë një vend të rëndësishëm sepse, sikurse thekson kollosi i Albanologjisë E.Çabej, ajo është një nga gjuhët më të lashta të Ballkanit, e cila që prej shekujsh ka pasur shkëmbime me gjuhët fqinje, se trualli gjuhësor i shqipes ka qënë më i madh nga ç'është sot, çka na çon të pranojmë që këto lidhje gjuhësore dikur

kanë qënë shtrirë edhe më tej, se shtegtimet dhe ngulimet e shqiptarëve në viset fqinjë kanë çuar te popujt përreth edhe të tjera elemente të gjuhës.

Në afrinë e gjuhëve ballkanike kanë ndihmuar disa rrethana të caktuara të karakterit historik e gjeografik.

Në pikëpamje **historike** përhapja e Ilirëve nga Perëndimi gjer në Lindje të Gadishullit dhe përhapja e Trakasve nga Lindja gjer në Perëndim, pati sjellë qysh në kohët e lashta të antikitetit një farë rrafshimi të ndryshimeve nacionale. Këtë proces njësimi e plotësoi më vonë shtrirja e kulturës dhe e gjuhës greke nëpër gjithë Bregdetin e në pjesën Jugore të kësaj treve.

Më vonë sundimi romak, me përhapjen e latinishtes si gjuhë zyrtare dhe në kohë të mesme sundimi i gjatë i Bizantit, me kulturën e tij gjysmë orientale e me gjuhën e kishën greke, ndihmuan në formimin e **Njësisë ballkanike**.

Edhe vendosja e sllavëve e më vonë dyndja e osmanëve shtuan disa veçori të përbashkëta të popujve ballkanike e të gjuhëve të tyre.

Në pikëpamje **gjeografike** duhet theksuar se në këtë trevë kanë banuar qëmoti një tok gjuhësh në një territor relativisht të ngushtë: dy gjuhë indoeuropiane më vete (shqipja dhe greqishtja), pastaj gjuhët sllave: bullgarisht, serbokroatisht (me sllovenishten), maqedonisht, një gjuhë romane (rumanishtja me degëzimet e saj) dhe një gjuhë joindoeuropiane (turqishtja).

Këto gjuhë, para se të piqeshin në këtë trevë, nuk ishin aq të afërta midis tyre sa janë sot, bile turqishtja nuk kishte asnjë lidhje afrie me gjuhët që ndeshi në këtë Gadishull të Evropës.

Është për t'u saktësuar se afria e gjuhëve të Ballkanit, siç e thamë më lartë, nuk është **afri gjenetike ose farefisnore**, por është një "bashkim gjuhësor", një Lidhje që është quajtur **Afri Kulturore**.

Me fjalë të tjera tiparet që i bashkojnë sot këto gjuhë u zhvilluan shkallë-shkallë në rrjedhje të kohës.

Qysh në shekullin e kaluar është vënë re se popujt e Gadishullit të Ballkanit paraqesin elemente të përbashkëta në kulturën e tyre materiale e mendore, sidomos në mënyrën e ndërtimit të shtëpive, në kuzhinë e veshje, në doke e zakone, në figurat e besimeve popullore, në vallet, këngët, veglat muzikore etj.

Dijetari gjerman **Karl Dieteriç** në vitin 1902 ka bërë një studim krahasues të poezisë popullore të viseve të Ballkanit dhe ka gjetur elemente e motive të përbashkëta si: figurat, stilin, metaforat dhe krahasimet. Ai ka vënë re se edhe fillimi i këngëve me një figurë nga Natyra si Hyrje: **Lulëzoi molla, Lulëzoi dardha; Ra një shi e zbuti dhenë** etj, gjendet në poezinë popullore në të gjitha vendet e Ballkanit.

Të përbashkëta - thotë ai - janë edhe metaforat, krahasimet që përdoren në përshkrimin e hieshisë fizike të gruas si: **shtatin si selvi, vetullën si gajtan, dhëmbët si inxhi, syrin si filxhan, hundën si qiri, gojën si kuti.**

Dieteriç thotë se shumica e tyre janë me burim oriental dhe kanë hyrë në Ballkan me anë të Bizantit.

Të përbashkëta janë edhe shumë nga motivet e nga figurat e përrallës popullore si: E Bukura e Dheut, Divi, Arapi, Kuçedra etj.

Përhapje ballkanike ka gjithashtu motivi i Ngritjes së Vëllait të vdekur prej varrit për të marrë Të motrën e për ta çuar kështu në vend Besën që i pat dhënë, si edhe gojëdhëna e Mburojës së një gruaje të gjallë në një këmbë ure ose në një kala me qëllim që ndërtesa të mbajë.

Në marrëdhëniet e shqipes me gjuhët fqinje të Ballkanit ka rëndësi të madhe roli dhënësisht i shqipes. Përgjithësisht kjo fillon me një ndikim etnografik. Shqiptarët kanë ruajtur kulturën e vjetër të Ballkanit më mirë nga çdo popull tjetër i kësaj zone. Ata, me mënyrën e jetesës dhe me zakonet që kanë ditur t'i mbajnë nëpër shekuj, janë përfaqësuesit e një tipi etnografik të veçantë në rrethin e popujve ballkanik.

Kanë depërtuar te popujt fqinjë, siç u theksua edhe më lart, nga

ky origjinalitet i jetës shqiptare, elemente të kulturës materiale e shpirtërore. Mjafton të përmendim se në viset kufitare të Shqipërisë së Veriut, në Bosnjë dhe në mal të Zi, na shfaqen elemente të kostumeve të burrave shqiptarë, elemente të së drejtës popullore e të dokeve e të zakoneve shqiptare; meloditë e malësorëve shqiptarë, të kënduarit e këngëve, përcjellë me një tepsi bakri të madhe, i gjejmë në ato anë.

Rrethana të tilla na dalin edhe në Lindje e në Jug të Shqipërisë: te Bullgarët, te Maqedonët, te Grekët e te Arumunët.

Grekët e Epirit i këndojnë këngët e tyre me melodi labërishte, Arumunët e toskërisë i këndojnë të vetat kolonjarçe.

Nga të tilla marrëdhënie, në sferën materiale e mendore, kup-tohen edhe Ndikimet gjuhësore sepse bashkë me to kanë shtegtuar edhe emërtimet e tyre. Pastaj shpërnguljet e shpeshta të një pjese të popullsisë dhe ngulja e saj në një vend tjetër në kohët e para, shtegtimit periodike të barinjve, endjet e zejtarëve popullore poshtë e lartë, kanë ndihmuar në shtegtimit e fjalëve nga një gjuhë në tjetrën.

Që të dalë më qart afria e gjuhëve të Ballkanit duhet të shikojmë përafër marrëdhëniet e shqipes me secilën nga këto gjuhë.

Marrëdhëniet **greko-shqiptare** burojnë prej kohëve të mugëta të lashtësisë; ato kanë qënë të shumëfishta. Në Epir të Vjetër piqeshin fiset ilire me grekët. Ilirët duket se, në kohë shumë të vjetra, kanë hyrë thellë në Greqi, në anën tjetër grekët erdhën e themeluan kolonitë e tyre në bregdetin ilir.

Në kohë të mesme vala e shqiptarëve u derdh mbi Greqi e nguli në ato anë, ku elementi shqiptar është i gjallë edhe sot e gjithë ditës.

Jo vetëm ka marrë nga greqishtja e vjetër, siç janë: **drapën/ drapër** nga **drāpanon**; **mokën/mokër** nga **mākhana**; **lakën/lakër** nga **lākhanon**, por gjuha shqipe edhe i ka dhënë qoftë greqishtes së vjetër e të mesëm, qoftë greqishtes së re.

Ne e përmendim më lart se, sipas E.Çabejt, fjala **diza** “dhi”, që

jepet për lakonishten e Dorasve të moçëm të Peloponezit, nuk mund të ndahet nga shqipja **dhizë** “keç”, po edhe **dhi**. Fjala e greqishtes së vjetër **laros** “pulëbardhë”, rrjedh nga një shkallë e vjetër e shqipes **larë** (njollë e bardhë mbi lëkurë të shtazës).

Në greqishten bizantine, të mesme, N.Jokli përmend fjalën **rentai** “vrapim kuajsh në hipodrom”, nga shqipja **rend**, **vrapoj**.

Ndikimi i shqipes mbi greqishten e re është i madh; elemente të shqipes kanë hyrë atje me anë të dialekteve të Shqipërisë Jugore e pjesërisht nëpërmjet ishujve gjuhësor shqiptar, të themeluar prej shekujsh në Greqi. Ndër më kryesorët përmendim: **vëllamis** nga **vëllam**, **dhasos** nga shqipja **dash**, **ciapos** nga **cjap**, **dosa** nga **dosë**, **giza** nga shqipja **gjizë**, **cupra** nga **çupë**.

Nga shqipja kanë depërtuar edhe elemente leksikale që përmbahen në argot e në gjuhët e fshehta të zejtarëve shëtitës të Greqisë Veriore.

Marrëdhëniet e shqiptarëve me **sllavët e Ballkanit**, që zgjatën gati tetë shekuj (fillojnë nga shekulli VII e mbarojnë në vitin 1389, vit në të cilin mori fund mbretëria serbe nën grushtin osman) kanë lënë gjurmë edhe me gjuhë.

Nga një analizë e elementit sllav në shqipen, shihet se ajo përfshin fusha të ndryshme si fushën e ekonomisë shtëpiake, sidomos bujqësinë, blegtorinë e zejtarinë. Fjalë të tilla si: **opangë**, **opingë**, **stol**, **kovë**, **koritë**, **prashit**, **vadit**, **kosit**, **sanë**, **otavë**, **gozhdë**, **zdrugë**, **log**, **gostit**, **zheg** etj, etj, janë të burimitt sllav.

Një ineteres të veçantë paraqet pyetja se nga të cilat gjuhë sllave burojnë sllavizmat e shqipes.

Në pajtim me rrethanat historike, me përhapjen dikur të ndikimit bullgar në Shqipëri të Mesme e të Jugut dhe të ndikimit serb në Shqipërinë e Veriut, në vija të përgjithëshme mund të thuhet se huazimet sllave që gjenden në Shqipëri të Mesme dhe të Jugut janë marrë prej bullgarishtes, kurse sllavizmat e Shqipërisë Veriore janë marrë prej serbokroatishtes, çka vërtetohet edhe gjuhësisht: fjala **opangë** e Gegërishtes Veriore ka ardhur nga serbokro-

atishtja **opanak**, **opanka**, ndërsa fjala **opingë** e Shqipërisë së Mesme dhe Jugore ka ardhur nga bullgarishtja **opinci**:

Duhët theksuar se edhe shqipja nga ana e saj ka ndikuar mbi gjuhët sllave. Disa elemente që ato kanë marrë nga shqipja kanë shkuar edhe më tej, si në polonisht, ukrainisht, në vise jashtë Ballkanit, kurse disa të tjera janë më të kufizuara gjeografisht, duke përfshirë vetëm truallin e serbokroatishtes, bullgarishtes e më fortë të folmet e Malit të Zi, të Serbisë e të Maqedonisë.

Ndër të parat përmendim:

balgë, **bajgë** (shqip) - **balega** (serbokroatisht) - **balega** (rumanisht) - **balega** (ukrainisht); **vatër**, **votër** (shqip) - **vatra** “zjarr” (serbokroatisht) - **vatra** (rumanisht), - **vatra** (ukrainisht) - **vatra** (çekisht) - **vatra** (polonisht) - **vatra** (sllovakisht); **katund** (shqip) - **katun** “kasolle, stan” (serbokroatisht) - **katun** “arixhi” (bullgarisht) - **këtun** (rumanisht), **katuna** “çadër, fushim” (greqishte e mesme); **shytë**, **shutë** (shqip) - **siutos** (greqishtja e re) - **sut** (serbokroatisht, bullgarisht) - **ciut** (rumanisht) - **suta koza** (çekisht) - **szuty** (polonisht) - **suta** (ukrainisht) - **csuta** (hungarisht).

Nëpër dialekte serbokroate që fliten në afërsi të shqipes ruhen fjalë nga shqipja si: **ugič** nga shqipja **ogič**, **çeno** nga **qen**, **ira** nga shqipja **hirra**, **frus** nga shqipja **fruth**.

Në bullgarisht kanë hyrë fjalë të tilla si: **dashko** “qingj”, nga shqipja **dash**; **kekav** “i dobët, shëndetlig” nga shqipja **keq**; **karpa** nga shqipja **karpë** etj.

Megjithëse ndikimi i shqipes mbi turqishten është shumë i pakët, prapëseprapë ka ndonjë rast edhe atje; p.sh. fjala **besë-a**, nga shqipja ka shkuar në të gjitha gjuhët e Ballkanit, duke përfshirë edhe turqishten.

Fjala **luk-u**, sikurse ka vërejtur N.Jokli, ka shkuar në turqishten, duke ndërruar atje trajtën në **uluk**; nga turqishtja kaloi në gjuhët e Ballkanit në trajtën turke e, pastaj, u kthye përsëri në shqipen me këtë trajtë turke si **ulluk**.

Në lidhje me përkimet që ekzistojnë midis shqipes e ruman-

ishtes mund të thuhet se ato janë aq të shumta sa kanë prekur fone-
tikën, strukturën gramatikore e leksikore, formimin e fjalëve,
frazologjinë, proverbat, fjalët e urta, me një fjalë tërë sistemin
gjuhësor.

Në leksik, ndër më kryesoret, po veçojmë:

Shqip

ajkë, alkë
avull
bredh
brisk
daltë
gërresë
flutur
hamës (që ha shumë)
këlbazë, gëlbazë
maz, mëz
qafë
shkrumb
shtrungë
gardh

Rumanisht

alkă, alkë
abur
brad
brishkë
daltë
gresie
fluture
hamësh (Ilupës)
këlbeazë
mînz
ceafă, ceafë
scrum
strungë
gard

Këto fjalë dhe të tjera, që afrohen numrit njëqind, kanë pasur
interpretime të ndryshme. Nuk është vendi këtu që të hyjmë në
konsiderata historike dhe në teoritë e ndryshme, por e theksojmë
se këto çifte fjalësh, siç shkruan E. Çabej, pjesërisht kanë farefis
e tyre në shqipen, janë ndërtuar me mjetet fjalëformuese të sh-
qipes, kanë lindur në truall të shqipes dhe se nga ana shqiptare
është ruajtur një shkallë më e vjetër ose më konkrete e kuptimit.

Rumune - thekson Çabej - nuk janë sepse paraqiten të izoluara
në atë gjuhë, nuk gjejnë një shpjegim bindës brenda sistemit të saj.

Miklosiçi, siç do ta shohim më poshtë në vendin përkatës,
mendonte se ato kanë një burim të përbashkët që është Substrati

(nënshtesa) trak, në bazë, në themel të këtyre dy gjuhëve, teori që më vonë e ndoqën edhe Shuhardti dhe Hasdeu.

E. Çabej nënvizon se fjalët e përbashkëta të rumanishtes e të shqipes gjejnë një të tillë shpjegim brenda shqipes sa u vë vulën e karakterit shqiptar. Këto fjalë shpesh herë nuk janë të izoluar brenda shqipes por paraqiten si çerdhe e një familjeje leksikore.

Kështu, p.sh., **këlbazë, gëlbazë** (rumanisht: këlbeazë) shkon me foljen **kalb, kalbem** të shqipes dhe është një zgjerim me prapashtesën **zë**; **hamës** (edhe rumanisht: hamësh “llups”) është një zgjerim i foljes **ha**, sikurse **pimës** nga **pi**; **gëresë/gërresë** (rumanisht gresie) është një formim me prapashtesën **esë** i fjalës **gërryej, gërij**, sikurse fshesë që shkon me foljen **fshij**; fjala **shtrungë** (rumanisht strungë) që del edhe në gjuhë të tjera të Ballkanit, në gjuhën shqipe, përveç vendit ku milen dhentë, ka edhe kuptimin “vend për të fjetur, shtrat, krevat, shtresë” dhe është formuar, sipas Çabejt, nga **shtrojë** me prapashtesën - **ung**, ashtu siç është formuar **shtëllungë** nga **shtjell**, me prapashtesën **ung**.

Edhe fjala moshë (rumanisht mos) lidhet me shqipen **mot**.

Fjala **magar**, me përhapje edhe përtej Ballkanit, po sipas të madhit Çabe, lidhet me **gar** “gomar” që gjendet te Buzuku; sot **Qafa e Agrit** “Qafa e magarit”, gomarit më vonë me prapashtesën **-ma**.

Pra baza, burimi është te shqipja. Patjetër bashkëpërkimet e vjetra midis shqipes e rumanishtes shpjegohen edhe me fqinjësinë e moçme midis stërgjyshërve të shqiptarëve dhe të rumunëve. Prapë kolloksi i albanologjisë E.Çabej e thotë fjalën e vet të artë: “Degët e skajit më verilindor të etnosit shqiptar... në Mesjetën e hershme, pas gjase në një kohë ende para dyndjeve sllave, kanë qënë në një fqinjësi të pandërmjetme, fqinjësi kontakti me *degët e skajit më jugperëndimor të etnosit rumun dhe kjo lidhje u ushqye më tej edhe me anën e transhumancës së barinjve shtegtar. Duke gjykuar nga dëshmitë gjuhësore ky kontakt duhet të ketë qënë mjaft intim dhe vise-vise ka shkuar mbase gjer në Sim-*

biozë” (bashkëjetesë).

Dhe më poshtë vijon: “ai (kontakti) gjatë së ashtuquajturës periodë të rumanishtes së përbashkët mund të ketë vazhduar për disa shekuj me radhë, me siguri gjer në shkëputjen e aromunëve prej trungut rumun të përbashkët dhe me shtegëtimin e tyre për nga jugu, shtegëtim që u krye vonë-vonë (jo më vonë se) gjatë shekullit X. Në këtë periodë mund të vendosen ato marrëdhënie të rumanishtes me shqipen që shfaqen në mbarë degët dialektore të rumanishtes”.

Të gjitha huazimet që u cekën më lart, të përbashkëta për disa gjuhë ballkanike, kanë ndihmuar në formimin e **Njësisë gjuhësore ballkanike**.

Edhe në morfologji, edhe në sintaksë, edhe në Fjalëformim e frazeologji ka përkime në mes të gjuhëve të Ballkanit, të cilat kanë ndihmuar në zhvillimin dhe formimin e mëtejshëm të Njësisë gjuhësore ballkanike.

Dukuritë që bashkëjetojnë në gjuhët ballkanike dallohen midis tyre përsa i përkjet përhapjes së tyre; vihet re se secila gjuhë e Ballkanit, përveç lidhjeve të rendit të përgjithshëm ballkanik, ka edhe afrime të veçanta me një a dy gjuhë të këtij Gadishulli. Kështu rumanishtja ka disa tipare të përbashkëta vetëm me shqipen, disa të tjera vetëm me bullgarishten, kurse kjo e fundit ka disa pika afrimi vetëm me shqipen, si, p.sh., **mënyra habitore**.

Me siguri me një gjurmim më të hollësishëm do të dalë se elementët e shqipes, që kanë shkuar në gjuhët fqinjë, janë më të shumta, të cilat kanë rëndësi edhe për vetë historinë e shqipes, sepse ato ruajnë atje trajta më të vjetra që në shqipen humbën me kohë dhe u zëvendësuan me trajta të tjera.

Mund të përfundojmë për këto çështje, që u trajtuan më lart, **se disa nga problemet kryesore të Filologjisë Ballkanike lidhen me problemet e gjuhës shqipe dhe të historisë së saj.**

Përveç marrëdhënieve (dhënie, marrje) me gjuhët e Ballkanit, shqipja ka marrë ndonjë huazim edhe nga gjuhët e tjera ro-

mane, si edhe nga turqishtja.

Nga **Dalmatishtja**, sipas Mayer-Lybke^s dhe N.Jokl-it, është marrë fjala **kumbonë/kumborë**.

Nga **Spanjishtja** fjala **Palabra** “fjalë të kota, dokrra”, ka shkuar në të gjitha gjuhët e Ballkanit duke përfshirë edhe shqipen (Pallavra), bile edhe në turqishten osmane, siç duket - mendon E.Çabej - nëpërmjet gjuhës së çifutëve spanjollë.

Emri i përbindëshit, polifemit, divit me një sy **Katallā - Katalani**, figurë e ruajtur mirë në Shqipërinë e Veriut, si edhe në disa vende të Ballkanit, është i fundit të shekullit XIII dhe i fillimit të shekullit XIV.

Sipas G.Mayerit dhe miratuar nga E.Çabej, ky emër (Katala) është emri i mercenarëve nga Katalonja e Spanjës, të cilët perandori bizantin Androniku në vitin 1302 i mori në shërbim për të shtypur disa kryengritje në Ballkan, (edhe në Shqipëri), me ç’rast u sollën tepër ashpër.

Por midis shqipes dhe spanjishtes ka edhe ndonjë përkim krejt të rastit, pa asnjë lidhje apo shtegtim fjalë si: spanjisht **chico** “djalë”, **chica** “vajzë”, shqip **çikë** “vajzë” (në shqipen verilindore), që të dyja siç pohon E.Çabej, me burim prej fjalës feminare **çik** “i vogël, pak” ose prej një baze të ngjashme me këtë.

Ndikimi italian mbi gjuhën shqipe ka qënë i madh dhe ka vijuar që me shembjen e Perandorisë Romake.

Dihet se marrëdhëniet e Shqipërisë me Italinë kanë qënë ekonomike, tregtaro-ekonomike, politike, fetare, dhe kulturore. Por faktori kryesor që i ka mbajtur gjallë këto marrëdhënieve ka qënë Venediku dhe Kisha Katolike, e cila është përpjekur të mbajë gjithnjë të ndezur fenë katolike.

Pastaj do shtuar se shtetet mesjetare të Italisë janë munduar të ruajnë interesat e tyre territoriale e tregtare në Shqipëri, shpeshherë në rivalitet në mes tyre.

Republika e Venedikut ka pasur zotërimë në brigjet lindore të Adriatikut.

Duhet dalluar elementi latin nga elementi italian i shqipes.

Për këtë arsye duhet ditur se italishtja u formua prej latinishtes në shekullin e VII të erës së re.

Dijetari gjerman **Robert Helbig** në vitin 1903 u ka kushtuar elementeve italiane të shqipes një studim të veçantë: **Die italienischen Elemente im Albanesischen** (Elementi italian në shqip).

Sipas tij, kisha, tregtia, lundrimi, lufta dhe armët, jeta shtëpiake janë sferat ku ndihet më fort ndikimi italian: **paguaj, bankë, barkë, vapor, batare, timon, marinar** etj.

Një fakt i vërtetë është se fjalët latine, për punë të vjetërsisë së tyre, kanë pësuar në shqipen ndryshime më të mëdha në trajtën e tyre fonetike se sa fjalët italiane që janë më të reja.

E.Çabej ka shtruar pyetjet: Nga të cilat dialekte të Italisë janë më të shumtat huazime italiane? Cilat dialekte shqiptare janë më të pasura me këto huazime?

Dhe përgjigja e dhënë nga vetë ai është se huazimet më të shumta janë nga dialekti venecian, ndërsa arbëreshët e Italisë, Shkodra me rrethina, Himara me bregdetin kanë thithur huazime më tepër.

Pas shpalljes së Pavarësisë ndikimi italian ka qënë në shumë sfera të jetës sidomos në terminologjinë shkencore dhe në sferat e kulturës: **frena, torno, freza, bas, vidë, kuzinë, monedë** etj.

Ndikimi freng është i ndjeshëm dhe ndahet në dy faza: një **Mesjetare** dhe një **Moderne, e Re**.

Nga sundimi i Anxhuive, në shekullin e XIII, kur më 1269 Karl Anxhuin (1226-1285) zbarkoi në Vlorë dhe tre vjet më vonë e shpalli veten **Rex Albaniae** (mbret i Shqipërisë), sipas N.Joklit ka mbetur fjala **Trevë** (krahinë).

Por ndikimi francez modern është i madh i cili filloi që në shekullin e XIX.

Ndikimi i kulturës franceze është ndjerë në tërë Ballkanin, bile deri në Orient (Lindje), çka lidhet edhe me përhapjen e frëngjishtes kudo në botë, si gjuhë e kulturës, e dijes dhe si gjuhë

ndërkombëtare.

Në gjuhën shqipe ai ndikim ka prekur shumë sfera të jetës: **bursë, burokraci, zhuri, plazh, barikadë, pardesy, pallto, bluzë, triko, metrazh, paradë, shofer, trotuar, asamble** etj.

Ndikimi turk, më se pesëqind vjet, ka lënë gjurmë në tërë Ballkanin. Është një ndikim më tepër qytetar e nga këtu u përhap në fshatra. Shumë fjalë turke në gjuhën shqipe janë të burimit arab.

Ndikimi turk ka prekur gjithë jetën qytetare: **saraj, bahçe, hambar, oxhak, hile, hesap, haraç, haram, mëhyrë, coh, terezi, bajrak, mejdan** etj.

———— * ————

Gjuha shqipe, bijë e ilirishtes, e cila u rezistoi, u qëndroi e papërkulur stuhive të pushtuesve të shumtë shekullorë, sot flitet në Dy Dialekte Kryesore: **Gegërishtja** në pjesën Veriore dhe **Toskërishtja** në pjesën Jugore.

Dallimet në mes dy Dialekteve si: Hundorësia në Veri, (me bā, hāna), mungesa e saj në Jug; Rotacizmi në toskërisht (zëri, rëra), mungesa e tij në gegërisht; grupi **vo** në Veri (vorr) dhe **va** në Jug (varr), paskajorja e tipit **me punue** në Veri dhe **për të punue** në Jug janë të periudhës së hershme.

Në një fazë të caktuar të zhvillimit të gjuhës shqipe përgjithësisht këto ndryshime kishin marrë fund, sepse huazimet e mëpastajme, me përjashtime të rralla, nuk u janë nënshtruar këtyre ndryshimeve, këtyre ligjeve. Prandaj dallimet më thelbësore të dy Kryedialekteve të shqipes që u përmendën më lartë si: **Hundorësia** (nana), **Ndërrimi i a^{se} kundorë në ë** (hana-hëna), të **vo^{se}** nistore në **va** (voj-vaj), **Rotacizmi** (zani-zëri), janë, siç e theksuam, të një moshe shumë të madhe; mendohet para shekullit VIII të erës së re e disa e çojnë deri në shekullin e X. Të gjitha ndryshimet e tjera dialektore të gjuhës shqipe janë të periudhave të mëvonshme.

Zbërthimi dialektor i sotëm i shqipes është përfundimi i një

diferencimi, i kryer shkallë-shkallë në rrymë të kohëve - pohon E.Çabej.

Është vërtetuar plotësisht se pak shekuj më parë, dy Dialektet tona, megjithëse ishin formuar me tiparet e tyre themelore, në shumë pika qëndronin më afër njëra-tjetrës se sa qëndrojnë sot.

Gjuha e një autori të Veriut, si Gjon Buzuku (1555) dhe e një autori jugor, si Lekë Matrenga prej Siçilisë (1592) paraqesin më shumë tipare të përbashkëta ndërmjet tyre, nga ç'paraqesin dy Dialektet kryesore në gjendjen e tyre të sotme.

Në kohën e shpërnguljeve të elementit shqiptar për në Itali, i cili rridhte prej krahinash jugore të vendit e, kryesisht, prej Bregdetit, ç'përmban afërsisht prej anëve të Vlorës gjer në anët e Prevezës, disa nga tiparet themelore të dallimit midis Dialekteve si: Hundorësia (me *bā*), Rotacizmi (vera), grupet **vo-va** (vorr-varr) e ndonjë tjetër me kohë kishin zënë vend në gjuhë, por në anën tjetër disa ndryshime të tjera, që vërehen në shekujt e mëpastajme, nuk kishin zënë rrënjë si: grupet **kl, gl, mb, nd, ng, ngj**; grupet e zanoreve **ua/ue, ye, ie** të cilat ishin gjallë për gjithë gjuhën shqipe.

Arbërishtja e Italisë, kjo degë dialektore e shkëputur katërpesë shekuj më parë prej trungut të përbashkët të gjuhës sonë, paraqet disa tipare të përbashkëta fonetike, morfologjike, sintaksore e leksikore me gjuhën e autorëve të vjetër të Veriut të shekujve XVI e XVII: Buzuku, Budi, Bardhi. Arbërishtja e Italisë ruan forma e përdorime të trashëguara të gjuhës që ishin veçori për mbarë shqipen: për toskërishten e për gegërishten.

Mund të përmendim si të tilla: **Pjesorja** dhe format e tjera të pjesores së adjektivizuar: **bekuam, i shtruam, baam, lam, me lyem, duruam, pim, ziem** të cilat gjenden edhe te autorët e vjetër të veriut; **Formimi i emrave**; te Matrenga: **të dashunë**; Buzuku: **ensë dashunitë së botësë sanë** (nga dashuria për atdheun tonë); Fr.Bardhi: **të dashunë**; **Përemrat pronorë**; arbëreshët: **nipat taj** (nipat tuaj), Buzuku: **bijte taj** (bijte tuaj).

Do shtuar se në atë periudhë disa fjalë, forma fjalësh, ndërtime fjalish që gjenden te Buzuku, ndeshen edhe te arbëreshët e Italisë: **përdorës** (lypës), **lëfton** (lufton), **dëreq** (drejt), **qesh** (tall), **gjellë** (jetë), **kanka** (kënga), **krip** (flokë), **gluhë**, **klumsht**, **ulk** etj.

Gjuha e Buzukut afrohet me ligjërimet e toskërishtes e shpesh herë me ato të Kolonive të Greqisë e të Italisë më tepër se sa afrohet sot gegërishtja me toskërishten; qoftë me ruajtjen e grupeve të zanoreve (kujtuom), qoftë në ruajtjen e grupeve të bashtingëlloreve, qoftë në ruajtjen e zanores ë, çka dëshmon qart afërsinë e dialekteve.

Zanorja e patheksuar ë (lopë, pulë), grupet e bashtingëlloreve **ua/ue**, **ye**, **ie** (mësuar, fyell, diell), grupet e bashtingëlloreve **mb**, **nd**, **ng**, **ngj** (këmba, nderi, ngacmoj, ngjyey), sot i ruan përgjithësisht toskërishtja e pjesërisht edhe disa të folme të gegërishtes, por të plota kanë ekzistuar dhe janë shkruar pak shekuj më parë në tërë truallin e shqipes, siç e dëshmojnë shkrimet e asaj periudhe.

Shkrimtarët e vjetër të Veriut (Buzuku, Budi, Bardhi, Bogdani, Kazazi), si edhe ata të arbëreshëve (Matrenga me shokë), ruajtës të një tradite shkrimore të gjuhës, i kanë përdorur të plota këto dukuri.

Për arsye të ndryshme të karakterit historik, ekonomik e social, me mungesën e një organizimi shtetëror të mirëfilltë e të një qarkullimi rrugor të rregullt, me shpërnguljet e brendshme të popullsisë, me kontaktet e pakta krahinë më krahinë, me dallimet fetare e faktorë të tjerë, ligjërimet e ndryshme të shqipes në periudhën e pushtimit osman - shkruan prof. E.Çabej - morën një rrugë jo aq afruese se sa më fort larguese, pra në një farë vështrimi një zhvillim më fort divergjent se sa konvergjent. Pastaj tradita e shkrimit, e cila në kohët e para të pushtimit osman kishte marrë një hov të ri në Shqipëri, për disa rrethana të brendëshme e të jashtme, vërtetë se nuk u ndërpre krejt gjer në Rilindjen letrare

të shekullit XIX, por megjithatë ra fash (në heshtje) në shumë pikëpamje. U kufizua në një letërkëmbim tregtar e privat, në shkrime të hartuara për qëllime praktike të shërbimit fetar e në disa shkrime laike të karakterit pak a shumë privat që mezi qarkullojnë përbrenda disa rretheve të ngushta shoqërore.

Një fakt i tillë nuk ndihmon në afrinë e dialekteve por, përkundrazi, në lindjen e veçorive të reja dialektore. pra dialektet e shqipes gjatë pesë shekujve të fundit kanë kryer evolucione, zhvillime të pavarura në vetvete që i kanë larguar edhe më tepër njëri nga tjetri. E rëndësishme është që ato dikur kanë qënë shumë më afër, çka dëshmon se kemi të bëjmë me një **Njësi gjuhësore** e, si rrjedhim, edhe me një popull që e flet atë - **popullin shqiptar**.

Në qoftë se gjuha e shkrimit mbyllet në vetvete, duke u larguar gjithnjë e më tepër nga të folët popullorë, atëhere me kohë paraqitet mundësia e një **diglosíe**, gjë që ka ndodhur në disa gjuhë të botës.

Megjithë ndryshimet dialektore që kanë ndodhur në këta katërpesë shekujt e fundit, studimet e gjëra dialektologjike kanë treguar se elementët e përbashkëta në të dy dialektet e shqipes janë më të shumta nga ç' mendohej në të kaluarën; janë pikërisht ato që kanë ruajtur ndër shekuj **Njësinë e gjuhës shqipe**, duke mos lejuar që të krijohet te ne një **diglosí** a **triglosí**.

Gjuha ndryshon vazhdimisht, por, megjithatë, ajo në çdo epokë historike mbetet një fenomen tërësor e unik. Gjuha paraqitet njëkohësisht edhe si **sistem**, edhe si **zhvillim**.

Mund të themi me bindje të plotë, duke u mbështetur në fakte të pakundërshtueshme se dallimet në mes të dy dialekteve të shqipes janë fare të vogla dhe të parëndësishme në krahasim me dialektet e gjuhëve të tjera.

Në kumtime, në komunikime, në biseda krejt të zakonshme, një shqipfolës në skajet më Veriore të trevave shqiptare, në fshatrat më të thella të Kosovës, nuk ka asnjë pengesë, asnjë vështirësi për t'u marrë vesh me një shqipfolës në skajet më Jugore të

Atdheut tonë. Kjo tregon se struktura gramatikore, fondi themelor i fjalëve është krejt i njëjtë, krejt i përbashkët. Sidomos në strukturën leksikore e fjalëformuese afria e dialekteve është më e madhe se sa në fonetikë. Dallimet në morfologji e në sintaksë janë të pakta e të parëndësishme për shqipfolësit.

Ndryshimet dialektore te ne kanë më fort karakter fonetik, d.m.th., në mënyrën e shqiptimit të tingujve. Në të dy dialektet e gjuhës sonë fondi themelor i fjalëve dhe struktura gramatikore është e njëjtë, çka lejon marrëveshjen pa asnjë vështirësi të të gjithë shqipfolësve.

Fjalët e përdorimit të përditshëm si: **bukë, ujë, shtëpi, gur, dru, arë, fushë, djalë, burrë, shi, diell, rrugë, lis, i ri, i vjetër, plak, nuse, vonë, punoj, shkoj** e me qindra të tjera gjenden në të gjithë truallin e shqipes.

Duhet vënë në dukje se tiparet dalluese që karakterizojnë dialektet nuk kanë të gjitha të njëjtën shtrirje territoriale.

Vihet re se **Gegërishtja** është më e zërthyer në të folme dhe më pak e njësishtme se sa **Toskërishtja**. Në disa tipare më konservative është Gegërishtja e në disa të tjera Toskërishtja dhe në disa të tjera të dy dialektet inovojnë ose inovon njëri dialekt pa varësisht nga tjetri.

Kështu, për shembull, Gegërishtja me **a** hundore (nāna), me **n** ndërzanore (zani), me **vo** mistore (vorr), me bashtingëlloret e zëshme në fund fjale (elb, i madh) dhe me ruajtjen më mirë të zanoreve të gjata, ka qëndruar në gjendjen e qëmoçme sepse janë tipare të vjetra dialektore. Përkundrazi Toskërishtja në vend të dukurive të lartëpërmendura ka respektivisht **ë** (nēna), **va** (varr), rotacizëm (zëri), shurdhim të bashtingëlloreve në fund (elp, i math) dhe nivelin të gjatësisë. Por Toskërishtja në ruajtjen e **ë-së** së patheksuar (lopë, klasë), sidomos në fund fjale, me ruajtjen e togjeve dhe diftongjeve (punuar, fyell, diell), me ruajtjen e grupeve të bashkëtingëlloreve **mb, nd, ng, ngj** (këmba, nderi, ngrihem, ngjyjej), paraqitet më konservative se sa Gegërishtja, sepse

kjo e fundit i ka reduktuar, nuk i ka ruajtur.

Përgjithësisht në një periudhë mesjetare, e cila mund të quhet **paraletrare**, Gegërishtja paraqitej më konservative, kurse Toskërishtja ka një tip gjuhësor të përbashkët; në një periudhë të mëpastajme, **letrare**, Toskërishtja i mbahet më me ngulm gjendjes së hershme, ndërsa Gegërishtja kryen më fort inovacione, siç ka vënë në dukje kollosi i gjuhësisë shqiptare, akademiku E.Çabej.

Përbrenda dialektit të Gegërishtes ekzistojnë ndryshime që burojnë mbase nga një fazë më e lashtë se sa më të vjetrat ndryshime që kanë ndërmjet tyre Gegërishtja me Toskërishten.

Duke i vështruar dukuritë në tërësinë e në lidhjet e ndërsjellta të tyre, shihet se diferencimi i njërive të mëdha në më të vogla dhe futia e njërive të vogla në më të mëdha, kanë vepruar krah për krah e në të njëjtën kohë.

Këtë e mbështetë edhe fakti që emri **Toskë** në krye të herës ka shënuar vetëm pjesën më Veriore të shqiptarëve të Jugut, ndërsa emri **Gegë** shënonte pjesën më Jugore të shqiptarëve të Veriut; kështu që shtrirja sot më e hapët e këtyre emrave edhe etnografikisht shihet se është përfundim i një zgjerimi të kryer shkallë-shkallë e pak e nga pak.

Kështu pra - theksonte E.Çabej - gjithçka na mëson që vërtetë nuk ka pasur ndonjëherë një shqipe të njësishtme e pa dialekte por struktura dialektore e sotme ka rrjedhur prej një strukture të ndërtuar disi ndryshe, ku dy grupet kryesore, të quajtur Gegërisht e Toskërisht në kuptimin e sotëm ende nuk ekziston.

Është pohuar nga autoritetet shkencore më në zë se Shqipëria karakterizohet nga një njësi e plotë gjuhësore, se dallimet dialektore në gjuhën shqipe janë krejt të papërfillshme.

Ja ç' thotë lidhur me këtë albanologu i shquar danez Pedersen: "Shumë herë është thënë se nuk ka njësi gjuhësore në Shqipëri, se dialekti i Veriut ndryshon krejt nga dialekti i Jugut, kështu që marrëveshja midis këtyre dy pjesëve të Shqipërisë është e pamundur. Po ky është një pohim krejt i rremë. Ndryshimi mi-

dis të dy dialekteve të gjuhës shqipe është shumë më i vogël se sa ndryshimet dialektore që janë midis shumë gjuhëve të tjera e nga pikëpamja praktike ndryshimi midis dialekteve të gjuhës shqipe nuk ka asnjë rëndësi. Një i huaj që ka mësuar një nga këto dialekte nuk gjen asnjë mundim serioz për të kuptuar tjetrin dialekt”.

Dhe, më poshtë, për madhështinë dhe bukurinë e gjuhës shqipe, ai shkruan: “Gjuha shqipe lipset të jetë mburojë për folësit e saj dhe një vegël e shenjtë për rritjen mendore dhe arsimore të kombit shqiptar”.

———— * ————

Populli ynë e ka ndërjerë gjuhën amtare kurdoherë si diçka të pandarë nga vetë qenia e tij. Me të ai ka shprehur personalitetin e tij etnik e shoqëror, mendimin dhe urrejtjen.

Gjuha është pjesë e shpirtit të popullit, e jetës së tij, është tipar themelor i kombit.

Nuk është e rastit për të gjithë pushtuesit që kanë mprehur thika e kanë paguar flori, si për kokat e Isa Boletinëve, ashtu edhe për kokat e Dhaskal Todhërve. Por gjuha shqipe u ruajt dhe lulëzoi si vetë populli që e flet.

Dihet që kombet gjithmonë në periudhat e zgjimit i kanë dhënë një hov të madh zhvillimit të gjuhës e të kulturës së tyre.

Kjo ka ndodhur edhe me Rilindjen tonë Kombëtare, e cila karakterizohet, ndër të tjera, nga lufta për ta bërë gjuhën e shkruar shqipe pronë të popullit, si mjet emancipimi mendor e shpirtëror e, mbi të gjitha, si hallkë solide të bashkimit e fuqizimit kombëtar të shqiptarëve.

Lufta për ta mbrojtur dhe për ta evidentuar gjuhën shqipe, si gjuha më e vjetër në Ballkan, lufta për mësimin, lëvrimin, pastrimin dhe pasurimin e saj, ishte dhe mbeti një nga qëllimet kryesore të Lëvizjes sonë të gjërë dhe të thellë të Rilindjes Kombëtare.

Kjo ndodhi për arsye se për të mbrojtur sa më mirë të drejtat e popullit shqiptar kundër synimeve gllabëruese të Fuqive të

Mëdha, kundër synimeve dashakeqe të monarkive shoviniste ballkanike, sidomos kundër synimeve serbo-malazeze, mendimit politik shqiptar të Rilindjes, i duhej të përdorte edhe argumente shkencore historike e gjuhësore, i duhej të vinte në pah lashtësinë dhe historinë heroike, veçoritë kombëtare, aftësitë krijuese, pasurinë shpirtërore të popullit shqiptar, veçanërisht lashtësinë e gjuhës së tij.

Gjuha shqipe, si dallojë e rëndësishme e kombit, si hallkë e fortë e bashkimit kombëtar përmbi dasitë fetare e krahinore, si mjet i arsimimit të masave të gjera të popullit, si mjet i zhvillimit dhe i lulëzimit të kulturës kombëtare, tërhoqi vëmendjen e forcave më të shquara të Rilindjes.

Në të gjitha Protestat, Memorandumet që u drejtoheshin në ato vite heroike Fuqive të Mëdha, Portës së Lartë, Konsujve etj, theksohet se Populli Shqiptar krahas tokave të Atdheut, është i vendosur të ruajë **gjuhën** e vet dhe preferon më mirë të zhduket se sa të pranojë të nënshtrohet nga të huajt, duke humbur kështu **gjuhën, zakonet, traditat, kombësinë**, të cilat i ka ruajtur si të vetmet thesare përmes rrebesheve të pushtimit të huaj në shekuj.

Problemi i përpunimit, i lëvrimit dhe i shkrimit të një gjuhe mbarëkombëtare të zhvilluar që t'u përgjigjej nevojave të reja të jetës politike e kulturore kombëtare, u shtrua me forcë të madhe.

Ja përse, krahas organizatës politike të **Lidhjes Shqiptare të Prizrenit**, u ngrit organizata letrare-kulturore, **Shoqëria e të Shtypurit Shkronja Shqip**, në Stamboll më 1879.

Ajo arriti t'i japë një zgjidhje çështjes së Alfabetiti, duke caktuar një Alfabet të përbashkët.

Naum Veqilharxhi në "Enqiklikën (Qarkore) për tërë të pasurit e të mësuarit ortodoks", që më 1836 shkruante: Sa kombe që kanë mbetur në padije u ngjasin gjithnjë robëve, duke punuar nga ditë për fatbardhësinë e të qytetëruarve e të fuqishmëve; ata vetëm atëherë kanë për të dalë nga gjendja e bagëtishme, ku gjenden, kur të nisin të lërojnë gjuhën e tyre kombiare. Po kjo

nuk fitohet ndryshe veçse me shkronja të veçanta kombiare që janë filluar para meje. Po me të përzierët e të huajve dhe me dinakërinë e disa njerëzve të nakartë mbetën të gjithë pa marrë fund”.

Ai shkruante me besim të patundur për të ardhmen: “Le të hedhim farën e mirë; me siguri natyra do t’i japë asaj ngjallje, çelje, rritje dhe padyshim pemët e bukura e të ëmbla, brezat që do të vinë sot e tutje do t’i vjelin, duke bekuar mbjellësit e mirë dhe farën”.

Më 1879 u krijua Alfabeti Shqip ose Alfabeti Shqip i Stambollit, i cili, siç e quajti Asdreni “ishte një agim për shqiptarët”.

Ky alfabet, i parashtruar nga S.Frashëri, i bazuar në parimin “një tingull me një gërmë dhe një gërmë për një tingull”, u mbështet në alfabetin latin, duke u plotësuar me disa shkronja të tjera të veçanta.

Ai u përhap gjërësisht e deri në fund të shekullit XIX ishte Alfabeti kryesor i Rilindjes sonë.

Poeti ynë i madh kombëtar Naim Frashëri plot optimizëm në këtë kohë do të këndonte:

Si lumë kush zë të mbjellë

Lumë kush vë këtë pemë

Se kjo ka për të pjellë

S’mbulohet me rremë.

Si mjet i përforcimit të bashkimit të popullit shqiptar, si mjet i unitetit të tij të fortë, si një detyrë të menjëhershme që nuk duhet lënë për një të ardhme të largët, e vështronte ideologu dhe dijetari i madh i kombit shqiptar Sami Frashëri çështjen e njësimimit të gjuhës së shkruar shqipe.

“Puna e të gjallëruarit të gjuhës shqipe dhe e të bashkuarit të dialekteve të saj e të ndritësuarit e kombit tonë, që është një punë shumë e vlefshme dhe e shenjtëruar, është punë e shoqërisë sonë” - thotë Samiu (Është fjala për Shoqërinë e të Shtypurit Shkronja Shqip - shënimi im Xh.G.).

Më tej ai pohon: “Shumë gjuhë e dialekte sjellin ndarje e mërgim (humbje). Vërtetë se kemi disa dialekte, por këto nuk janë të huaja njëra nga tjetra”.

Në Alfabetaren e Gjuhës Shqipe të Stambollit Samiu i jep një rëndësi shumë të madhe shkrimit të gjuhës shqipe, si shpëtimtare e kombit.

“Është për t’u çuditur - vijon dijetari unë - qysh ka rrojtur gjer më sot kombi i shqiptarëve, duke me mos shkruar e duke me mos kënduar gjuhën e tyre kur janë humbur kaq kombe që shkruanin e këndonin gjuhën e tyre si: sirianët, kaldenjasis, finikasit, latinët etj”.

Dhe më poshtë po aty shkruan: “Kombi shqiptar nga të mosshkruarit e gjuhës së vetë ka humbur gjer më sot më të shumtët e njerëzvet; po në ka humbur aqë në kaqë mijë vjet, ata që kanë mbeturë do t’i humbin në fort pak kohë, se kohë e sotme nuk ngjan me kohërat e vjetëra; sot kombet piqen e përzihen fort çpejt dhe ata që janë më të fortë e më të ditur mundin kurdoherë ata që janë të dobët e më të paditur”.

Pastaj vë në dukje se “Edhe bariu edhe bujku, edhe mjeshtri i mureve do të mos jenë pa dituri”.

Plot besim për të ardhmen Samiu konkludon: “Me të marrë shqiptarët gjuhën e bukur të tyre të shkruar aq mirë, i zunë shkronjat me të dy duart”.

Me Alfabetin e Stambollit, me 36 shkronja, u botuan një numër librash, duke filluar me **Alfabetaren e Gjuhësë Shqipe** (1879).

Më vonë u krijuan edhe Alfabete të tjera si: Alfabeti i Shoqërisë Bashkimi (1899) dhe i Shoqërisë Agimi (1901) në Shkodër. Por ishte Kongresi i Manastirit (14-22 nëntor 1908) ai që e zgjidhi përfundimisht çështjen e Alfabetit të gjuhës shqipe.

Dijetari me famë evropiane Hoxha Tahsini, drejtues aktiv i Shoqërisë së të Shtypurit Shkronja Shqip, i jepte një rëndësi shumë të madhe çështjes së Alfabetit për gjuhën shqipe.

Ai mendonte se mbarëvajtja e një gjuhe varej shumë nga një Alfabet i ndërtuar me kritere të shëndosha shkencore dhe të përshtatshme për atë gjuhë.

Më 1872 shpiku dhe përhap një Alfabet personal të tij.

Jani Vreto kishte dashuri të madhe për gjuhën amtare të cilën e quante “nga më të bukurat”. Ai punoi shumë për lulëzimin e shqipes, duke e pasuruar me një varg fjalësh të reja.

Vretoja e konsideronte gjuhën amtare si bazën e bashkësisë e të vëllazërimit kombëtar.

“Ne mbjellim farën - shkruante patrioti Koto Hoxhi - e nuk mbjellim kripë dhe duhet ta dini që kjo farë do të mbijë një ditë”.

Por hapin më të madh, të mishëruar si qëllim të vetëdijshëm, e bëri Konstandin Kristoforidhi: afrimin e të dy varianteve letrare dialektore në shkrim jo vetëm si dëshmi të afrisë si variante të një gjuhe të vetme por edhe si një hap historik real përpara për njësimin e gjuhës së shkruar.

Me veprën e tij ai u bë nismëtari i një dukurie të pashembullt në historinë e shqipes së shkruar - nga i njëjti autor të shkruhen të dyja variantet letrare.

Kështu pra Rilindja jonë Kombëtare bëri hapin më të vësh-tirë e më të guximshëm për krijimin e një gjuhe letrare shqipe. Ajo e nxori gjuhën tonë të shkruar nga një gjendje e prapambetur e shekujve të kaluar, e vuri në një rrugë krejt të re dhe shtroi kërkesën e krijimit të gjuhës së përbashkët letrare si një problem të madh për gjithë kombin tonë.

Pas shpalljes së **Pavarësisë**, fillon një Etapë e re, e cila kishte si synim lëvrimin dhe përparimin e mëtejshëm të gjuhës shqipe që do të bëhej edhe gjuhë zyrtare e Shtetit të ri shqiptar dhe do të mësohej nëpër shkolla që do të hapeshin në Shqipëri.

Në këtë Etapë të re jetuan edhe disa personalitete të pendës, të cilët kishin vepruar gjallërisht që në fazën e fundit të Rilindjes si: L.Gurakuqi, A.Xhuvani, N.Mjeda, F.Konica, F.Noli, Petro Nini Luarasi, Papa Kristo Negovani, Sotir Peci, etj.

Këta studiues dhe veprimtarë të shquar i çuan edhe më tej rezultatet e viteve të mëparëshme.

Lëvrimi i mëtejshëm i gjuhës shqipe, mësimi i saj në shkollë, diskutimi për problemin e gjuhës letrare të njësuar, hartimi i fjalorëve dy gjuhësh dhe dialektorë, hulumtime në disa çështje të gramatikës historike e të historisë së gjuhës - ja gama e problematikës të kësaj etape.

Përpjekjet e studiuesve dhe e patriotëve të tjerë çuan në themelimin e Komisionit Letrare të Shkodrës (1916) dhe në Kongresin e Lushnjës (1920).

Komisia Letrare e Shkodrës, ku bënë pjesë L.Gurakuqi, N.Mjeda, A.Xhuvani, H.Mosi, S.Peci etj, u mor, ndër të tjera, edhe me çështjen e gjuhës letrare dhe të drejtshkrimit të saj, duke i vendosur edhe disa terma shqip.

Kongresi Arsimor i Lushnjës, në të cilin ishin të pranishëm edhe A.Xhuvani, S.Peci, diskutoi, në mes shumë çështjeve të tjera, problemin e terminologjisë së gjuhës shqipe.

Më 1922 dhe më 1924 u mbledhën edhe dy Kongrese të tjera të këtij tipi në Tiranë.

Me fillimin e shekullit XX mori shtysë hartimi i Abetareve. E para Abetare është ajo e N.Veqilharxhit, e botuar në vitin 1844 dhe e ribotuar në vitin 1845; më pas K.Kristoforidhi, në vitin 1867, botoi një Abetare Gegërisht dhe një tjetër Toskërisht, ndërsa në 1879 në Stamboll S.Frashëri, P.Vaso, K.Hoxhi, J.Vreto, botuan **Alfabetarja e gjuhës shqipe**.

Me fillimet e këtij shekulli më 1905 L.Gurakuqi botoi në Napoli **Abetari për Msoitore Filtare të Shqypnisë**, P.Qiriazzi botoi në Manastir më 1909 **Abetare për shkollat e para**, N.Lako botoi në Paris më 1909 **Stërvitetorja**.

Më vonë punuan në këtë fushë S.Shuteriqi, A.Xhuvani, J.Minga, L.Lumezi etj.

Kontribut të madh, siç do ta analizojnë më poshtë në kapitullin përkatës, dha Aleksandër Xhuvani, i cili e kishte filluar vep-

rimtarinë e tij që në Rilindje; në vitin 1905 në një artikull të botuar, në revistën Albania u shpreh për formimin e një gjuhe letrare shqipe të përbashkët.

Duke ecur në vazhden e Rilindasve, A.Xhuvani i kushtoi vëmëndje pastrimit dhe pasurimit të gjuhës shqipe, duke mënjeluar fjalët e huaja e të panevojshme e duke krijuar fjalë të reja sipas gjedhëve, modeleve fjalëformuese, duke dhënë vetë shembull në këtë drejtim.

Vëmëndje të posaçëm i kushtoi edhe drejtshkrimin të gjuhës shqipe, duke dhënë ndihmesë në afrimin e shkallë-shkallshëm të të dy varianteve të shqipes letrare. Ai dha ndihmesë edhe për përmirësimin e vazhdueshëm të normave gramatikore nëpërmjet teksteve mësimore për gjuhën shqipe.

Një ndihmesë të madhe në lëvrimin dhe pasurimin e gjuhës shqipe ka dhënë edhe Fan Noli. Ai është ndër pasuruesit më të shquar e më të mbarë të visarit leksikor të gjuhës sonë e të mjeteve shprehëse të saj. Me mjeshtëri e shije, si pak kush, në një masë më të madhe se çdokush tjetër, ky mjeshtër i madh i fjalës shqipe, i çoi lart mundësitë shprehëse të gjuhës sonë, duke bërë që të ngrihet kjo në rangun e gjuhëve më të zhvilluara, e aftë për të shprehur një mendim sado të lartë, çdo ndiesi sado të hollë.

Fan Noli, si edhe F.Konica shkroi një gjuhë letrare të përpunuar jugore (toskërisht).

Mirë e sintetizon M.Domi ndihmesën e Nolit në lëvrimin dhe pasurimin e gjuhës shqipe, kur shkruan: “E shumanshme dhe nga më të gatshmet ka qënë puna e tij në përpunimin, pasurimin e zhvillimin e gjuhës sonë letrare; i gjërë dhe i thellë ndikimi i tij. Ai tëharri shqipen letrare të variantit jugor, të përpunuar prej Rilindasve të mëdhenj, të shekullit të kaluar, nga elementet dhe tiparet arkaike e ngushtësisht dialektore, nga variante të shumta morfologjike, i dha asaj një karakter më të përgjithshëm, më të njësuar, më të stabilizuar dhe e bëri më të lakueshëm e më të kristalizuar. Ai është, përveç kësaj, ndër pasuruesit më të shquar e më

dorëmbarrë të visarit leksikor të gjuhës sonë letrare e të mjeteve shprehëse të saj... Ai farkoi sa e sa neologjizma, u dha formë shqipe shumë fjalëve të huaja, sajoi kombinime të ndryshme fjalësh me një ndjenjë të hollë të natyrës së gjuhës sonë e sidomos me një shije të rrallë artistike”. (Revista Nëntori, 1965/4).

Noli mbetet një nga ata mjeshtra që i dhanë tonin shkrimit shqip pas Rilindjes Kombëtare.

Një **Epokë e re** nis për gjuhën shqipe pas **Luftës së dytë Botërore**, rezultatet e së cilës do t’i analizojmë gjerësisht në pjesën e dytë dhe të fundit të kësaj vepre.

Këtu do të theksojmë vetëm faktin se krijimi dhe konsolidimi i një gjuhe letrare të vetme, të përbashkët për të gjithë kombin, u realizua në këtë periudhë.

Sot ne kemi një gjuhë të vetme letrare për të gjithë kombin shqiptar. Norma e saj është formuar, krahas me zvogëlimin dhe shuarjen e funksioneve shoqërore të varianteve letrare të mëparshme.

Gjuha e sotme letrare shqipe ka krijuar tashmë një sistem të vetë mbidialektor që ka lidhje të shumanshme me dialektet, por bën një jetë të mëvetësishme, si një sistem i një tipi të ri, më i përpunuar, më i lartë.

Baza themelore e këtij sistemi janë elementet e përbashkëta në të dy dialektet.

Gjuha e sotme letrare shqipe kryen funksione më të gjëra që mund të kryejë një gjuhë kombëtare e zhvilluar; ajo përfshin të gjitha sferat e veprimtarisë shoqërore. Shqipja letrare e përbashkët gjithashtu përfshin të gjithë popullsinë shqiptare brenda dhe jashtë Republikës së Shqipërisë dhe është bërë norma gjuhësore ideale për të gjithë ata që shkruajnë dhe flasin shqip.

Gjuha letrare shqipe asnjëherë nuk ka shprehur vlera kaq të mëdha kulturore se sa ato që shpreh sot. Ajo është shprehje e gjallë e kulturës së popullit tonë, e dinamizmit të tij historik dhe, në të njëjtën kohë, është fryt i shumë brezave.

Me krijimin e një gjuhe të vetme letrare, proçesi i shuarjes së dialekteve është shpejtuar dhe në të ardhmen do të shpejtohet edhe më tepër.

Dialektet janë një kategori mbeturinore e së kaluarës. Por kjo nuk do të thotë se dialektet do të shuhën menjëherë. Gjuha është kategori shumë e qëndrueshme. Dialektet do të vazhdojnë të bashkëjetojnë akoma për një kohë të gjatë me gjuhën letrare, si një formë mbeturinore më e ulët, më e ngushtë e kumtimit gojor të shtresave të caktuara të popullsisë.

Pjesa e Dytë

Nga Historia e Studimit të Gjuhës Shqipe

Nga Historia e Studimit të Gjuhës Shqipe

Albanologjia është tërësia e studimeve që janë bërë dhe që bëhen për historinë, gjuhën, folklorin dhe kulturën e popullit shqiptar.

Shqipëria, populli shqiptar, historia, gjuha, kultura e tij prej shekujsh kanë tërhequr vëmendjen e studiuesve të huaj. Ato janë bërë objekt kërkimesh dhe hulumtimesh për albanologë e dijetarë të shquart të vendeve të ndryshme të botës.

Një pjesë e mirë e tyre i kanë vështruar me objektivitet çështjet shqiptare dhe kanë hartuar vepra me shumë vlerë, por ka pasur dhe ka edhe sot studiues, të cilët, të nisur nga qëllime të paracaktuara, kanë mbajtur qëndrim antishkencor e antishqiptar.

Albanologjia, si drejtim i veçantë studimesh për Shqipërinë dhe Shqiptarët, lindi në fund të shekullit XVII dhe në fillim të shekullit XVIII por u konsolidua në gjysmën e dytë të shekullit XIX.

Në fillim problemet e Albanologjisë u trajtuan kryesisht në kuadrin e studimeve për Evropën Juglindore, pa u zërthyer në probleme të veçanta.

Vëmendja e studimeve në këtë Etapë u përqendrua veçanërisht në historinë tonë të lashtë, sidomos në problemin e prejardhjes së popullit shqiptar dhe të gjuhës së tij.

Një nga figurat kryesore të kësaj periudhe është historiani suedez, por profesor në Universitetin e Hallës në Gjermani **Hans Tun-**

man (1746-1778), i cili siç do ta shohim më poshtë në vendin përkatës, në veprën **Kërkime mbi historinë e popujve të Europës Lindore** (Untersuchungen über die Geschichte der östlichen europäischen Völker), shënoi një kthesë në studimin e historisë, të gjuhës e të kulturës së popullit shqiptar mbi baza shkencore.

Me fillimin e shekullit XIX studimet albanologjike u zgjeruan; u bënë përpjekje për të njohur më afër rrugën e zhvillimit të popullit shqiptar, të gjuhës, të kulturës, të historisë, të traditave të tij etnokulturore.

Në mesin e shekullit XIX Vepra që shënoi një etapë të rëndësishme në fushën e Albanologjisë ishin vëllimet **Studime shqiptare të Hanit**, të cilat, si për problemet e shumta që trajtohen në to, ashtu edhe për materialet e pasura që përmbajnë për historinë, gjuhën, folklorin, etnografinë dhe gjeografinë e Shqipërisë, shërbyen si bazë për studimet e mëvonshme albanologjike.

Në këtë Libër ne do të flasim për historinë e Albanologjisë **kryesisht** në sferën e gjuhësisë, duke lënë mënjanë arritjet në fushën e historisë, arkeologjisë, folklorit dhe etnografisë, pasi nuk janë objekt i studimit tonë. Megjithatë, herëpasëhere janë cekur edhe vepra të rëndësishme nga këto fusha, në të cilat bëhet fjalë për çështje të prejardhjes së popullit shqiptar dhe të gjuhës së tij.

Gjuhësia shqiptare është shkencë që përfshin të gjitha studimet e shqiptarëve për gjuhën e tyre. Megjithatë ne nuk do të bëjmë fjalë vetëm për kërkimet dhe hulumtimet e dijetarëve shqiptarë, por edhe për studimet e dijetarëve të huaj që kanë bërë për shqipen.

Në studimet albanologjike do të dallojmë katër periudha:

I. Periudha e parë, Parashkencore, e cila shkon nga fundi i shekullit XVI e deri në fillimet e shekullit XIX.

II. Periudha e dytë nis me fillimet e shekullit XIX e vazhdon deri në shpalljen e Pavarësisë.

III. Periudha e tretë zgjat me vitet e shpalljes së Pavarësisë deri në vitin 1944, me mbarimin e Luftës së dytë Botërore.

IV. Periudha e katërt fillon me Çlirimin e Shqipërisë dhe vazhdon edhe sot.

Le t'i analizojmë mendimet që janë dhënë në çdo Periudhë.

Periudha e parë

Në këtë zgjatje kohore jepen mendime për gjuhën shqipe në vepra të ndryshme kushtuar gjuhëve të botës.

Shkruhen për shqipen Fjalorë praktik dhe ndonjë Gramatikë, disa prej të cilave mbeten dorëshkrim. Jepen njoftime edhe për prejardhjen e shqipes dhe të popullit shqiptar.

Që në shekullin e XVI bëhen përpjekje nga humanistët evropianë për studimin e gjuhëve botërore, duke i përshkruar dhe klasifikuar ato.

Në këtë përpjekje gjejmë edhe të dhëna për shqipen, shumë herë krejt të gabuara.

Në vitin 1555 në Zvicër doli një vepër me titull: **Mitridati ose Vëzhgime mbi gjuhët më të lashta në Evropë dhe mbi gjuhët që fliten sot në vende të ndryshme të botës**, nga **K.Gesner** (1516-1565), një natyralist zviceran.

Gjuha shqipe vetëm sa përmendet në një **pasqyrë** që jepet për gjuhët dhe popujt sllavë.

Shqiptarët përmenden me dy emra: **Epirot** dhe **Albanes**

Është kjo një etapë kur bëhet një konfuzion i madh në mes sllavishtes dhe ilirishtes, sa përzihen njëra me tjetrën.

Me gjuhë ilirike shpesh emërtohen gjuhët e sllavëve të Jugut.

Mbi bazën e veprës së Gesnerit u shkrua një vepër tjetër nga G.Megiser (1555-1616) me titull **Visari shumëgjuhësh** në vitin 1603, ku jepet një **Pasqyrë** e gjuhëve të botës dhe klasifikimi i tyre. Në një **Tabelë** jepen gjuhët Ilirike (në kuptimin gjuhët sllave) duke i evidentuar shqipen, moldavishten, gjuhët baltike si gjuhë jo sllave. Shqipen e flasin epirotët - thuhet atje; pra shqiptarët njihen me emrin **Epirotë**.

Më 1587 u botua vepra e **Andrea de Poza** (spanjoll), vepër kjo për gjuhën e vjetër spanjolle: aty bëhen përpjekje për klasifikimin e gjuhëve të Evropës, me ç' rast flitet edhe për shqipen.

Në një **Shënim** autori pohon se ka kontakt të drejtëpërdrejtë me shqiptarët, se kishte pas bisedë me ta, të cilët shërbenin në ushtrinë spanjolle. Gjuha shqipe është gjuhë e Albanezëve, të qua-

jtur Epir në lashtësi - thotë autori; ai vë në dukje se shqipja është gjuhë e dalluar, e ndryshme nga sllavishtja. Nuk përdor termin Epir por Albanez.

G.Skaliger (1540-1600), gjuhëtar francez me origjinë italiane ka shkruar një vepër më 1599 me titull: **Mbi gjuhët e Evropës**. Në këtë vepër bën një klasifikim të gjuhëve, duke dalluar njëmbëdhjetë grupe gjuhësh: katër grupe të mëdha (latinisht, greqisht, gjuhët gjermanike dhe sllave) dhe shtatë grupe të vogla; këtu fut edhe shqipen, duke e njohur si gjuhë më vete. G.Skaliger shkruan: Gjuha epirote të cilën e quajmë gjuhë shqiptare është gjuhë e folur prej një popullsie shumë luftarake për të cilin nuk mund të thuhet me siguri në se është vendas apo i ardhur”. Mendimi i tij është i avancuar.

Klod Dyré (vdekur 1611), francez, në vitin 1590 boton një vepër për **Gjuhët e botës**, ku flitet për 57 gjuhë; aty flitet edhe për shqipen, por e përzien me sllavishten, duke anuar te lidhja e shqipes me sllavishten.

———— * ————

Në periudhën për të cilën po flasim dallohen edhe Shqiptarë, të cilët bëjnë përpjekje qoftë për lërimin e letërsisë, qoftë për lëvrimin e gjuhës shqipe dhe studimin e saj:

Gjon Buzuku, autor i parë që njihet gjer tani i letërsisë shqiptare, shqipëruesi dhe hartuesi i një libri kishtar që është quajtur **Meshar**, botuar në vitin 1555, më i vjetri libër i shtypur që ka arritur deri në ditët tona.

Vepra në fjalë tregon për një traditë shkrimi të shqipes, çka e tregon gjuha relativisht e përpunuar e saj. Ajo ka rëndësi të madhe për historinë e shqipes së shkruar dhe të letërsisë shqiptare.

Një botim shkencor të Mesharit me Faksimile dhe Transkribim, të pajisur me një Studim Hyrës të gjërë dhe me shënime tekstologjike, e ka bërë i madhi prof.E.Çabe, botuar në dy vëllime në vitin 1968.

Pjetër Budi (1566-1622), nga Mati, shkrimtar i shquar i Letërsisë së vjetër shqipe, pat botuar në Romë tri Vepra: **Doktrina e**

Krishterë (1618), Pasqyra e të rrëfyemit (1621), Rituali roman (1621).

Veprat në fjalë kanë rëndësi, sidomos për studimet historike të gjuhës shqipe.

Siç na kumton studiuesi hungarez Von Vindish në një punim të tij të vitit 1782, për të cilin do të flasim më poshtë, Pjetër Budi kishte botuar një **Gramatikë të shqipes** që ishte shumë e rrallë. Kjo gramatikë duhet të jetë shtypur para vitit 1622, vit në të cilin vdiq autori i saj.

Këtë fakt e dëshmon edhe Miklosiçi më 1870, i cili i referohet Von Vindishit.

Nuk dihet asgjë, për këtë gramatikë gjer më sot.

Frang Bardhi (1606-1643), historian, leksikograf, folklorist, etnograf nga Zadrima.

Si historian ai botoi më 1636 në Venedik veprën **Gjergj Kastrioti i Epirit, i quajtur Skëndërbe, princ shumë trim dhe i pathyeshëm i shqiptarëve** (Georgius Castriotes Epirensis, vulgo Scanderbeg, Epirotarum Princeps fortissimus ac invincitivimus).

Veprën e shkroi latinisht si polemikë për të hedhur poshtë mendimin e pathemeltë të një Peshkopi boshnjak, bashkëkohës, i cili i mohonte Skëndërbeut prejardhjen shqiptare.

Në vitin 1635 Bardhi botoi veprën madhore të tij: **Fjalori latinisht - shqip**, i pari Fjalor i gjuhës shqipe, me të cilën fillon Leksikografia shqiptare (Dictinarium latino - epiroticum).

Autori e hartoi atë, siç shprehet vetë në Parathënie, i shtyrë nga synimi atdhetar me qëllim që t'i ndihmonte “gjuhës sonë që po bdaretë e po bastardhonetë sa më parë të ve” (po humbet e po prishet me të “kaluar të kohës), si edhe për t'u shërbyer klerikëve katolikë shqiptarë që nuk e dinin latinishten.

Në këtë **Fjalor** për herë të parë shqipja u ballafaqua me sukses me një gjuhë si latinishtja që ishte gjuha më e përparuar ndërkomëtare e asaj kohe. Fjalori përfshin rreth 4500 fjalë latine, të cilave u përgjigjen rreth 2500 fjalë të shqipes; krahas fjalëve jepen edhe togfjalësha dhe shembuj që tregojnë përdorimin e tyre. Përveç kë-

tyre ka edhe fjalë të ndërtuara nga vetë autori prej brumit të shqipes, si barasvlerëse të atyre latine. Bien në sy mjaftë fjalë, të ndërtuara me prapashtesa, të cilat janë më prodhimtare në Rilindje e këtej.

Nganjëherë pranë fjalës latine vihet edhe përkthimi italisht; gjithashtu herë-herë pranë fjalës shqipe jepet edhe ndonjë huazim nga turqishtja.

Fjalori përfshin edhe **Lista** të disa pjesëve të ligjëratës, emra qytetesh e kështjellash të Shqipërisë, si edhe **Përsëndetje** në gjuhën shqipe. Aty gjejmë për herë të parë një Listë me 113 provebra e thënie të urta.

Faktikisht është Fjalor dy gjuhësh por vende-vende ka marrë karakterin e një Fjalori shumëgjuhësh, sepse shtohen edhe ca fjalë nga italishtja dhe turqishtja. Ka raste që merr karakterin e një Fjalori shpjegues, kur nuk e jep direkt fjalën shqipe por e shpjegon kuptimin e fjalës latine në shqip. Kudo mbizotëron leksiku abstrakt.

Në Fjalorin e Bardhit, në të cilin ka shumë fjalë të sferës fetare, gjejmë edhe elemente të gramatikës. Pas faqes 188 shton këta kapituj: Numërorë (themelorë dhe rrjeshtorë), Emra gjinie, Emra të përveçëm të Shqipërisë, disa Ndajfolje, pak Parafjalë e Pasthirrma. Ai vë në dukje se shqipja është gjuhë më vete.

Në të vërtetë Fjalori ka edhe të meta, për të cilat autori tregohet i vetëdijshëm; është hartuar në mënyrë të pabarabartë; deri te shkronja **E** ka pak material; më pas numri i fjalëve dhe i frazeologjisë shtohet.

Kjo vepër e Frang Bardhit ka shërbyer dhe shërben si burim i rëndësishëm për studimin e historisë së gjuhës shqipe e të kulturës shqiptare.

Pjetër Mazreku (vdekur më 28.V.1635), Arqipeshkvi shqiptar i Tivarit, në një **Relacion**, dërguar Papës, që mban vitin 1633, thotë se Shqiptarët janë pasardhësit e Maqedonasve të vjetër dhe thekson se shqipja është gjuhë më vete, por ka fjalë në të nga italishtja dhe greqishtja.

Ai bën edhe një përpjekje për analizë historike të leksikut të shqipes. Është përpjekja e parë për Etimologji.

P.Mazreku jep një Listë prej 32 fjalësh që mendon se janë nga italishtja; **pulë < polo, kali < cabalo, kabalo, liqe < lago.**

Për shkrimin e tyre përdor Alfabetin e Budit.

Pjetër Bogdani (1625-1689), nga Guri i Hasit, personalitet i madh i dijes dhe kulturës shqiptare, peshkop i Shkodrës dhe kryepeshkop i Shkupit, botoi në vitin 1685 në Padova veprën **Çeta e Profetëve** (Cuneus prophetarum) shqip dhe italisht (në dy shtylla).

Ky burrë, nga më të mëdhenjtë që ka nxjerrë kombi shqiptar gjatë shekujve në fushën e dijes, shkroi me dashuri të madhe për gjuhën shqipe, për Shqipërinë dhe popullin shqiptar, punoi për mëkëmbjen dhe zhvillimin e kulturës kombëtare, luftoi për çlirimin e vendit dhe kërkoi që t'i jepeshin popullit shqiptar libra në gjuhën amtare.

Vetë Bogdani luftoi me vetëdije të plotë për ta pasuruar dhe përpunuar gjuhën shqipe, gjurmoi dhe vuri në qarkullim fjalë dhe shprehje të vjetra të lëna në harresë, krijoi edhe fjalë të reja, duke bërë përpjekjet e para për krijimin e terminologjisë dhe të termave në ndonjë degë të shkencës.

Me veprën e tij gjuha shqipe shënon hapa të rëndësishëm përpara.

Pjetër Bogdani në Parathënien e veprës së tij na dëfton se Ungji i tij **Andrea Bogdani** pat hartuar një **Gramatikë** latinisht-shqip, një Gramatikë “fort të goditiçime latin e shqip”, por fatkeqësisht i humbi të nipit (Pjetrit) aty rreth vitit 1684, gjatë luftës austro-turke, kur po tentonte të arratisesh, i ndjekur nga ushtritë turke.

Kjo gramatikë - thotë Pjetër Bogdani - u tret si “kripa nd’ujët”. Mbase vepra e tij u shkrua për nevojat e mësimin të latinishtes nga kleri katolik shqiptar.

Andrea Bogdani ishte njeri shumë i ditur; ai pat lindur në Gur të Hasit në vitin 1604 (disa thonë në vitin 1595); studioi në Romë, pastaj shërbeu në Famulli të ndryshme në Shqipëri.

A. Bogdani më 1651 u emërua Arqipeshkv i Ohrit e më vonë i Shkupit.

Vdiq më 13.12.1683.

Dhimitër Dervina, lëvrues i shqipes, përktheu një katekizëm (Himarë, 1627) me një gjuhë të pasur, çka flet për një traditë shkri-mi në zonat jugperëndimore të vendit, si edhe për disa shkolla fetare që mbajtën në shekujt XVII-XVIII në Himarë, Misionarët e huaj, si edhe Arbëreshët e Siçilisë.

Për historinë e gjuhës sonë ka rëndësi edhe **Kuvendi i Arbërit**, një Kuvend kishtar katolik, i mbajtur pranë Lezhës më 1703. Në vitin 1706 u botuan **Përmbledhje dokumentash** nga ky Kuvend.

Gjon Nikollë Kazazi (1702-1752) arqipeshkv i Shkupit, i cili zbuloi i pari më 1740 **Mesharin** e Buzukut, përktheu dhe botoi një vepër në shqip në vitin 1743, mbi bazën e së folmes së Gjakovës: **Përmbledhje e shkurtër e doktrinës kristiane. Përkthyer në gjuhën shqipe për përdorim dhe mësim nga fëmijët e këtij kombi.** (Breve Compedio della Dottrina Cristiana. Tradota in lingua albanese per l'utilita e l'istruzione del fanciulli di quella Nazione).

Ky përkthim dhe botim ka rëndësi për njohjen e së folmes së Gjakovës në shekullin e XVIII, nga ishte vetë autori.

———— * ————

Le t'u kthehemi disa dijetarëve shqiptarë, të dalë kryesisht nga Shkolla e Voskopojës.

Voskopoja, sot fshat me 500 shtëpi, 25 km në Perëndim të Korçës, e vendosur në një Pllajë 1100m mbi nivelin e detit, rrethuar prej vargmalesh, në shekullin e XVIII ishte një nga qytetet më të mëdhenj të Ballkanit, me rreth tridhjetëmijë banorë, një Qëndër e rëndësishme ekonomike dhe kulturore e vendit tonë, me 24 kisha, një spital, një jetimore, bibliotekë, shtypshkronjë, shkollë etj.

Kishte marrëdhënie tregtare me shumë vende të huaja (Vjenë, Lejpcig etj).

Të kësaj periudhe janë një varg monumentesh kulture. Këtu lulëzoi një veprimtari e gjërë arsimore-kulturore, çka gjeti shprehje në themelimin e Akademisë së Re dhe të një Shtypshkronje (1720).

Akademia e Re (1750) ishte e nivelit të shkollës së mesme, por shumë e avancuar: aty jepej filozofi, astronomi, fizikë, matematikë etj. Personeli ishte shqiptar dhe arumun e mësimi bëhej greqisht.

Me fillimin e shekullit XIX kjo vatër kulture u shua, por dolën nga ajo burra të shquar në fushën e dijes, të përmendur në qendra universitare, kulturore e fetare evropiane si:

Dhimitër Prokop Pamperi - mjek, filozof; mësues në oborin e princërve të Vllahisë.

Ambroz Pamperi - prift i Kishës ortodokse të Lejpcigut, i cili shkroi libra të ndryshëm dhe vjersha (greqisht).

Konstandin Ukuta - protopapë në Poznan të Polonisë, i cili hartoi një **Manual** për mësimin e gjuhës arumune, botuar në Vjenë më 1797.

Dhimitër Bojaxhiu - profesor i greqishtes së vjetër më 1817 në Universitetin e Vjenës, autor i një Gramatike të rumanishtes e të arumanishtes.

Kostë Xhehani - nga Voskopoja; shkoi në Halle të Gjermanisë për të vijuar mësimet atje, ku u njoh me H.Tunman, të cilën e ndihmoi në hartimin e veprës së tij, sidomos në kapitullin për **Shqiptarët** dhe **Shqipërinë**.

Më pas K.Xhehani bëri udhëtime në tërë Europën, në qendrat më të famshme universitare të kohës: Vjenë, Paris, Londër, Stamboll etj.

Në Leiden të Hollandës mori famë në polemikën e tij me një nga profesorët e atjeshëm, i cili guxoi të flasë me përbuzje për popujt e Ballkanit.

K.Xhehani qëndronte në lartësinë e kulturës së kohës.

Ja ç`thotë H.Tunman për të në vitin 1774: "Është burrë me shumë njohuri, veçanërisht në filozofi dhe matematikë, me një

mendje të ndritur dhe që meriton një fat më të mirë. Pasi qëndroi dy herë, gjithsej tre vjet, në këtë Universitet (në Halle-shënimi im) dhe pasi vizitoi Leiden dhe Kembrixh, pasi pa Francë e Itali, tani po kthehet në Atdheune tij, për t' u shërbyer bashkatdhetarëve me njohuritë që ka fituar”.

Kostë Xhehani shkroi greqisht disa vepra letrare e shkencore, çka dëshmojnë për kulturën e gjërë enciklopedike të tij.

Nga Shkolla e Voskopojës dolën gjithashtu studiues dhe dijetarë të tjerë shqiptarë të cilët dhanë ndihmesë në studimet albanologjike në mes të cilëve po përmendim:

Teodor Kavalioti (1718-1798), filozof dhe iluminist i shquar, i cili lindi dhe vdiq në Voskopojë; zhvilloi një veprimtari të gjërë shkencore, letrare dhe pedagogjike. Pikërisht në sajë të punës së tij si Drejtor u ngrit Shkolla në rangun e një Gjimnazi të avancuar që mori emrin Akademia e Re. Ai ka shkruar shumë, por ne na intereson vepra: **Protopiria** (Mësimet e para) e vitit 1770. Në të ka lëndë të zakonshme të një Abetareje të asaj kohe, (lutje, këngë kishtarë, tregime nga historia biblike, sentenca të shkurtëra dogmatike e morale - të gjitha greqisht), si edhe një **Fjalor** tregjuhësh: greqisht - vllahisht (arumanisht) - shqip, më 1170 fjalë.

Vepra ka rëndësi se na jep material gjuhësor nga dialekti i jugut, sidomos për të folmet e Korçës në shekullin e XVIII.

U ribotua më vonë nga dijetarë të huaj.

T.Kavalioti na ka lënë disa trakte: Fizika, Logjika, Metafizika.

Daniel Haxhi Voskopojari ose Dhanil Adam Haxhiu (1754-1825), hartues i veprës **Eisagogike Dhidhaskalia** (Mësimet fillestare), botuar në vitin 1802.

Ky libër ka rreth 235 fraza nga sfera e jetës së përditshme dhe përmban një formë Dialogu, një Doktrinë të krishterë të shkurtër, disa njohuri aritmetike e fizike, modele letrash dhe aktesh, këshilla nxënësve, disa vjersha dhe Kushtime; aty gjenden edhe Materiale bisedimi (tekste, dialogje, fraza) në katër gjuhë: greqisht - arumanisht - bullgarisht - shqip), me rreth 1200 fjalë.

Ka rëndësi kjo vepër për historinë e gjuhës; ajo u shfrytëzua

shumë nga albanologë të huaj në studimet e tyre.

Në vitin 1975 u ribotua nga një studiues gjerman.

Adam Haxhiu, përgjithësisht, ishte për përhapjen e gjuhës greke që ishte për të “mëma e diturisë”, dhe mohonte lëvrimin e gjuhës amtare.

Konstandin Berati (Kostë Berati 1740-1828), me sa duket beratas, por nxënës i Akademisë së Voskopojës; prej tij kemi një Dorëshkrim të vitit 1768: **Libër mësimi fetar greqisht - shqip**, me 152 faqe.

Në gjuhën shqipe në të gjenden: disa urata e lutje kishe, një vjershë fetare, pjesë të Ungjillit, si edhe dy **Fjalor**: greqisht -shqip dhe shqip - greqisht me 1700 fjalë. Ai ka përdorur një Alfabet krejt të veçantë.

Vepra ka rëndësi gjuhësore.

Duket përpjekja e tij për futjen e shqipes në shërbimet fetare ortodokse, siç e tregojnë copëzat ungjillore, lutjet dhe vjershat shqip.

Proza didaktike fetare shqipe, 88 vargjet e Vjershës dhe Fjalori na japin material të bollshëm për të njohur gjuhën shqipe e veçanërisht të folmen e Beratit të shekullit XVIII.

Grigor Voskopojari (vdekur rreth vitit 1772), lëvrues i shquar i gjuhës shqipe, ndër figurat kryesore të jetës kulturore të Voskopojës në mesin e shekullit XVIII.

Më 1767 u zgjodh Mitropolit i Durrësit e prandaj u quajt edhe **Grigori i Durrësit**.

Vitet e fundit duket se i kaloi në Manastirin e Shën Jonit pranë Elbasanit.

Gjon Zavira (1719-1804) thotë për Grigorin se ai përktheu Dhjatën e Vjetër dhe të Re, duke krijuar edhe një **Alfabet** të veçantë, të shpikur nga ai vet.

Teodor Haxhifilipi (1730-1805), i njohur me emrin **Dhaskal Todhri**, punoi si mësues dhe u përpoq shumë për futjen e shqipes në shërbesat fetare e për mësimin e saj në shkollë.

Ai përktheu Dhjatën e Vjetër dhe të Re, prej të cilave na kanë

mbetur vetëm disa fragmente, si edhe porositi diku në Evropë një shtypshkronjë.

Dhaskal Todhri krijoi edhe një **Alfabet** të posaçëm, i cili u përdor gjëresisht në Elbasan deri në fillimet e shekullit XX, ai pat një përhapje edhe jashtë Elbasanit si në Berat e Kavajë.

Todhri shkroi elbasanishten e kohës dhe krijoi Neologjizma për nevojat e përkthimeve, duke krijuar kështu në Elbasan një traditë të mirë shkrimi me Alfabetin e tij.

Në fakt Elbasani ka pasur një traditë shkrimi edhe më parë; përmendim **Theodhor Bogomili**, i quajtur **Anonimi i Elbasanit**, nga i cili kemi një Dorëshkrim me titull **Psalltiko**, d.m.th., **Meshar**, me tiparet karakteristike të së folmes së Elbasanit; i përket mesit të shekullit XVII; gjuha e tij është arkaike.

Autori ka përdorur një **Alfabet** krejt të veçantë; është i pari **Alfabet** i posaçëm që njohim gjer më sot; ndryshon nga ai i K.Beratit dhe i Dhaskal Todhrit.

Në mesin e shekullit XVII në Elbasan ka vepruar edhe prifti **Papa Totasi**, i cili përktheu në të folmen e atij qyteti pjesë të ndryshme nga Ungjilli dhe përdori një **Alfabet** krejt të veçantë.

Pas këtyre do të zhvillojë veprimtari të gjërë arsimore dhe kulturore tregtari tjetër elbasanas **Simon Kazanxhi**, i cili në vitet 1821-1822 ka punuar një **Fjalor** gjermanisht - sllovenisht - çekisht - hungarisht - italisht - shqip.

Duke udhëtuar nëpër viset e ndryshme të Evropës, ai shënoi fjalë në gjuhët e vendit ku shkoi dhe u jep atyre përgjegjëset në gjuhën e vet (në gjuhën shqipe). Ka përdorur Alfabetin e Todhrit. Më vonë në këtë qytet do të veprojë **Tushi Pina** (1869-1896), i quajtur në të vërtetë **Dhimitër Pina**, një mësues i apasionuar pas mësimit, lëvrimit dhe studimit të gjuhës shqipe.

Ai pat kryer gjimnazin në Manastir (greqisht), mbajti fjalimin mbi varrin e Kristoforidhit ditën që vdiq, por edhe vet vdiq i ri, në moshën 27-vjeçare.

Tushi Pina shqipëroi letërsi fetare, i hyri përkthimit të veprave të letërsisë së vjetër greke e latine, ndërmori një **Gramatikë** të

shqipes (dorëshkrim), punoi për një **Fjalor** (dorëshkrim), shkroi poezi.

Të gjitha i punoi mbi bazën e së folmes së Elbasanit.

Për dijetarët e shquar të këtij qyteti K. Kristoforidhi dhe A. Xhuvani do të flitet në kapitujt përkatës.

———— * ————

Më duket më e përshtatshme që të vë në pah pikërisht këtu ndihmesat në fushën e albanologjisë të disa studiusve, të cilët nuk janë të shkollës së Voskopojës. Ata e zhvillojnë veprimtarinë e tyre në çerekun e parë të shekullit XIX, por unë për lehtësi studimi dhe nga kontributi që kanë dhënë po i grupoj në periudhën e parë.

Vangjel Meksi (1760-1823), përkthyes dhe lëvrues i gjuhës shqipe; ishte nga Labova e Gjirokastrës.

Pasi kreu studimet e larta për mjekësi në Napoli, punoi si mjek pranë Ali Pashë Tepelenës deri në vitin 1810 kur ra në mëri me të; më pas punoi si mjek në Greqi dhe në Turqi.

Puna madhore e Meksit është përkthimi i **Dhjatës së Re** (1819-1820) në Stamboll.

Grigor Gjirokastriti (vdekur 1829), peshkop i Eubesë (1821) dhe në vitin 1827 kryepeshkop i Athinës, redaktoi dhe botoi përkthimin e Meksit (Ungjilli sipas Shën Mateu) në një variant dygjuhësh (shqip dhe greqisht) dhe në vitin 1827 në Korfuz gjithë Dhjatën e Re e botoi përsëri në variantin dygjuhësh.

Përkthimi është mbështetur në të folmen e Gjirokastrës dhe ndihmoi shumë për ta përdorur shqipen në shërbesat fetare, si edhe u bë mbështetje për studimin e gjuhës shqipe nga albanologë të huaj.

Vepra është hartuar mbi bazën e alfabetit greqisht.

Vangjel Meksi hartoi edhe një **Gramatikë** të gjuhës shqipe, të cilën e njohim vetëm si titull, pasi nuk dihet gjë për të.

Në **Postenan** të Leskovikut, **Jani Vretoja** na tregon se në çerekun e parë të shekullit XIX aty ka pasur një çerdhe të lëvrimit të gjuhës shqipe, qoftë edhe për të meshuar shqip, duke e predikuar Ungjillin shqip.

Vëllezërit **Nikollë** dhe **Stefan Postenani** (Ekonomi) kishin bërë një punë të madhe në këtë drejtim; ata kishin përkthyer shqip vepra fetare dhe ndonjë **Gramatikë** nga gjuhë të huaja, kryesisht nga greqishtja.

Stefani që përpara vitit 1822 kishte hartuar një **Gramatikë** të greqishtes në gjuhën shqipe, duke përdorur një Alfabet grek me 37 shkronja.

Shumë shkrime të tyre nuk gjenden.

Jani Vellaraj (1771-1823), pat studiuar mjekësi në Padova; ishte mjek i djalit të Ali Pashë Tepelenës, Veliut.

Në vitin 1801 hartoi veprën **Shënime gramatikore greqishte e re - shqip**, e cila ruhet në Bibliotekën Kombëtare të Parisit. Në atë veprë ai ka përdorur një Alfabet të posaçëm dhe dialektin çam.

Është një Alfabet i krijuar mbi bazën e alfabetit latin, me disa kombinime, është i katërti Alfabet i njohur origjinal i shqipes, pas atyre të **Papa Totasit** të **Kodikut të Beratit** të vitit 1764 (Kostë Beratit) e të **Dhaskal Todhrit**.

Autori në veprën e lartpërmendur flet për lakimin e emrave, për shkallët e mbiemrave, për foljet; ka fjalë të urta greqishte e re - shqip, frazeologji, emra të ndryshëm qëniesh të gjalla, emra pemësh, perimesh, pjesë të trupit të njeriut.

Disa studiues Jani Vellarajn e konsiderojnë grek, disa e marrin për shqiptar, kurse ca të tjerë e nxjerrin me origjinë vllehe.

———— * ————

Nga fundi i shekullit XVII studimi i gjuhës shqipe fillon intensivisht edhe nga Arbëreshët.

Dihet se pas vdekjes së Skëndërbeut një numër i madh shqiptarësh u detyrua të lërë Atdheun e të marrë udhën e mërgimit për në Itali, megjithëse ky proces, që u krye valë-valë, kishte nisur me kohë, para vdekjes së Skëndërbeut.

Mbreti i Napolit i vendosi ata në krahinat e varfëra të Jugut të Italisë: në Kalabri e në Siçili.

Ndonëse në kushte tepër të vështira ekonomike, pa përkrahje, pa ndihmë, shqiptarët e mërguar ditën të ruajnë gjuhën, zakonet,

traditat e lashta të **Të parëve** të tyre. Ata gjithnjë patën bindjen se janë “të huaj te dheu lëtti” (italian) dhe gjithnjë mbajtën të pashlyer kujtimin e Atdheut dhe të luftërave heroike që kishin bërë stërgjyshërit e tyre nën drejtimin dhe udhëheqjen e Skëndërbeut kundër pushtuesve osman.

Shqiptarët e mërguar në fillim jetuan përgjithësisht të shkëputur nga vendasit, duke ruajtur mirë tiparet e kombësisë së tyre.

E theksojmë këtu se në vitin 1601 **Xhirolana Marafioti**, historian kalabrez (jo arbëresh), na ka lënë një vepër me 688 faqe, italisht, për historinë e Kalabrisë, me titull: **Croniche e antichità di Calabria** (Kronika dhe antikiteti i Kalabrisë).

Autori është përpjekur, duke u mbështetur në më se 150 autorë grekë, latinë etj, të japë një histori sa më të dokumentuar të Krahinës së Kalabrisë. Aty u kushton edhe disa faqe **Arbëreshëve të Kalabrisë**, çka ka rëndësi për historinë, folklorin dhe gjuhën. Flet mbi kishën shqipe të Arbëreshët e Kalabrisë që në vitin 1601, se atje, në kishë, Mesha thuhej shqip.

Historiani me kulturë për kohën, Marafioti, tregon në ato pak faqe se Arbëreshët e quajnë veten **Albanesi**; përshkruan disa zakone të arbëreshëve, organizimin shoqëror të tyre, mënyrën e jetesës, veshjen e grave, ndonjë kuriozitet (si e pjekin mishin në gropa në dhe), zakonet e martesës etj.

“Ata jetojnë - thotë ai - në banesa të këqia, pa shtëpi të ndërtuara, në kasolle prej dërrase, jetojnë në vise malore dhe pyje; merren me blegtori e pak bujqësi”.

Zakonet e martesës i përshkruan mirë çka dalin tamam si në Shqipëri.

Marafioti përpiqet të depërtojë në gjuhën e tyre por nuk ia arin. Ai pohon: “Kjo gjuhë i ngjet asaj Maureske, persiane dhe arabe e shumë rrallë përzihen në të fjalë greke”.

Gjuhën e tyre e quan Lingua Albanesca.

Për shërbesat fetare shkruan, me ç’rast ka rëndësi: “... bëjnë shërbesat fetare të kishës sipas zakonit të gjuhës së tyre, çka është shumë e ndryshme nga zakoni latin e grek”.

Pra del se në shërbesat fetare përdornin gjuhën e tyre. Mund të jetë një traditë nga vendlindja, Shqipëria, që e bartën atje, pra një traditë e vjetër që e çuan nga Shqipëria në Kalabri.

Në shekullin e XIX, me zhvillimin e mëtejshëm të kapitalizmit, edhe në krahinat më të prapambetura jugore të Italisë, nisën të shtohen kontaktet dhe lidhjet e arbëreshëve me vendasit, nisi të depërtojë kultura italiane; si pasojë mjaftë fshatra u asimiluan dhe e humbën fizionominë shqiptare, duke humbur edhe gjuhën mëmë.

Jeta kulturore - arsimore e arbëreshëve që në shekullin e XVI filloi të gjallërohet çka duket në përpjekje për të shkruar gjuhën e tyre dhe për të krijuar edhe një letërsi kryesisht fetare.

Shënojmë se në pjesën e parë të shekullit XVIII jeta kulturore dhe arsimore e arbëreshëve mori hov të madh, sepse u hapën dy Kolegje (Kalabri - 1732, Siçili - 1734), nga ku dolën me dhjetra e dhjetra studiues, dijetarë, shkrimtarë, të cilët dhanë një kontribut shumë të madh në historinë, folklorin, letërsinë, etnografinë, gjuhësinë shqiptare.

Para se të hyjmë tamam në sferën tonë, le të përmendim shkurtazi disa studiues dhe letrarë arbëreshë nga fillimi deri në shekullin e XVIII, të cilët u shquan në lëvrimin e letërsisë fetare dhe në mbledhjen e folklorit.

Lekë Matrënga (1560-1619), autori më i vjetër arbëresh nga Hora (Siçili); më 1592 përktheu nga italishtja dhe e botoi në Romë një Katekizëm **E mbsuame e Krishterë** (Doktrina Kristiane). Vepra ka rëndësi si dokument i një faze të vjetër të të folmeve arbëreshe; ajo tregon për një traditë shkrimi më të herëshme.

Zhuzepe Skiroi (1690-1760), peshkop arbëresh nga Siçilia, qëndroi si misionar 24 vjet në Himarë; thuhet se jipte meshën shqip; ka shkruar një Doktrinë të Krishterë shqip (1729).

Nikollë Brankati (1675-1741), nga Hora; shkroi poezi, këngë fetare.

Nikollë Filja (1691-1769), folklorist dhe poet arbëresh i Siçilisë; përshtati shqip edhe një Doktrinë të krishterë; la dorëshkrim këngë popullore arbëreshe.

Gavrill Dara Plaku (1765-1832), gjyshi i Gavrill Dara i Riu, mbledhës i zellshëm i folklorit në Palac Adriano, në vendlindjen e tij.

Edhe në Kalabri fillon një lëvrim intensiv i letërsisë dhe folklorit; sjellim ndërmend:

Françesko Avati (1717-1800), mbledhës folklori ndër të parët në Kalabri, që arriti të bëhej profesor universiteti.

Jul Variboba (1724-1788), nga Mbusati i Kozencës, vjershëtar i njohur; shkroi në gjuhën e fshatit të tij vëllimin poetik: **Gjella (Jeta) e Shën Mërisë Virgjër** dhe e botoi në Romë në vitin 1762.

Po e vë në dukje edhe punën e madhe të eruditit **Pompilio Rodota**, i cili, duke shkruar për historinë kishtare, na ka lënë shumë faqe mbi historinë e Arbëreshëve, ku i kushton vend të veçantë kohës dhe lavdisë së Skëndërbeut me një ndjenjë të theksuar patriotike, aty rreth vitit 1763. Vepra e tij mban titullin: **Dell' origine, Progreso e Stato Presente del Rito Greko in Italia** (Mbi origjinën, përparimin dhe gjendjen e sotme të rritit grek në Itali)

Pasi vumë në dukje, në pah, kontributin e disa personaliteteve arbëreshe të shekujve XVI, XVII, XVIII në fushën e letërsisë dhe të folklorit të cilët përgatitën terrenin për kërkuesit e shekujve të mëvonshëm, le të fillojmë me studiuesit dhe dijetarët arbëreshë të shekujve XVIII, XIX, XX që dhanë një ndihmesë shumë të madhe në studimin e gjuhës shqipe dhe të prejardhjes së popullit shqiptar, duke i parë radhazi sipas periudhave.

Gjergj Guxeta (1662-1756), i lindur në Piana deli Albanesi afër Palermos; prift famulltar dhe udhëheqës shpirtëror i shqiptarëve në Siçili.

Emri i tij është i lidhur kryesisht me themelimin e Seminarit italo - shqiptar në Palermo (1734) dhe të shkollave të tjera fetare në vendlindjen e tij, të cilat u bënë burim zhvillimi për ruajtjen, lëvrimin dhe pasurimin e gjuhës shqipe, si edhe burim shkollimi për shumë burra të ndritur arbëreshë.

Për Gjergj Guxetën (Giorgio Guxetta) thuhet se ishte i pajisur me virtytet më të mira: urtësi, mirësi, bujari, e dashuri për popullin

dhe për traditat më të vyeshme të tij.

Qëkur ndiqte mësimet mendonte vetëm për të mirën e Kombit shqiptar, i cili përpëlitej në zgjedhën osmane dhe shpresonte “për ta shikuar atë ditë të bekuar e të lumtur të shpëtimit të Shqipërisë, për ta parë prapë të lirë, si në kohërat trimërore të atit tonë Skëndërbe”.

Qëllimi kryesor i Gjergj Guxetës ishte përparimi dhe arsimimi i popullit, i arbëreshëve të Italisë, si edhe lartësimi dhe njohja e gjërë e Kombit shqiptar.

Për këtë synim ai u bë nismëtari i çeljes së këtij Kolegji (Seminari) për ta mbajtur gjallë dhe për ta farkëtuar dashurinë për Mëmdheun, për Shqipërinë, për traditat më të mira të tij; si edhe për mësimin dhe lëvrimin e gjuhës shqipe.

V. Dorsa thotë se Guxeta kishte shkruar edhe një vepër **Etimologjico** (Etimologji) për të cilën nuk dihet gjë, ndërsa Petrota pohon se ai (Guxeta) e quan gjuhën shqipe një “përzierje të maqedonishtes me latinishten”.

Ai është edhe autor i një vepre historike: **Cronica della Macedonia fino tempi di Scanderbeg** (Kronikë e Maqedonisë deri në Periudhën e Skëndërbeut).

Termi **Maqedoni** te arbëreshët shënon Shqipërinë Qëndrore, krahas Maqedonisë.

Pal M. Parrino (1710-1765), nxënës i Guxetës, Rektor i Seminarit, e çoi më tej mendimin e mësuesit të tij.

Ai theksoi se Shqiptarët dallohen përse u përket origjinës, zakoneve, gjuhës nga sllavët dhe grekët; mbrojti tezën se Shqiptarët janë pasardhës të iliro-maqedonasve të vjetër, por shqipen e konsideroi më tepër si vijim të maqedonishtes, me shumë fjalë latine; vuri në dukje strukturën gramatikore të veçantë të saj.

Nikollë Keta (1742-1803), lëvrues i shquar i gjuhës shqipe dhe poet arbëresh nga fshati Kuntisa (Siçili).

Pasi kreu studimet në Kolegjin e hapur nga Gj.Guxeta, u bë prift e më vonë Rektor i atij Kolegji (Seminari).

Ishte studiues i thellë dhe i apasionuar. Hartoi një varg veprash:

Fjalor italisht - shqip (1763); Etimologji e gjuhës shqipe (e humbur); Thesare shënimesh mbi maqedonët - dorëshkrim, (Tesario di notizio su dei Macedoni); Katalogu mbi familjet e mëdha arbëreshe.

Vepra **Thesare shënimesh mbi maqedonët** kishte mbi 250 faqe, sipas Zhuzepe Spatës, i cili e përshkroi dhe i bëri një Përmbledhje mjaft të gjërë në librin e tij **Studi etnologici di Nikolo Cheta** (Studime etnologjike të Nikollë Ketës), botuar më 1867.

Zhusepe Spata (1828-1912), admirues i madh i Nikollë Ketës, shkruan se Keta u përpoq të provojë se Shqiptarët janë pasardhës të Maqedonëve të lashtë dhe se grekët e morën qytetërimin nga Maqedonët.

Zh.Spata vë në dukje se N.Keta, duke studiuar gjuhën shqipe nga ana fonetike, leksikore, strukturore, arriti në përfundimin se ajo është gjuhë që e flitnin maqedonët e vjetër.

Shqipja për N.Ketën është më e vjetër se sa greqishtja dhe populli shqiptar më i vjetër se sa ai grek, bile shqipen e lidhë me pellazgjishten, i pari autor në këtë drejtim, d.m.th., e lidhë me popullsinë e vjetër parahelenike, paragreke.

N.Keta ishte edhe një vjershëtar i mirë. Veprat e tij shumica janë dorëshkrim.

Mikele Belushi (1754-1806) bashkë me të vëllanë **Domeniko Belushi** (1774-1833), predikonin shqip në meshat e tyre; të dy ishin peshkopë nga Frasnita.

Në një botim italisht të vitit 1794 M.Belushi polemizon me një Arqipeshkv katolik duke pohuar se “Ne, Arbëreshët, quhem dhe na kujtojnë për grekë sepse jemi të një Riti fetar me grekët. Po, në të vërtetë, Shqiptarët nuk janë e njëjta gjë me grekët; ata kanë një tjetër origjinë dhe një tjetër gjuhë. Ata dallohen mirë prej tyre nga shumë karakteristika dhe besimi fetar nuk mjafton që të shuajë dallojat midis kombeve. Kështu i njëjti rit latin nuk duhet të na bëjë të përziejmë kaq kombe të Perëndimit evropian, si, bie fjala, francezët me italianët”.

Paskuale Bafa (1749-1799), nga Shën Sofia, ishte një filolog

i shquar klasik i kohës që dha kontribut në gjallërimin e studimeve arbëreshe.

Ëngjëll Mashi (1758-1821), studiues arbëresh, i diplomuar në drejtësi në Napoli.

Në vitin 1807 botoi italisht veprën: **Discorso sull' origine, costumi e stato attuale della nazione albanese** (Sprovë mbi zanafillën, doket dhe gjendjen aktuale të kombit shqiptar), në të cilën vë në dukje autoktoninë e popullit shqiptar, prejardhjen e largët nga Pellazgët, ngre lart luftën e shqiptarëve për liri dhe kërkon që arbëreshët e Italisë të njihen nga shteti si kombësi e veçantë.

Në këtë vepër ka një kapitull të posaçëm për **Arbëreshët**, largimin e tyre, jep fakte me interes edhe për organizimin fisnor të Veriut.

E.Mashi bën fjalë për lashtësinë e popullit shqiptar në bazë të të dhënave të autorëve të vjetër grekë dhe latinë. Mbron tezën e autoktonisë së popullit shqiptar, duke pohuar vijimsinë e gjuhës së maqedonasve, të ilirëve, të epirotëve nëpërmjet shqipes e duke vënë në dukje se gjuha e sotme shqipe është po ajo që flinin maqedonët, ilirët, epirotët në vjetërsi. Tezën e tij mundohet ta argumentojë duke përdorur shembuj gjuhësorë; kështu fjalën **Asspetto** me të cilën - thotë Plutarku - quhej Akili në gjuhën epirote (çka do të thotë **i shpejtë**), e afroi me shqipen **i shpejtë**.

Ai rimerr tezën e Tunmanit për prejardhjen **ilire** të shqipes dhe përpiqet ta vërtetojë me të dhënat e Toponimisë, duke sjellë si shembull emra ilirë e duke i përqsuar me shqipen. Është i pari që vuri në dukje afrinë e emrit të malit **Bora** (një emër mali në kufi në mes të Ilirëve dhe Epirit), me emrin e sotëm **Borë**, çka qëndron plotësisht.

E.Mashi hodhi poshtë mendimet për origjinën kaukaziane të shqipes. Ai mori 60 fjalë të shqipes dhe i krahasoi me gjeorgjishten me ç'rast tregoi se nuk kanë afri; sjell si shembuj 41 fjalë nga dialektet e arbëreshëve për të vërtetuar tezën e tij.

Mashi i kushtoi vëmendje edhe zhvillimit historik të gjuhës shqipe duke theksuar se ajo gjatë shekujve ka pësuar ndryshime e

zhvillime, sepse ka marrë huazime nga greqishtja, latinishtja, sllavishtja etj, çka është një fakt bindës se shqiptarët janë vendas në trojet e tyre të sotme - pohon ai:

Ëngjëll Mashì (Angelo Masci) mbetet një nga burrat e mëdhenj të Arbëreshëve të Italisë.

———— * ————

Në këtë periudhë për gjuhën shqipe interesohen edhe misionarët e huaj, sidomos italianë, të dërguar nga Vatikani.

Nilo Katalano (1637-1694), murg italian, i lindur në Mesinë të Siçilisë; shërbeu në Shqipëri si misionar, konkretisht në Bregdet, në Dhërmi të Himarës ku edhe vdiq.

Ai hartoi një **Sprovë gramatikore të shqipes** dhe një **Fjalor shqip-italisht** dhe **italisht-shqip**.

Fjalori është ndërtuar mbi bazën e veprave të Budit, Bardhit dhe Bogdanit.

Dorëshkrimet ruhen në Bibliotekën Mbretërore të Kopenhagës.

I pari që na bëri të njohur këtë dorëshkrim ka qënë Zef Krispi, por ai që na jep informata më të plota është Zef Skiroi. Ky në veprën **Della lingua albanese e della sua letteratura** -1917 (Mbi gjuhën shqipe dhe mbi letërsinë e saj), thotë se Dorëshkrimin e Katalanos në vitin 1917 e kishte në dorë, se ai është gegërisht; pra as i Himarës ku shërbeu, as i Kolonive Arbëreshe.

Një Dorëshkrim tjetër që mban vitin 1710 i cili është një **Gramatikë** në dialektin gegërisht, ruhet në Manastirin e Grotaferatës (Romë), i hyrë këtu në vitin 1923. Ka një vëllim prej 95 fletësh, por autori nuk dihet.

Në fillim vepra ka një Listë fjalësh që autori i emërton **Fjalor italisht-shqip**, sipas alfabetit; vazhdon pastaj një pjesë e titulluar **Mbi shkronjat e shqipes** dhe përfundon me një **Gramatikë** të vogël e me disa copa katekizmi.

Vepra në fjalë mban këtë datë: Durrës, 12.4.1710.

Pasi radhiten gërmat e Alfabetit, hyn në Morfologji, duke daluar nyjet, dy numra, gjashtë rasë, shtatë lakime e tetë zgjedhime në folje.

Françesko de Mario da Leçe, misionar italian, autor i gramatikës më të vjetër të gjuhës shqip, botuar në Romë më 1716 me titull **Vërejtje gramatikore mbi gjuhën shqipe dhe mbi ortografinë e saj**.

Fr. da Leçe, pasi kreu studimet e larta dhe pasi shërbeu si profesor në Romë, erdhi në Shqipëri më 1692. Më 1702 hartoi një **Fjalor italisht-shqip** që mbeti dorëshkrim.

Nga viti 1705 deri në vitin 1711 dha mësim për shqipen në Romë, ku ndihmoi për hapjen e Katedrës së gjuhës shqipe. Më 1711 kthehet prapë në Shqipëri, ku qëndroi deri në vitin 1713.

Në vitin 1716 botoi **Gramatikën** e lartëpërmendur; me këtë veper emri i tij mbetet i shënuar në historinë e gramatologjisë shqiptare.

Ndre Mjeda thoshte: “Na kena namin e mirë me ken ma t’part ndër popujt e Ballkanit qi kena një gramatikë në g-juh tonë ç’prej vitit 1716”.

Vetë Da Leçe thotë se **Gramatikën** nuk e shkroi për shqiptarët, por për të huajt, prandaj kërkon falje për gabimet që i kanë rrëshqitur.

Vepra e Da Leçes hapet me një **Letër** italisht prej 4 faqesh e datës 25 tetor 1715 (Bari) ku thekson se qëndroi 20 vjet në Shqipëri dhe atje e mësoi shqipen.

Pas kësaj Letre vijon kapitulli me titull **Lexuesit**, në të cilën bën fjalë për qëllimin e kësaj vepre.

Gramatika e Da Leçes ndahet në dy pjesë.

Në **Pjesën e parë** trajtohet Fonetika dhe Morfologjia. Pasi flet për alfabetin e shqipes, hyn në morfologji ku dallon tetë pjesë të ligjëratës (emër, përemër, folje, pjesore, parafjalë, ndajfolje, pasthirrmë, lidhëz), gjashtë rase, dy gjini, dy numra, tre lakime; njeh **nyjet**, flet për **mbiemrin** dhe llojet e **përemrave**.

Kapitulli më i gjërë është ai i **Foljes**, ku dallon dhjetë zgjedhime dhe u kushton vëmëndje foljeve ndihmëse.

Është studiuar mirë **pjesorja, parafjala, ndajfolja, pasthirrma** dhe **lidhëza**.

Pjesa e dytë ka një Kapitull me **Vërejtje rreth Ortografisë së gjuhës shqipe**, një **Tabelë** me numërorë themelorë (1-100).

Vepra mbyllet me mënyrën e përshëndetjeve të shqiptarëve.

Gjatë shekullit XIX, kur u zgjua interesi për shqipen, vepra e Fr. da Leçes ishte një burim i madh për studiuesit. Siç do ta shohim më poshtë, u mbështetën te kjo Gramatikë dijetarët: Adelung, Hobhauz, Ksilandër, Bop, Miklosiç, Mayer etj.

Edhe Severin Vater më 1822 botoi një Përmbledhje të Gramatikës së Da Leçes, prej 50 faqesh.

Përveç Gramatikës së lartpërmendur, Françesko da Leçe hartoi edhe një **Fjalor italisht-shqip** (1702) në dorëshkrim.

Dhimitër Kamarda e përmend dhe jep mendime për të; thekson se e pati në dorë dhe ~~se Da Leçe~~ e kishte shkruar në Mat në vitin 1702, me të njëjtin alfabet që kishte përdorur në Gramatikë.

Do të përmendim edhe dy vepra gramatikore dorëshkrim:

a) Gramatikë shqipe (1722) nga **Didacus a Desio** (Dezio), një misionar italian që erdhi në Shqipëri ku qëndroi 7 vjet (1702-1709), duke shërbyer kryesisht në Kelmend.

Kur u kthye në Romë, mbajti Katedrën e gjuhës shqipe nga viti 1711-1722.

Si mësues i gjuhës shqipe, përpiloi një **Gramatikë të shqipes** e cila mbeti dorëshkrim dhe sot nuk dihet se ku ndodhet.

b) Gramatika e Germanosit nga Kreta, i cili ishte njeri i ditur dhe zotëronte: latinisht, greqisht, frëngjisht, italisht, arabisht, turqisht, shqip e që kishte hartuar gramatika për këto gjuhë.

Rreth vitit 1750 përpiloi edhe për shqipen një **Gramatikë**.

Ishte në manastirin e Limbosit në Greqi.

Vdiq në vitin 1760.

———— * ————

Në shekullin e XVIII fillon të rritet interesi i të huajve për gjuhën shqipe dhe për shqiptarët.

Ndër dijetarët më të shquar që u morën me çështjet e Albanologjisë do të përmendim:

G.W.Lejbnic (1646-1716), filozof gjerman me famë botërore, Kryetar i Akademisë së Shkencave gjermane (1700-1716), autor i veprës filozofike **Monadologjia** (1714); përveç kontributeve të tij në fushën e filozofisë, matematikës, fizikës, gjeologjisë, biologjisë, mekanikës etj, etj, çfaqti interesa edhe për gjuhësinë.

Ai u interesua edhe për shqipen; në pesë **Letra** shkruar dhe dërguar mikut të tij **M.V.Lakrozë** (1661-1739) orientalist francez, kryebibliotekar në Berlin, nga data 24.6.1704 deri më 15.3.1715, shtron problemin e prejardhjes së gjuhës shqipe, të përkimeve, takimeve dhe marrëdhënieve të saj me gjuhët e tjera indoeuropiane dhe të nevojës së dallimit të asaj që shqipja e ka të vetën nga ajo që e ka huazuar.

Ai vuri një Parim të drejtë për studimin e gjuhës shqipe: **Doni të dini origjinën e shqipes? Zhvisheni nga elementët e huaj, studiojeni mirë çfarë ka marrë e nga i ka marrë, dallojeni mirë elementin e vetë shqipes; pra, me një fjalë, zbulojeni vetë skeletin e gjuhës shqipe dhe do të dalë qartë origjinaliteti i saj.**

Në ato **Letra** Lejbnic, ky kollos i dijes njerëzore, vuri në dukje përkime e analogji të fjalëve shqip me fjalë të gjuhëve latine e gjermanike, tërhoqi vëmendjen te mëvetësia dhe individualiteti i shqipes që gjendet në malet e Shqipërisë dhe të Epirit, si gjuhë e veçantë, e dallueshme nga sllavishtja, greqishtja, turqishtja dhe hungarishtja; u interesua për të pasur Fjalorin e Bardhit dhe një vepër të Budit, të cilat i kishte La Krozë.

Në **Letrën** e parë Lejbnici thotë se shqipja nuk ka të bëjë fare me ilirishten dhe pandeh se mos shqipja është bijë e sllavishtes, përderisa flitet në brigjet e Adriatikut.

Në **Letrat** e fundit pranon prejardhjen ilire të shqipes dhe i analizon disa fjalë të saj, duke i krahasuar me gjuhët e tjera.

Lejbnici, autor i thënies **Harmoni e Paracaktuar e Botës**, gjuhën shqipe e quan së fundi “gjuhë e Ilirëve të lashtë”, por Ilirët e lashtë i konsideron të farës Keltë: veteres **Illyrii erant celtici generes** (Ilirët e lashtë ishin të gjinisë kelte).

Hans Tunman (1746-1778), historian me famë botërore i cili

vdiq i ri (32 vjeç).

Në vitin 1774 botoi veprën dinjitoze dhe të pavdekshme që u bë burim i pashtershëm për të gjithë dijetarët që erdhën pas:

Untersuchungen über die greschichte der östlichen europäischen völker (Kërkime mbi historinë e popujve të Evropës Lindore).

Në këtë vepër i kushtoi një Kapitull të veçantë shumë të gjërë Historisë së popullit shqiptar.

Për sqarimin e historisë së popujve, që i mori në shqyrtim, ai përdori edhe material gjuhësor.

Në bazë të argumenteve historike, të nxjerra nga burimet greko-latine e bizantine, por edhe gjuhësore, arriti në përfundimin se Shqiptarët janë pasardhës të drejtëpërdrejtë të Ilirëve, të cilët nuk u romanizuan si Dako-Trakët, as nuk u zëvendësuan nga një popullsi e mëvonshme e dyndur këtu.

H.Tunman në veprën e tij shkruan: “Në historinë e tyre (të shqiptarëve - Xh.G.), unë nuk kam gjetur asnjë gjurmë të ndonjë shtegtimi të tyre të mëvonshëm; gjuha e tyre ka dhënë dëshmi të tilla nga fatet e popullit (shqiptar - Xh.G.) që unë në këta nuk mund të **mos shoh fqinjët e stërmoçëm të grekërve dhe të nënshtetave të Romës së vjetër. Dhe të dyja këto na tregojnë Ilirët e vjetër**”. (nënvizimi im - Xh.G.)

Tunman nënvizon se huazimet latine dhe greke tregojnë se Shqiptarët kanë qënë fqinjë shekullorë të latinëve dhe grekërve.

Ai rrëzoi hipotezën se, gjoja, shqiptarët kanë ardhur nga Kaukazi, duke përdorur argumente të forta historike e gjuhësore; mendon se Ilirët dhe Trakasit ishin fise shumë të afërta në mes tyre.

Tunman vuri në dukje praninë e elementit trak edhe në Ballkanin Perëndimor dhe përmend vendbanimet me emra trakas: **Thermidava** (afër Shkodrës), **Quinmedava** (në Dardani); shënon se **dava** ose **deva** është me burim trak dhe do të thotë **Qytetëz**; thekson se emra qytetesh me këtë element përbërës ka pasur me shumicë në Traki, Daki, Mezi.

Ai vë në dukje edhe huazimet e shqipes nga sllavishtja, latin-

ishtja, greqishtja, por duke theksuar se shqipja ruajti individualitetin e saj.

Aromunët - thotë ai - vinë nga Dako - Trakasit.

Tunman përfshiu në veprën e tij Fjalorin e Kavaliotit që ia kishte dhënë Konstandin Xhehani, një voskopojar i ditur, me të cilin u takua në Halle (Gjermani).

Konstandin Xhehani kishte studiuar nëpër universitete të ndryshme të Evropës; ishte poet, filozof, matematicien, siç e theksuam më lart.

Vepra e Tunmanit është aktuale edhe sot.

Studiuesi hungarez **Von Vindish** në vitin 1782, siç e cekëm edhe më lart, botoi një punim me titull: **Die Klimentinern in Sirmien** (Mbi kelmendasit e Sirmies).

Pak sqarim: Më 1737-1738, gjatë Luftës Austro-Turke, familje shqiptare të Kelmendit morën anën e Austrisë, e cila u thye. Shumë kelmendas, duke mos pranuar të jetojnë nën pushtimin turk, emigruan në viset serbe që ishin nën Austrinë. Ata u vendosën në fshatrat Nikinc dhe Herkovc të Sirmies, në Sllavoni, pranë lumit Sava. Atje, megjithëse larg Atdheut dhe të izoluar midis sllavësh, hungarezësh e gjermanësh, kelmendasit ruajtën për një kohë të gjatë gjuhën dhe zakonet.

Deri në vitin 1921 dimë se kishte edhe katër vetë në Nikinc dhe pesë në Herkovc që e flitnin mirë shqipen.

Sot është shuar plotësisht.

Pikërisht për gjuhën, origjinën, jetën, zakonet, veshjet e kësaj popullsie shqiptare na flet studiuesi në Artikullin e tij.

Von Vindish na jep legjenda e gojëdhëna për kelmendasit se, gjoja, emrin e kanë marrë nga një farë Klementi.

Dijetari në fjalë i përshkruan me simpati të madhe si njerëz të një race të bukur, me zakone fisnike, ushtarë trima, blegtorë të zot që merren edhe me bujqësi.

Ai na tregon se ata martohen vetëm midis tyre, se rrojnë në familje të mëdha prej më se tridhjetë vetash. Bën përshkrimin e jetës së tyre, zakoneve, veshjes, çfarë ka interes për etnografinë.

Duke folur për vallet e tyre, Von Vindish thotë se ata nuk njohin asnjë vegël muzikore, se vallet i përcjellin me këngë, veçanërisht me këngë “që përmbajnë trimëritë e disa heronjve të vjetër të kombit të tyre, sidomos të princit Gjergj Kastrioti”.

Gjuhën e tyre - shkruan ai më tutje - ata nuk e quajnë as shqip, as arbërisht, por kelmendisht.

Lëndën gjuhësore dhe informatat e tjera Von Vindish nuk i mblodhi vet, me ç’rast shkruan: “Këto fjalë (shqipe - Xh.G.) si edhe një pjesë të mirë të këtyre lajmeve, ia detyroi miqësisë të shumë të çmuarit dijetar plotë merita, mjeshtrit Daniel Kornides, që ka afër pesë vjet që ai vet ishte në Herkovce; ato fjalë e fraza ia diktoi këtij një misionar françeskan prej Italie, i quajtur Pater Kandido, i cili qe dërguar atje prej Kongregacionit të Propagandës”.

Pra të dhënat i mori nga historiani transilvan Daniel Kornidesi (1732-1787) i cili i vizitoi ato dy fshatra rreth vitit 1777. Vetë Kornidesi i mori nga misionari italian, Pater Kandido, i dërguar në ato dy fshatra prej Propagandës Fides.

Megjithë gabimet në materialet e mbledhura, sepse u mblodhën nga të huaj, ato prapë kanë vlerë për historinë e gjuhës sonë, sepse na dëshmojnë për gjendjen e një të folmeje të shqipes në shekullin e XVIII.

Von Vindish njeh edhe disa botime të mëparëshme shqip si: Fjalorin e Bardhit, Doktrinën e krishterë të Budit, Fjalorin e Kavaliotit.

Johan G. Herder (1744-1803), kritikë dhe filozof i madh gjerman me famë botërore; në veprën e tij **Ideen zur Philosophie der Geschichte der Menschheit** (Ide për filozofinë e historisë së njerëzimit), botuar në vitet 1784-1791, në një vend pohon, pa sjellë argumente, autoktoninë e shqiptarëve, prejardhjen e tyre ilire dhe karakterin evropian të tyre.

Herder, ky kollos i kulturës, i cili e ka vlerësuar përsëtepërmi Folklorin e popujve, në veprën e lartëpërmendur flet për ardhjen e Hunëve, Protobullgarëve (Bullgarët e parë turanik), sllavëve e më pas cek popuj të tjerë të ardhur si Hazarët, Avarët, Peçenegët etj.

që kanë luajtur rol të tmerrshëm në Perandorinë Romake të Lindjes por që shpesh u kthyen nga erdhën në Azi, ose u shkrin me masën e popujve. Dhe më poshtë ai shkruan: **“Ende më pak të drejtë kemi të futim ata popuj që kanë dalë nga ilirët, trakët dhe maqedonasit e lashtë, d.m.th., shqiptarët, vllahët, arnautët. Ata nuk janë aspak të huaj, por një popull i lashtë i familjes evropiane; dikur ata kanë qënë kombe kryesore, kurse sot kanë mbetur si gërmadha të braktisura të shumë popujve dhe gjuhëve”**.

Pra ideja e tij gjeniale është se **Shqiptarët** dhe **Rumunët** (Vllahët), nuk janë popuj të ardhur, nuk janë popuj të huaj, por popuj të lashtë evropianë dhe, për më tepër, dikur kanë qënë kombe kryesore, ndërsa më vonë, me kalimin e shekujve, për vet kushtet historike, shfaqen si gërmadha të hedhura njëra mbi tjetrën.

———— * ————

Në fund të shekullit XVIII u bë e njohur vepra e studiuesit spanjoll **Lorenzo Hervas Y Panduro** (1735-1809), i cili jetoi dhe vdiq në Itali, me titull: **Katalogu i gjuhëve të popujve të njohur. Njehsimi i tyre. Ndarja dhe klasifikimi i tyre sipas të folmeve dhe dialekteve**.

Vepra përmban rreth 300 (treqind) gjuhë. Për 40 gjuhë jep edhe përshkrimin e strukturës gramatikore të tyre.

Në këtë Katalog shqipes i kushton rreth 20 faqe duke shtruar edhe problemin e prejardhjes së saj. Mendon se shqipja është e ndryshme nga gjuhët e Evropës; pohon se Shqiptarët kanë ardhur nga Albanët e Kaukazit, shumë kohë para se të vinin sllavët në Ballkan, se vetë Ilirët kanë ardhur nga Kaukazi në kohët prehistorike. Jepen edhe tekste për shqipen: dy versione fetare nga arbëreshët e Italisë dhe nga Kelmendi i Sinjës.

Më 1797 dijetari gjerman (natyralist) **Simon Pallas** (1741-1811) botoi në Petërburg një Fjalor shumëgjuhësh, (me 276 gjuhë) me titull: **Fjalori i krahasuar i të gjitha gjuhëve dhe të folmeve** (Evropë, Azi, Afrikë, Amerikë). Këtu gjenden edhe 270 fjalë shqip me përkthim rusisht. Është përdorur alfabeti rus.

Më 1806-1807 gjuhëtari i njohur gjerman **J.Ch.Adelung** (1732-1806), botoi një Fjalor me titull: **Mitridati ose Gjuhësi e përgjithshme**, që përmban 500 (pesëqind) gjuhë. Këtu është një Lutje: **Ati ynë që je në qiell**, përkthyer në të gjitha këto gjuhë, është edhe në shqip.

Në këtë vepër flet edhe për **shqipen**, duke e kundërshtuar mendimin e Tunmanit për prejardhjen ilire të shqipes, si edhe duke mospranuar asnjë lidhje të shqipes qoftë me gjuhët e Ballkanit, qoftë me gjuhët e tjera të Evropës.

Gjuhëtari i përmendur e vendos shqipen, bashkë me hungarishten, nën Rubrikën “Gjuhë të përzierra në Evropën Juglindore” dhe shkruan: “Po të çlirohej ajo nga gjuhët gjermane, sllave, romake, greke dhe turke, do të mbetej një material themelor i konsiderueshëm, i cili, me sa di unë, nuk e ka origjinën me asnjërin nga gjuhët që njihen”.

Adelung mendon se Shqiptarët janë “një mbeturinë e përzier e trungut tartar”, se shqiptarët vinë nga gjyshër bullgarë turq, se shqiptarët e vjetër ishin protobullgarët e paasimiluar ose stërgjyshërit e shqiptarëve janë shpërngulur para turqve nga vise në lindje të Detit të Zi, se ata janë kushurinjtë e Albanëve të Kaukazit.

Më tutje ai shkruan: “Populli i fundit që sundoi këtu para turqve ishin bullgarët - fis tartar. Mund të mendosh se shqiptarët janë mbeturinë e përzier e këtij populli. Mirëpo mund të pandehet se ka ndonjë lidhje midis këtyre shqiptarëve dhe Albanëve në Lindje, midis malit Kaukaz dhe lumit Kir. Ka të ngjarë që të jenë identik me Alanët në Evropë dhe në Rusinë Jugore, të cilët madje në kohën e Ammianit quheeshin Alani”.

Adelung mendon se shqiptarët kanë ardhur në viset ku janë sot në shekullin e V ose si Alanët dhe Bullgarët, në shekullin e VII.

Severin Vater (1771-1826), e redaktoi dhe e botoi veprën e Adelungut në vitin 1822 në të cilin përfshiu në të edhe një Përmbledhje të shkurtër të Gramatikës së Da Leçes.

Ai nuk e miraton hipotezën mbi origjinën kaukaziane të popullit shqiptar. Shpreh mendimin se korrespondencat e shqipes me

latinishten mund të kenë të bëjnë me një origjinë të përbashkët të bartësve të këtyre gjuhëve.

J.S.Vater jep edhe informata për ndarjen dialektore të shqipes sipas Pukëvililit.

Von Arndti në përpunimin e Fjalorit të krahasuar që u hartua në kohën e careshës Katerinë të Rusisë thotë se shqipja ka lidhje burimore me gjuhën e Iberëve të Spanjës.

H.Suinbörn (Swinburne), udhëtar anglez në veprën **Trawels in the two Sicilie** (Udhëtime në dy Siçili), botuar në Londër në vitet 1783 e 1785, në vëllimin e parë thotë se **Shqipja** njihet në Europë prej gati njëqind vjetësh, se ajo nuk ka alfabet të saj, se gërmat latine e greke nuk i japin mirë disa tinguj të saj. Mendon se shqipja është një përzierje me plotë fjalë të latinishtes, të greqishtes së vjetër, të frëngjishtes, gjermanishtes, bile edhe të anglishtes.

Jep disa fjalë anglisht që gjejnë përdorim në shqip.

Konrad Malte - Brun (1755-1822), gjeograf i njohur me origjinë daneze, por që punoi në Francë; në veprën e tij, disa vëllimshë **Annales des Voyages de la Geographie et de l'histoire** (Analet e udhëtimeve në gjeografi e në histori), botuar në Paris në vitin 1809, publikoi të përkthyer frëngjisht, veprën e Mashit. Merr 102 fjalë nga E.Mashi dhe harton nëfund të veprës një Fjalor.

Malte-Bryn në veprën e lartëpërmendur mbrojti tezën e lashtësisë së popullit shqiptar, duke pohuar se shqipja është më e vjetër se sa greqishtja, se ajo lidhet me greqishten parahomerike; pra shprehu idenë e prejardhjes së shqiptarëve nga Pellazgët.

Një **Shënim** i tij ka të bëjë me huazimet e disa fjalëve të shqipes nga gjuhët e tjera, duke theksuar se **shqipja** është gjuhë më vete, por ka shumë fjalë të huazuara.

Malte-Bryn nënvizoi edhe disa përkime të shqipes me gjuhët e tjera indoeuropiane.

Nga vinë këto?

Është Franc Bopi, i pari, siç do të flasim më poshtë, në kapitullin përkatës, që sqaroi se ato kanë një burim të përbashkët, sepse janë gjuhë indoeuropiane, rrjedhin nga një trung.

Malte-Bryn vuri në dukje edhe ndonjë përkim në mes të toponomisë ilire dhe shqiptare; kështu, sikurse Mashi, **Bora**, emri i një mali në trevat e Ilirisë, e afroi me shqipen **Borë-a**.

Dijetari në fjalë në veprën e tij ka folur edhe për një “Alfabet kishtar”, të shqipes dhe e kërkon origjinën e këtij alfabeti jo te alfabeti latin, ku bazohet gati krejtësisht, por në alfabete të ndryshme të lashtësisë: - fenike, hebraike, armene, jeroglifike. Në fakt është Alfabeti i J.Vellarait, për të cilin folëm më lart.

Periudha e dytë

Në këtë Etapë studimi i gjuhës shqipe arrin maja të larta, qoftë nga dijetarë shqiptarë, qoftë nga dijetarë të huaj.

Me fillimin e shekullit XIX u bënë hapja të rëndësishëm në të gjithë shoqërinë e asaj kohe.

Zhvillimi i të gjitha degëve të shkencës, përparimi i artit, kulturës, arsimit, rritja shumë e nivelit të dijes në të gjitha sferat, çoi në progresin e shoqërisë njerëzore.

Duhet theksuar se në zhvillimin dhe përparimin e shkencave shoqërore **tre** ishin faktorët kryesorë:

1. Depërtimi i konceptit historik, çka solli një këndvështrim të ri në progresin e shoqërisë njerëzore, në një interpretim të ri të dukurive të ndryshme shoqërore, duke i parë ato nga një kënd historik, si zhvillim në bazë të ligjeve të caktuara.

Të gjitha këto kaluan edhe në gjuhësi.

2. Lindja dhe zhvillimi i Romantizmit, e cila qe një Rrymë e fuqishme në shekullin e XIX që u shfaq në fusha të ndryshme të shkencave shoqërore, veçanërisht në Letërsi, por që ndikoi edhe në Gjuhësi.

Përgjithësisht Romantizmi e kthen fëtyrën nga e kaluara e popujve, interesohet për popujt e panjohur, primitivë, për të kaluarën e tyre të papërsëritshme, për folklorin, gjuhën, zakonet, traditat e tyre të paarritshme dhe të mrekullueshme.

3. Njohja e sanskritishtes, e gjuhës së vjetër letrare të Indisë së lashtë, si edhe e disa gjuhëve të popujve të vegjël e të panjohur, çka solli fakte të reja për krahasim.

Lindi Metoda historiko-krahasuese, e cila solli një tip të ri gramatike: **Gramatika historiko-krahasuese** në të cilën përqasen të dhëna e fakte gjuhësore nga shumë gjuhë indoeuropiane.

Rilindja europiane patjetër ndikoi edhe në kombin shqiptar nga i cili dolën burra të ndritur edhe atdhetar të flaktë. Ata, të arsimuar dhe të edukuar nëpër shkollat europiane, ku u pajisën mirë me dije e kulturë bashkëkohore, me ndjenja të zjarra patriotike, iu kushtuan çështjes shqiptare, arsimimit të popullit shqiptar, u përpoqën të

venë në pah lashtësinë e këtij kombi, virtytet e pastërta të tij. Për këtë qëllim ata gërmuan deri në thellësi të shekujve, përtej Ilirëve, deri te Pellazgët.

Hani në veprën e tij **Studime shqiptare** formuloi tezën se epirotët, maqedonët ishin jogrekë, barbarë dhe, bashkë me ilirët, janë farefis në mes tyre, se ilirishtja është gjuhë pellazgjike në një kuptim të gjërë, se të gjithë këta popuj janë të ardhur prej pellazgëve.

Rilindasit tanë të mëdhenj këtë ide të Hanit e rrëmbyen me entuziazëm, vetëm e vetëm për të dëshmuar autoktoninë e tejlash-të të kombit shqiptar; sidomos arbëreshët nuk pushuan së theksuari së Ilirët ishin pasardhës të Pellazgëve.

Edhe në vitin 1964 studiuesi **Spiro Konda** botoi librin **Shqiptarët dhe Problemi Pellazgjik**, ku u mundua të provojë se shqiptarët janë pasardhës të Ilirëve e këta të fundit pasardhës të Pellazgëve.

Historikisht pellazgët janë një popull në trevat e Ballkanit, më konkretisht në trevat e Greqisë, të Ilirisë e të Trakisë, i tejlashtë, paragrek, parailir, paratrak, i dëshmuar nga zbulimet arkeologjike dhe i përmendur nga autorët grekë, të cilët e quanin Pellazgë popullsinë paragreke.

Disa dijetarë kanë menduar se grekët, ilirët, italikët e vjetër, kur zbritën në trevat mesdhetare, gjetën aty popullin e vjetër pellazgjik, rreth 2000 vjet para erës së re.

Patjetër popujt indoeuropianë që u vendosën ku janë sot, nuk i gjetën vendet e zbrazëta, por gjetën banues, të cilët u shkrinë me ardhësit, pas një bashkëjetese të gjatë, duke lënë gjurmë në gjuhën dhe zakonet e pasardhësve.

Në Spanjë edhe sot e gjithë ditën jetojnë Baskët të cilët flasin një gjuhë që nuk është indoeuropiane.

Personalisht mua, autorit të këtyre radhëve, profesor Eqrem Çabej më ka pohuar se çështja pellazgjike as që duhet ngritur, se, s'ka asnjë rëndësi se pasardhës të kujt ishin Ilirët, se mjafton të vërtetohet se ne shqiptarët jemi pasardhës të Ilirëve që me fillimin

e Epokës së Re, se Pellazgët janë një popull shumë i lashtë (mbi 4000 vjet), i pidentifikuar mirë, se edhe grekët pohojnë se janë pasardhës të Pellazgëve, se patjetër edhe në trevat ilire (shqiptare) ka pasur fise parailire, të cilët në një mënyrë ose tjetër edhe mund të jenë asimiluar nga fiset ilire, çka ka ndikuar edhe në gjuhë.

Nga fusha e etnografisë N.Jokli përmend zakonin e **Kuvadës** ndër reliket e kulturës paraindoeuropiane. Këtë zakon e shënon edhe K.Kristoforidhi për Belsh të Dumresë së Elbasanit kur thotë: **Mërkosh** i thonë burrit që, kur len fëmija, dirgjet në shtrat porsi Lehona duke pritur e përcjellë ata që vijnë për ta parë.

Ky zakon ka qënë te Baskët, si edhe në Francën mesjetare.

Nga fusha e gjuhësisë N.Jokli si reliket sheh numërimin **vigesimal** (me njëzetë), i cili qëndron kundrejt numërimit **dekadik** (me dhjetëshe) karakteristikë për botën indoeuropiane.

Është pranuar se sistemi i numërimit mbi bazën e **Njëzetës** nuk është i tipit indoeuropian por nëna e shqipes, ilirishtja, e ka marrë nga substrati (nënshtresa) i saj.

Pra **Njëzetë, Dyzetë** (te arbëreshët e Italisë e të Greqisë trezet “60”, katërzet “80”) dëshmojnë për ruajtjen e gjurmave të një sistemi numërimi paraindoeuropian, i cili mbështetej në numrin **Njëzetë**, sikurse në gjuhën baske sot (krahaso edhe frëngjishten: quatre-vingts, katër-njëzeta, “80”).

Në numërimin **tridhjetë, pesëdhjetë, gjashtëdhjetë...etj**, shqipja ka ruajtur sistemin e numërimit indoeuropian, duke shtuar numërorin e thjeshtë (tre, pesë, gjashtë...) para numërorit Dhjetë.

Mendohet se edhe fjala **Mal** është marrë nga ai Substrat (nënshtresë) parailir.

Tani le të vështrojmë Rilindasit tanë sipas radhës, sipas kohës kur vepruan.

Kjo periudhë fillon me Arbëreshët.

Mikele Skutari, famulltar i fshatit arbëresh të Shën Konstandinit; ka shprehur mendime të vyera në një vepër të botuar në vitin 1825 në Potenza me titull: **Notizie storiche sull' origine e stabilimento degli Albanesi nel Regno delle du Sicille, sulla loro in-**

dole linguaggio e rito, compilate dal R.Arciprete di S.Constantino, Dr.Michele Scutari, Potenza, 1825 (Lajme historike mbi origjinën dhe vendosjen e Shqiptarëve në mbretërinë e Dy Sicilive, mbi bazën e gjuhës së tyre të vjetër dhe të riteve, kryer nga R.Arciprete i Shën Konstandinit, Dr.Mikele Skutari Potenza, 1825).

Aty ai mbron me krenari origjinën “fisnike” të popullit shqiptar i cili - thotë M.Skutari - nuk duhet të përzihet me popujt e tjerë dhe i fton bashkatdhetarët e vet që të kenë dijeni “për origjinën e tyre si pjesëtarë të një kombi të vjetër”.

Mikele Skutari pohon se “Me të vërtetë, duke konstatuar se prej shumë shekujsh erdhi brenda kësaj mbretërie të Napolit një komb si ai arbëresh, krejt i ndryshëm në gjuhë, rite fetare, zakone e mënyrë jetese, ç’turp i madh është për italianët të injorojnë se si erdhi ai e si u prit në viset e tyre e ç’turp i madh për vetë arbëreshët të jetojnë të pavetëdijshëm ndaj origjinës së vetë”; dhe më tutje vijon: “Pasi do të shqyrtoj origjinën e tyre, domosdo duhet të bëj fjalë për natyrën e tyre, për doket, zakonet, mënyrën e jetesës që i karakterizon e, mandej, duhet të prekë me të shpejtë **karakterin e gjuhës dhe do të përpiqem të shpjegoj se si ajo nuk është një grumbull i pacaktuar, i kombinuar nga shumë mënyra të të foluri, por e njëjta gjuhë që e flasin dhe e kanë si gjuhë amtare bashkatdhetarët e Epirit, të Shqipërisë, të Ilirëve e të Maqedonisë**” (nënvizimi im - Xh.Gosturani).

Rol pozitiv për të ruajtur kulturën shqiptare kanë luajtur në fillimet e shekullit XIX, siç thamë, edhe **Mikele Belushi** dhe i vëllai i tij, i famshmi peshkop **Domeniko Belushi**, drejtues i Kolegjit të Shën Adrianit në vitet 1803-1833, të dy nga Frasnita.

Zef Krispi (Giuseppe Crispi: 1781-1859), një nga përfaqësuesit kryesor të Rilindasve arbëreshë; Klerik, Rektor i Seminarit arbëresh të Palermos; më vonë profesor i greqishtes në Universitetin e atij qyteti.

I lindur në Palazzo Adriano (Siçili) ai është një studiues i shquar qoftë për greqishten, qoftë për shqipen.

Që në vitin 1827 boton librin **Memorie sulla origine e fondazione di Palazzo Adriano** (Kujtime mbi origjinën dhe themelimin e Palazzo Adriano) ku autori bën historikun e fshatit të vet arbëresh Palazzo Adriano dhe tregon për mosmarrëveshjet që lindën midis klerit otodoks të fshatit dhe atij katolik që erdhi e u vendos aty.

Kleri katolik - thotë Krispi - nuk orvatet vetëm që t'i kthej me forcë arbëreshët në ritin latin por edhe i lufton gjuhën dhe zakonet, me qëllim që ata të humbin kombësinë. Ai shkruan: **E' la lingua di una nazione, che ne mantiene gli usi e le costumanze, ed e' cosa piu' dubbia, le Nazioni mantenersi, o distuggersi a misura che se ne mantiene, o si distrugge la lingua** (Është gjuha e një Kombi që ruan zakonet dhe doket dhe dyshohet se Kombet ruhen ose shkatërrohen në atë masë që ruhet apo shkatërrohet gjuha).

Në vitin 1831 botoi veprën **Memoria sulla lingua Albanese** (Përkujtimore mbi gjuhën shqipe). Autori titullit i shtoi edhe këtë shënim: **së cilës i tregohet natyra e saj shumë e vjetër**.

Ai u përpoq të tregojë lashtësinë shumë të thellë të shqipes që sipas tij, është në themel edhe të gjuhës parahomerike.

Krispi mbase është ndër të parët që vjetërsinë e shqipes e lidh me popujt parahistorik - me **pellazgët**. Është mbështetur të N.Keta, të cilin e kishte pasur si mësues në Seminarin Arbëresh të Palermos. Mendon se Pellazgët ishin një popull më i lashtë se grekët dhe se kishin një gjuhë së cilës i diktohen gjurmët në gjuhën shqipe.

Maqedonët dhe Epirotët flisnin të njëjtën gjuhë - pohon ai.

Krispi orvatet të gjejë etimologjinë hebraike greke, latine etj, të më se dyqind fjalëve. Në ndonjë rast ka edhe lajthitje: **Pellazg** e shpjegon me fjalën shqipe **Plak**, por e pa drejt fjalën **Dalmatia**, **Delmatia** të cilën e lidhi me shqipen **Delme**, **Dele**, çka është plotësisht e vërtetë.

Ai, me sa duket, është i pari që shtron tezën e afrisë midis **shqipes dhe etruskishtes**, duke theksuar se njohja e shqipes ndihmon shumë për të shpjeguar monumentet etruske; bën edhe ndon-

jë krahasim fjalësh në mes të dy gjuhëve: fjalën etruske **Larthes** që tregon **Zotërinë**, e shpjegon me shqipen **Lart**.

Mendimin e tij se shqipja rrjedh nga pellazgishtja do ta përkrahin dhe do ta çojnë më tej Jovan Skiroi, Jeronim de Rada, si edhe një radhë Rilindas tanë të mëdhenj.

E njohur është edhe vepra e tij mbi zakonet arbëreshe: **Memorie storiche di talune costumanze appartenenti alle colonie greco-albanesi di Sicilia - Palermo 1853** (Kujtime historike mbi disa doko që u përkasin kolonive greko-shqiptare të Sicilisë).

Aty është botuar edhe folklor arbëresh.

Zef Krispi mbetet një dijetar i thellë.

Vinçens Dorsa (1823-1885), studiues dhe atdhetar i flaktë arbëresh.

Më 1847 në Napoli botoi veprën **Sugli Albanesi - Ricerche e pensieri** (Mbi shqiptarët - gjurmime dhe mendime).

Kjo vepër tërhoqi vëmendjen e një opinioni të tërë për pasurinë e të dhënave historike, gjuhësore, folklorike, etnografike, letrare. Interes të veçantë kanë **Shënimet** që bëjnë fjalë për historinë e ngulimeve arbëreshe, për njerëzit e tyre të shquar, për gjuhën dhe historinë e popullit shqiptar, si edhe të dhënat për zakonet dhe këngët popullore arbëreshe.

Ishte edhe një folklorist i zellshëm arbëresh i shekullit XIX.

Optimizmi i tij për kombin shqiptar, të shpërndarë por një të vetëm, ishte i madh. Me besim ai sheh ditën kur edhe shqiptarët do të hyjnë në qytetërim.

Në vitin 1861 botoi veprën tjetër: **Studi etimologici sulla lingua albanese** (Studime etimologjike për shqipen).

Në këtë vepër u përpoq më tepër të shpjegojë origjinën pellazgjike të shqipes. Por krahasimet dhe përfundimet shumë herë janë edhe të pabaza; p.sh. fjalën **dorë** në shqip e përçasi dhe e afroi me fjalët **dorom** (greqishte e vjetër) dhe **donum** (latinisht) të cilat kanë kuptimin **Dhuratë**, çka nuk shkon fare.

Por Dorsa pat edhe krahasime të qëlluara: **dru** e krahasoi me greqishten e vjetër **drys**; **vjet** e afroi me latinishten **vetus** dhe me

greqishten e vjetër **etos**.

Disa pohime të tij janë të gabuara kur thotë se shqiptarët janë pasardhës të fisit të vjetër grek Eolët dhe shqipja bijë e eolishtes.

Ai tha se shqipja ka lidhje me gjuhët semitike (arabishten). Dorsa ishte mësues në shkollat greko-latine; kishte njohuri të mira, por nuk ishte i përgatitur për studime shkencore, nuk njihej me arritjet e mira të shkencës gjuhësore.

Dhimitër Kamarda (1821-1882), arbëresh me kulturë të gjërë, gjuhëtar dhe mbledhës i folklorit; njeri shumë i ditur.

Në vitin 1864 botoi veprën: **Saggio di grammatologia comparata sulla lingua albanese** (Sprovë e gramatologjisë krahasuese e gjuhës shqipe).

Në këtë vepër ai u përpoq të japë një gramatikë historike-krahasuese të shqipes.

“Me të - shkruan Petrota - i ngrehi një përmendore të pavdekshme gjuhës sonë”.

“Emri i Kamardës - thotë G.Mayeri - meriton të përmendet e të ngrihet në historinë e shkencave”.

“Libri i tij i siguron përngaherë një vend të zgjedhur midis shqiptarëve dhe është një stoli e vërtetë për literaturën filologjike” - pohonte Askoli.

Vepra e tij ndahet në tri pjesë: **Fonologji, Morfologji, Sintaksë**. Është shumë e rëndë në të lexuar dhe me të meta të mëdha. Ka vëzhgime me interes për dialektet e shqipes.

Në pjesën e **Fonologjisë** flet për korrespondimet fonetike, ndërsa në pjesën e **Morfologjisë** vëzhgon lakimin e emrave, përemrave, mbiemrave, numërorëve, bën fjalë për zgjedhimin e foljeve, për pjesët e pandryshueshme të ligjëratës, për formimin e fjalëve.

Në pjesën e fundit vështron përdorimin e emrave, mbiemrave dhe të parafjalëve në **Sintaksë** etj.

Kamarda në këtë vepër flet për lidhjen e ngushtë të shqipes me greqishten e vjetër, përpiqet të nxjerrë në dukje fijet e përbashkëta që shfaqen në shqipen e tanishme e në shqipen e lashtë me greqishten klasike, çka nuk ka asnjë bazë. Ai mbron tezën se **shqipja**

afrohet me **çiftin pellazgjik**, por më tepër me greqishten se “të dyja janë kundruall njëra-tjetrës si dy binjakë”, mendim ky tashmë i hedhur poshtë.

Dh.Kamarda bëri disa krahasime të drejta: **njeri-aner** (greqishte e vjetër); është e njëjta temë indoeuropiane; pohon me të drejtë se **sk** indoeuropiane ka dhënë në shqip **h: gnosko** (latinisht) - **njoh** (shqip); **s** ka dhënë **th: sus** (latinisht) - **thi** (shqip). Ka edhe krahasime të gabuara.

Më vonë botoi vëllimin e dytë **Shtojcë e gramatologjisë së gjuhës shqipe**, ku solli materiale të reja.

Ai u mor edhe me problemin e gjuhës letrare dhe mendon që të jetë dialekti jugor, duke marrë elemente të të folmeve kalimtare; pohon se si gjuhë kulture të jetë greqishtja.

Më 1869 botoi **Alfabetin e përgjithshëm të gjuhës shqipe**.

Më 1870 doli në dritë, nën kujdesin e tij, një Pëmbledhje vjer-shash me titull: **Dora D’Istrias - Shqiptarët**.

Dhimitër Kamarda kishte lidhje me Dora D’Istriian, Th.Mitkon, Jeronim de Radën etj.

Zef Kamarda (1831-1878), i vëllai i Dhimitrit, përktheu Ungjillin e Shën Mateut në dialektin e Horës së Arbëreahërve, si edhe është autori i një **Pëmbledhjeje me Këngë Popullore Arbëreshe**.

Jeronim de Rada (1814-1903), poet, publicist, folklorist, filolog, një nga personalitetet më të mëdha të kulturës arbëreshe, dhe shqiptare të shekullit XIX.

Ky kollos i dijes dhe kulturës arbëreshe, ky patriot dhe atdhetar shumë i madh, që në vitet dyzetë të shekullit XIX, u përpoq të tregojë identitetin e shqiptarëve me pellazgët dhe u mundua të shpjegojë shumë emra perëndish greke me shqipen.

Gjithë jetën e tij mbrojti pikëpamjen se shqipja rrjedh nga pel-lazgjishtja; bile e kundërshtoi edhe mendimin e G.Majerit se sh-qipja rrjedh nga ilirishtja.

Në vitin 1840 De Rada botoi një Shkrim me titull: **Divinazio-ni Pelasghe** (Hyjni pelazgjike).

I entuziazmuar nga idetë e Krispit, si edhe nga lidhja e ngushtë

miqësore me bashkëfshatarin e Krispit, Emanuel Bidera që merrej edhe ky me këtë çështje, në vitin 1844 Jeronim de Rada e ribotoi shkrimin e tij me titull: **Identità degli Albanesi con i Pelasghi** (Identiteti i Shqiptarëve me Pellazgët) në librin e Bideras: **Passegiate per Napoli e Contorni** (Shëtitje nëpër Napoli dhe Rrethina).

Ky artikull më pas u ribotua prej mikut të tij arbëresh **Tomazo Paçe** në Fletoren e Athinës **Minerva** të vitit 1845. Shkrimi i lartëpërmendur pati jehonë prapë në Rumani sepse në vitin 1846 **Eliade Radulesku** e ribotoi në gazetën e tij.

Autori iu kthye kësaj teze disa herë si në vitin 1864 në librin **Antichità della Nazione Albanese** (Lashtësia e kombit shqiptar) dhe më 1885 në artikullin **Pelasghi ed Elleni** (Pellazgët dhe Helenët), botuar në vitin 1893 në **Conferenza su l'antichità della lingua albanese**, mbajtur në Napoli (Konferenca mbi lashtësinë e gjuhës shqipe).

Në këto studime De Rada, siç na kumton vet, vuri në dukje “fondin unik” të emrave të politeizmit heleno-latin dhe tregoi se ky Fond shpjegohet “vetëm me gjuhën shqipe”.

Në vitin 1871 qarkulloi libri **Gramatika e gjuhës shqipe**, me autor Zef de Rada, i biri i Jeronimit.

Zefi ka vdekur në vitin 1883 në moshë të re. Kur u botua kjo **Gramatikë**, ai ishte 17-18 vjeçar, gjimnazist, prandaj kjo vepër është padyshim e të jatit - e Jeronim de Radës. Mbase këtë gjë e bëri Jeronimi për ta nxitur të birin drejt studimit të gjuhës shqipe, pasi ai ishte me talent ose e bëri edhe për oportunitet politik kombëtar që të shtohet edhe një firmë tjetër për studimet shqiptare, ashtu siç kishte bërë njëzetë vjet më parë me të vëllain, Kamilin, të cilit ia dhuroi **Gramatikën** e vitit 1847, duke e vënë atë si autor.

Libri **Gramatikë e gjuhës shqipe** e Zef de Radës u shit menjëherë dhe u kërkua me ngut nga shumë dijetarë që interesoheshin për shqipen.

Gramatika në fjalë është ndërtuar mbi bazën e gjuhës popullore të arbëreshëve të Italisë, duke shfrytëzuar edhe poezinë pop-

ullore dhe shkrimtarët arbëreshë.

Pas një **Kushtimi** drejtuar Elena Gjikës, vepra shpaloset me një **Parathënie**, ku vihet në dukje qëllimi i autorit dhe theksohet se **E folmja e arbëreshëve** i ka të gjitha cilësitë për të qënë **bazë e gjuhës sonë letrare kombëtare**, sepse ajo, sipas autorit, përmbledh në gjirin e vet të gjithë larmitë dialektore që u bartën nga mërguesit e ndryshëm dhe se ajo ruan më mirë se të tjerët dialekte shenjat shquese të një kulture të moçme.

Kjo ide, të cilën e ka mbrojtur me zell gjatë tërë jetës, është e gabuar, çka u kundërshtua që atëhere, sidomos nga arbëreshi i përmendur në drejtësi Pjetër Kjara.

Në këtë vepër jepet pak **Fonetikë**, ku flitet për alfabetin, për zanore e bashkëtingëllore, për diftongje, për theksin etj.

Morfologjia është shtjelluar hollësisht; ka rëndësi të theksohet këtu se ai e pranon dhe bën fjalë për Asnjanësin.

Vepra ka vlera të shënuara për gramatikën historike, për leksikologjinë e leksikografinë dhe sidomos për dialektologjinë, sepse na jep të dhëna për të folmet arbëreshe të shekullit XIX.

Më 1894 Jeronim de Rada botoi italisht veprën **Tipare dhe Gramatikë e gjuhës shqipe**. Libri ka dy pjesë: **Fonetikë** dhe **Morfologji**.

Në **Hyrjen** e saj De Rada shpreh konsideratën e tij për lashtësinë dhe pasurinë e shqipes, si edhe disa mendime për Alfabetin që duhet përdorur për të.

Në **Fonetikë** jepen njoftime për vokalizmin, duke dalluar shtatë zanore, për bashtingëlloret, për grupet e bashtingëlloreve, për diftongjet, për theksin, tonin, gjatësinë etj.

Qoftë fonetike, qoftë morfologjia është studiuar mirë nga ana shkencore dhe kanë mjaftë ndryshime nga Gramatika e vitit 1871.

Qëllimi i Jeronim de Radës në këtë vepër duket se është të zbulojë rrënjët e thella historike të shqipes, të lartësojë origjinalitetin dhe forcën shprehëse të saj, të pasqyrojë larminë e formave gramatikore, të tregojë pasurinë leksikore dhe laryshmërinë e trajtave fonetike.

Me këto dy Gramatika ai solli një kontribut të madh në historinë e Gramatologjisë shqiptare.

Në veprimtarinë gjuhësore të Jeronim de Radës duhet përmendur edhe organizimi i dy **Kongreseve gjuhësore të shqipes**: i pari në vitin 1895, kurse i dyti në vitin 1897.

Vetë ai dha mësimin e gjuhës shqipe në Kolegjin arbëresh të Shën Mitër Koronës për disa dekada.

Gjatë shekullit XIX një Plejadë e tërë dijetarësh arbëreshë në fusha të ndryshme të dijes si në histori, letërsi, folklor, etnografi etj, prekën anë të ndryshme të gjuhës shqipe, duke dhënë kështu një ndihmesë të mirë në sferën e Albanologjisë.

Andrea Dara (1796-1872), nga Palazzo Adriano (Siçili), i biri i **Gavrill Dara Plakut** (1757-1835) dhe babai i **Gavrill Dara i Riu** (1826-1885) përveçse mblodhi folklor, sikurse i gjithë brezi i tij, hartoi edhe një **Fjalor** italisht-shqip dhe shqip-italisht (1867), një **Punim** mbi zakonet e fshatit të tij, ndërmori hartimin e një **Gramatike** të shqipes (1830) - pothuajse të gjitha dorëshkrim.

Xhovani Skiro (Giovani Schiro) ose **Jovan Skiro**, për jetën e të cilit nuk dihet shumë, ishte nga Piana deli Albanesi (Siçili), profesor në shkollat e ndryshme të mesme të Palermos.

Në një studim të gjërë **Raporti tra l'Epiro e il Regno delle due Sicilie, Memorie** - Palermo, 1834 (Raportet midis Epirit dhe Mbretërisë së dy Siçilive, Kujtime), e cila u botua edhe si libër i veçantë, gjenden katër **Memorie**: **E para** trajton çështjen e preardhjes pellazgjike të shqiptarëve; mendon se pellazgjishtja akoma rron te shqipja; ndjek rrugën e Ketës dhe të Krispit.

Në Memoriet e tjera autori merret me historinë e popullit shqiptar që nga lashtësia e deri në vdekjen e Skëndërbeut.

Emanuel Bidera (1784-1858), nga Palazzo Adriano (Siçili), ishte letrar dhe piktor, por u mor edhe me çështjen pellazgjike.

Në vitin 1844 botoi librin **Passegiate per Napoli e Contorni** (Udhëtime nëpër Napol dhe Rrethina), ndërsa më 1846 publikoi në Napoli dy vëllime: **Quaranta secoli: Racconti su le due Sicile del Pelasgo Matneer** (Dyzetë shekuj: Tregime mbi dy Siçilitë e

Pellazgut Matne-eer).

Në këto dy vëllime, sidomos në të parin, ka lëndë të ndryshme nga visari i shqipes. Ai përpiket t'u japë shumë fjalëve shqipe etimologjinë pellazgjike; sjell vargje të ndryshme nga të folmet arbëreshe, këngë popullore etj. Në vëllimin e parë gjenden disa **Shënime gramatikore**, si edhe disa emra personash të Mitologjisë greke, të cilëve ai kërkon t'u gjejë etimologjinë shqipe, duke cituar Ketën, Krispin, De Radën, Maltebryn.

E. Bidera ishte mik i Jeronim de Radës.

Engjëll Bazile (Angelo Basile: 1813-1848), prift, por me ide përparimtare, i lidhur shumë ngusht me çështjen kombëtare. Ishte nga Plataci (Kozencë) dhe mik i De Radës; shkroi, por edhe mbledhi folklor.

P. Matranga (1807-1855) nga Piana deli Albanezi, me kulturë të gjërë, rektor kolegji në Romë ku edhe vdiq. Shkroi vjersha, përktheu, mbledhi folklor, por u mor edhe me studimin e gjuhës shqipe.

Luigj Petrasi (vdekur 1843) nga Qana (Kalabri), aktivist i viteve dyzetë, mbledhës i këngëve popullore. Përktheu Këngën e parë të veprës së Bajronit Çajlld Harold në shqip.

Cesare Marini, mik i De Radës, aktivist i Revolucionit të viti 1848; mbledhës folkori.

G. Tocci, mik i De Radës, arbëresh i ditur, studiues i ngulimeve arbëreshe (1850).

Nikola Arçiprete, kryeprift në fshatin Lungo (Kozencë); ka mbledhur këngë të vjetra arbëreshe.

Anton Santori (1818-1894), letrar; la dorëshkrim një **Gramatikë** të gjuhës shqipe në vjershë.

Bernard Bilota (1843-1918), nga Frasnita (Kalabri), letrar, poet, folklorist, filolog, mik i De Radës.

Është autor i një **Dizionario filologico albanese** (Fjalor filologjik i gjuhës shqipe) i vitit 1888, me 6000 fjalë i cili përmban 200 faqe me material gjuhësor nga e folmja e Frasnitës, si edhe shumë sprova etimologjike, duke gjurmuar etimologjinë e shumë fjalëve dhe emrave të shqipes që nga Pellazgët.

B. Bilota mbron tezën pellazgjike të shqipes dhe të shqiptarëve.

Ai ka shkruar edhe vepra të tjera si **Zakonet e Frasnitës** etj, dhe foli për **Alfabetin**.

Mikele Markiano (1860-1921), letrar dhe gjuhëtar, emri i të cilit është i lidhur me atë të Jeronim de Radës, jo vetëm pse u lind në Maqi, por edhe pse u mor gjërësisht me studimin dhe përhapjen e veprës së De Radës.

Markiano punoi shumë në fushën e folklorit, duke botuar një Përmbledhje për këtë sferë; ai u dallua në fushën e letërsisë dhe në atë të studimeve filologjike.

U shqua dhe si lëvrues i gjuhës shqipe.

Pjetër Kjara (1840-1915), nga Pallaci i Siçilisë, kushuri i Gavrill Dara i Riu, jurist dhe gazetar, i cili vizitoi edhe Shqipërinë; është autor i dy librave italisht për Shqipërinë: **L'Albania** - Palermo 1869, monografi me 12 krerë për gjuhën, letërsinë, historinë dhe politikën shqiptare; **L'Epiro, gli Albanesi e la Lega** - Palermo 1880 (Epiri, Shqiptarët dhe Lidhja).

(Lidhja Shqiptare e Prizrenit).

Anton Argondica (1839-1918), poet, folklorist dhe filolog nga Mbuzati (Krahina e Kozencës); është botues i Revistës Ylli i Arbëreshërve, në vitin 1896.

Ai vizitoi edhe Shqipërinë.

———— * ————

Në mesin e shekullit XIX Gjuhësia Historiko-Krahasuese po korrtë suksese të mëdha.

Udhëtarë dhe diplomatë të huaj, të pajisur me kulturë e dije të thellë, njohës të shumë gjuhëve, dynden në Shqipëri, në një vend të virgjër, ku mbledhin një material të pasur folklorik, gjuhësor, etnografik, historik, arkeologjik, gjeografik dhe hartojnë vepra dinjitoze, të cilat mbeten monumente të kulturës shqiptare dhe i bënë të pavdekshëm emrat e autorëve të tyre.

Fransua Pukëvil (1770-1838), mjek, historian, natyralist, arkeolog, diplomat francez. Ishte Konsull i përgjithshëm i Francës në Janinë, pranë Ali pashë Tepelenës (10 vjet). Vizitoi një pjesë të madhe të vendit tonë, nga Janina deri në Shkodër e Kosovë.

Pukëvili ishte dashamirës i madh i popullit grek dhe përgjithësisht ka urrejtje për Ali Pashë Tepelenën dhe për shqiptarët, me ç' rast fajtor për gjendjen e tyre të mjeruar i bën vetë shqiptarët dhe jo pushtuesit shekullorë.

Në vitin 1820 diplomati francez botoi frëngjisht veprën **Voyage dans la Grece** (Udhëtim në Greqi) në pesë vëllime; në dy vëllimet e para jep edhe një Pamje historike dhe gjeografike për Shqipërinë, shpesh të pasaktë.

Në **vëllimin e dytë**, në një Kapitull flet gjithashtu për gjuhën shqipe. Këtu gjendet Alfabeti që përdor për gjuhën shqipe: 27 gërma (dy greke).

Më 1826 e ribotoi veprën duke e plotësuar dhe rishikuar me gjashtë vëllime.

Në **vëllimin e tretë**, të këtij botimi në kapitullin e XII bën fjalë për shqipen. Këtu ka renditur edhe një Fjalorth me rreth 700 fjalë shqip me përkthimin frëngjisht, si edhe disa shënime gramatikore.

Në **Shënimet gramatikore** Pukëvili informon lexuesin se gjuha shqipe, në pikëpamje të intonacionit, ka shumë analogji me frëngjishten, se ajo ka dy numra dhe tre gjini, se emri lakohet pa ndihmën e nyjes ose si në latinisht; jep 30 fjalë numërorësh, emrat e muajve dhe të ditëve të javës; ka edhe disa tabela lakimi dhe zgjedhimi, jo shumë të sakta.

Ai ndesh në gjuhën shqipe fjalë të njëjta ose të ngjashme dhe shumë analogji të tjera, me frëngjishten, italishten, rumanishten, gjermanishten, latinishten, greqishten, të cilat, pohon ai, janë rezultat i kontakteve të popujve.

Shënimet gramatikore të konsullit frëng mbyllen me disa pyetje - përgjigje dhe me disa përshëndetje familjare, gjithsej 22.

Pukëvili në veprën e tij pohon se shqiptarët janë popull i veçantë dhe nuk ka lidhje të ngushtë me asnjë popull të Ballkanit. Por e mundon dyshimi: A është ky popull pasardhës i Ilirëve apo ka prejardhje nga Kaukazi? Dhe përgjigjet: “Dijetarët që do t’i krahasojnë fjalët e Fjalorit shqip, të cilat unë po i paraqes në fund të këtij kapitulli, me ato të gjuhëve të tjera, do të gjejnë ndoshta disa tipare speciale të ngjashmërisë ndërmjet shqiptarit të Ilirisë maqedone dhe të atyre që jetonin pranë Detit Kaspik”.

Këtë tezë të tij, Tezën Kaukaziane sipas së cilës Shqiptarët kanë ardhur nga Kaukazi, nga Skythët pranë Detit Kaspik, çka në vitet e mëvonshme do ta përkrahin edhe të tjerë, ai mundohet ta mbështesë me të dhëna gjuhësore; merr emra fisesh kaukaziane dhe i krahason me emra fisesh shqiptare: **Mirditën** e përqsas me fisin **Mardataive** të Kaukazit, **Gegët** i afron me **Gogët** e Kaukazit.

Sipas tij shqipja ka marrë nga Skythët (pranë Detit kaspik) fjalë të tilla si **U** (uria), **zjarm** (zjarr) etj.

Diplomati francez mendon se maqedonët e vjetër ishin grekë dhe jo popull i veçantë në këtë Gadishull, me ç’rast shprehet: “Ata që e përkrahin këtë mendim (d.m.th. maqedontë nuk ishin grekë-shënimi im Xh.G.), më kot pretendojnë të bindin se maqedonët flitnin gjuhë tjetër nga ajo e grekërve”; pra nuk pajtohet me mendimin e autorëve të lashtësisë Straboni, Plutarku, Tukididi, të cilët pohojnë se maqedonët nuk kanë qenë grekë.

Pukëvili dalloi pesë fise të shqiptarëve: **Mirditë, Gegë, Toskë, Lab, Çam** e, si rtrjedhim, pesë dialekte.

Vepra e tij në lidhje me shqipen dhe shqiptarët, ka mangësi e të meta të mëdha.

H.Hekard (Hecquard 1814-1866), diplomat dhe studiues francez, Konsull i përgjithshëm në mesin e shekullit të kaluar në Shkodër; në veprën e tij **Historia et Description de la Haute - Albanie ou Guegarie** (Historia dhe Përshkrimi i Shqipërisë së Epërme ose Gegëria), botuar në Paris në vitin 1857, thekson prejardhjen ilire të Shqiptarëve me ç'rast edhe shkruan: "Po të kishin ardhur shqiptarët në Evropë në ndonjë kohë jo aq të largët, do të diheshin imigrimet (hyrjet, ardhjet) e tyre, por historiografia nuk na thotë asgjë në këtë drejtim. Nga kjo natyrisht nuk duhet të konkludojmë se ata kanë ardhur në Shqipëri që në periudhat më të lashta. Popujt e parë të racës së bardhë, të cilët e kanë pushtuar Evropën, para bile edhe Keltëve dhe Grekërve, janë Ilirët, Etruskët e Thrakasit; mandej **Ilirët janë paraardhësit e shqiptarëve të sotëm**" (nënvizimi im - Xh.G.).

Më tutje Hekardi shkruan: "Për sa i përket gjuhës, karakterit etnik dhe pamjes fizike, ky popull nuk ka asnjë lloj ngjashmërie, as afiniteti me asnjërën nga racat e tjera që e popullojnë Turqinë evropiane, d.m.th., as me rumunët, as me grekët, as me sllavët dhe as me turqit osmanllinj.

Shqiptari është popull sui generis" (i një lloji të veçantë).

Xhozef Riter Ksilander (1794-1854), me profesion oficer i xhenios në Mbretërinë Bavareze, por edhe studiues i shquar gjerman. Libri i tij u botua në Frankfurt. Mbi Majn, gjermanisht me titull: **Die Sprache der Albanesen oder Schkipetares** (Gjuha e albanezëve ose e shqiptarëve - 1835). Përmban 13+320 faqe. Ka shfrytëzuar materiale nga Da Leçe, Kavalioti, Pukëvili, por burimi kryesor mbetet Bibla e Korfuzit (1827), botuar nga Grigor Gjirokastro-triti.

Vepra përmban: një **Gramatikë**, dy **Tekstel**, të cituara nga Bibla, materiale Folklorike, **Fjalor** gjermanisht-shqip dhe shqip-gjermanisht me 3500 fjalë.

Në fillim të **Gramatikës** ai jep konsiderata për Alfabetin e gjuhës shqipe, i cili, sipas tij, ka 33 shkronja. Përdor alfabetin grek, por me disa shtesa për të dhënë vlerën e disa tingujve të gjuhës

sonë. Pastaj bën fjalë për emrin, mbiemrin, nyjen, përemrin, numërorët, ndajfoljet, parafjalët dhe më gjërë për foljen.

Vepra është shkruar për të huajt që duan të mësojnë shqipen, mbi bazën e toskërishtes, duke mos munguar edhe konsiderata për gegërishten.

Vepra ka rëndësi të madhe për historinë e gjuhës shqipe, pasi ka të dhëna me shumë interes.

“Vepra e tij - thotë Falmerajer - doli si një statujë e bukur, pa shpirt, derisa Hani erdh e i dha frymë, gjallëri dhe jetë”.

Ksilander është i pari që argumentoi, ende në mënyrë të pamjaftueshme, prejardhjen indoeuropiane të shqipes.

Nga një analizë e leksikut të gjuhës shqipe arriti në përfundimin se shqipja nuk është një përzierje pa formë prej gjuhëve të reja romane, as nuk ka burim tartar dhe se lënda themelore e konsiderueshme e shqipes është indoeuropiane, se, për karakterin indoeuropian të shqipes, nuk mund të ketë asnjë dyshim, se shqipja e ka burimin te gjuha ilire.

Pra hodhi poshtë mendimin e Adelungut për të cilin folëm më lart.

Argumentat e Ksilanderit janë nga fusha e leksikut, por, megjithatë, janë të qëndrueshme. Ai ka edhe pasaktësi sepse nuk dalloi fjalët e huazuara nga leksiku i trashëguar i një gjuhe. Ai bëri krahasime me shumë gjuhë deri me sanskritishten:

asht, është - est (latinisht) - **ast** (sanskritisht); **njeri** - aner (greqisht) - **nar** (sanskritisht). Drejt e pa fjalën **valë**, të krahasueshme me gjermanishten **wele**, por jo fjalën **shtëpi** kur e krahasoi me gjermanishten **shtube** (shtëpi vjen nga latinishtja *hospitum*).

Ksilander miratoi mendimin e Kopitarit për karakterin ilir, ballkanik të shqipes, duke pohuar se shqipja ka ruajtur edhe shqiptimin antik të huazimeve latine me **c**: **cicer - qiçër, civitatem - qytet**.

Ksilander vuri re gjithashtu ndonjë afri midis shqipes arumanishtes dhe bullgarishtes dhe shtroi i pari hipotezën se këto gjuhë mund të kenë një bazë të përbashkët, të hershme ballkanike, pra

një **substrat**; ai vuri në dukje nyjen e prapme në këto gjuhë. Ksionder pa edhe ndonjë mbaresë emërore, foljore dhe gjeti elemente të përbashkëta me gjuhët gjermanike dhe sanskrite.

Si përfundim ai pohoi origjinën iliro-trake të shqipes, pasi këto gjuhë ishin të afërta.

Pikërisht me veprën e tij fillon studimi shkencor i gjuhës shqipe.

Xhon Kam Hobhaunz (1786-1869), më vonë Lord Broton. personalitet politik letrar anglez, shok shkolle dhe mik i ngushtë i Bajronit, të cilin e shoqëroi në udhëtimet e tij në Shqipëri, Greqi, Turqi, etj. Përshkrimin e këtij udhëtimi e dha në veprën **A journey through Albania and other provinces of Turkey in Europa and Asia duering jears 1809-1810** (Një udhëtim përmes Shqipërisë dhe provincave të tjera të Turqisë në Evropë dhe Azi gjatë viteve 1809-1810), botuar në Londër në vitin 1813, botim i ripunuar në vitin 1855.

Vëzhgimet e tij për Shqipërinë përfshijnë pjesën jugperëndimore deri në Tepelenë. Jep një përcaktim të kufijve etnik të shqiptarëve dhe një tablo të jetës ekonomike-politike të vendit. Atë e tërheq shumë figura e shqiptarit me doket, zakonet, gjuhën, këngët, vallet dhe sidomos ndjenja e fuqishme kombëtare.

Një vend të rëndësishëm në veprën etij zë Ali pashë Tepelena.

Vepra ka 1175 faqe; në fund boton Gramatikën e Da Leçes prej 25 faqesh dhe disa këngë popullore të arbëreshëve të Greqisë, të mbledhura nga vetë ai.

Kundërshton mendimin e Da Leçes, sipas të cilit shqipja dhe italishtja kanë afri; vë në dukje se shqipja ka edhe huazime; thekson se afria mund të jetë e vërtetë vetëm për kalabrishten dhe italishten.

Hobhauz ka edhe mendime të padrejta, të pabaza shkencore kur thotë: 24 dialektet e Shqipërisë së lashtë aziatike. Por më tutje pohon se në Shqipëri mund të dallohen mbeturinat e dukshme të një gjuhe të lashtë që nuk ekziston më. E ka fjalën për ilirishten apo pellázgjishten vallë?!

Nuk dihet.

Alfabeti që përdori është me bazë latine, por krijoi edhe disa kombinime për të pasqyruar tingujt e shqipes.

W.Martin Lik (1777-1860), ushtarak anglez, topograf, artilier, gjeograf, arkeolog.

Në fillim shërbeu në Flotën angleze e pastaj Konsull pranë Ali pashë Tepelenës.

Është autor i dy veprave anglisht: **Resarches in Greece** - 1814 (Kërkime në Greqi) dhe **Travels in Northen Greece** - volum 1-4, 1835 (Udhëtime në Greqinë Veriore).

Në **veprën e dytë** gjejmë materiale përshkruese, të bollshme për ekonominë, shoqërinë dhe gjendjen politike të Shqipërisë Jugore nën sundimin e Ali pashë Tepelenës, si edhe për vendgjetjet arkeologjike.

Në veprën e parë **Kërkime në Greqi**, përveç materialeve të ndryshme me karakter ekonomik-shoqëror e politik, jep edhe **Shënime mbi Gramatikën shqipe**, ndërtuar mbi materialet e toskërishtes jugore, më konkretisht mbi disa veçori të të folmeve të Vithkuqit, të Përmetit dhe të Gjirokastrës, të përpiluara me ndihmën e një shqiptari, mësuesit të gjimnazit të Janinës Jani Evstrat Vithkuqari (1755-1822); bile mendohet se ky është hartuesi. (Ish-te njeri me kulturë të gjërë; u mor edhe me shqipen).

Vëmëndje i ka kushtuar edhe Fjalëformimit.

Në veprën e Likut gjejmë shumë të dhëna për historinë e Shqipërisë dhe të Ballkanit. Por kujdes më të madh i ka lënë Greqisë dhe gjuhës së saj.

Ai i jep të dhëna me interes për gjuhët e Ballkanit, duke theksuar tiparet e përbashkëta; jep një histori të shkurtër të Shqipërisë ku dallon katër fise: Gegë, Toskë, Lab, Çam.

Vepra në fjalë ka një **Fjalor** greqisht-shqip me 2100 fjalë i cili ka rëndësi për historinë e leksikologjisë shqiptare.

Martin Liku boton Kushtrime në pesë gjuhë (përveç gjuhëve ballkanike edhe anglisht); jep fraza, biseda me qëllim që të vëjë në dukje fjalorin më të përdorshëm. Në Fjalor është mbështetur shumë

te Kavalioti dhe Danieli.

Autori u shpreh për origjinën ilire të shqipes; u hedh një sy huazimeve greke, latine, sllave, gote, turke, italiane, franceze, duke dhënë edhe kohën kur depërtuan.

Në veprën **Kërkime në Greqi** thotë: “Por duhet të konsiderohet e çuditshme që ajo (=shqipja) ka një karakter të ndryshëm në mes të gjuhëve rreth saj, duke qënë, pas gjithë gjasash, Ilirishtja e vjetër, me disa ndryshime të të njëjtit lloj, si ato që ka pësuar latinishtja dhe greqishtja prej pushtesve teutonikë dhe sllavë të Evropës Jugore”.

Terminologjia gramatikore është anglisht, kurse alfabeti që përdori është latinisht, por me disa kombinime që i pa të nevojshme.

Vepra e Likut qëndron ndër veprat më të mira të asaj periudhe dhe mbetet Vepër pionieri në Ballkanistikë.

Joan Georg Fon Han (1811-1869), me profesion jurist, por me interesa shumë të gjëra shkencore: gjuhëtar, historian, folklorist, etnograf; ishte doktor në drejtësi.

Në vitin 1834 u dërgua në Greqi për të ndihmuar shtetin e sapoformuar grek, me ç’rast hyri në punë në Ministrinë e Drejtësisë.

Vetë Fuqitë e Mëdha në atë periudhë dërguan një mori nëpunësish për të ndihmuar shtetin grek.

Hani punoi pastaj (1843-1847) si Konsull provisor në Athinë. Më 1847 emërohet si Zëvendëskonsull i Austrisë, prej nga ishte, në Janinë, e cila kishte 26000 banorë. Këtu ra në kontakt me shqiptarët dhe me Shqipën. Ai u njoh me dy studentë shqiptarë që studionin në Gjimnazin Zosimea: me elbasanasin Konstandin Kristoforidhi dhe me Apostol Panajotin nga Labova e Gjirokastres.

Në fillim Hani u mor me mbledhjen e folklorit, por shpejtë, aty nga viti 1850, ai ngarkohet nga Austria të studiojë situatën politike dhe ekonomike në Shqipëri. Kështu më 22 korrik të vitit 1850 u nis nga Janina për Gjirokastër; vizitoi Delvinën, Vlorën, Myzeqenë, Peqinin, Durrësin, Matin, Shkodrën, gjithnjë duke mbajtur shënime. Sëmuret nga ethet dhe kthehet në Vjenë për të pushuar. Në

vjeshtën e vitit 1851 arriti në Syra, si Konsull i Austrisë për Greqinë Lindore, ku mbeti deri në vitin 1855. Ndërkohë në Jena më 1854 botoi kryeveprën e tij në tre vëllime: **Albanesische Studien** (Studime shqiptare), e cila e bëri shumë të njohur në botën shkencore. Është një Enciklopedi e vërtetë; ajo karakterizohet nga një pasuri e madhe material nga fusha e gjuhësisë, historisë, folklorit, etnografisë.

Vëllimi i parë përmban përshkrimin e vendit, gjendjen e shoqërisë së atëhershme shqiptare, historinë dhe prëjardhjen e popullit shqiptar.

Vëllimi i dytë merret me strukturën gramatikore të shqipes nga pikëpamja fonetike dhe morfologjike mbi bazën e toskërishtes. Autori e titullon: **Kontribut për një gramatikë të dialektit toskë.**

Por duhet nënvizuar se Gramatika e Hanit paraqet gjithashtu edhe një kuadër të plotë të fonetikës krahasuese në mes të dy dialekteve, si dhe morfologjinë e tyre.

Në fillim vepra në fjalë ka një Parathënie e pastaj vijon alfabeti shqip me 33 shkronja greke, duke dhënë shënime për zanoret dhe bashkëtingëlloret. Morfologjia hapet me Nyjen, pastaj analizon Emrin, duke dalluar tre lakime, Mbiemrin, Përemrin dhe Numërorët.

Një kapitull i kushtohet Foljes, duke dalluar dy zgjedhime e disa klasa.

Kapitull i veçantë u kushtohet Parafjalëve, Ndajfoljeve dhe Lidhëzave.

Në fund është një **Fjalor** gjermanisht-shqip, dhe shqip-gjermanisht me 5500 fjalë.

Vetë autori thotë se kjo vepër i kushtoi katëer vjet punë, kur ishte konsull në Janinë.

Vepra e Hanit u bë gurrë e pashtershme për gjuhësinë historiko-krahasuese evropiane, për dijetarët që merreshin me shqipen; me një fjalë e bëri botën shqiptare të njohur në rrethet kulturore-shkencore evropiane.

Për qëllime kryesisht politike Hani ndërmori një udhëtim nga Beogradi deri në Selanik në vitin 1858, rezultat i të cilit është vepra **Reise von Belgrad nach Saloniki - 1858** (Udhëtim prej Beogradi në Selanik).

Nga viti 1859 deri në vitin 1863 Hani është përsëri në Syra.

Më 1864 i përktheu gjermanisht dhe i botoi dy vëllime **Përralla greke dhe shqiptare** (Griechische und Albanesische Märchen), me një Hyrje teorike mbi Origjinën e përrallave.

Materialin e kishte mbledhur që më parë në Janinë dhe rrethet e saj. Ai ishte një mbledhës i shkëlqyer i Përrallave popullore.

Në vitet shtatëdhjetë ai do të botojë edhe veprën tjetër **Studime për gojëdhënat me vëzhgime krahasimtare**.

Më 12 gusht të vitit 1863 Hani arrin me vapor në Durrës, me gjithë një Ekip; nga këtu nisët për në Tiranë, pastaj në Mat. Kudo mban shënime: përralla, këngë, zakone, doke, besime popullore, gojëdhëna etj.

Në Mat ai vërejtë se popullsia i mbahet Kanunit të Skëndërbeut, si edhe në Dibër, ndërsa pjesa veriore e Malësisë i përmbahet Kanunit të Lekë Dukagjinit, Kanunit të Maleve.

Nga Mati arrin në Shkodër, më pas në Dukagjin, nëpër Malësi e në Prizren (Kosovë). Nga Prizreni mbërrin në Dibër e, pastaj, nëpër Strugë, Ohër, Prespë e në Selanik. Si pasojë e këtij udhëtimi doli vepra tjetër e tij: **Reise durch die Gebiete des Drin und Vardar - 1867** (Udhëtime nëpër viset e Drinit dhe të Vardarit).

Në vitet 1864-1869 Hani kaloi në Syra. Në janar të vitit 1869 sëmuret nga asma, shkon në Vjenë për shërim dhe vdes më 25 shtator të vitit 1869, në moshën 59 vjeçare.

Hani u përpoq të tregojë origjinën ilire të shqipes. Ai kishte korrespondencë të rregullt me gjuhëtarin e njohur në tërë Evropën, **August Fridrih Pot** (1802-1887), themeluesi i shkencës së vërtetë etimologjik indoeuropjane, i cili dyshonte në përfshirjen e shqipes në Trugun indoeuropian dhe në pre-

jardhjen e saj nga ilirishtja.

Më 1856 u botua nga Poti një artikull kundër A.Shlajherit dhe Hanit në të cilin mohohet prejardhja e shqipes nga ilirishtja dhe pohohet afëria e saj me greqishten.

Ky artikull nuk zuri vend.

Sipas A.Potit analogjitë në formën e trupit, në besime, në zakone, në gojëdhëna ose edhe në tingujt e fjalëve, janë prova jogjuhësore, d.m.th., të pavërtetuara gjuhësisht, ato janë - përsëriste Poti- vetëm pikëmbështetje të lëkundshme që të çojnë edhe në gabime. Megjithë lutjen e Hanit dhe dërgimin e materialeve të tij, Poti ishte në mëdysheje.

Më në fund A.Poti e pranoi prejardhjen ilire të shqiptarëve, por për të mbeti enigmë marrëdhënia e ilirishtes me pellazgjishten.

Në veprën **Studime Shqiptare Hani** problemin e prejardhjes së shqiptarëve dhe të shqipes e shtron për zgjidhje shumë më gjërë se sa paraardhësit. Për këtë qëllim shfrytëzoi burimet antike që flasin për karakterin jogrek të ilirëve, të epirotëve dhe të maqedonëve, duke ndjekur kështu rrugën e Tunmanit.

Në **vëllimin e parë** të veprës së lartpërmendur ai pohon se shqiptarët janë “pasardhësit e banorëve të lashtë parasllavë të vendit”. Këta banorë parasllavë i quan **pellazg**, të cilët i barazon me ilirët. Ai mbron tezën pellazgjike të shqipes me zjarr, çka më vonë e përqaftuan Rilindasit tanë të mëdhenj.

Vetë shënon ilirisht-pellazgjisht në kuptimin më të gjërë. Më tutje ai shkruan: “... duke qënë se shqiptarët nuk janë sllavë dhe me asnjë popull nuk kanë afri, duke qënë se burimet, me të vërtetë të pakta, përveç shtegtimit sllavë, nuk bëjnë fjalë për asnjë shtegtim tjetër që të ishte i mjaftë rëndësishëm për të krijuar një popull të madh, atëherë njeriu ka të drejtë të pranojë që shqiptarët e sotëm janë pasardhësit e banorëve të lashtë parasllavë të vendit”. Dhe më poshtë shton: “Prandaj neve na duket shumë e natyrshme pranimi që stërgjyshërit e shqiptarëve të sotëm qysh në kohën e romakëve dhe të grekëve zinin vend-

banimin e sotëm të tyre dhe që zakonet e tyre të përbashkëta me popujt fqinjë janë ruajtur në mënyrë më të pastërt dhe më besnike se sa te fqinjët e tyre”.

Pastaj ai vë në dukje se “Epirotët, Maqedonët dhe Ilirët ishin farefis” dhe se “Në hulumtimet e mësipërme ne kemi arritur në përfundimin se Epirotët dhe Maqedonët, të cilët ishin farefis midis tyre, duket se formojnë një degë të madhe të mëvetësishme të trungut Ilir”.

Për Hanin Ilirët ishin një nga degët themelore të popullsisë paleobalkanike, të cilët qëndronin përballë grekëve të vjetër në mënyrë të mëvetësishme.

Hani, për të argumentuar tezën e tij, shfrytëzoi shumë të dhënat e **Onomastikës** dhe i shpjegoi me anë të shqipes disa **toponime** ilire. Ai vërtetoi se shumë emra vendesh të viseve shqiptare ishin vazhdim i drejtëpërdrejtë i emërtimeve të dikurshme ilire, me ç’rast zbuloi mjete fjalëformuese ilire që rrojnë në emrat e sotëm shqiptar.

Siç e kemi theksuar në pjesën e parë të kësaj vepre, është Hani ai që e krahasoi **Dalmatia**, **Delmatia**, për nga kuptimi, por edhe për nga forma me shqipen **Delme**, **Dele**, **Delmer** (bari dhenësh). Ky krahasim është plotësisht bindës, pasi emrin e qytetit **Dalmion** të Ilirëve, Straboni e quan në greqisht **Fushë dhënëushqyese** çka vërteton se në ilirishten **Dalm** ose **Delm** ka qënë emri i **Deles** së cilës në Veri sot i thonë **Delme** (Tropojë-Kosovë). Gjithashtu, për më tepër për nga pamja e jashtme, prapashtesën **-ates** të emrit etnik **Delmates** e afroi me prapashtesën **at** të shqipes që gjendet në emra të tillë si **Dukat**, **Filat**.

Një krahasim tjetër i qëlluar që bëri Hani ishte emri **Dardania** (Kosova e sotme), me fjalën e shqipes **Dardhë**, **Vend dardhash** (dard-dardh); vetë ai, më vonë, kur e përshkoi gjithë Kosovën, e gjeti të vërtetë këtë barazim gjuhësor (dard-dardh, Dardani - vend dardhash), pasi pa me sytë e vet se sa shumë dardha të buta e të egra bëhen në ato anë.

Dijetari në fjalë drejtë e pa gjithashtu barazimin **Olcinium**

(latinisht), **Oulkinion** (greqisht), me shqipen **Ulk, Ujk** (Ulqini i sotëm).

Hani arriti në përfundimin se shqipja është vazhduese e drejtëpërdrejtë e njërit prej dialekteve të vjetra të ilirishtes dhe u bë një mbrojtës i vendosur i autoktonisë së shqiptarëve. Ishte i mendimit se ilirishtja ka qënë një gjuhë pellazgjike në kuptimin e gjërë të fjalës.

Mendimet e Hanit ishin në kundërshtim me tezën e përhapur në shekullin e XIX se, gjoja shqipja lidhej me greqishten si gjuhë motra, për shkak të prejardhjes së përbashkët të shqiptarëve dhe të grekërve prej Pellazgëve.

Duke u mbështetur te Herodoti, Hani tha se para grekërve kanë banuar banorë jogrekë - **Pellazg** dhe se në kohën e grekërve të lashtë, në Veri të tyre jetonin popullsi jogrekë (barbar). Ai theksoi se ky popull **barbar** që do të thotë **I huaj** e që janë pasardhës të pellazgëve, ishin Ilirët e vërtetë.

Hani gjeti elemente të përbashkëta në mes të Ilirëve dhe Shqiptarëve edhe në organizimin shoqëror e fisnor.

Tezën e tij u përpoq ta argumentojë edhe me të dhëna historike, arkeologjike, etnografike, bile edhe me legjenda.

Hani mendoj se gjeti një **Alfabet** të vjetër të shqipes dhe e quajti **Alfabet pellazgjik**. Mirëpo më 1901, Gj.Pekmezi u dërgua prej Akademisë së Shkencave të Vjenës në Elbasan për studimin e shkrimtarëve dhe shkrimeve të vjetra të këtij qyteti. Pas një verifikimi të imtë rezultoi se Alfabeti i përmendur nga Hani nuk ishte i vjetër, por i shpikur vonë nga Dhaskal Todhri, për të cilin folëm më lart.

Hani mbetet një nga Kolloset e Albanologjisë. N.Jokli thoshte se Hani është një Gjani.

Karl Hajnrih Teodor Rajnhold (1834-1880), me profesion mjek, i lindur në Gotingen të Gjermanisë; pasi mbaroi Fakultetin e Mjekësisë, shkoi në Greqi ku do të gjente një atdhe të dytë. Atje shërbeu si mjek e më vonë si kryemjek në Flotën Mbretërore derisa vdiq. Pikërisht këtu ra në kontakt me Ar-

bërëshët e Greqisë të cilët zinin 1/3 e popullsisë.

Më 1855 botoi veprën **Net Pellazgjike** (Noctes Pelasgicae) ose **Kontribut për të njohur dialektet pellazgjike të Greqisë**.

Vepra ndahet në tri pjesë:

a) **E para** përmban një Gramatikë të shqipës ose një skicë gramatikore.

b) **E dyta** ka një Fjalor.

c) **E treta** ka Tekste (Antologji). Gjithë materiali është mbledhur te Arbëreshët e Greqisë në Atikë; në ishujt Poros, Hydra.

Ka rëndësi të madhe kjo Vepër për dialektologjinë shqiptare, për leksikologjinë historike, për folkloristikën; me një fjalë për të folmet e atyre anëve para 150 vjetëve.

Që në Parathënien e librit ai shkruan: “Kaq jam dhënë pas gjuhës së ëmbël të tyre (të marinarëve arbëreshë të Greqisë - shënimi im, Xh.G.) e kaq më ka kapur një dëshirë e madhe për visaret e saj, sa që mjaft kohë pushimi që më tepëron prej punëve mjekësore, e kaloi duke studiuar gjuhën elegante të shokëve (= të Marinarëve arbëreshë të Flotës Mbretërore helenike - shënimi im Xh.G.) dhe gjithënjë kënaqem edhe nga vetë tingulli i së folmes shqipe”.

Në faqen e parë **Pellazgjishtja** autori shkruan greqisht këto fjalë. Përsa u takon Pellazgëve (d.m.th., Arbëreshët e Greqisë - shënimi im Xh.G.) **ata janë më të vjetër se sa ata që sundojnë sot në Greqi**” (nënvizimi im - Xh.G.).

Më pas vjen një kapitull tjetër: **Dialekti i Marinarëve**. Për të shkruar gjuhën shqipe, Rajnholdi thotë: “Më pëlqen më tepër të përdor shkronjat latine që të evitojë atë përzierje të mërzitshme të shenjave dhe të thekseve që ka greqishtja, ndërsa për të shtjelluar gjërat pellazgjike mendova të përdor gjuhën greke”.

Në faqen e tretë fillohet me alfabetin e krijuar nga Rajnholdi, pastaj nis **Morfologjia** duke u shtjelluar mirë, **emri** (gjini, numër, rasë) dhe lakimi i tij (me ç`rast dallon tre lakime),

përemrat (të gjitha llojet), **mbiemrat**, **foljet** (zgjedhim, diatezë), duke dalluar katër mënyra e tri kohë. Foljet i ndanë: ato që mbarojnë me zanore; ato që mbarojnë me bashkëtingëllore. Folja analizohet imtë.

Në **pjesën e dytë** gjendet **Fjalorthi** me shpjegime greqisht, latinisht, frëngjisht; gjithsej 968 fjalë.

Pjesa e tretë është një **Antologji**, me këngë popullore, mbledhur te arbëreshët e Greqisë.

Shumë materiale folklorike të mbledhura nga Rajnhholdi e që mbeten dorëshkrim, i pat botuar G.Mayer në veprën e tij **Studime Shqiptare**.

Ogyst Dozon (August Dozon - 1822-1880). Balkanolog dhe Albanolog francez, i cili shërbeu në konsullatën franceze në Janinë dhe në Selanik. Më 1879 botoi veprën **Manual i gjuhës shqipe** (Manuel de la langue shqipe on albanaise), Paris, 1879.

Pjesa e parë e Librit përmban përralla, këngë popullore, proverba dhe tekste të tjera.

Pjesa e dytë ka një Gramatikë të shqipes, të bazuar kryesisht në të folmen e Përmetit (195 faqe). Në fund të Librit jepet një **Fjalor** shqip-frëngjisht me rreth 4000 fjalë.

Më 1880 Dozoni botoi edhe përmbledhjen: **Përralla shqiptare** me një **Hyrje** të gjërë.

Në **Gramatikën** e tij Dozoni në fillim paraqet alfabetin prej 38 shkronjash të adoptuar nga ai mbi bazën latine; bën fjalë për zanore e bashkëtingëllore; jep fenomenet fonetike më kryesore.

Pjesa e dytë, Morfologjia, ka 165 faqe; përshkruan mirë emrin, mbiemrin, nyjen, përemrin, numërorin, foljen; ai e shpjegon aoristin me **v** si bashkëtingëllore antihiatizues (Bopi, siç do ta shohim më poshtë jo).

Në **pjesën e tretë** flet për **Fjalëformimin** e shqipes.

Në **pjesën e katërt** flitet për **Sintaksën** e shqipes me rreth 40 faqe.

Vepra e Dozonit mbyllet me një **Shtojcë** që ka dy pjesë: **në të parën** flet për gjininë asnjane duke u përpjekur ta argu-

mentojë qenien e saj; në **pjesën e dytë** përshkruan tiparet themelore të Gegërishtes në Fonetikë e në Morfologji.

Në vepër ka krahasime me frëngjishten, greqishten, latinishten, sllavishten, turqishten.

Dozoni ka meritë se e njohu i pari, si mënyrë të veçantë, **Habitoren** (Ai e quan Admirativ).

Vepra e tij shquhet për origjinalitet.

———— * ————

Këtu do të vëmë në pah ndihmesën e disa studiuesve dhe udhëtarëve të huaj në fushën e albanologjisë.

Ami Bue (Ami Boue: 1794-1881), etnograf, gjeolog dhe udhëtar francez, i cili punoi për një kohë të gjatë në Vjenë. Bëri udhëtime të gjata në Evropë, në Ballkan dhe veçanërisht në Shqipëri.

Vepra e tij kryesore me interes për çështjen shqiptare është **Turqia evropiane** (La Turquie d'Europe), botuar në Paris në vitin 1840 në katër vëllime, si edhe vepra tjetër në dy vëllime: **Përmbledhje udhëtimesh në Turqinë Evropiane** (Recueil d'itinéraires dans la Turquie d'Europe), botuar në Vjenë më 1854.

Përgjithësisht në veprat e tij ai paraqet të dhëna për historinë politike dhe ekonomike të Shqipërisë, por edhe për veçoritë e kulturës materiale e shpirtërore të popullit tonë (organizimi shoqëror, banesa, veshjet etj).

Në vëllimin e dytë të veprës **Turqia evropiane**, autori flet për **shqipen** dhe jep lëndë nga ajo, duke e krahasuar me disa gjuhë të tjera. Mendon se shqipja është gjuhë indoevropiane dhe është pasuese e ilirishtes.

Shqipja, sipas tij, ka tre dialekte: **Gegërishtja** (Veriu), **Toskërishtja** (Jugu), **Dialekti i Shqipërisë së Mesme**.

Ami Bue thekson se gjuha shqipe ka shumë fjalë nga gjuhët e popujve me të cilët ajo pati marrëdhënie gjatë shekujve. Ai jep një Listë fjalësh shqipe dhe i krahason me fjalë të sanskrishtes, latinishtes, greqishtes së vjetër, frëngjishtes, italishtes, gjer-

manishtes, suedishtes, gotishtes, danishtes, islandishtes, letonishtes, keltishtes, sllavishtes, turqishtes, vllahishtes, baskishtes (gjuha baske).

Autori pretendon të tregojë se çfarë shqipja mund të ketë të përbashkët me gjuhët e tjera.

Për fjalët shqipe përdor alfabetin latin.

Përveç 500 fjalëve të shqipes, të cilat i gjen të njëjta, të afërta ose të ngjashme me ato të gjuhëve të përmendura e që i boton në formë Fjalori, dietari në fjalë mendimin e tij e përforcon dhe e ilustron edhe me shumë toponime dhe të dhëna historike.

Eduard Shnajder (Schneider), një studiues dhe udhëpërshkrues francez në fundin e shekullit të kaluar, shkruan artikuj për gjuhën shqipe dhe lashtësinë e saj, botuar edhe te Revista Albania në vitet 1898-1900 si: **Lashtësia e gjuhës shqipe, Etruskët dhe Shqiptarët** etj.

Përgjithësisht ai merret shumë me Etruskët dhe gjuhën e tyre, duke u munduar që t'i dëshifrojë me anë të shqipes; jep mbishkrime etruske dhe i zbërthen me ndihmën e shqipes. Dietari i lartëpërmendur këmbëngul në **prejardhjen pellazgjike të shqiptarëve** në veprën e tij të botuar në Paris në vitin 1894 me titull: **Une race oubliée. Les Pelasges et leurs descendantes** (Një racë e harruar. Pelazgët dhe pasardhësit e tyre).

Ai, duke u mbështetur në burime të ndryshme antike, bën fjalë për Pellazgët, si popull shumë i vjetër indoeuropian, si shtresë antike paragreke, jo më ekzistuese në periudhën antike.

“Shqiptarët - shkruan ai - janë pasardhësit e drejtëpërdejtë të pellazgëve, ndërsa gjuha shqipe është një indiomë indoeuropiane pak a shumë e transformuar e pellazgjishtes”.

Për të vërtetuar këtë tezë ai bën fjalë gjërë e gjatë për këtë popull (pellazgët) shumë të vjetër të Ballkanit, prejardhjen e tij, teoritë, legendat dhe mitet e ndryshme.

E. Shnajder përpiqet të depërtojë në natyrën e gjuhës shqipe, shpjegon domethënien e emrave të muajve, të javëve, numërorët

në këtë gjuhë.

Më tutje ai shkruan se, për shkak të kushteve historike apo të tërheqies në brendi të vendit, populli shqiptar ka arritur të ruajë gati të paprekur jo vetëm gjuhën, por edhe organizimin e tij shoqëror, doket, zakonet, veshjen, mënyrën e jetesës etj, të të parëve të tij të hershëm.

A.Degrad, arkeolog i shquar francez dhe studiues i popujve të vjetër, mendon se shqiptarët janë pasardhësit e Pellazgëve.

Në veprën **Souvenirs de la Haute - Albanie** (Kujtime nga Shqipëria e Veriut), botuar në Paris në vitin 1901, ai përshkruan gjurmimet arkeologjike gjatë vizitës në Koman të Pukës dhe bën përpjekje për të mbështetur pikëpamjen e tij.

Dijetari në fjalë mendon, në bazë të gërmimeve në Koman, se “ndoshta unë u ndodha në praninë e mbeturinave të një Imigrimi (Hyrjeje) pellazgjik; mungesa e mbishkrimeve dhe monedhave nuk e mohon këtë. Varrezat janë të vendosura sikurse ato që pata rastin t’i hap në Samotrasë (Greqi), por atje pllakat prej toke ishin në një kodrinë të ngritur. Pak nga pak, të zmbrapsur prej Greqisë, këta Pellazgë misterioz, ndoshta paraardhësit e Shqiptarëve, si të mundur, janë strehuar në male, duke mos dashur ose mos mundur të vendosen atje; ata brodhën nëpër këto pyje para se të zbritnin në Rrafshinë”.

Më tutje thekson se për të provuar lashtësinë e shqiptarëve, për të provuar në se janë Pelazg apo jo, na vjen në ndihmë identiteti i plotë i kostumeve të malësorëve të këtyre anëve, si edhe disa zbukurime prej bronzi që njerëzit e këtushëm i bëjnë për brez, të cilat edhe sot prodhohen në Shkodër, me një numër të atyre që i gjeta; ngjashmëria ishte aq e madhe sa që mund të besohet se e kanë burimin në këto varre.

Po sqarojmë, siç e kemi theksuar më lart, se Kultura e Komanit i takon Mesjetës së hershme dhe se bartës të saj janë banorët vendës autoktonë - **Arbërit**. Ajo është vazhduese e drejtëpërdrejtë e Kulturës ilire dhe shërben si dëshmi se bartësit e saj - Arbërit e Mesjetës së hershme - janë pasardhës të

Ilirëve.

E.Reklys (Reclus) - një udhëpërshkrues dhe gjeograf i njohur francez - pohon në veprën e tij **Nouvelle geographie universelle** (Gjeografia e Re Universale), botuar në Priz në vitin 1876 se “qoftë Gegët, qoftë Toskët e kanë prejardhjen nga pellazgët e lashtë, se gjendja e tyre shoqërore, doket, zakonet, mënyra e të menudarit dhe e të vepruarit nuk kanë ndryshuar shumë nga ato të Pellazgëve të para tre mijë vjetëve, se para imigrimeve barbare, shqiptarët e popullonin gjithë pjesën perëndimore të Gadishullit të Ballkanit deri në Danub. Më vonë qenë të detyruar të tërhiqeshin dhe tërë territori i Shqipërisë u okupua nga Serbët dhe Bullgarët”.

L.Lamush (lasmouche) në veprën e tij: **La Peninsule Balkanique** - Paris 1899 (Gadishulli Ballkanik), përkrah tezën iliro-trake, duke pohuar se Shqiptarët janë të vetmit përfaqësues të drejtëpërdrejtë të racës iliro-trake, se ata nuk mund të lidhen në mënyrë të veçantë me asnjë nga popujt evropianë.

Udhëpërshkrues i lartëpërmendur francez thekson se ndërmjet Shqiptarëve dhe Grekëve janë bërë përzierje të mëdha e të shpeshta, se popullsia e Greqisë së lirë është pjesërisht me prejardhje shqiptare, se roli i shqiptarëve gjatë luftërave të saj për pavarësi është i madh, se **kostumi kombëtar grek është kostumi shqiptar** (nënvizimi im - Xh.G.).

Lamush pohon se Ilirët, Epirotët dhe Maqedonët kanë formuar tri degë të një Familjeje.

Ai i kushton një kapitull të tërë gjuhës shqipe, në të cilën gjen shumë afri ose ngjashmëri me gjuhët e tjera si: latinisht, greqisht, frëngjisht, rumanisht etj.

G.Lezhan (Lejean), një etnograf i njohur francez, në veprën **Ethnographie de la Turquie d'Europe** - 1861 (Etnografia e Turqisë Europiane), i bën një analizë të thuktë Ilirëve si popull, duke u mbështetur në të dhëna të shumta qoftë etnografike, qoftë historiko-gjuhësore dhe arrin në përfundimin se Shqiptarët janë pasardhësit e Ilirëve të lashtë.

Lezhan mendon me të drejtë se fjalët greke e latine në gjuhën shqipe janë pasojë e kontakteve të këtyre popujve apo, siç shprehet vetë ai, “janë pasojë e pushtimit moral të Ilirëve nga civilizimi grek dhe mandej nga ai romak”.

Më tutje pohon se sllavët, të cilët erdhën në shekullin e VII nga Veriu, e zbrapsën në jug këtë popull të vjetër që “më vonë Bizantinët e njohën me emrin Arvaniti, një bastardim i emrit Albanoi, Albani, të cilin e mbante një nga fiset e tij në kohën e Ptolemeut. Popujt e Perëndimit e ruajtën emrin Alban, kurse, nga ai bizantin, turqit krijuan emrin Arnaut, ndërsa emri i sotëm kombëtar është Shqiptar, i cili ka të bëjë diçka me kuptimin Malësor” - përfundon ai.

A.Dymon (Dumont), një studiues dhe udhëpërshkrues tjetër francez, i cili në veprën e tij **Le Balkan et l'Adriatique** - Paris, 1873 (Ballkani dhe Adriatiku) mendon se shqiptarët janë pasardhësit e Ilirëve, ndërsa për lashtësinë e tyre shkruan: “Nuk ka në Evropë racë më të vjetër se sa shqiptarët. Asnjë dëshmi klasike nuk flet për periudhën kur ata kanë ardhur në Gadishullin e Ballkanit. Ata janë vendosur këtu qysh gjatë kohës para se pushtuesit sllavë zbritën nga Danubi; padyshim këtu ata (shqiptarët) ishin shumë shekuj para sllavëve”.

Koloneli francez Beker në veprën e tij **L'Albanie et Les Albanais** - Paris, 1880 (Shqipëria dhe Shqiptarët) përkrah tezën ilire të prejardhjes së popullit shqiptar dhe përpiqet të shpjegojë edhe emrin Albani, i njohur për Shqipërin në Perëndim.

Ai këtë fakt e lidh me ngjarjet historike të viteve 1081-1083 kur Robert Giskari (Guiscard), mbret i mbretërisë frenge të Sicilisë, zbarkoi në Shqipëri dhe arriti të nënshtrojë pjesën më të madhe të saj.

Në rrugë për në Ohër Robert Guiskari me armatën e tij kaloi nëpër Elbasan, i cili, sipas Bekerit, në atë kohë quhej Albanopolis. Ushtarët e Robertit, duke mos e njohur gjuhën e vendit, për shkak të kontakteve të pakta me vendasit, e emëruan Albania rajonin ku Albanopolisi ishte qyteti më i rëndësishëm dhe ky

emër, i sjellë në Itali, u zgjerua pak nga pak për gjithë vendin e banuar nga raca së cilës i takonin edhe banorët e rrethit të Elbasanit - përfundon Koloneli Beker.

J.G.Falo (Fallot: 1809-1836), gjuhëtar francez, si edhe P.Akerman, na kanë lënë dy **Fjalorë** të gjuhës shqipe, të cilët ruhen në Bibliotekën Kombëtare të Parisit.

I pari ka titullin **Glossaire latin-albanais** (Fjalor latinisht-shqip), me 129 fletë, shkruar në vitin 1836.

Aty mësojmë se autori na ka dhënë Fjalorin e Bardhit, duke shënuar pranë fjalëve shqip fjalë nga gjuhë të ndryshme të Evropës (latine, greke, frenge etj), të cilat, sipas tij, kanë afri me gjuhën shqipe.

Autori mendon se shqipja ka afri të madhe me **gjuhën provansale** (gjuhë romane e folur dikur në të gjithë Krahinën e Provancës - Juglindje e Francës), se shtatë të tetat e saj, të paktën, janë formuar me fjalë të gjuhës latine, se, të paktën, pesë të dhjetat janë marrë nga gjuha provansale, nga italishtja e vjetër ose nga gjuha katalone (gjuhë e krahinës së Katalonës në Spanjë - dialeket i spanjishtes), tri gjuhë që, sipas tij, janë të njëjta. Dhe përfundon: "Kur përkrah një fjalë shqipe, unë vë një fjalë frënge moderne, italiane apo spanjolle, këtë e bëj që të zëvendësoj një fjalë romane që është fjala e vërtetë primitive e cila i korrespondon shqipes". Pra ai i mëshon tezës së pathemeltë se shqipja është një gjuhë romane ose gjysmë romane, duke bërë edhe një provë studimi krahasues të shqipes.

Fjalori i dytë me titull **Glossaire grek - romaique albanais** (Fjalor greqisht - rom - shqip), ka 168 fletë, mbështetur te M.Liku, me shënime e vërejtje në fund.

G.Barittiu (1812-1893), një iluminist dhe demokrat rumun i shekullit të kaluar, tregoi një simpati të veçantë ndaj çështjes sonë kombëtare dhe pat lidhje edhe me N.Veqilharxhin.

Në një artikull që botoi në vitin 1845 me titull **Shqiptarët dhe gjuha e tyre**, Barittiu shkruan se shqiptarët janë trima dhe të pasionuar për lirinë, porse ky popull jeton në terr të thellë sepse

gjuha e tij nuk ka qënë shkruar dhe nuk ka pasur alfabet të sajën.

Që në vitin 1842, kur përgatiste një **Fjalor** rumanisht -gjer-manisht, ai është interesuar të mbledhë edhe disa fjalë shqipe, siç thotë vetë ai, ia kishte dhënë “një tregtar arnaut”. Ato fjalë ai i përcjell me korrespondentët, me përgjegjëset greqisht dhe rumanisht.

Sot ato gjenden në fund të Fjalorit dorëshkrim që ruhet në Bibliotekën e Akademisë së Shkencave Rumune.

Tasos Nerucos (1826-1892), grek, por nga e ëma ishte farefis me arbëreshë të Athinës e, për pasojë, shqipen e njihnte mirë.

Studioi mjekësi në Gjermani dhe më pas u vendos në Egjipt, ku u mor veçanërisht me arkeologji.

Kur studionte në Bavierë, ai mbajti **Shënime për gjuhën shqipe** dhe u përpoq të rindërtonte tekstet shqipe, të botuara nga Bajroni dhe Hobhauzi, sipas ribotimit të Ksilanderit, të cilat (tekste arbëreshe athiniote) ishin të deformatuara.

T.Nerucoja u bëri edhe një përkthim gjermanisht dhe ia dërgoi G.Mayerit në vitin 1888.

Shënimet mbi gjuhën shqipe janë të vitit 1840.

Nerucoja më vonë i dërgon disa **Letra** albanologut të madh, në mes të cilave ai pohon se Arbëreshët e Greqisë nuk i njohin fjalët **shqip, shqiptar, e Shqipëri**, se veten ata e quajnë **Arbër** dhe **Arbnorë**, kurse Atdheun e të parëve të tyre e quajnë **Arbëri, Arbëni**.

Nerucoja nënvizon se në Greqi “duke marrë parasysh orientimin helenizues të brezit të ri, çdo mësim në gjuhën shqipe është i ndaluar dhe i kundërshtuar prej shtetit dhe gjuha e folur shqipe trajtohet në këtë mënyrë me një vlerësim të ulët e me përbuzje. Kush flet në Greqi shqip, vetëvetiu i përket shkallës më të ulët të komunitetit neohelenik, pra shtresës fshatare dhe të detarëve. Përkundrazi, kush flet greqisht dhe helenizon, megjithë prejardhjen e tij sllave ose shqiptare është një helen i vërtetë dhe pinjoll direkt i Maratonomakut, Mitridatit e Themistokliut...”.

“S’është për t’u çuditur pra - vijon ai - që askush prej banorëve të tanishëm të Greqisë nuk guxon të flasë publikisht shqip dhe fare pak në rrethin e ngushtë familiar të tyre guxojnë të komunikojnë në gjuhën e tyre amtare”.

Duket sikur Nerucoja tregon një farë dhëmbshurie për arbëreshët e Greqisë që as mund të flasin lirisht gjuhën e tyre, por, faktikisht, më vonë ai i vështroi me mosbesim dhe përçmim përpjekjet e Rilindasve tanë për shqipen dhe çështjen kombëtare, duke luftuar çdo orvajtje të tyre.

———— * ————

Gjatë shekullit XIX, me zhvillimin e shkencës dhe të teknikës personalitete shkencore botërore, profesora universitetesh, dijetarë me famë, u dyndën në studimin e gjuhës shqipe dhe të prejardhjes së popullit shqiptar, një popull krejt i veçantë në Gadishullin e Ballkanit.

Duke pasur një material të pasur gjuhësor e folklorik në dorë, të mbledhur e të botuar tashmë për gjuhën shqipe nga studiues të huaj dhe vendas, të nxitur nga interesat e tyre shkencore, ata dhanë vepra me shumë vlera shkencore, të cilat kanë mbetur të pavdekshme në sfondin e artë të shkencës shqiptare.

T'i shikojmë me radhë.

Franc Bopi (1791-1867), profesor në Universitetin e Berlinit, gjuhëtar i shquar gjerman, një nga themeluesit kryesor të Metodës Historiko-Krahasuese, Gjenerali; dinte të gjitha gjuhët e vjetra dhe të reja indoeuropiane; kishte njohuri të mira për gjuhët semitike (arabisht) dhe maleziane; autor i **Gramatikës Krahasuese** të të gjitha gjuhëve indoeuropiane në pesë vëllime, autor i **Gramatikës Kritike të Sanskritishtes** dhe i **Fjalorit Sanskritisht - Latinisht**.

Më 23 shkurt të vitit 1843 Bopi lexoi para Akademisë së Shkencave të Berlinit Referatin **Mbi numërorët dhe përemrat e shqipes**, në të cilin, duke u bërë një analizë numërorëve deri në dhjetë dhe përemrave, sidomos përemrave pronorë e duke i krahasuar me të gjitha gjuhët indoeuropiane, arriti në përfundimin gjenial se Gjuha shqipe është gjuhë indoeuropiane. Sipas teorisë së tij të Aglutinimit (Përngjitjes) përemrat pronorë të shqipes janë formuar nga përngjitja e dëftorëve me vetorët: im < ai, mua; yt < ai, ty; jonë < ajo, neve; tanë < ata, neve.

Më 18 maj të vitit 1854 mbajti Referatin e famshëm: **Ueber das Albanesische in seinen verwandtschaftlichen**

Beziehungen (Mbi shqipen dhe lidhjet e saj farefisnore), botuar si vepër e veçantë po atë vit.

Në këtë vepër ai hodhi bazat e **Morfologjisë historiko-krahasuese të gjuhës shqipe**, duke e vërtetuar përfundimisht vendin e Shqipes në Familjen e gjuhëve indoeuropiane si një vend më vete se “Kjo gjuhë me të vërtetë i përket në mënyrë të sigurtë familjes indoeuropiane, se në themelet e saj kryesore nuk ka ndonjë lidhje më të ngushtë ose, aq më pak, ndonjë lidhje prejardhjeje me asnjërën nga motrat sanskrite indoeuropiane të Kontinentit tonë dhe as lidhje birërie me to”, se “ajo gjen me ndihmën e sanskritishtes një pikë ndërmjetësimi më lehtë dhe pashtënguar se sa me anë të greqishtes”.

Me anë të analizës morfologjike ai mendonte të gjente vetëm ato elemente të strukturës morfologjike të shqipes që e lejonin të kthehej prapa, në gjendjen origjinale të gjuhës së përbashkët indoeuropiane, në gjuhën fillestare.

Duke i bërë një analizë tërësore strukturës morfologjike dhe pak leksikut të gjuhës shqipe e duke i krahasuar me gjuhët indoeuropiane të vjetra e të reja, ai arriti në përfundimin lapidar se Shqipja bënë pjesë në Familjen indoeuropiane dhe zë një vend të veçantë.

Në veprën e lartpërmendur Bopi vështroi më tepër Morfologjinë e më pak Leksikun dhe Fonetikën historike. Është kjo një vepër shumë e rëndësishme dhe bazamentale për gjuhën shqipe, është një sintezë dhe një skicë e morfologjisë historike të shqipes.

Ai i bëri një analizë të mirë sistemit emëror, përemëror e kryesisht foljor për vërtetimin e teorië së tij. Vërejtja se sistemi foljor i ka ruajtur më mirë trajtat e vjetra indoeuropiane, ndërsa sistemi emëror ka pësuar ndryshime të mëdha gjatë kohës.

Bopi tregoi karakterin indoeuropian të mbareses **-m** të vetës së parë, numër shumës, të kohës së tashme të mënyrës dëftore (lajm, korrim, krahaso latinisht: **laudamus**, rusisht: **çitajem**), si edhe të mbaresës **-t** të vetës së dytë shumës të aoristit (shkuat, dolët).

Ai dëshmoi ekzistencën e zgjedhimit indoeuropian me **-mi** në gjuhën shqipe, duke pohuar se mbeturinat e saj gjenden te foljet **jam, kam**.

Gjuhëtari në fjalë i afroi trajtat e ndryshme të aoristit sigmatik (rash, pash) me trajtat e aoristit të gjuhëve të ndryshme indoeuropiane.

Ai gjeti si indoeuropjane edhe format e ndryshme të Pjesores së shqipes, duke nënvizuar se trajtat e tipit **pasun, lidhun** janë forma të pjesores indoeuropiane me **-n** (-no) dhe e shpjegoi zanoren **u** (lidhun) si zanore lidhëse tematike, ndërsa trajta e toskërishtes (lidhur) doli me rotacizmin e **-n^{se}** në **-r**.

Dijetari i përmendur disa trajta të pjesores me **-ë** i shpjegoi drejt, si trajta të dala nga asimilimi **rnë: r** (bjerrnë: bjerrë, djegnë-djegë). Edhe pjesoren me **ën** (shpënë) e lidhi me pjesoren indoeuropiane me **-n** (-no).

Bopi u mor edhe me pjesoren e gegërishtes veriore me **-m**, duke e lidhur me pjesoren indoeuropiane me **-mo** (-meno^s) e duke e krahasuar me disa gjuhë të Kontinentit tonë.

Ai foli gjithashtu për pjesoren me **-t** në gjuhën shqipe, e cila i përgjigjet pjesores indoeuropiane me **-to**. Mbiemri **i plotë** ai tha se është pjesore e adjektivizuar (i mbiemërzuar).

Në atë kohë ai nuk e njihte veprën e Buzukut e nuk pat shembull, por te Buzuku dalin plotë raste pjesorësh me **-t** (baat, rat, fleet “fjet”).

Duket gjenialiteti i Bopit në çdo çështje që trajton.

Duhet nënvizuar se jo të gjitha zgjidhjet e Bopit qenë të drejta; u gabua në aoristin me **-va** (këndova) kur e afroi me latinishten **Cantabam**; nuk e pa natyrën antihiatizuese të bashkëtingëllores -

v.

Nga një krahasim i tillë pa bazë shkencore më vonë mori fill një tezë e gabuar se gjoja ndikimi latin ka qenë i madh në strukturën gramatikore të shqipes, sidomos te G.Mayeri, çka nuk është e vërtetë.

Te vetë Bopi ideja e ndikimit të latinishtes nuk mori hov.

Për ndërrimet e disa tingujve ai dha mendime të vjera; në al-ternimin **t:s** në vetën e parë e të dytë njëjës të foljeve të tipit **vras-vret, shes-shet**, mendoj se kjo **-t** është tingull i parë, ndërsa **s** tingull i shndërruar.

Ai bëri krahasime të qëlluara; foljen **jam** (asht-është) e krahasoi me sanskritishten **asmi**, me latinishten **est** (essere), me avestishten (persishten e vjetër) **ahmi**, me lituanishten **esmi**, me sllavishten e vjetër **jesmi**, etj.

I madhi Bop i studioi drejtë, përmes etimologjisë, përveç foljes, edhe disa emra, përemra, ndajfoje, lidhëza, parafjalë të shqipes.

Duke analizuar numërorët ai pohoi se fundorja **-t** (gjashtë, nëntë) nuk mund të identifikohet me rrënjën fillestare përkatëse; kështu e lidhi **gjashtë** (shqip) me **shash, sash** (sanskritisht); **nëntë** (nantë) e afroi me **navan** (sanskritisht).

E shtjelloi përemrin pyetës **kush** dhe e krahasoi me sanskritishten dhe lituanishten **ka^s** dhe me **kvas** të gotishtes.

Ai e çoi morfemën **u** të pasivit në aorist (**u** mësua) te forma e lashtë indoeuropiane e përemrit vetëvetor ***suom**, ***sue** që la gjurmë në gjuhën shqipe.

Fr.Bopi bëri edhe disa krahasime në leksik: **asht** (kockë) e krahasoi me sanskritishten **osthan**, me latinishten **os-osis**;

natë - nox, noctis (latinisht) - **nykt** (greqishte e vjetër) - **nak-tam** (sanskritisht); **vit - vatas** (sanskritisht); **viç - vatsah** (sanskritisht); **muej - mens, mensis** (latinisht) - **masa** (sanskritisht) **njeri - nar** (sanskritisht).

Metoda e tij është rreptësisht shkencore; vetë ai përdori terminologji: **Analizë krahasuese, Krahasim analitik, Anatomi gjuhësore**.

Pikërisht kjo terminologji dëshmon për rigorozitet në kërkimet shkencore.

Vepra e Bopit është vlerësuar shumë; ajo ruan aktualitetin edhe sot.

August Shlajher (A.Schleicher 1821-1868), gjuhëtar i madh gjerman, njohës i thellë i të gjitha gjuhëve të vjetra dhe të reja indoeuropiane, autor i disa vëllimeve; në vitin 1850 në veprën e tij **Gjuhët e Evropës në vështrimin gjenealogjik**, e përfshiu shqipen brenda **Drurit Gjenealogjik**, duke e vendosur atë me pika, pasi nuk ishte i sigurtë, në afërsi të greqishtes dhe të latinishtes, por më afër greqishtes dhe e përmbloodhi me emrin Çifti i familjes Pellazgjik.

Ai u përpoq të tregojë këtë afri shqip-greqisht në disa izoglosa shqip-greqishte e vjetër, duke anuar nga mendimi se ato janë vijueset e greqishtes së vjetër.

Idenë e Çiftit pellazgjik e ndoqën edhe G.Shtiri dhe Dh.Kamarda, të cilët besonin se të dy gjuhët klasike ishin të afërta njëra me tjetrën.

Teoria e Drurit Gjenealogjik ndjek më shumë vijën e zhvillimit të gjuhëve pasi u shkëputën nga Trungu i përbashkët.

A.Shlajher në veprën e lartpërmendur përmend edhe bashkëpërkimet e rumanishtes, shqipes, bullgarishtes në prapavendosjen e nyjes shquese.

Më 1871 J.Schmid (1843-1901) paraqiti **Teorinë e Valëve** në të cilën afria e gjuhëve del në formën e Rrathëve koncentrik që presin njëra-tjetrën.

Shqipen e vendosi në një rreth të përbashkët me gjuhët balto-sllave me një rreth anë dhe me armenishten dhe trako-frigishtes me anën tjetër.

Teoria e Valëve e merr në konsideratë më fort gjendjen e gjuhëve në një kohë të lashtë, para se të shkëputeshin nga njëra-tjetra, nga popujt që i kanë folë.

G.Shtiri (Stieri), studiues gjerman, u mor me problemin e përkatësisë indoeuropiane të shqipes. Ishte mik me Jeronim de Radën dhe i përktheu disa këngë të tij në gjermanisht. Më 1854 botoi një Artikull me titull: **A është shqipja një gjuhë indoeuropiane?** Në këtë punim analizoi kryesisht **numërorët** dhe foljen **jam** dhe, duke i krahasuar me gjuhët indoeuropiane, gjeti se përveç numërorëve 100, 1000, të tjerët janë indoeuropianë.

Ai zbuloi se edhe folja **jam** (asht, është) i ka trajtat korresponduese të saj në gjuhët indoeuropiane.

Duke u marrë me foljen **jam**, ai e shtriu analizën edhe në folje të tjera në sistemin foljor në përgjithësi dhe gjeti se ky sistem lidhet me sistemin foljor indoeuropian; pra mbështeti tezën se shqipja është gjuhë indoeuropiane.

Shtiri mendonte se në mes të shqipes dhe të greqishtes kishte afri, kishte një lidhje të madhe.

Në vitin 1862 botoi studimin tjetër: **Emrat e kafshëve në gjuhën shqipe**. Ai mblodhi 220 emra kafshësh dhe i analizoi me metodën krahasuese, me ç'rast zbuloi se kishin korrespondime me gjuhët e tjera indoeuropiane.

Më 1871 publikoi studimin: **Mbi emrat e ngjyrave në gjuhën shqipe**, ku prapë dalloj korespondime me gjuhët indoeuropiane, duke u përforcuar edhe më tepër përkatësia indoeuropiane e shqipes.

Më vonë lindi teoria sipas së cilës shqipja është gjuhë greko-latine sepse bota shqiptare ka qenë në mes të grekërve dhe romakëve, se ka ekzistuar Tring **italo-grek-pellazgjik: latino-grek-shqiptar**.

Në këtë periudhë në Greqi lindën ide panhelenike, se, gjoja, shqipja është dialekt i greqishtes së vjetër; bile disa studiues shkuan edhe më tej, duke pohuar se shqiptarët nuk janë autoktonë por janë të ardhur nga Kaukazi, dhe se shqipja s'ka të bëjë fare me gjuhët indoeuropiane.

Nikoklesi, studiues grek, në vitin 1855, një vit pas publikimit

të veprës së Hanit, botoi latinisht tezën e tij të doktoraturës **Mbi origjinën e shqiptarëve**, që e kishte mbrojtur në Gjermani. Në atë tezë ai e hidhte poshtë mendimin e Hanit për prejardhjen ilire të shqiptarëve dhe pohonte se shqiptarët kanë ardhur nga Albanët e Kaukazit në kohën e mesme.

Jakob Falmerajer (1790-1866), historian i madh gjerman (austriak), bizantist, e dërmoi plotësisht tezën e Nikoklesit dhe vuri në dukje tezën e drejtë të Hanit.

Në veprat e tij Falmerajer shprehu idenë se populli grek nuk ka asnjë pikë gjaku të grekëve të vjetër, se ai është një **përzierje shqiptarësh dhe sllavësh**; pikërisht për këtë arsye u bë një nga figurat më të urryera në Greqi.

Në veprën e tij **Das albanesische element in Griechenland** (Elementi shqiptar në Greqi), botuar në tri pjesë në vitet 1857-1861, shqiptarët i vlerëson shumë; aty flet për vitalitetin e lartë të popullit shqiptar, qëndresën e tij të jashtëzakonshme ndaj asimilimit kulturor dhe etnik dhe e konsideron popullin shqiptar si një shembull të gjallë të faktit se një popull luftarak është në gjendje të mbijetojë dhe të përballë rrebeshet më të egra të historisë.

Në veprën e lartëpërmendur ai argumenton autoktoninë e shqiptarëve, duke shfrytëzuar për këtë qëllim rezultatet e studimeve të deriathershme të kërkimeve historiko-gjuhësore.

Ja tezat dhe mendimet kryesore të tij:

1). Ka një popull në Siujdhesën Ilirike, gjuha e të cilit nuk ka asnjë lidhje me asnjërën nga gjuhët e Ballkanit.

2). Ky popull e quan veten **Shqiptar**, kursë vendin ku banon **Shqipëri**.

3). Të gjitha kombet e tjera e njohin me emrin **Albanier, Albanezë, Arvanit, Arnaut**, kurse vendin e tyre e njohin me emrin **Albania, Arbënia, Arbania**.

4). Populli **albanez** ose **arnaut**, ose **arvanit** ndahet në dy Fise kryesore: **Gegë** dhe **Toskë**; kufiri midis tyre është lumi Shkumbin; ata flasin të njëjtën gjuhë.

5). Vendbanimi i tyre i hershëm, në të cilin e zbulon së pari popullin shqiptar historia, është rripi bregdetar i ngushtë dhe i gërryer, që është një vend malor, kryesisht i ashpër e që kufizohet nga Jugu me gjirin e Ambrakisë, nga Veriu me Liqenin e Shkodrës, nga Perëndimi me detet Jon dhe Adriatik e nga Lindja me vargmalet e Pindit. Gjysma jugore e këtij vendi në lashtësi quhej **Epir**, kurse gjysma veriore quhej **Iliri**.

6). Shqiptarët nuk kanë literaturë kombëtare, nuk kanë pasur ndonjëherë një Alfabet të përbashkët, nuk kanë arsim, por megjithatë, kanë ofruar shembullin e gjallë se një popull që është burrëror dhe luftarak, në qoftë se u nënshtrohet të paktën kushteve të përgjithshme të sjelljes njerëzore, edhe pa Akademi, pa Art, madje pa ABC, mund të jetojë dhe të ruajë forcën e tij fillestare ballëllart midis kombeve më të kulturuara.

7). Shqiptarët përkrahin kudo paqen, masën e vetëpërmbytjes dhe konservatorizmin më këmbëngulës, siç e kupton atë vetëm Orienti përjetësisht i palëvizur dhe i ngrirë në vetvete.

8). Shqiptarët janë artizanë, lundërtarë, ndërtues dhe udhëtarë të shkathët, të patrembur, të matur dhe rezistentë.

Dhe pyet: **Cilët janë shqiptarët? A janë shqiptarët autoktonë apo kanë imigruar (ardhur)?**

J.Falmerajer shkruan se autori bizantin **Halkokondili** Shqiptarët i bën të ardhur në Epir dhe në Iliri nga **Alba e Italisë**. Ky është mendimi i vetëm dhe i fundit që Bizanti, i cili po hiqte shpirt, la rreth prejardhjen dhe kombësisë së popullit shqiptar aktiv dhe që synon të përparojë - shprehet J.Falmerajer.

Ky dijetar më tutje na kumton se historianët kishtarë **Le Quien** dhe **Assemani** që në mesin e shekullit XVIII pohonin se shqiptarët - një popull i përzier, i afërt (fillimisht) me **Bullgarët finë** (Bullgarët e parë - Protobullgarët - Xh.G.) kanë ardhur nga **Albania e Kaukazit**, në shekullin e VII të erës sonë, përmes Ruisë Jugore, në Shqipërinë Ilirike - mendim ky i përkrahur më vonë nga Adelong dhe Pukëvili.

Falmerajer citon **Ksilanderin**, i cili nënvizonte se fjalët latine në dialektet e sotme shqiptare kanë ruajtur ende plotësisht shqiptimin romak të Epokës së Augustit e, rrjedhimisht shqiptohen:

c (k) - q; g - gj: Cicer (latinisht) dha **qiqer** (shqip), **cerasum** (lat) dha **qersh**i (shqip), **piscis** (lat) - **peshk** (shqip), **gens** (lat) - **gjind** (shqip).

Më tutje historiani më famë evropiane thotë se dijetari **Arndt** ka pohuar se në keltishten e lashtë **alb, alp** kishte kuptimin e **maleve**, dhe, me që në shqipen ende sot **shkëp, shkip, shkipe** tregojnë **Shkëmbin**, del se, me shtimin e një prapashtese mashkullore **tar**, mund të ketë lindur etnonimi **Shqiptar** që gjithashtu do të duhej të përkthehej vetëm “banor i një vendi shkëmbor” - vë në dukje Falmerajer.

Për autoktoninë e shqiptarëve, për prejardhjen ilire të tyre, ai u referohet edhe dijetarëve të tjerë: Lejbnic, Han, Malte-Bryn etj.

Dhe Falmerajer përfundon: “Në qoftë se shqiptarët nuk e njohin fare emrin **Nemcoi** dhe ende sot na quajnë ne gjermanëve me emrin e njohur nga popujt romanë **Allaman**, kjo është një dëshmi tjetër se shqiptarët gjendeshin në trekëmbëshin ilirik para atyre popujve që na quajnë Nemcoi (është fjala për popujt sllav sepse këta i quajnë gjermanët Nemcoi - shënimi im, Xh.Gosturani) dhe, me gjithë epërsinë numerikë dhe madhësinë politike të sllavëve, greko-sllavëve dhe turqve, ruajtën nomenklaturën e tyre të trashëguar nga lashtësia. Emri Alemani ndër kronistë romakë, u përdor në fillim të shekullit të tretë nga Karakalla dhe, me sa dihet,.... nuk u njoh ndonjëherë në Danubin e Poshtëm.

“Prandaj përpjekjet për të hedhur poshtë autoktoninë e shqiptarëve ilirë, të gegëve e të toskëve, dhe ta afrojnë ardhjen e tyre në shekullin e III, duhen hedhur poshtë se janë historikisht të pambështetura, të gabuara, joshkencore dhe jokritike” (nënvizimi im - Xh.G.).

Teodor Mommsen (1817-1903), historian nga më të mëdhenjtë e Gjermanisë, profesor në disa Universitete (Berlin, Lejpcig, Cyrih

etj); në kryeveprën e tij **Römische Geschichte** (Historia e Romës), vol I-III, vepër ku duket erudicioni i tij i jashtëzakonshëm dhe stili i rrallë poetik i të shkruarit, ai **Epirotët** e lashtë, të pirirë nga Pirroja, i quan **Shqiptar** të lashtësisë; më tutje flet për **Ilirët**, duke pohuar në disa vende fakte si: **Popullsia fillestare ilire, pasardhësit e fundit të së cilës duket se janë shqiptarët e sotëm**

Ai ka shkruar edhe vepra të tjera, në mes të cilave përmendim, pasi ka rëndësi për ne: **Unter italische Dialekt** - 1850 (Dialektet e Italisë së Jugut), ku ndër të tjera merret edhe me Mbishkrimet Mesapike dhe mbështet prejardhjen ilire të shqiptarëve.

Vuk Karaxhiçi (1787-1864), personalitet i shquar i Rilindjes serbe, themelues i gjuhës letrare serbokroate; folklorist, etnograf, historian, gjuhëtar; mbledhi 12 këngë popullore shqipe afër Pejës dhe mendoj për hartimin e një **Gramatike shqipe** (mbase edhe e hartoi) për të cilën nuk dihet asgjë.

Këngët popullore ia dërgoi dijetarit sloven në Vjenë:

Jernej Kopitar (1780-1844), i cili interesohej për shqipen. Ky gjuhëtar dhe drejtues i Bibliotekës Mbretërore të Vjenës me gjuhën shqipe nuk është marrë drejtëpërdrejtë, por ka botuar dy Artikuj studimor të thuktë, në formë Recensionit në vitet 1826 dhe 1829.

Artikulli i parë **Shqiptarët, Vllehët dhe Bullgarët** është shkruar në lidhje me veprën e Martin Likut **Researches in Greece** (Kërkime në Greqi).

Artikulli i dytë **Gjuha shqipe, vllahe dhe bullgare** (Albanische, Walachische, Bulgarische Sprache - 1829) është hartuar në lidhje me botimin e një Fjalori latinisht-gjermanisht-rumanisht-hungarisht (1825).

Brenda këtyre Punimeve gjendet edhe një Përkthim nga Ungjilli (Luka XV, 11-32) **Djali plangprishës**, bërë nga dy vëllezërit gjirokastrit: Anastas dhe Spiro Çelo, të cilët ishin në Vjenë.

J.Kopitar në studimet e tij jep informata të përgjithshme për gjuhët në shqyrtim, duke theksuar për shqipen disa pikëpamje të

tij:

1. Ai u përpoq të mbështesë tezën e Tunmanit mbi origjinën ilire të shqipes e të shqiptarëve, duke u shprehur qart: “Që shqiptarët janë pasardhësit e Ilirëve të vjetër, kjo përveçse me dëshmitë historike të Tunmanit, mund të përforcohet edhe me faktin që huazimet latine në shqip pasqyrojnë shqiptimin romak të kohës së Augustit”.

Dhe këtu ai jep shembuj: **qiqer** (nga latinishtja cicer), **qytet** (nga latinishtja civitas), **qepë** (nga latinishtja cepa), **peshk** (nga latinishtja piscis), **gjind** (nga latinishtja gens).

Ai shton se këto huazime latine kanë depërtuar në gjuhën shqipe në një kohë kur **c**, e ndjekur nga një zanore e përparme, ruante ende shqiptimin velar.

Ky fakt u argumentua më gjërë në vitet e mëpastajme nga

W.Mayer - Lybke (1861-1936) në veeprat: **Elemente latine në shqip** (Die lateinischen Elemente im Albanesischen 1904-6); **Rumanishtja, Romanishtja, Shqipja** (Rumanisch, Romanisch, Albanesisch - 1914), në të cilat, duke vënë në dukje karakterin arkaik të elementit latin të shqipes, pohon se ky element përfaqëson një gjendje gjuhësore më të vjetër se sa në çdo njëren nga gjuhët romane.

Mayer-Lybke është pasues i prejardhjes ilire të shqipes.

2. Kopitar ka vënë në pah se në shqip ka edhe pak fjalë me burim nga greqishtja e vjetër.

Ky mendim u përforcua më tej nga **A.Tumbi** (1865-1915) më 1910 në veprën e tij: **Elemente të greqishtes së vjetër në shqip** (Altgriechische Elemente im Albanesischen), në të cilën pohon elemente të greqishtes së vjetër në shqipen, duke llogaritur deri 21 fjalë, se huazimet greke të greqishtes së vjetër në Gegërisht janë më të vjetra se ato të Toskërishtes, sepse më vonë në Gegëri, në një kohë të caktuar, u ndërpre në, ndërsa në Jug vazhduan edhe më tej. Ai bëri një **Kronologji** të huazimeve greke, një **Shtresëzim** kohor të tyre.

Kopitari pat theksuar se huazimet latine të shqipes janë dy - tre herë më të shumta se sa huazimet nga greqishtja. J.Kopitari ka cekur, mbase i pari, edhe çështjen e Nyjës së prapme të shqipes, rumanishtes dhe bullgarishtes. Ai theksoi se kjo dukuri e përbashkët e këtyre gjuhëve ballkanike që i dallon nga gjuhët neolatine dhe gjermanike, si edhe nga greqishtja, e ka burimin te struktura e përbashkët e shqipes dhe rumanishtes (d.m.th. te Substrati), ndër-sa bullgarishtja - theksoi ai - është ndikuar nga rumanishtja.

Kopitari në Artikullin e dytë anon më tepër për prejardhjen trake të shqipes.

Franc Miklosiçi (1813-1891), slloven; profesor i filologjisë sllave në Universitetin e Vjenës, sllavist, balkanolog dhe albanolog; themelues i filologjisë moderne sllave, anëtar i Akademisë së Shkencave të Vjenës.

Në vitet 60-70 të shekullit XIX, ai u mor gjërësisht me studimin historik të krahasuar të gjuhës shqipe, duke sjell kështu një ndihmesë me vlerë për ndriçimin e marrëdhënieve të saj me gjuhët e tjera.

Që në veprën e tij **Die slavischen Elemente im Rumanischen** (Elemente sllvae në rumanisht), botuar në Vjenë më 1861, në të cilën shtroi edhe problemin e lidhjeve në mes të gjuhëve të Ballkanit, trajtoi gjithashtu mjaft çështje të historisë së shqipes, u mor me fjalët autoktone të përbashkëta të shqipes e të rumanishtes, me latinizmat e gjuhës sonë.

Ballkanizmat i shpjegoi me hipotezën e Substratit, duke i lidhur me elementin autokton të lashtë ballkanik që për të është në thelb i njëjtë ose shumë i afërt me gjuhën shqipe, të cilën e konsideronte si vijim të ilirishtes.

Pas vitit 1870 ai u mor me studimin e Fonetikës dhe të Leksikut të shqipes, duke dalluar shtresa të veçanta të leksikut sipas burimit të tyre e duke sqaruar veçoritë fonetike e strukturore të fjalëve.

Në vitet 1870-1871 botoi tre vëllime **Albanische Forschun-**

gen (Gjurmime shqiptare).

Në **vëllimin e parë Elemente sllave në gjuhën shqipe**, jep një përshkrim të përhapjes së shqipes, pastaj një pasqyrë bibliografike të teksteve të shqipes, të botuara deri në atë kohë, si edhe disa veçori fonetike të shqipes; vjen pastaj një listë e fjalëve sllave në shqip.

Ai vuri në dukje se ndikimi sllav në shqip është vetëm në Leksik, jo në strukturën gramatikore, por vetëm pak në Fjalëformim.

Vëllimi i dytë (1871) i kushtohet elementeve latine e romane në shqip. Ky vëllim ka dy pjesë:

Në **pjesën e parë** jepet pasqyra e fjalëve latine e romane në gjuhën shqipe (gjithsej 930 fjalë).

Në **pjesën e dytë** ka vëzhgime fonetike nga latinishtja në shqip: korrespondime fonetike.

Duke e përshkruar sistemin fonetik të shqipes, ai ka vënë në dukje se gjatë evolucionit historik të saj, zanoret e patheksuara kanë pësuar një dobësim të madh të shkallëshkallshëm; në fillim ato janë reduktuar në **ë** dhe më pas kanë rënë fare; **amicus**>**ëmik**>**mik**, **april**>**ëpril**>**prill**, **augustus**>**ë gusht**>**gusht**.

Ai vuri në dukje se një **o** e theksuar, e ndjekur nga **n** fundore, është diftonguar në **ua** në toskërisht dhe **ue** në gegërisht: **drangua**, **dranguë** nga latinishtja **dracon-em**; **capua**, **capue** nga italishtja **capone**.

Miklosiçi theksoi gjithashtu se në gjuhën shqipe një **-n** fundore ka rënë duke lënë gjurmë në hundorëzimin e zanores paraprijëse në gegërisht dhe në shndërrimin e zanoreve **a** dhe **e** në **ë** në toskërisht. Ajo bashttingëllore rishfaqet kur ndiqet nga një zanore tjetër, duke u rotacizuar në dialektin jugor: **kufi-kufi-kufini-kufiri** nga latinishtja **cofine-em**; **li-li-lini-liri** nga latinishtja **lin-um**; **lua-luan-luani** nga latinishtja **leon-em**; **fre-fre-freni-freri** nga latinishtja **fren-um**.

Ai ka dhënë edhe konsiderata të tjera në fonetikë duke shënuar edhe fjalë me burim latin. Kështu fjalën **Pukë** që gjendet në Fjalë-

rin e Bardhit e shpjegoi nga latinishtja **Publica**; Bardhi e ka paraqitur si **udhë pukë** e cila sot ka dalë jashtë përdorimit.

I shpjegoi mjaft mirë edhe disa fjalë me burim latin, duke ndjekur evolucionin e tyre fonetik: **pyll < padulem; fe < fides, nyjë < nodis.**

Kanë rëndësi vëzhgimet e tij mbi ndryshimet që kanë pësuar zanoret dhe bashtingëlloret latine në terrenin shqiptar.

Vëzhgimet e tij në këtë sferë sollën në atë kohë një qartësi të madhe në konfuzionin lidhur me korrespondimet fonetike latinisht-shqip.

Me këtë vepër, siç thekson N.Jokli, u vunë baza të forta studimit historik të shqipes.

Vëllimi i tretë i kushtohet formës së foljes së huazuar në gjuhën shqipe dhe në gjuhët e tjera të Ballkanit. Ai vuri në dukje një fakt: Foljet në gjuhët e Ballkanit janë marrë në një trajtë të caktuar bashkë me formatin e në bazë të kësaj janë formuar trajtat e tjera. Kështu foljet nga turqishtja në gjuhët e Ballkanit janë marrë nga Aoristi; ato të greqishtes së re janë marrë nga Aoristi sigmatik.

Miklosiçi pohoi se gjuha shqipe, foljet nga sllavishtja i ka huazuar në formën e paskajores me formatin **-iti**, si: **gjobit** nga sllavishtja **globiti**, **grabit** nga serbishtja **grabiti**.

Ai vëren se nga greqishtja e re, shqipja i ka huazuar foljet, siç e thamë, në formën e Aoristit sigmatik: **nakatos** nga greqishtja **anakaton**; **gremis** nga **gremniz**.

Foljet e huazuara nga turqishtja kanë hyrë në formën e Aoristit së cilës i është shtuar **is** e aoristit grek: **braktis** nga turqishtja **brakmaq**, **besdis** nga **bezmek**, **sajdis** **sajmaq** (aoristi **sajdym**) **ujdis** nga turqishtja **ujmaq** (aoristi **ujdym**).

Fr.Miklosiçi ka shprehur edhe këto mendime:

I. Disa emra nga latinishtja kanë depërtuar në shqip nga forma e rasës kallëzore latine: **mend** nga latinishtja **ment-em**, **morte** < **mort-em**, **prind** < **parent-em**, **shëndet** < **sanitatem**, **luan** < **leon-em**.

2. Për nyjën (mbaresën) e prapme **u** (pas bashkëtingëlloreve k, g, h) dhe **i** në rastet e tjera (breg-u, krah-u, djali), ai vuri në dukje të njëjtën prirje edhe në vetën e tretë njëjës të së kryerës së thjeshtë (prek-u, erdh-i). Sipas tij në të dy rastet nuk kemi të bëjmë me elemente etimologjiksht të ndryshme, ndonëse nuk pohon se cila nga këto elemente është burimore.

Miklosiçi traktoi edhe elementin sllav e roman në gjuhën shqipe, duke e paraqitur edhe një listë të këtyre huazimeve: **316** huazime prej burimit sllav dhe **930** huazime nga burimi roman (latin e italian). Ai ka paraqitur edhe një listë prapashtesash që kanë depërtuar në gjuhën shqipe nga sllavishtja dhe nga gjuhët romane. Fr. Miklosiçi në veprën **Mbi ndikimin turqishtes në gramatikën e gjuhëve të Evropës Juglindore** (Über die Einwirkung des Türkischen auf die Grammatik der Südosteuropaischen Sprachen) - 1884 - 1890, shqyrtoi hollësisht edhe turqizmat e gjuhës shqipe, të cilat i vështroi jo të veçuara, por në kuadrin e orientalizmeve të Ballkanit, duke i parë jo vetëm në shqip, por edhe në gjuhët e tjera të Gadishullit tonë, bile edhe në rusisht, ukrainisht, polonisht.

Kjo vepër pati rëndësi jo vetëm për historinë e gjuhës shqipe por edhe për ballkanistikë.

Shumë fjalë që u konsideruan latine, prof. E.Çabej, më vonë i ka nxjerrë me bazë indoeuropiane.

Fr. Miklosiçi u kushtoi një vëmëndje të madhe, si balkanolog që ishte, edhe dukurive të përbashkëta të gjuhëve të Ballkanit në përgjithësi dhe elementit të vjetër të përbashkët të shqipes dhe rumanishtes, sidomos në studimin e tij. **Elementet sllave në rumanisht** (Die Slavischen Elemente im Rumanischen) - 1860.

Ai paraqiti këto elemente të përbashkëta ballkanike:

1. E ardhmja me foljen **dua**: shqip, rumanisht, bullgarisht, greqisht.

2. Zhdukja e paskajores me **me** dhe zëvendësimi i saj me lidhoren: shqip (përveç gegërishtes), rumanisht, bullgarisht, greqishte e re.

3. Nyja e prapme: shqip, bullgarisht, rumanisht.
4. Identiteti rasor gjinore - dhanore: shqip, rumanisht, greqisht.
5. Denduria e përdorimit të zanores ë: shqip, rumanisht, bullgarisht.

6. Shfaqja e shpeshtë e zanoreve hundore në krye të fjalëve: shqip, rumanisht.

7. Rotacizmi: shqip, rumanisht.

8. Fenomene të ndryshme sintaksore (Rimarrja e kundrinave nëpërmjet formave të patheksuara të përemrit vector): shqip, rumanisht, bullgarisht, greqishte e re.

9. Formimi i numërorëve 11-19 nëpërmjet një parafjale të futur midis numërorit të vogël dhe numërorit **-dhjetë**: shqip, rumanisht.

Nga vinë këto elemente të përbashkëta?

Burimi i tyre - vëren ai - në shumicën e rasteve, është te elementi i lashtë autokton dhe shton “ne besojmë që ai element të ketë qenë i afërt me shqipen e ditëve tona të cilën **ne e konsiderojmë si vazhdim të ilirishtes**”(nënvizimi im - Xh.G.)

Rumanishtja, sipas tij, u formua nga elementet latine me elementet vendase (autokton).

Ai u kushtoi kujdes edhe disa fjalëve që ndeshen vetëm në shqip e rumanisht, duke renditur 50 të tilla: **avull - abur, vatër - vatr, gropë - groap, mal - mal, kodër, kodru, katun - këtun**.

Këto elemente i lidh me substratin trako - ilir.

Studimet e mëvonshme kanë treguar se shumë prej tyre e kanë burimin te shqipja dhe kanë hyrë në rumanisht, si **gëlbazë, këlbazë** (rumanisht; kalbeazë), të cilën Çabej e ka lidh me shqipen **kalb** e nuk është substrat trako - ilir, siç e theksuam më lart.

Fr. Miklosiçi vuri në dukje se në mes të shqipes e rumanishtes ka përkime fonetike në mjaft latinizma si:

caballum - kalë

- kalë (në të dy gjuhët)

Venum - vëner, vërerë (shqip)

- venim (rumanisht)

Pra ndryshimet fonetike kanë qenë të njëjta.

Miklosiçi i kushtoi vëmëndje ndikimit latin mbi shqipen dhe pohoi se latinishtja nuk e mundi shqipen sikurse ndodhi në Francë. (flitej gotishtja) apo në Spanjë (flitej iberishtja), në të cilat mbi-zotëroi latinishtja. Pra latinishtja nuk e mundi ilirishten, por ndikoi në leksik, pa e prekur strukturën gramatikore të saj.

Ai pohoi se latinizmat e shqipes e të rumanishtes pasqyrojnë forma më arkaike se sa format që pasqyrojnë në italisht dhe frëngjisht.

Për ndarjen dialektore të shqipes pohon se ndahen në lumin Shkumbin, duke theksuar se i njëjti Lum ndante tributë iliriane dhe ato të Epirit.

Fr. Miklosiçi mbetet balkanolog i madh.

Gustav Mayer (1850 - 1900), profesor në Universitetin e Gracit, albanolog, turkolog; njeri me dije shumë të gjëra; vdiq i çmendur në vitin 1900, ashtu siç vdiq edhe Fr.Niçe po atë vit.

G.Mayer u mor gjerësisht me gjuhën shqipe, sidomos me studimin historik të saj. Hartoi të parin **Fjalor etimologjik** të saj (Etymologisches Wörterbuch der Albanesischen Sprache), si edhe është autori i veprës **Studime Shqiptare** (Albanesische Studien, 1883 - 1896) në gjashtë vëllime dhe i **Gramatikës së përmbledhur të gjuhës shqipe** (Kurzgefassi Albanesische Grammatik).

Përveç këtyre veprave themelore, ai botoi edhe studime me vlera të shënuara shkencore për gjuhën shqipe dhe historinë e saj.

Në studimin **Pozita e shqipes në rrethin e gjuhëve indoeuropiane** (1884), i kushtoi vëmëndje vendit të shqipes në Trugun indoeuropian, duke shtjelluar edhe faktin se si reflektohen në gjuhën shqipe tingujt indoeuropianë e duke nxjerrë përfundimin se me të cilat gjuhë ka afri.

Në këtë studim kemi një pasqyrë të saktë pak a shumë të korrespondimeve fonetike, të cilat qëndrojnë edhe sot në shumicën e tyre. Në fund autori konkludon:

a) Shqipja i përket gjuhëve indoeuropiane.

b) Shqipja largohet nga greqishtja.

c) Shqipja afrohet me gjuhët e Evropës Veriore më shumë se sa me gjuhët e Evropës Jugore; ajo afrohet veçanërisht me gjuhët balto-sllave veriore, sidomos në bashtingëlloret grykore, por edhe në zanore.

Ai theksoi se zanorja **o** indoeuropiane në shqip, si edhe në gjuhët balto-sllave dhe gjermanike, reflektohet në **a**, ndërsa në latinisht dhe në greqishten e vjetër mbetet **o**; **natë** (shqip), latinisht: **nox, noktis**, lituanisht: **naktis**, gjermanisht: **nacht**; **asht-i** (shqip), latinisht: **os, osis**, greqisht: **osteon**.

Në shqip **b^h** indoeuropiane dhe **b** ndërsa në latinisht dhe në greqishten e vjetër dha **f**; **bie, bjer** nga një bazë indoeuropiane **bhero**, latinisht: **fero**, greqisht: **fero** (phero).

Po kështu si në gjuhët balto-sllave guturalët janë reflektuar në këtë mënyrë: **k - th, g' - dh** por edhe në okluzivin **d**; latinisht: **acidus** (shqipto akidus), shqip **i athët**; latinisht **gener**, në shqip **dhëndër**, latinisht: **lego**, shqip **(mb) ledh**; latinisht **hiems**, sanskritisht: **hima** (kraho: Himalaja), shqip **dimër**.

Pikërisht në këto tipare shqipja pjek me gjuhët Satem.

G.Mayer vështroi gjithashtu disa isoglosa shqip - lituanisht; shqip: **djeg**, lituanisht: **degu**.

Në fund pohoi se shqipja formon Degë të veçantë në Trungun indoeuropian.

Studimi tjetër **Mbi gjuhën dhe letërsinë shqiptare** është një Bibliografi për çfarë ishte shkruar në gjuhën shqipe; aty shprehen edhe mendime për origjinën e shqipes dhe për marrëdhëniet e saj me gjuhët fqinjë, mbron pikëpamjen se shqipja është vazhdim i ilirishtes dhe del kundër pikëpamjes së afrisë së shqipes me greqishten.

“Shqipja - shprehet ai - paraqet fazën më të re të njërit nga dialektet e vjetra ilire” (nënvizimi im - Xh.G).

G.Mayer hartoi edhe dy Punime në lidhje me morfologjinë historike të shqipes:

1) Folja - emër në shqip (Folja substantiv në shqip).

Këtu i bëhet një analizë foljes **jam**; vihet në dukje se në themel të foljes **jam** dhe **kam**, megjithëse ka pasur modifikime, janë ruajtur format e vjetra indoeuropiane; sidomos folja **jam** ka ruajtur më shumë mbeturina të tipit arkaik indoeuropian. Ai sqaroi shumë veçori të sistemit foljor të shqipes.

2) Përfekti indoeuropian me -e

Mayeri në këtë punim trajtoi problemin e foljeve të shqipes të tipit **djeg-dogja, dredh-drodha, sjell-solla**, duke treguar se forma me **o** (solla) është vazhdim i së kryerës indoeuropiane e duke shënuar edhe vjetërsinë e saj.

Dijetari i lartëpërmendur u mor gjithashtu me Ndikimin e latinishtes mbi shqipen, duke i kushtuar dy punime:

1) Ndikimi i latinishtes mbi morfologjinë

2) Elementi latin në gjuhën shqipe

Punimi i fundit u botua në një Traktat mbi gjuhët romane.

G.Mayer mendon se elementi latin paraqet një fazë të vjetër të latinishtes, një fazë arkaike, më të vjetër se sa në frëngjisht dhe italisht. Këtë e vërteton fakti i reflektimit të bashkëtingëlloreve **k, g**, latine në shqip: **cicër, cepa** (latinisht), në shqip kanë dhënë **qiqër, qepa**; në krye të herës në latinisht shqiptoheshin me **k** (kikër, kepa) e më vonë u shqiptuan me **c** në latinisht, ndërsa në shqip shqiptohen me **q**, sikurse edhe fjala latine **centum** dha në shqip **qind**.

Siç e përmendëm edhe më lart, problemin e ndikimit latin në gjuhën shqipe e trajtoi edhe te vepra **Gjuha dhe Letërsia S' shqiptare**.

Ai u përpoq të dallojë huazimet latine dhe përfundoi se ato kanë hyrë herët në shqipen, kështu që ka vështirësi për t'i dalluar sepse kanë ndodhur asimilime.

Latinishtja nuk e preku strukturën grammatikore të shqipes - pohoi Miklosiçi, ndërsa Mayeri tha se ajo e preku rend, duke nënvizuar se Ilirishtja **me zor të madh** i shpëtoi latinizmit; pra ndikimi që shumë i madh.

G.Mayer në krahasimet dhe përqasjet ka pasaktësira dhe gabime; kështu përemrin **i Tij** e lidhi me përemrin e latinishtes **Is-tius**; përemrin **Kujt** e afroi me përemrin e latinishtes **Cuius**; Nyjen e prapme (mbaresë) **i** e lidhi me përemrin e latinishtes **ile** (ai); foljen me **oj** e lidhi me latinishten **are** (lëvdoj-laudare); Aoristin me **va** po ashtu e lidhi me latinishten **cantabam** (këndova), çka e kishte thënë më parë Bopi, por e kishte rrëzuar Dozoni; Dëshiroren me **fsh** prapë e lidhi me më se të kryerën e lidhores të latinishtes **cantavisse**m çka e hodhi më vonë poshtë Pedersenin.

Nga këto analiza jo të sakta, ai arriti në përfundimin e gabuar se Ndikimi latin mbi Strukturën gramatikore të shqipes është i madh, se shqipja është gjuhë gjysmëromane.

Të gjitha këto janë hedhur poshtë me argumente shkencore.

T'i shikojmë pak vëllimet **Studime Shqiptare**.

Në vëllimin e parë (1883) shqyrton sistemin emëror të shqipes, sidomos formimin e shumësit.

Në vëllimi e dytë (1884) merr në shqyrtim numërorët e shqipes dhe i krahason me gjuhët e tjera indoeuropiane.

Ka vëzhgime me interes edhe për Fonetikën historike të shqipes. Numërorët **dy**, **tre**, sipas tij, janë edhe indoeuropiane edhe huazime, pra edhe të trashëguara edhe të huazuara. Numërorët e tjerë, **4**, **100**, **1000**, i nxjerr nga latinishtja, ndërsa numërorin **5** e lidh me formën bazë indoeuropiane **pent**i.

Ai vuri në dukje se numërorët e shqipes janë formuar me prapashtesën **të**, çka është veçori edhe për gjuhët sllave.

Nga trajtimi fonetiko-historik i tyre, autori zbuloi edhe disa përkime fonetike.

Vëllimi i tretë i kushtohet fonetikës historike të gjuhës shqipe.

Në vëllimin e katërt është ribotuar Fjalori i Kavaliotit greqisht-vllahisht-shqip.

Në vëllimin e pestë dhe **të gjashtë** (1896, 1897) botoi prozë e poezi popullore, proverba të mbledhura në krahina të ndryshme të Shqipërisë, si edhe në kolonitë arbëreshe të Italisë e të Greqisë.

Këtu janë botuar edhe materiale të mbledhura nga **Reinholdi** (vëllimi i pestë).

G.Mayer botoi edhe veprën **Gramatikë e shkurtër e gjuhës shqipe**, më 1888 gjermanisht, në Lejpcig, kushtuar Shuhardtit.

Gjithë vepra përbëhet nga 116 faqe, mbi bazën e toskërishtes veriore; është një gramatikë shumë konçize. Ndahet në dy pjesë: **në të parën** jepet përshkrimi i shkurtër i tingujve dhe një **gramatikë** e përpiktë; **në të dytën** jepen copa leximi, përralla, si edhe një Fjalorth.

Vepra themelore e tij është **Fjalori etimologjik**, botuar më 1891, i pari i këtij lloji në gjuhën shqipe. Megjithë të metat që ka, vlerë ka edhe sot.

Në të vuri 5140 fjalë dhe ua zbërtheu etimologjinë e tyre. Në **Parathënie** vuri rezultatin e shtjellimit që bëri.

G.Mayer nxorri 400 fjalë indoeuropiane, 730 fjalë pa shpjegim. 1420 fjalë latine e romane, 1120 fjalë turke, 540 fjalë sllave. 830 fjalë greke. Ai pohoi edhe një herë se gjuha shqipe është një **gjuhë e përzierë, gjysmë romane**, çka nuk është e vërtetë.

Shumë fjalë që Mayer i quajti të huaja kanë dalë vendase: vendase dolën edhe 730 fjalët që i la pashpjegim. Studimet e mëvonshme, sidomos studimet e E.Çabejt, kanë treguar se burimi vendas është shumë i madh.

Përfundimet e Mayerit nuk janë edhe aq të sakta sepse:

1) Materiali i përdorur nga ai qe shumë i kufizuar; u mbështet shumë në Fjalorin e Rosit i cili është i mbushur me italianizma, si edhe me materiale folklorike, marrë te veprat e autorëve arbëreshë, në Fjalorin e Hanit etj.

2) Mos-harrja e këtij materiali, moszgjedhja e tij ashtu siç duhet. Petrota thotë se këtë gjë Mayeri e bëri me qëllim që të provojë tezën e tij se shqipja është gjuhë gjysmë romane.

3) Ai deshi të nxjerrë përfundimin nga statistika thjeshtë numerike, pa marrë parasysh qarkullimin e tyre, peshën e tyre. G.Mayer shkroi edhe artikuj në organe të ndryshme të kohës. Ka

bërë studime me vlerë gjithashtu për greqishten dhe turqishten.

Ai vuri në dukje rolin dhënës të shqipes në greqishten e re ku dalloi 64 fjalë.

N.Jokli e quan Mayerin **Mjeshtër i gjuhësisë shqiptare**. Atë e ka vlerësuar edhe E.Çabej i cili e emërton si **themeluesi i vërtetë i studimit të gjuhës shqipe**.

Por E.Çabej vuri në dukje edhe të metat e tij, sidomos në Fjalorin Etimologjik, si mosnjohja e visarit të vërtetë leksikor të shqipes, çka në fakt nuk kishte si ta njihte, prandaj “ky dijetar - përfundon Çabej - nuk pat mundësi ta rrokte gjuhën shqipe prej trungut, por e rroku prej degësh”.

G.Askoli (1829-1907), gjuhëtar i njohur italian, dha një ndihmesë edhe në studimin e gjuhës shqipe; ai i bëri një Recension Kritik veprës së Kamardës që në vitin 1877.

G.Askoli theksoi se problemi i përcaktimit shkencor të gjuhës shqipe është shumë i vështirë; nuk pajtohet në shumë gjëra me Kamardën, por vë në dukje meritat e tij; thekson mundësinë e lidhjes së shqipes me etruskishten, çka nuk është e vërtetë.

Dijetari i lartëpërmendur tha se ka elemente të përbashkëta në mes të shqipes-greqishtes-latinishtes, por duhet shpjeguar me kujdes se ku e kanë burimin.

G.Askoli bëri edhe shtresëzimin e leksikut të shqipes dhe parashtroi një plan pune të tërë për shqipen. Gjuhëtar i përmendur u mor edhe me substratin.

Hugo Shuhardt (1842-1928), gjuhëtar i njohur austriak, profesor në Universitetin e Gracit; në veprat e tij **Brevier** (Shkurtore), **Albanesisches und Romanisches zu Miklosich's Albanesischen** (Shqipja dhe Rumanishtja në kërkimet shqiptare të Miklosiçit); **Vokalizmi i latinishtes vulgare**, u mor mirë edhe me problemet e shqipes: **prejardhja e shqipes; Ndikimi i latinishtes mbi shqipen; Marrëdhëniet shqip-rumanisht**, duke e përkrahur teorinë e Substratit të Miklosiçit.

Shuhardti tha se nuk mund të mos pranojmë se rumanishtja ka

një origjinalitet të trashëguar nga popullsia e lashtë autoktone e territorit të saj, sepse bash këtu kanë ndodhur përzierje në mes popullsisë vendase me kolonët romakë. Nga kjo përzierje doli **rumanishtja** dhe **rumunët**.

Përgjithësisht mbështeti pikëpamjen e Miklosiçit për shqipen **me prejardhje ilire**, me një komponent trak.

H.Shuhardt pohoi se elementet e përbashkëta **shqip-rumanisht** nuk janë të një periudhe të vonë (mesjetare), siç mendohej, por janë të lashta, qysh te Fiset iliro-trake.

Ai foli për ndikimin e latinishtes mbi shqipen, duke theksuar se latinishtja në Iliri dhe Panoni u bë edhe gjuhë e folur nga popullsia vendase për një kohë të gjatë, por, megjithatë, ajo nuk arriti ta zhdukë gjuhën vendase të Ilirisë, nuk preku strukturën gramatiko-re të saj.

Në mes të **Ilirishtes** dhe **Latinishtes** u zhvillua një luftë e gjatë nga e cila fitoi **Ilirishtja**, por latinishtja, fatkeqësisht la gjurmë të thellë, duke e mbushur me njësi leksikore. Pra e mbivlerësoi ndikimin e latinishtes mbi gjuhën shqipe.

Ai nënvizoi se banorët e Ilirisë mezi shpëtuan nga romanizimi, ndërsa fiset afër Danubit (Dakët) u romanizuan.

Mosromanizimi i stërgjyshërve të shqiptarëve ndodhi për dy arsye:

a) Qëndresa e popullsisë ilire.

b) Zona tepër malore.

Pikërisht, duke e mbivlerësuar ndikimin e latinishtes mbi shqipen, disa fjalë që i lidhi me prejardhje latine, nuk janë të tilla: **asht** (është) e nxori me burim latin **est** (është), çka nuk është e vërtetë, sepse burimi i të dyjave është indoeuropiane, kanë një bazë të përbashkët indoeuropiane.

Shumë fjalë huazime të latinishtes në shqip, ai i lidhi me latinishten vulgare, popullore, bisedore e jo me latinishten klasike; sjell shembuj: **camba** ka dhënë **kamba**, **këmba**; **plep** rrjedh nga latinishtja vulgare **plopus** e jo nga latinishtja klasike **populus**.

Trajtat e latinishtes vulgare, pohoi ai, na japin mundësi të përcaktojnë edhe kohën e depërtimit të tyre.

H.Shuhardti shtroi nevojën e dallimit të latinizmave nga fjalët romane, neolatine; pra problemin e **Shtresëzimit kronologjik të latinizmave**.

Ai vuri në dukje se disa fjalë të shqipes mund të përcaktohen në se kanë burim latin apo neolatin p.sh fjala **pjeshkë** nuk vjen nga latinishtja **persica**, por nga italishtja **pesca**.

Fjala **rrugë** në shqip ka hyrë nga dialekti venecian **rugà**.

Në fakt nuk është lehtë dallimi në mes latinishtes së vonë, italishtes dhe venetishtes.

Shuhardti vuri në dukje karakterin e veçantë që mori latinishtja vulgare në Ballkan, e cila u zhvillua edhe si dialekt i veçantë, duke marrë veçoritë përkatëse nga banorët vendas.

Veçoritë e përbashkëta ballkanike i shpjegoi me një Substrat, por edhe për elementet e përbashkëta shqip-rumanisht pohoi se kanë një Substrat (nënshtresë) të njëjtë.

Në territorin e Dakisë (Rumania e sotme), sipas tij, u ndesh gjuha vendase (dakishtja) me latinishten, ndërsa në Ballkanin Perëndimor, në Iliri, ndodhi ndeshja latinisht-ilirisht duke fituar ilirishtja por mori shumë fjalë nga ajo.

Shuhardti zhvilloi tezën e Miklosiçit më tej, sipas së cilës ka paralelizma, përkime, analogji edhe në ndryshimet fonetike e semantike të fjalëve latine në shqip e rumanisht; ai solli si shembull fjalët: **gula** (latinisht) - **gurë** (rumanisht) - **gojë, grykë** (shqip), **compater** (latinisht) - **cumantru** (rumanisht) - **kumtër, kumbar** (shqip).

Dijetarë të përmendur kishin pohuar se shqipja ka marrë shumë huazime nga gjuhët e ndryshme evropiane, ndërsa Shuhardti theksoi se shqipes do të vijë koha që shumë nga këto huazime t'i kthehen si fjalë të saja vetiake, jo huazime, çka u vërtetua plotësisht më vonë, sidomos me studimet madhore e të pavdekshme të Eqrem Çabejt.

K.Brugman (1849-1919), gjuhëtar shumë i thellë gjerman, me njohuri për të gjitha gjuhët indoeuropiane, e vlerësoi veprën e pavdekshme të G.Mayerit.

Brugman në veprën e tij: **Grundriss der vergleichenden Grammatik der idg. Sprachen** - 1913, 1916 (Skicë e gjuhësisë krahasuese indoeuropiane), theksoi disa veçori të karakterit indoeuropian në gjuhën shqipe si: kalimi i **-o^{si}** së shkurtër në **-a**, kalimi i **-o^{si}** së gjatë në **e**, reflektimi i grupit bashkëtingëllor **-sk** indoeuropiane në **-h**, reflektimi i **-s^{si}** në **gj** (serpens - gjarpër) etj.

Si veçori për shqipen ai përmend edhe shtrirjen e madhe të zgjedhimit të foljeve me **nio** (lanio-lanj-laj).

Dijetari i përmendur ka trajtuar edhe çështje të tjera të fonetikës historike të shqipes.

S.Bugge, dijetar norvegjez, i cili u mor me shqipen dhe me gjuhët e vjetra të Ballkanit, bëri njaft plotësime dhe ndreqje në Etimologjinë e G.Mayerit.

Ai në fundin e shekullit XIX i kushtoi vëmëndje Mesapishtes, të cilën e quajti **Dialekt të Ilirishtes**; u mundua të bëjë deshifrim të saj me anë të shqipes, me ç' rast vuri në dukje shumë përkime fonetike dhe leksikore.

Në mes të tjerash ai shkruan në studimin e tij të vitit 1892: **Beitrage zur etymologischen erleuterung der albanesischen sprache** (Kontribute për ndriçimin etimologjik të gjuhës shqipe). "Mesapishtja, në qoftë se interpretimi i mbishkrimeve mesapike do të arrihet në një shkallë më të plotë, pas mendimit tim, do të marrë rëndësi për arsye se do të zëvendësoj pjesërisht shqipen e moçme që na mungon".

Qiro Truhelka (1865-1942), arkeolog me famë evropiane nga Sarajeva, profesor në Universitetin e Shkupit, është marrë me arkeologji, me parahistori, histori, etnografi, folklor; autor i më se 150 punimeve.

Në vitin 1905 i mblodhi dy Vëllime **Përralla shqiptare** dhe i përktheu nga shqipja në serbokroatisht; i botoi po atë vit në Sara-

jevë.

Dijetari në fjalë gjurmoi stacione prehistorike në Bosnjë, shkroi artikuj si: **Mbeturina ilire në Bosnjë**, botuar te Revista Albania 1899, 1900.

U mor edhe me prejardhjen e shqiptarëve dhe tha se shqiptarët, bashkë me Baskët në Pirene, janë pasardhësit e popujve më të vjetër, të cilët në kohë shumë të lashta parahistorike kanë jetuar në Kontinentin evropian, por, shtoi më tutje se **Shqiptarët** janë pasardhës të **Ilirëve** duke përmendur një varg emrash gjeografikë me prejardhje iliro-shqiptare, si emra lumenjsh, malesh, qytetesh etj.

Paul Kretçmer (1866-1956), i lindur në Berlin, profesor i gjuhësisë indoeuropiane të krahasuar në Universitetin e Vjenës.

Në vitin 1896, në një moshë të re, botoi veprën dinjitoze **Einleitung in die Geschichte der griechischen Sprache** (Hyrje në historinë e gjuhës greke), në të cilën pohoi me maturi se para nguljes së elementit helen në Greqi të vjetër, ka pasur një **shtresë të lashtë jogreke**, se para nguljes së popujve indoeuropianë, nëpër vendet Mesdhetare kishte një shtresë më të lashtë (Protindoeuropjane), e cila u tret me popullsinë e ardhur, duke lënë gjurmë të dukshme në gjuhët e mëpastajme, çka u vërtetua më vonë nga zbulimet arkeologjike.

Në këtë kryevepër i kushtoi një Kapitull prej 40 faqesh **Fiseve ilire**, ku në bazë të të dhënave gjuhësore që kishte në dispozicion, pohoi identitetin e ilirishtes, mesapishtes e të shqipes, duke kontribuar në argumentimin e autoktonisë së shqiptarëve në trojet e tyre të sotme dhe në përcaktimin e shtrirjes hapësinore të Ilirëve.

Pra shqip-ilirisht-mesapisht lidhen ngushtë; ai duke folur për lidhjen e shqipes me ilirishten, i përcakttoi mirë fiset e ndryshme ilire.

P.Kretçmer mbrojti pikëpamjen se shqipja është pasardhëse e ilirishtes, duke nënvizuar se “pranimi që gjuha shqipe përfaqëson fazën më të re të ilirishtes ose, siç shprehet në mënyrë të matur G.Mayer, një nga dialektet e moçme ilire, është sipas gjithë rretha-

nave kaq e vërtetëdukshme, sa që njeriu duhej të sillte arsye shumë të forta, shumë të rëndësishme për ta kundërshtuar atë”.

Kretçmer vë në dukje se Shqiptarët banojnë aty ku në kohën antike banonin fise ilire dhe se shqipja ka lidhje më të shumta me gjuhët balto-sllave dhe me gjuhët e grupit lindor, se ndarja duhet parë si diçka komplekse.

Ai u mor edhe me **pozicionin zonor të Venetishtes**.

Disa dijetarë, si K.Paul, atë e quanin gjuhë ilirike. Por e vërteta është, thekson Kretçmer, se gjuha venete, sidomos në pikëpamje fonetike, përfaqëson kontrastin më të mprehtë me mesapishten dhe ilirishten - në qoftë se për këtë ne ballafaqësojmë shqipen sepse asnjëra prej tipareve fonetike të trajtuara deri tani të shqipes dhe të mesapishtes nuk gjenden në venetishten, duke sjell për këtë qëllim shembuj. Por nga ana tjetër, midis venetishtes dhe shqipes ka edhe përputhje të dukshme, sidomos në mes venetishtes dhe ilirishtes, veçanërisht në Nomenklaturë, të cilat i ka evidentuar mirë Pauli.

Më tutje - vijon Kretçmer - “mendoj se edhe në lëmin e Fonetikës ka përputhje, prandaj kjo situatë në tërësi na shtrëngon të pranojmë ekzistencën e **dy dialekteve ilire**, të dallueshme qart që lidhen me njëri tjetrin më shumë **përmes përputhjeve morfologjike dhe leksikore; njëri përfaqësohej nga venetishtja, kurse tjetri nga mesapishtja dhe shqipja** (nënvizimi im - Xh.G).

Në mënyrë të ngjashme ndahen edhe dialektet italike në dy grupe - pohon ai; në grupet Umbrik-Oskan dhe Latin-Falisk.

“Është e pamundur të caktohet me saktësi - vijon Kretçmer - se ku kalonte kufiri midis ilirishtes veriore dhe asaj jugore përderisa e njohim gjuhën e Ilirisë së vërtetë vetëm nëpërmjet një numri fare të vogël glosash dhe emrash të cilat, siç thotë G.Mayer, nuk japin në të vërtetë ndonjë bazë të sigurtë për konkluzione historiko-gjuhësore”.

Paul Kretçmer, ky dijetar me një formim të jashtëzakonshëm, mendon se **Mesapët** dhe **Japygët** (Fise ilire të vendosur në Jug të Italisë), ndonëse të afërt nga prejardhja, prapëseprapë mund të kenë

genë të ndryshëm njëri nga tjetri sepse Mesapët duket se në vendin e origjinës zinin skajin më jugor të territorit Ilir, ndërsa Japygët bëjnë pjesë në fiset ilire më Veriore.

Siç ndodh shpesh me Kolonitë që vendosen jashtë territorit të tyre, po kështu emigruesit ilirë në truallin italik janë përzier njeri me tjetrin në atë mënyrë që nuk është më e mundur një veçim i fiseve të lashta. Prandaj në jug të Bregdetit italian Japygët dhe Mesapët u shkrin aq shumë me njëri tjetrin, sa që tanimë për të lashtit ata ishin vetëm një popull dhe ashtu ishin me të vërtetë - konkludon P.Kretçmer.

Dijetari në fjalë e nje **maqedonishten** e vjetër si gjuhë më vete; ai bën fjalë për konkordancat parciale të shqipes me greqishten e re; u mor edhe me grupin e gjuhëve indoeuropiane në periudhën antike.

Në punimin e tij **Sprachliche Vorgeschichte des Balkans** (Prehistoria gjuhësore e Ballkanit), P.Kretçmer shkruan: “Pas helenëve u dyndën po ashtu nga Veriu edhe dy Fise indoeuropiane: në Lindje Trakët e në Perëndim Ilirët, të cilët mbushën hapësirën e gjërë të Siujdhesës ballkanike. Imigrimi (ardhje, hyrje) ndodhi në mijëvjeçarin e dytë p.e.r, i cili u krye valë-valë, ashtu siç pat ndodh edhe me imigrimin helen. Mbeturinat gjuhësore të këtyre popujve (ilirë, trakë) që nuk arritën të krijojnë një literaturë të shkruar, janë aq të pakta, sa nuk mund të krijojnë një tablo të përafërt të gjuhës së tyre. Krahas trakëve dhe ilirëve në Veri të Ballkanit, kanë luajtur një rol të rëndësishëm edhe Skithët iranianë... Skithët i gjejmë si Mbishtresë të agatirsëve deri në Siebenburgen edhe më tej në Perëndim”.

Që Ilirët ose të paktën një pjesë e tyre kanë shkuar në trojet e tyre jugore më vonë se sa Trakët, kjo duhet pranuar sepse Ilirët vende-vende u janë mbishtresuar Trakëve dhe atyre u mbeti vendi në Perëndim të Ballkanit deri në detin Adriatik - thekson Kretçmer.

Në Lindje ndonjë fis ilir (si Dardanët) përmes territorit trak kanë shtegtuar edhe në drejtim të Azisë Veriperëndimore.

P.Kretçmer ka folë edhe për kontaktet **keldo-ilire** në lashtësi të thellë, duke theksuar se vendbanimi i hershëm i Keltëve ka qenë në Danub, se ato janë shtrirë e fut thellë në trojet ilire dhe trake.

Herman Hirt (1865-1936), në studimin **Die Sprachliche Stellung des Illyrischen** (Pozita gjuhësore e ilirishtes), botuar më 1898, e kundërshton mendimin e shprehur nga Kretçmer mbi prejardhjen ilire të shqipes dhe mbron prejardhjen e saj nga Trako-Frigishtja.

Ai parashtron këto argumente:

1. Fakti që shqiptarët banojnë qysh nga shekulli i XI në një trevë, ku në kohët e vjetra banonin Ilirët, nuk ka shumë rëndësi sepse në Gadishullin e Ballkanit ka pasur gjithnjë dyndje popujsh, prandaj shqiptarët, ashtu si sllavët (serbë, bullgarë) kanë ardhur më vonë në vendbanimin e tyre të sotëm.

2. Emri **Albanoi**, bashkë me emrin e qytetit **Albanopolis** që përmend Ptolemeu, nuk dëshmon për prejardhjen ilire të këtij populli që e quan veten **shqiptar** sepse Emrat e vendeve dhe të popujve mbeten shpesh të ngulitur në një trevë, edhe kur gjuhët dhe popujt ndërrohen.

3. Gjuha e Venetëve, që sipas Herodotit ishin ilirë, ka qenë një gjuhë Kentum; edhe ilirishtja, nga studimi i mbeturinave të saj, ishte një gjuhë Kentum, ndërsa shqipja është gjuhë Satem. As dëshmitë e sjella për të vërtetuar karakterin Satem të mesapishtes nuk janë të pakundërshtueshme.

4. Bashkëpërkimet fonetike midis shqipes dhe mesapishtes nuk provojnë asgjë, sepse dukuri të tilla fonetike ndeshen edhe në gjuhë të popujve fqinjë. Ai shton se Venetët dhe Mesapët i përkisnin një trangu gjuhësor i cili duhet përfshirë në gjuhët Kentum, me të cilat shqipja s'ka të bëjë fare.

5. Dallimet dialektore të ilirishtes nuk janë të mbështetura shkencërisht.

6. Ka disa përkime, lidhje që bien në sy midis shqipes dhe gjuhëve që fliteshin në trevën gjuhësore të trakishtes së vjetër, jo vetëm në trajtimin e elementit latin, por edhe në fusha të tjera të struk-

turës gjuhësore.

Dhe së fundi pohon: Pra unë parapëlqej pikëpamjen që shqipja dhe rumanishtja kanë në themel një Substratë (Nënshtresë) të për-bashktë dhe, duke qenë se ky Substrat nuk mund të ketë qenë ilirishtja, hëpërhë mbetet vetëm trakishtja, por natyrisht vetëm për arsye se trakishtja është e vetmja gjuhë prej së cilës nga treva lindore e Gadishullit të Ballkanit ne kemi në dorë të paktën disa mbeturina që lejojnë të njihet përkatësia e saj në gjuhët Satem.

Karl Paul e ndau shqipen nga ilirishtja dhe e lidhi me trakish-ten. Lidhjet e veçanta të shqipes me mesapishten dhe largimin e saj prej Venetishtes, ai e shpjegon me faktin se venetishten e njëj si dialekt të ilirishtes, kurse mesapishten dhe shqipen i konsideron dialekt trak në truall të ilirëve.

Ai mundohet të sjellë edhe argumente gjuhësore në veprën **Eine Vorgriechische Inschrift von Lemnos - 1894** (Një mbishkrim paragrek i Lemnosit).

Karl Jireček (1854 - 1918), historian çek, me një horizont shumë të gjerë në fushën e dijes, në veprën e tij **Die Handelsstrassen und Bergwerke von Serbien und Bosnien Während des Mittelalters** (Rrugët tregtare dhe minierat e Serbisë dhe të Bosnjës gjatë Mesjetës), të botuar në vitin 1879 mendon se shqiptarët janë autoktonë kur pohon: “Shqiptarët e mesjetës së hershme ishin autoktonë, gjysmë të romanizuar, një popull luftarak i maleve. Në provincat e tjera të Perandorisë Romake popullsia anase me kohë dalëngadalë u romanizua, ndërsa banorët e maleve shqiptare nga fundi i kohës së vjetër u ndalën në mes të rrugës në një stadium të pakryer të romanizimit”.

Shqiptarët ai i gjeti që në antikitet përgjat Bregdetit Adriatik, të cilët, po në këtë kohë, në vitet e para të erës sonë, përqaftuan fenë e re, Krishtërimin, gjithsesi para dyndjeve sllave që vërshuan në zotërimet e Perandorisë romake e në tokat shqiptare.

Po ky dijetarë më vonë në veprën **Geschichte der Serbien - 1911** (Historia e Serbëve), sikur lëkundet pak kur pohon se “Ilirët

gjysmë të romanizuar, në kohën e shtegtimimit të popujve, u shtynë prej krahinave malore midis Dalmacisë dhe Danubit dhe morën rrugën për nga Jugu”.

K.Jireçek u ka kushtuar vëmendje të veçantë marrëdhënieve sllavo-shqiptare, sidomos te vepra e tij **Romanët në qytetet e Dalmacisë gjatë mesjetës**, por edhe te **Historia e Serbëve**.

Holger Pedersen (1867-1953), gjuhëtar i shquar danez, indoeuropjanist me interesa të shumanshme shkencore, profesor në Universitetin e Kopenhagës, autor i një morie veprash. Përveç gjuhës shqipe, ai ishte njohës dhe studiues i thellë i Keltishtes dhe Armenishtes.

Më 1895 botoi në Lejpcig veprën **Tekste shqiptare** me një **Fjalorth**, e cila përmban 12 përralla, 18 gjë e gjëza, 13 këngë dhe disa besime popullore. Nga 207 faqe format i madh që ka libri. 80 faqe zënë tekstet e mbledhura nga vetë autori gjatë një qëndrimi gjashtëmujor në Korfuz dhe të një udhëtimit të shkurtër në Shqipërinë Jugore, në vitin 1893.

Kyçi i veprës së tij është **Fjalori shqip-gjermanisht**, që ngërthen 102 faqe. Po në këtë vepër (Tekste shqiptare), pas një **Parathënieje** të shkurtër, vjen **Shënime gramatikore** me vlerë, në të cilat bëhet fjalë për zanoret, bashtingëlloret, për lakimin e emrave dhe të përemrave. Kujdes u kushton Foljeve sidomos veçorive të kohës së tashme, të së pakryerës, mënyrës dëshirore dhe pjesores.

Glosari shqip-gjermanisht është hartuar me përpikmëri të madhe.

Në vitin 1894 ai botoi një studim **Mbi disa etimologji të shqipes**; po atë vit botoi një monografi **Mbi historinë e gjuhës shqipe**.

Në vitin 1895 prapë publikoi një studim **Mbi tingullin I, II të shqipes**.

Punim me vlerë është ai i botuar më 1897 **Mbi gjininë asnjëse në gjuhën shqipe**, në të cilin del rëndësia e shqipes për

historinë e asnjansit evropian.

Në vitin 1899 dha mendime për **Alfabetin e shqipes**. Më 1900 botoi monografinë **Mbi grykoret (guturalet) në gjuhën shqipe**, ndërsa më 1901 artikullin shkencor **Mbi shqipen dhe armenishten e një tjetër Mbi paskajoren e shqipes**.

Në vitin 1902 shfaqti përsëri mendime për Alfabetin e shqipes; në vitin 1905 publikoi një punim tjetër me titull **Shqip**.

Me vlerë të posaçme janë edhe botimet **Bibliografi shqipe për vitet 1899-1901** dhe **Bibliografi** (1904).

Mendime për shqipen ka dhënë edhe në veprat e tjera që ka hartuar ai për gjuhët e ndryshme, si, p.sh. në kryeveprën e tij: **Gramatikë krahasuese e gjuhëve Kelte; Përemrat dëftorë të Armenishtes së vjetër** etj.

Pederseni mbajti një qëndrim kritik objektiv ndaj mbivlerësimit të ndikimit të huaj mbi gjuhën shqipe (sidomos ndaj mendimit të G.Mayerit), duke arritur në përfundimin se ai ndikim në Strukturën gramatikore të shqipes është **baras me zero**.

Ai mbrojti me zjarr tezën e prejardhjes ilire të shqipes.

Holger Pederseni në studimin: **Grykoret (guturalet) në gjuhën shqipe** vë në dyshim argumentet që sjell Hirti për të vërtetuar karakterin Kentum të ilirishtes sidomos nëpërmes materialeve gjuhësore nga venetishtja.

Ai pohon "Ne duhet të dallojmë katër popuj jogrekë të kohëve të vjetra në Gadishullin e Ballkanit.

- a). Maqedonët
- b) Ilirët e Jugut dhe Mesapët (Shqiptarët e sotëm.
- c) Ilirët e Veriut me Venetët
- d) Trakasit.

Prandaj, përfundon ai, për të vërtetuar karakterin Kentum të Ilirishtes, Hirti duhej të vërtetonte përkatësinë e Ilirishtes Jugore në gjuhët Kentum dhe jo atë të Ilirishtes Veriore.

Në studimin e tij del se ai Venetishten e dallon si gjuhë më vete, e ndryshme nga ilirishtja. Këtu Pederseni mbron tezën se në

gjuhën shqipe ndeshen reflekset e tri serive të grykoreve indoeuropiane:

a) Prapaqielozet e mirëfillta kanë dhënë në shqip **k, g**.

b) Buzoprapaqielozet kanë dhënë **s, z**, kur janë ndodhur para zanoreve të përparme (e, i) dhe kanë përfunduar në **k, g** në rastet e tjera.

c) Qiellzoret kanë dhënë **th, dh, d**, në fillim të fjalës.

Të gjitha i ilustron në shembuj.

Holger Pedersen ishte një gjuhëtar i thellë me sens dhe dije të madhe dhe dashamirës i popullit shqiptar.

Në historinë e Albanologjisë H. Pedersen është nga më të mëdhenjtë.

Françesko Rosi (1814-1888), misionar italian, i cili më 1840 erdhi në Shqipëri dhe shërbeu në Gjakovë e Prizren e pastaj në Shkup.

Në Shqipëri qëndroi 13 vjet deri në vitin 1853. Për 28 vjet dhe mësim mbi gjuhën shqipe në Kolegjin e Shën Pjetrit në Romë.

Botoi **Rregulla gramatikore të gjuhës shqipe** (1866), **Fjalor italisht-shqip** (1866) me 924 fjalë; më 1870 përktheu shqip Ungjillin sipas Shën Mateut dhe më 1875 botoi në Romë **Fjalorin shqip-italisht** me 1400 fjalë.

Vepra **Rregulla gramatikore të gjuhës shqipe**, me një vëllim prej 350 faqe, shpaloset me një **Njoftim** mbi Alfabetin e shqipes, pastaj fillon Morfologjia ku trajton: emrin, mbiemrin, përemrin, numërorin, nyjen; folja është shtjelluar hollësisht, e cila përfshin 250 faqe.

Në fund autori ka vendosur një **Bashkëbisedues shqip** që përmban një Fjalorth për botën, kohën, njeriun, shtëpinë, kuzhinën, qytetin, fshatin, si edhe një **Dialog italisht-shqip**, me pyetje e përgjigje, me mënyra përshëndetje, me fjalë të urta: proverba, sentenca - gjithsej 90.

Autori e hartoi për nxënësit e tij në Kolegj dhe për misionarët që vinin në Shqipëri.

Xhakomo Jung (1837-1899), i lindur në Trento, më 1861 erdhi në Shkodër dhe u emërua mësues i gramatikës në Kolegjin Saverian të Etënve Jezuit në Shkodër.

Vepra e tij **Rregulla gramatikore të gjuhës shqipe**, u botua italisht më 1880 me 112 faqe.

Ajo u hartua për nevojat praktike të shkollës në fjalë, në të cilën gjuha shqipe u dha si lëndë e posaçme që me krijimin e Kolegjit (1877).

Vetë Jungu dha mësim aty, ku edhe vdiq në Shkodër pasi botoi pesë libra.

Baza e veprës së tij të lartpërmendur është **E folmja e Shkodrës** (e Gropës së Shkodrës), e cila është dhënë me mjaft saktësi, prandaj ka rëndësi për dialektologjinë historike.

Ajo hapet me disa njoftime paraprake mbi shqiptimin e drejtë të zanoreve dhe të bashkëtingëlloreve e vazhdon me çështje të morfologjisë.

Ai botoi edhe librin **Fjalor i vogël shqip-italisht**, në vitin 1895, me 12000 fjalë.

Luis Benloeu në vitin 1879 botoi frëngjisht veprën **Analizë e gjuhës shqipe** me një trajtim kryesisht historiko-krahasues.

Në Parathënie autori deklaroi se shqipja nuk është gjuhë indoeuropiane, tezë kjo krejt e gabuar.

Vepra ndahet në pesë pjesë:

Në të parin flet për shqipen në përgjithësi, për fonetikën, për fjalorët e saj.

Në pjesën e dytë trajton emrin dhe mbiemrin.

Në pjesën e tretë flet për numërorët dhe përemrat.

Në pjesën e katërt shtjellon foljen.

Në të pestën analizon pjesëzat, fjalëformimin, ndërtimet sintaksore.

Libri mbyllet me dy shtojca: **E para** me titull: **Ndikimi që ka ushtruar shqipja mbi dialektet e greqishtes së re**; **E dyta**: **vërejtje folklorike**.

Shënimet që mbyllin veprën bëjnë fjalë për Pellazgët.

Jan Urban Jarnik (1848-1923), gjuhëtar çek profesor i romanistikës në Universitetin e Pragës; u mor gjërësisht edhe me gjuhën shqipe. Mbajti Letërkëmbim të rregullt me N.Frashërin, K.Kristoforidhin, Th.Mitkon, Jeronim de Radën, Dh.Kamardën etj.

Në vitin 1881 botoi gjermanisht në Lejpcig veprën **Për gjuhësinë shqiptare**, ndërsa në vitin 1883 botoi në Pragë veprën tjetër çekisht: **Kontribut për njohjen e dialekteve shqiptare**.

Më 1899 publikoi librin **Përralla dhe Anekdota Shqiptare**.

Baza e veprave të tij është përgjithësisht E folmja e Gropës së Shkodrës.

Vlerë të madhe kanë edhe Recensionet e tij për disa vepra gjuhësore të shqipes, sidomos për Gramatikën e P.Vasos dhe të G.Mayerit. Këto Recensione Jarnik i ka botuar në pjesën më të madhe gjermanisht në Revistat shkencore austriake.

Julius Pisko, konsull në Janinë e disa vjet në Shkodër, me ç'rast edhe e mësoi gjuhën shqipe, veçanërisht dialektin e Shkodrës; në vitin 1896 botoi në Vjenë gjermanisht: **Manual i gjuhës shqipe të Veriut**.

Baza e librit të tij është E folmja e Shkodrës, në të cilin përshkruan pak Fonetikën e më gjërë Morfologjinë.

Në fund ka 40 faqe ushtrime në **shqip dhe gjermanisht**.

Vinçenzo Librandi, më 1897 botoi italisht në Milano një **Gramatikë shqipe** me poezi të rralla të Jul Varibobës.

Libri hapet me një Kushtim babait të hartuesit Mikel Librandi; vjen pastaj një Parathënie, në të cilën flitet për dyqind e ca mijë arbëreshë të shpërndarë në tetëdhjetë komuna të Italisë së jugut që janë sipas tij, pasardhësit e Pellazgëve. Më tutje fillon gramatika: pak fonetikë e më gjerë morfologjia.

Më 1928 pati një botim të dytë.

Eshtë për t'u theksuar se edhe antropologë të shquar kanë theksuar vijimsinë iliro-shqiptare. Kështu **Rudolf Virhov** (1821-

1892), një patolog dhe antropolog me emër në Gjermani, në vitin 1877 botoi studimin e parë antropologjik për shqiptarët në Berlin: **Mbi Kraniologjinë e Ilirëve**, në të cilën ai identifikon Shqiptarët (kafkat e të cilëve i ka studiuar mirë) me Ilirët dhe përfundimet e tij i përdori si argument kundër synimeve antishqiptare.

Dijetari i njohur francez **E.Pitar** (Pittard) në veprën e tij **Les peuples des Balkans** - Paris, 1916 (Populli i Ballkanit), është i mendimit se Shqiptarët janë pasardhësit e Ilirëve nga ana antropologjike.

Një studiues tjetër i shquar francez **Konti Gobinó** (Le Comte Gobineau), në punimin e tij **Essai sur inégalité des races humaines** (Studim mbi pabarazinë e racave njerëzore) pohon se Shqiptari, në pjesën e vërtetë kombëtare të vijave të tij, dallohet fare mirë prej popujve që e rrethojnë. Nuk i përngjan as grekut të ri, as sllavit. Nuk ka lidhje të ngushtë me vllahun. Marrëdhëniet e shumta, duke u afruar fiziologjikisht me fqinjët që e rrethojnë, e kanë prishur mjaft tipin e tij parak (primitiv), por karakteri i tij i veçantë nuk është zhdukur.

Sot pranohet se Evolucioni i grupeve njerëzore mund të krahasohet me Degët e një lumi që ndahen dhe bashkohen, duke arritur kështu në përfundimin se Shoqëria njerëzore duhet konsideruar si një Sistem biosocial, nënsistemet e të cilit janë: Individi, Familja, Popullata lokale, Etnia (Etnosi) dhe Rajoni biogeografik.

Në studimet e sotme antropologjike theksohet se popullsia shqiptare zë një vend të veçantë midis grupeve të tjera etnike të Ballkanit.

Studimi dhe interpretimi i të dhënave të përftuara nga skeletet njerëzore që kanë dalë gjatë kërkimeve arkeologjike dëshmon për një proces gradual të dobësimit të tipit njerëzor mesdhetar dhe të fuqizimit të elementit adriatik; pra formimi i tipit njerëzor antropologjik ilir, vështrohet si rezultat i një procesi të gjatë shndrrues mbi bazë autoktone, si një zhvillim antropologjik gradual të popullsisë parailire, protoilire, ilire dhe arbërore. Me një fjalë

është arritur në përfundimin se Ilirët, të cilët kishin prejardhje veriore dhe që elementi vendas i është nënshtruar veprimit zotërues të faktorit tipologjik verior, në pikëpamje të ndërtimit antropologjik, përbënin një popullsi Adriatiko-Mesdhetare me pakica veriore dhe alpine.

Tiparet antropologjike janë të shumta, por ne po vëmë në dukje dy më kryesorët: **Floku dhe Irisi i syrit**. Floku përbën një tipar fenotipik të rëndësishëm pasi nuk është i njëjtë te të gjithë kombet dhe kombësitë. Ai shfaqet me variacione të ndjeshme të formës, të nuancave të pigmentit dhe të strukturës mikroskopike.

Tek shqiptarët bie në sy fakti se kudo mbizotëron Floku kafe dhe gështenjë për të dy gjinitë (75%).

Është studiuar edhe ndryshueshmëria e ngjyrës së Irisit të syrit me ç' rast ka rezultuar se tek shqiptarët është veçori ngjyra kafe e Irisit (70%) dhe më pak e përhapur ngjyra blu (4%). Prandaj është arritur në përfundimin se tek Shqiptarët ngjyra përkatëse e Flokut dhe e Irisit është kryesisht e nuancave kafe dhe gështenjë dhe se mbizotëron përgjithësisht Floku i drejtë.

———— * ————

Që në shekullin e XV humanistë me famë botërore, me prejardhje shqiptare, zhvilluan një veprimtari të frytshme kulturore e shkencore në Universitetet e ndryshme të Evropës; ata ishin produkt i kulturës humaniste evropiane, por veçanërisht italiane.

U dalluan në fushën e dijes: **Gjon Gazuli** (1400-1465), matematicien, astronom dhe filozof; **Marin Barleti** (1450-1512), historian, autor i Historisë së Skëndërbeut; **Leonik Tomeu** (1456-1531), filozof i njohur; **Maksim Greku** (1480-1556), teolog dhe filozof; **Marin Beçikemi** (1468-1526), historian dhe dijetar, etj, etj.

Tani le të fillojmë me Rilindasit tanë të mëdhenj, të cilët bënë një punë kolosale në studimet albanologjike, duke u përpjekur kryesisht në këto fusha: Caktimi i një Alfabeti të vetëm, Hartimi i gramatikave, Vërtetimi i lashtësisë së popullit shqiptar dhe gjuhës së tij, Studimi historiko-krahasues i shqipes dhe i strukturës gramatikore të saj, Hartimi i Fjalorëve shqip-gjuhë e huaj, Formimi i një gjuhe letrare të njësuar etj.

Naum Veqilharxhi (1797-1846), ideologu i parë i Rilindjes Kombëtare Shqiptare, mendimtar i shquar iluminist, veprimtar i shkollës shqipe.

Ideja themelore e veprimtarisë së tij është: **Një popull mund të dalë nga prapambetja vetëm po të shkruaj gjuhën e vetë amtare dhe po ta përhapë arsimin dhe kulturën kombëtare.**

Më 1824 nisi punën për përpilimin e një **Alfabeti** të veçantë të shqipes me 33 shkronja. Me këtë Alfabet botoi librin e tij **Evetari** (Abetare e gjuhës shqipe), në vitin 1844.

Më 1845 e ribotoi me titull: **Fare i ri Evetari shqip**, pasi u kërkua me të madhe në Jug dhe në Veri të Shqipërisë.

Asaj i bëri një **Parathënie** për djemtë e ri shqiptar. Ai përgatiti edhe një **Gramatikë** por nuk është ruajtur.

Më 1846 hartoi një **Qarkore** greqisht (Enqiklikë), drejtuar bashkatdhetarëve të vetë ortodoks në Shqipëri dhe po atë vit i dërgoi një **Letër** nipit, i cili iu kishte kundërvënë përpjekjeve të tij për

çështjen shqiptare.

Parathënia, Qarkorja, Letra janë dokumentet programatike të Lëvizjes Kombëtare Shqiptare.

N. Veqilharxhi mendonte se mësimi i shqipes, ngritja dhe përhapja e kulturës mund ta vinin Atdheun në radhën e vendeve të përparuara, se pa çlirim kulturor nuk mund të ketë çlirim politik.

Ai u ngrit kundër dasive fetare dhe u bëri thirrje shqiptarëve për zgjimin e ndërgjegjes kombëtare.

E ndjeu rrezikun e shkollave të huaja dhe punoi për një shkollë shqipe; shfaqti mendime për lëvrimin e gjuhës shqipe, duke u mbështetur te gjuha e popullit; u shpreh për pastrimin e saj, duke krijuar vetë një mori fjalësh të reja e duke shti në përdorim fjalë të vjetra e të rralla.

Mendohet se u helmua.

Hoxha Tahsini (1811-1881), filozof i madh dhe mendimtar i shquar, një nga njerëzit më të ditur të shekullit XIX të Rruzullit tokësor - siç e cilëson Sami Frashëri; atdhetar i flaktë; Rektor Universiteti.

Ka shkruar shumë për Psikologji dhe Astronomi; i shtyrë nga dashuria për Atdheun u dha me pasion edhe pas veprimtarisë patriotike.

Shkrimi i shqipes, përhapja e arsimit dhe diturisë ishin për të Çelësi kyç për Çlirimin e Shqipërisë dhe lartësimin e popullit.

Që në vitet gjashtëdhjetë të shekullit XIX, në bashkëpunim me Rilindas të tjerë, filloi të mendojë e të punojë për krijimin e Shoqërive që do të punonin për përhapjen e diturive midis shqiptarëve dhe për hartimin e një Alfabeti të ri për gjuhën shqipe.

Ai mendonte se mbarëvajtja e një gjuhe varet parasëgjithash nga një Alfabet i ndërtuar me kritere të përshtatshme për atë gjuhë.

Hoxha Tahsini gjithënjë përsëriste një mendim të filozofit të madh gjerman Leibniz:

“Më jepni një palë shkronjëza të mira, t’u japë një gjuhë fort të mirë; më jepni një gjuhë të mirë, t’u jap një qytetërim fort të mirë”

Për rëndësinë e Alfabetiti ai shkruante: “Sado që janë të vogla si këmbët e milingonës, shkronjat janë arma më e fuqishme e përparimit dhe e diturisë, prandaj t’i pranosh ato pa treguar kujdes të veçantë, është më e dëshme se sa të zgjedhësh një armë të re dhe, pa e provuar, të luftosh me të”.

Është i njohur projekti i tij i Alfabetit të gjuhës shqipe me 30 bashkëingëllore e 8 zanore.

Më pas Hoxha Tahsini, ky kollos i dijes njerëzore, i lindur në Ninat të Sarandës, merr pjesë në Komisionin që hartoi Alfabetin e Stambollit.

Anastas Byku, lindur në Lekël të Tepelenës, mësues, gazetar dhe publicist.

Ai botoi për dy vjet (1860-1861) në Lamia të Greqisë gazetën **Pellazgu**, kushtuar tërësisht luftës për gjuhën dhe kulturën shqiptare, botim shqip dhe greqisht. Duke ndjekur rrugën e N.Veqilharxhit, për të cilën kishte një nderim të veçantë, nuk pushoi së theksuari se populli shqiptar, megjithë ndarjet fetare dhe krahinore, përbën një njësi kombëtare më vete, me histori të lashtë, pasardhëse e Pellazgëve dhe e Ilirëve që ka nxjerrë gjithnjë burra të mëdhenj si Skëndërbeun.

Zhvillimi dhe përparimi i këtij populli nuk mund të arrihet veçse me lëvrimin e gjuhës dhe të kulturës kombëtare, me zgjimin e tij, me anë librash e shkollash në gjuhën shqipe - mendonte ai.

Për këtë qëllim përshtati alfabetin e greqishtes dhe hartoi Abetaren **Gramë për shqiptarët** (1861).

Zef Jubani (1818-1880), ekonomist (hartues i disa veprave nga fusha e ekonomisë), mendimtar, aktivist i shquar. Në vitin 1871 në veprën e tij **Përmbledhje këngësh popullore dhe rapso-di poemash shqiptare**, brenda faqeve 25-54, botoi italisht kapitullin **Sistemi i ri i shkronjave latine dhe disa rregulla të reja caktuar kryesisht për këngët shqipe të kësaj vepre në mënyrë që lexuesi të mundohet vet të kuptojë dhe t’i shqiptojë fjalët shqipe në theksin e tyre origjinal.**

Pra ai del përpilues i një Alfabeti të posaçëm me bazë latine.

Në këto 30 faqe ai bën disa **Shënime Gramatikore** për gjuhën shqipe: në fonetikë, morfologji, drejtshkrim dhe drejtshqiptim; ndalet në pjesët e ndryshme të ligjëratës, duke dalluar tre lakime; jep shpjegime për përemrat, parafjalët dhe lidhëzat; zgjedhon foljen **me pasë** (kam) dhe **me qenë** (jam).

Jani Vreto (1822-1900), atdhetar dhe mendimtar i shquar i Rilindjes sonë Kombëtare. Në vitin 1879 në punimin **Udhë e të shkruarit të gjuhës shqipe**, dha disa elemente të gramatikës shqipe; foli për shkronjat, alfabetin, diftongjet, theksin, rrokjen; foli për disa pjesë të ndryshueshme të ligjëratës, për disa kompozita dhe për përdorimin e shenjave të pikësimit. Ky artikull prej 13 faqesh u botua te **Alfabetare e gjuhës shqipe**, në Stamboll më 1879.

Por duhet thënë se J. Vreto në vitin 1866 pat botuar librin **Gramatikë e greqishtes së folur në gjuhën shqipe**, në Stamboll, ku shpreh pikëpamje filoheleniste.

Vretoja përdori në këtë vepër 36 shkronja prej tyre 13 latine dhe të tjerat greke.

Në këtë Gramatikë ai shkruan se shqipja me të vërtetë mund të quhet një gjuhë që “duket shumë e vjetër”, “gjuhë e foshnjësisë” por ajo është “e afërt me elenikan e vjetër”, pra e afërt me greqishten e vjetër, - tezë kjo e Shlajherit, Shtirit, Kamardës.

J. Vreto shkruan më tutje se shqipja, kjo “gjuhë e foshnjërisë” së njerëzimit, ka mbetur atje tek ishte nga të palëruarit, “fare e varfër dhe e prishurë edhe e nakatosur me gjuhëra të tjera”.

Për të përhapur kulturën, dijen - çka është e nevojshme pohon ai - me që shqipja nuk e kryen dot këtë detyrë, duhet përdorur greqishtja, pra duhet mësuar mirë kjo gjuhë.

Me grekët - thekson Vretoja - ne “jemi gjitonë dhe të përzierë”; me ta kemi adete, tabiate të veshurit... Aq të afërt jemi ne me grekët, sa me një fjalë quhemi Degë e Elinëve, pavarësisht se jemi tjetër soj”.

Në Prathënien e veprës së lartpërmendur gjejmë thelbin e mendimit të tij filohelen, filogrek, çka në vitet e mëvonshme do ta ndryshojë. Ai është edhe për botimin e librave shqip.

Dora D'Istria, pseudonim i Elena Gjikes (1829-1888), shkrimtare dhe publiciste me origjinë shqiptare; i entuziazmoi në vitin 1866 të gjithë patriotët shqiptar me esenë (studimin) e saj frëngjisht. **La nationalité albanaise d'après les chants populaires** (Kombësia shqiptare sipas këngëve popullore), e cila u përkthye dhe u botua shqip e italisht pa mbushur mirë viti; në të shpallej përpara të gjithë botës e përpara shqiptarëve se ka një komb shqiptar me një kulturë të vetën dhe me aspiratat e tij kombëtare, të cilat ai shpejt a vonë do t'i arrij.

Çështje të tilla rrahin edhe studimet e tjera të saj: **Lescrivains albanais del Italie Meridionale** - 1867 (Shkrimtarët shqiptarë të Italisë Jugore); **Gli albanesi in Rumania** - 1873 (Shqiptarët në Rumani).

Ajo përkrahu gjallërisht Lëvizjen Kombëtare Shqiptare, sidomos Lidhjen Shqiptare të Prizrenit dhe mbajti lidhje të ngushta me veprimtarët e shquar: Jeronim de Rada, Dhimitër Kamarda, Zef Serembe, Zef Jubani, Thimi Mitko etj.

Sami Frashëri (1850-1904), dijetar i njohur me një prodhimtari shumë të madhe në disa fusha të dijes; shkrimtar, publicist, enciklopedist, aktivist i madh politik, ideologu kryesor i Lëvizjes sonë Kombëtare.

Sami Frashëri është edhe një albanolog i shquar, autor i së parës Gramatikë në gjuhën shqipe: **Shkronjëto e gjuhës shqipe**, sh-typur në Bukuresht të Rumanisë nga Shoqëria Drita në vitin 1886.

Vepra në fjalë, me 141 faqe, u përdor edhe si tekst mësimor në Mësonjëtoen shqipe të Korçës, por ajo i kalon kufijtë e një teksti mësimor, qoftë edhe të shkollës së mesme.

Është ndërtuar mbi baza të shëndosha shkencore. Ndonëse është shkruar mbi bazën e dialektit jugor, ka vëzhgime edhe nga gegërishtja. Shquhet për një gjuhë të pastërt, stil shkencor dhe konçiz,

ka qartësi dhe rregullsi të madhe. Veprën e bëjnë praktike paradigme e lakimeve dhe të zgjedhimeve; ajo është teorike, pa ushtrime praktike.

Shkronjëto e gjuhës shqipe, hapet me një **Parathënie** të shkurtër dhe vijon me **Fonetikën** dhe **Morfologjinë**.

Autori përmend dhjetë pjesë të ligjëratës (emër, nyje, mbiemër, përemër, folje, pjesore, ndajfolje, parafjalë, lidhëz, pasthirimë). Emrat i ndanë në gjashtëmbëdhjetë lakime, duke u nisur nga synimi për t'i dalluar sa më imtë; pranon gjashtë rase, gjashtëmbëdhjetë kohë e shtatë mënyra (habitoren dhe kushtoren i merr si kohë të mënyrës dëftore).

Për foljet e parregullta ka një koncept të gjërë: përfshin 54 folje, midis tyre edhe ato me ndërrim tingujsh.

Një punë të madhe autori ka bërë për krijimin e terminologjisë gramatikore shqipe.

S.Frashëri për gjuhën shqipe dhe rëndësinë e saj ka dhënë mendime të shkëlqyera edhe në vepra dhe studime të tjera, të hartuara nga ai, çka folëm në pjesën e parë të veprës sonë.

Me **Shkronjëto e gjuhës shqipe**, S.Frashëri hodhi bazat e Gramatologjinë shqiptare.

Pashko Vasa (1825-1895), rilindas shumë i madh, burrë shteti dhe letrar; ka shkruar shumë, por ne po përmendim veprimtarinë e tij në fushën e Gjuhësisë.

Ai shkroi e botoi një varg veprash, të cilat i shërbyen zgjidhjes së çështjes së shkrimit dhe mësimin të shqipes si: **Alfabeti latin i zbatuar në gjuhën shqipe**, frëngjisht në vitin 1878 (L'alphabet latin appliqué a la langue albanaise).

Rilindasi ynë përdori një sistem të tillë shkronjash që koha i dha të drejtë për kriteret që vuri në themel.

P.Vasa pat deklaruar edhe për hartimin e një **Fjalori të gjuhës shqipe**, i cili kurrë nuk e pa dritën e botimit dhe nuk dihet asgjë për të.

Në vitin 1887 P.Vasa botoi frëngjisht në Londër veprën: **Gra-**

matika shqipe për t'u përdorur nga ata që dëshirojnë ta nxënë këtë gjuhë pa ndihmën e një mësuesi (Grammaire albanaise a l'usage de ceux qui desirent apprendre cette langue sans l'aide d'un maître), me 169 faqe.

Këtu përdori Alfabetin e krijuar nga vetë ai, i cili u adoptua gati i tëri nga Kongresi i Manastirit.

Gramatika hapet me një **Parathënie**, frëngjisht, shkruar plotë ndjenja të thella patriotike për lashtësinë e popullit shqiptar dhe të gjuhës së tij; vjen pastaj **Hyrja** prej pesë faqesh në të cilën flet për shkronjat, abecenë dhe pak për **Fonetikën**; më tutje hyn në **Morfologji** ku dallon tetë pjesë të ligjëratës .

Më hollësisht është shtjelluar Folja (me rreth 100 faqe), ku ka dalluar tetë zgjedhime. Trajton mirë pjesët e pandryshueshme të ligjëratës dhe mbyllet me një **Pasthënie** frëngjisht në të cilën tregon rëndësinë e veprës në fjalë.

Duke u botuar kjo Gramatikë në një Qëndër të madhe kulturore si Londra, u dha mundësi studiuesve të huaj të njohin më mirë lashtësinë e shqipes dhe të popullit shqiptar, si edhe strukturën gramatikore shumë të pasur, të larmishme e vetiake të shqipes.

Për historinë e Albanologjisë ka rëndësi edhe vepra tjetër e tij: **E vërteta mbi Shqipërinë dhe Shqiptarët** (La verité sur l' Albanie et les Albanais, Paris 1879).

P. Vasa mbetet burrë shumë i madh i Rilindjes sonë Kombëtare.

Konstandin Kristoforidhi (1827-1895), figurë e shquar e Rilindjes sonë Kombëtare. Veprimtaria e tij e shumanshme është përqëndruar kryesisht te **gjuha** shqipe, sepse për të është i vetmi mjet për të siguruar bashkimin e popullit shqiptar dhe përparimin e Atdheut, sepse gjuha shqipe është një gjuhë e pasur, e larmishme, e përpiktë, shumë shprehëse me anën e së cilës mund të shkruhen e të përkthehen fare mirë vepra të kalibrit botëror, të shkencave shoqërore e natyrore, filozofike e artistike. Kontributi i Kristoforidhit në gjuhësinë shqiptare është shumë i madh dhe shtrihet në disa fusha: në çështjen e Alfabetit, në Leksikologji e leksikografi,

në Etimologji, Morfologji, Fonetikë, Dialektologji, Drejtshkrim, në Tekstologji etj.

Ai ka bërë përpjekje për të krijuar një Alfabet të shqipes me bazë kombëtare, me themel latin, i tillë që të njihet e të përdoret nga të gjithë shqiptarët, duke bashkëpunuar për këtë qëllim me shumë Rilindas të tjerë.

Në Leksikografinë shqiptare të periudhës së para Luftës së dytë Botërore. **Fjalori Shqip-Greqisht** i Kristoforidhit është vepra më dinjitoze në këtë fushë, botuar pas vdekjes së autorit, në vitin 1904 në Athinë, dhe me një **Hyrje** kritike, me transkriptim nga A.Xhuvani botuar në vitin 1961 në Tiranë. Është një Fjalor dygjuhësh, por në të vërtetë autori nuk ka pasur si qëllim të bëjë vetëm një Fjalor shqip-greqisht për t'u shërbyer grekërve që të studiojnë shqipen, as shqiptarëve që të studiojnë greqishten, por ka synuar të hartojë Fjalorin e Shqipes për Shqiptarët, çka e thotë edhe vetë: Është i gjithë gjuhës shqipe se është mbledhur fjalë “anë e këndë më këndë”; ai i shënon fjalët jo vetëm me siglat përkatëse (lab, çam, geg), por, shumë herë, edhe vendin ku është mbledhur. Mjaft fjalëve u shënon edhe trajtat dialektore më të holla, si edhe vendin e përdorimit të tyre.

Fjalët shënohen me saktësi të madhe dhe shpjegohen me përpikmëri. Ka gjithsej 11675 fjalë. Ai e quan Fjalorin themelin e gjuhës.

Vepra tjetër për gjuhën shqipe, mjaft e rëndësishme është **Gramatika e gjuhës shqipe**, botuar greqisht në Stamboll më 1882, mbi bazën e dialektit të toskërishtes me 167 faqe.

Mendimi i përgjithshëm është se ai e hartoi këtë Gramatikë toskërisht në gjuhën greke për t'u ardhur në ndihmë intelektualëve shqipëtarë dhe atyre që e njihnin greqishten e re por që nuk dinin atëherë të lexonin e të shkruanin shqip, kështu që me anën e kësaj gramatike do të mësonin gjuhën amtare.

Në Gramatikën e tij në fillim është një **Parathënie** e shkruar greqisht, në të cilën flet për dy dialektet e shqipes,. Pastaj është shënuar **Alfabeti** që ka përdorur autori i përbërë prej 36 shkro-

njash: 29 bashkëtingëllore dhe 7 zanore. Shkronjat janë greke, ndërsa për ato që mungojnë, ai i ka krijuar vet.

K.Kristoforidhi veprat toskërisht i botoi me alfabetin grek, sepse ai njihej në viset jugore, ndërsa për veprat gegërisht përdori alfabetin latin sepse ai përdorej në Veri.

Nëntë faqet e para merren me **Fonetikën** pastaj vijon **Morfologjia**, e cila jepet më shkoqur; **folja** është shtjelluar gjërësisht; **emrat** i ndan në katër lakime. Janë trajtuar mirë edhe **mbiemrat**, **përemrat**, **pjesët e pandryshueshme të ligjëratës**.

Materiali i veprës është shumë i pasur, i larmishëm dhe i thellë. Për shumë çështje që trajton jep shembuj për të dy dialektet e shqipes, duke dhënë shumë herë edhe shënime për shtrirjen e njëjës apo tjetrës formë.

Vepra tjetër e tij **Shënime për Shqipërinë** (1860) është me vlerë për historinë e gjuhësisë shqiptare.

Studimi **Memorandum për gjuhën shqipe** (1857) është një përpjekje për të vërtetuar nevojën e përkthimeve të reja në shqip.

Abetaret e tij, njëra gegërisht e tjetra toskërisht (1872) shërbyen shumë për përhapjen e shkrim-këndimit të shqipes në masat e gjëra të popullit tonë.

K.Kristoforidhi bëri një punë kolosale për pasurimin e gjuhës sonë me fjalë të reja, me neologjizma të krijuara nga brumi i shqipes; gjejmë fjalë të krijuara nga vetë ai si: **zanore**, **hundore**, **emërore**, **abetare**, **dyzanore** (diftong), por pati edhe nga ato që nuk zunë vend; p.sh. **rasa hekore** (rrjedhore).

Gramatika e Kristoforidhit është e katërta, relativisht e plotë, e botuar nga një shqiptar, brenda periudhës së Rilindjes (De Rada, S.Frashëri, P.Vasa, K.Kristoforidhi).

Kostandin Kristoforidhi mbetet një nga themeluesit e gjuhësisë shqiptare.

Hafiz Ali Ulqinaku (1855-1913), lindur në Ulqin, por punoi e jetoi në Shkodër dhe në Lezhë; hartoi një **Fjalor** turqisht-shqip dhe shqip-turqisht, si edhe një **Abetare shqip** me alfabet arab, të

cilat mbeten të gjitha dorëshkrim.

Fjalori, i hartuar rreth vitit 1897, të cilin e quajti vetë ai Ulqin, përbëhet nga tri pjesë: **Pjesa e parë** përmban një Fjalor turqisht në vargje; **Pjesa e dytë** përfshin një Fjalor të rregullt turqisht-shqip, me rreth 18000 fjalë; **Pjesa e tretë** ngërthen një **Fjalor** shqip-turqisht me rreth 5500 fjalë.

Ky Fjalor përmban mjaft fjalë të rralla dhe ka vlerë të madhe për leksikologjinë shqipe e për historinë e gjuhës.

Daut Boriçi (1823-1896), mësues dhe hartues tekstesh shkollore; botoi **Alfabeti shqip** (1861), **Abetarja shqipe** (1869, 1881); la dorëshkrim **Gramatikë shqipe, Fjalor turqisht-shqip** (1844-1850).

Ai bëri përpjekje të parreshtura për përhapjen e arsimit në masat e gjera në Shkodër, Lezhë, Krujë, Kavajë, Tiranë, Dibër, Ulqin.

Veprat e tij gjuhësore janë me interes për historinë e Alfabetit, të Gramatologjisë, të Leksikologjisë dhe të Dialektologjisë.

Ishte aktivist i madh në ngjarjet historike të viteve 1878-1881, duke mbrojtur me guxim Lidhjen Shqiptare të Prizrenit dhe interesat kombëtare të popullit shqiptar.

Shemimi Shkodra, në vitin 1835 pat hartuar një **Fjalor shqip-turqisht** me 1000 (njëmijë) fjalë dhe pak frazeologji.

Ai thotë se e hartoi për nevojat e ushtarëve turq që vinin në Shqipëri dhe të shqiptarëve që nuk e dinin turqishten; jep Abecenë prej 45 gërmash arabe që ka përdorur.

Së pari ka një **Hyrje** me vargje turqisht ku jepet titulli i veprës të cilën autori e quan **Nytkë** (Fjalim). Më pas vjen **Fjalori**, baza e të cilit është **E folmja e Shkodrës**, por ka edhe ndonjë fjalë nga të folmet e Beratit, çka tregon se Shemimiu ka jetuar edhe në këtë qytet.

Në fillim jep fjalën shqip, pastaj përgjegjësen turqisht; bile nganjëherë fjalën turqisht e shpjegon me turqizmat e shqipes.

Në këtë vepër ka edhe një **Vjershë** turqisht ku Shemimiu shpreh dhëmbje për vuajtjet që ka pllakosur Shkodrën: “Në popull ka zi e

qesat; zabiti bën keq dhe kadiu ha ryshfet; të frikshme si gremina, gjithëfarë sëmundjesh përhapen”.

Në fakt viti 1835 ka qënë vit trazirash në Shkodër.

Mendohet se ai në vitin 1838 hartoi një Gramatikë të shqipes, shkruar me alfabetin arab.

Kozma Qirici Kotra (1780-1852), gjirokastrit, mësues në Konicë, Përmet, Janinë etj.

Në vitin 1831-2 hartoi greqisht veprën:

Gjeografia e Shqipërisë dhe e Epirit, duke e shoqëruar me skica dhe harta, e cila u botua në Janinë, tani vonë, më 1964.

Ne na intereson fakti që autori në këtë vepër jep këngë popullore dasme nga Dangëllia e Përmetit, zakone shqiptare, flet për karakterin e shqiptarit e, mbi të gjitha, na ofron një **Listë fjalësh frëngjisht-shqip-greqisht, një Listë fjalësh italisht-shqip**; janë përpjekje etimologjike për të treguar se ç’ka të përbashkët shqipja me gjuhët me të cilat e krahason.

Faik Konica (1875-1942), studiues, letrar, njeri shumë i ditur. Drejtoi për dhjetë vjet Revistën **Albania** e cila botohej në Londër dhe Bruksel. Numri i parë i saj doli më 25 mars 1897 dhe vazhdoi deri në vitin 1907.

Pikërisht në këtë Revistë Faik Konica shprehu interesimin e tij, që ka qënë jashtëzakonisht i madh, për çështjet e Albanologjisë, veçanërisht për gjuhën shqipe.

Që në artikullin **Për themelimin e një gjuhe letrarishte shqipe**, botuar në numrin e parë të Revistës në fjalë e që vazhdoi në disa numra, shpreh mendimin se **çështja e gjuhës dhe çështja e kombësisë janë të lidhura njëra me tjetrën**. Në atë artikull ai shkruan: “Vetëm shqiptarët nuk kanë një gjuhë të përbashkët; edhe andej vjen që kanë mbetur të ndarë njëri nga tjetri, andej kanë rrjedhur aq të këqia për neve të mjerët. Është nevojë dhe shtrengim të hedhim themelin e një gjuhe letrare...”

Sipas Konicës **Gjuha dhe Karakteri pasqyrojnë njëri-tjetrin**, prandaj ndryshimi në **Gjuhë krijon ndryshime në Karakter**.

Toskërishtja, sipas tij, është diçka si e **shpejtë dhe e epur**, ndërsa Gegërishtja, përkundrazi, është si **diçka e ngadalshme dhe e rëndë**.

Për Konicën **Toskërishtja** do të ishte e aftë për **Prozë**, ndërsa **Gegërishtja** do të ishte e aftë për **Poezi**. Por kjo presupozon që shkrimtari toskë duhet të mësojë gegërisht për të shkruar Poezi, kurse shkrimtari gegë duhet të mësojë toskërisht për të shkruar Prozë.

Më në fund u bind se kjo mënyrë veprimi nuk njeh zbatim në praktikë.

Ja se çfarë shkruan në numrin 7 të Revistës:

“... ndofta e mira e së mirave do të jetë të përdoshin prej të gjithë shqiptarëve toskërishtja për prozën, e gegërishtja për Poezinë. Po shqiptarët nuk janë mjaftë të pjekur për të kuptuar shkakun e këtij mendimi. Pastaj nuk bëhet as dobi të shkruajnë gegët toskërisht, as toskët thjeshtë gegërisht. Andaj duhet pak e nga pak të afrojmë të dy dialektet njëri afër tjetrit gjersa t’i përziejmë në të shkruar”.

Dhe në të njëjtën Revistë (Albania), në numrin 8 vazhdon: “Sa e bukur dhe e ëmbël është gjuha shqipe; po megjithë bukurinë dhe ëmbëlsinë e saj, nuk është ende gjuhë e plotë. Që të jetë gjuhë si të tjerat duhet të përzihet dalngadalë e nga kjo përzierje të dalë një gjuhë e re dhe e shëndoshë: Gjuha shqipe e Përgjithshme”.

Pra, siç del, Konica anon nga mendimi për përzierjen dhe shkrirjen e të dy Dialekteve kryesore. Këtë ide e shpreh më qartë të artikulli frëngjisht, botuar te numri 10 i Revistës në fjalë: **Les dialectes albanais e la nécessité de leur fusion** (Dialektet e shqipes dhe nevoja e shkrirjes së tyre).

Një mendim të tillë e gjejmë edhe të Sami Frashëri në veprën **Shqipëria çka qënë, çështë dhe çdo të bëhet** kur flet për Kryeqytetin e ardhshëm të Shqipërisë, i cili duhet të jetë në mes të vendit dhe prandaj “... me qënë që ndenjësit e tij do të jenë të mbledhur nga të gjithë anët e Shqipërisë edhe **gjuha që flitet atje do të jetë e përzierë që të mund të quhet gjuhë e përgjithshme e gjuhë**

letrarishte e gjithë Shqipërisë” (nënvizimi im - Xh.G.).

Faik Konica plotë besim për të ardhmen, pohon në numrin 12 të Revistës së lartpërmendur: “Ne parandjejmë, në agimin e së nesërmes, një Shqipëri të lulëzuar e intelektuale, ku do të rrojë plotë gjallëri një rini e etshme për dije, e dhënë pas artit, bukurisë dhe punës. Këta shqiptarë të rinj do të gjykojnë me një drejtësi mëshirëplote përpjekjet tona, të shartuara me dështime, ngadalësi e paaftësi por plotë çiltërsi të zjarrtë. Ata do të shqyrtojnë, me të gjitha mjetet e dokumëntimit e të kritikës, se ç’ ishte gjuha jonë e djeshme dhe ç’do të jetë gjuha e tyre e nesërme, gjuha në të cilën ata do të shprehin mendimet e tyre ose ëndërrat e tyre. Kësaj gjuhe plot muskuj, ëmbëlsi e mprehtësi, ata do t’i kërkojnë datën e lindjes dhe do të dinë ta përcaktojnë këtë”.

Në disa numra të Revistës Albania ai ka shkruar artikuj të shumtë kushtuar anëve të ndryshme të gjuhës shqipe, në mes të cilëve do të përmendim: **Gjuha shqipe në rrezik; Ligjet e zhvillimit fonetik në gjuhën shqipe**, ku autori jep shtatë raste refleksesh të tingujve të shqipes nga greqishtja dhe latinishtja; **Një veçori fonetike e toskërishtes**, ku vëren se në toskërishte shquhen tri lloje e^{sh}: e -e mbylltë, e -e shurdhtë, e -e shurdhtë, e dobtë; **Neologjizmat e gjuhës shqipe**, ku ai jep këshilla propozime e qortime për përdorim fjalësh, për zëvendësim fjalësh të huaja, për krijim fjalësh të reja. Mendon se mënyrat e pasurimit të shqipes janë: kompozitat, ndërtime me prapashtesën -es etj.

Për neologjizmat flet më gjërë te artikulli frëngjisht: **Les neologismes et les lois de l’evolucion phonetique dans la langue albanaise** (Neologjizmat dhe ligjet e evolucionit fonetik në gjuhën shqipe).

Çështjen e fjalëve të reja e shtjellon edhe te artikulli **Çështje të shkrimit të shqipes** në të cilin trajton më tepër bazën shkencore të Neologjizmeve.

Gjithashtu edhe në artikullin **Fjalë shkence në gjuhën tonë**, F.Konica, disa termave shkencore frënge, u rrjeshton terma shqip,

të sajuar prej tij dhe propozon të futen në terminologjinë shqipe; tregon njëkohësisht metodikën që ka ndjekur për krijimin e tyre.

Faik Konica ka shkruar edhe artikuj të tjerë për anë të ndryshme të gjuhës shqipe. Ai mbetet burrë i madh i kulturës shqiptare.

Koto Hoxhi (Konstandin Hoxhi 1824-1895), nga Qestorati i Lunxhërisë, veprimtar i shquar i Rilindjes, i Arsimit dhe i Kulturës Shqiptare. Më 1879 mori pjesë në Komisionin e Stambollit për alfabetin e shqipes, si edhe në botimin e Alfabetares së Stambollit. Si mësues i shkollës së mesme në gjuhën greke, ai jepte mësim shqip fshehurazi.

Pandeli Sotiri (1843-1891), figurë e shquar e arsimit gjatë Rilindjes, nxënës i Koto Hoxhit; megjithëse me profesion mjek se i kishte kryer studimet e larta në Austri për mjekësi, tërë jetën ia kushtoi arsimimit dhe shkollës shqipe.

Në Bukuresht u aktivizua shumë në botimin e Revistës Drita e më pas Dituria. Ai dha ndihmesë të madhe për mbarëvajtjen e Mësonjtores shqipe të Korçës, duke qënë vetë Drejtor i parë i saj dhe i pari mësues i shqipes në këtë shkollë.

U vra në Stamboll në vitin 1891.

Said Najdeni (1864-1903) ose **Hoxhë Voka**, nga Dibra e Madhe, atdhetar i flaktë; punoi për çëhtjen e Atdheut tërë jetën. Më 1888 hapi një shkollë shqipe në shtëpinë e vet, në Dibër, dhe ndihmoi për përhapjen e shqipes në krahinat përreth.

Në mes të tjerash hartoi veprën **Abetare e gjuhës shqipe ndë të folë gegërisht** (1900), duke u mbështetur në veprën e Samiut.

Naum Dhimitër Naçi (1871-1927) ose **Nuçi Naçi**, aktivist i dalluar në fushën e arsimit shqiptar; Drejtor i Mësonjtores shqipe të Korçës, punoi si mësues i shqipes edhe në vende të tjera; dha ndihmesë për të futur frymën atdhetare në mësim dhe në veprimtarinë jashtëshkollore me nxënësit. Ai është autor i disa botimeve letrare dhe publicistike ku trajtoi çështje të arsimit të kohës.

Nuçi Naçi ishte aktivist i disa Shoqërive dhe Klubeve të kohës ku mbrojti me zjarrë të drejtat e popullit shqiptar.

Thimi Vasil Marko (1855-1922), veprimtar korçar i arsimit shqip. Nga Rumania, ku kishte emigruar që në moshë të re, në vitin 1886 erdhi në Korçë për të përhapur arsimin dhe mësimin në gjuhën shqipe, me ç'rast dha kontribut për çeljen e Mësonjtores së parë shqipe dhe ndihmoi në mbarëvajtjen e saj.

Gjok Shqiptari, pogradecar, gjatë shekullit XIX zhvilloi një veprimtari të dendur si mësues i gjuhës shqipe në zonën e Pogradecit dhe si përhapës i teksteve shkollore dhe i librave shqip në mënyrë të fshehtë.

Për këtë **aktivitet** u kap dhe u masakrua nga agjentët e Patriarkanës.

Gasper Benusi (1850-1931), një shkodran i ditur, i cili në vitin 1876 hapi në Shkodër një Shkollë private shqipe në shtëpinë e vet që e mbajti për dymbëdhjetë vjet.

Më 1876 në Bukuresht në Shtypshkronjën Dituria botoi **Abetare e gjuhës shqipe**, e cila pati edhe dy ribotime: njëra në vitin 1890 dhe tjetra në vitin 1907.

Ai ka botuar në Shkodër në vitin 1890, me një ribotim të dytë më 1897, edhe një **Manual** që ka diaa elemente gramatikore me titull: **Shqiptari i msuem në g-juh të vet**, me 161 faqe.

Dedë Koleci (vdekur, 1915) ishte shkrimtar dhe ndër theme-luesit e Shoqërisë Letrare **Bashkimi** në Shkodër, në vitin 1899.

Ai shkroi një **Gramatikë** dhe një **Fjalor** të gjuhës shqipe me titull: **Gramatika ja Folmarmja shqiptare**, e cila trajton fone-tikën dhe morfologjinë.

Shoqëria **Bashkimi** e botoi këtë **Gramatikë** në vitin 1901; ajo pat botuar edhe një **Broshurë** me 23 faqe me titull: **Oroe përmii abetare shqip**, e cila ka rëndësi për historinë e Alfabetit të gjuhës shqipe.

Pjetër Zarishti (1806-1866), poet dhe shkrimtar, ka lënë një **Gramatikë** dorëshkrim.

— * —

Gjatë periudhës së Rilindjes në jetën politiko-shoqërore dhe

arsimore-kulturore u aktivizuan për çështjen kombëtare edhe arbëreshë të Greqisë, patriotë të flaktë dhe të arsimuar mirë. Ndër ata që dhanë kontribut për gjuhën shqipe do të përmendim:

Marko Boçari (1790-1823), komandant suliot, luftëtar për pavarësinë e Greqisë, hero i Revolucionit grek.

Në vitin 1809 në Korfuz, me kërkesën e konsullit frëng në Janinë, Pukëvil dhe përpara syve të tij, diktoi një **Fjalor greqishte e re-shqip** me 1494 fjalë, duke u regjistruar nga Pukëvili.

Dokumenti ka rëndësi për të njohur të folmen e krahinës së Sulit që nuk ka qenë shkruar më parë.

Panajot Kupitori (1821-1881), studiues arbëresh nga Hidra e Greqisë (ishull); zhvilloi një veprimtari të gjërë patriotike për të zgjuar te bashkëatdhetarët ndjenjën kombëtare, si edhe për ruajtjen dhe gjallërimin e gjuhës shqipe te arbëreshët e Greqisë. Hapi edhe një shkollë shqipe natën. Mblodhi material dialektor te bashkatdhetarët e vet dhe botoi disa punime për gjuhën shqipe, sidomos për të folmet shqipe të Greqisë si: **Studim historik e filologjik për gjuhën dhe kombin shqiptar** (1879); **Disertacion për përemrat e vetës së tretë në të folmet shqipe të Greqisë**, kryesisht për të folmen e Hidrës (1879).

Anastas Kullurioti (1820-1887), veprimtar i shquar nga arbëreshët e Greqisë (Salamina). Në vitet e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit botoi gazetën **Zëri i Shqipërisë** (I fonitis Albanias), ku mbrojti me guxim të drejtat e popullit shqiptar.

Ai shkroi një **Abetare** shqip me alfabetin grek, një **Fjalor shqip-greqisht** si edhe dy **Broshura** me titull të përbashkët: **Alvaniko Parerga** (Ankimet shqiptare).

Mbrojti tezën se shqiptarët janë autoktonë, se shqipja është gjuhë indoeuropiane; kërkoi që kombi shqiptar të arsimohet në gjuhën amtare, duke hapur të gjitha shkollat deri te Universiteti i tij.

U interesua për mbledhjen e folklorit shqiptar, të leksikut, për hartimin e Fjalorëve dhe të Studimeve.

Periudha e tretë

Në këtë kohë studimi i gjuhës shqipe vijon në mënyrë intesive qoftë nga vet studiuesit shqiptarë, qoftë nga arbëreshët, qoftë nga dijetarët e huaj.

Në këtë fazë më tepër vazhdon hartimi i gramatikave si tekste shkollore, hartimi i Fjalorëve dygjuhësh dhe dialektorë, diskutimi për problemet e gjuhës letrare të njësuar dhe rregullat kryesore të drejtshkrimit të saj. Nuk munguan as studime të tjera të thella për morfologjinë, për sintaksën, për fjalëformimin, leksikografinë, për problemet e gramatikës historike e të historisë së gjuhës shqipe.

Kufi të prerë në mes të periudhave nuk ka sepse njerëzit mund të jetojnë e të zhvillojnë aktivitetet në dy periudha, bile edhe në tri periudha, siç është rasti i Aleksandër Xhuvanit.

Prandaj disa personalitete të shquara të jetës politiko-shoqërore e shkencore që zhvilluan një veprimtari të mirë në fundin e shekullit XIX dhe në dhjetëvjeçarin e parë të këtij shekulli (shekulli XX), ne menduam që t'i trajtojmë në periudhën e tretë, në Periudhën e Pavarësisë.

Le të fillojmë sipas radhës.

Petro Nini Luarasi (1865-1911), veprimtar i shquar i Rilindjes sonë Kombëtare, publicist dhe pedagog, një nga mësuesit e parë dhe një nga dëshmorët e shkollës dhe të përhapjes së gjuhës sonë të shkruar.

Punoi si mësues në fshatrat e Kolonjës, ku u mësonte fëmijëve fshehurazi gjuhën shqipe dhe përgatiti një grup mësuesish.

Në vitin 1887 hapi shkollën e parë shqipe në Ersekë dhe pak më vonë (1892-1893) disa shkolla në Krahinën e Kolonjës.

Në vitet 1888-1889 mësues dhe Drejtor i Mësonjtoreve shqipe të Korçës dhe më vonë i shkollës së Negovanit (1909-1911).

Petro Nini Luarasi shkroi pamfletin **Mallëkimi i shkronjave shqip dhe çpërfolja e shqiptarit** - Manastir, 1911 e cila doli si libër i veçantë, si edhe poemën **Kundër Mallkimit të gjuhës shqipe**, ku sulmon dhe stigmatizon kishën greke dhe agjentët e

Patriarkanës.

Në këto dy vepra mbron të drejtën e popullit shqiptar për kulturën e vet kombëtare.

Vdiq i helmuar nga kisha greke në Ersekë më 17.8.1911.

Papa Kristo Negovani (1875-1905), shkrimtar dhe klerik patriot, mësues dëshmor i gjuhës dhe i çështjes shqiptare në fund të shekullit të kaluar e në fillim të shekullit XX; shkroi për letërsinë në prozë e poezi, kryesisht krijime didaskalike për fëmijë; futi meshën shqip në kishë, shërbeu si mësues i Negovanit dhe i Ballkamenit në afërsi të Follorinës.

Ai propogandoi me të madhe idenë e bashkimit të forcave patriotike në luftë kundër synimeve grabitqare të shovinistëve fqinj, si edhe domosdoshmërinë e mësimit të gjuhës shqipe në shkollë.

Vdiq i therur me thika barbarisht nga andartët grekë.

Kristo Luarasi (1876-1934), veprimtar i shquar i Rilindjes, kontribuoi në përhapjen e shkrimit e këndimit në gjuhën shqipe, në përhapjen e arsimit dhe shkollave shqipe; vetë punoi si mësues i gjuhës shqipe (1892-1894), në një nga shkollat e para shqipe të çelura në Luaras me përpjekjet e Petro Ninit. Më pas, në Sofje, së bashku me Kostë Trebickën, themeluan Shtypshkronjën Mbrothësia, ku u shtypën një varg librash shkollore, vepra të Rilindasve dhe *Gazeta*.

Ai u aktivizua shumë në shpalljen e Pavarësisë.

Anton Xanoni (1862-1915), durrsak, kreu filozofi dhe retorikë jashtë Shqipërisë; shërbeu në Itali dhe në Poloni; më 1904 erdhi në Shkodër dhe emërohet mësues; vdiq po këtu më 16.2.1915.

Në vitin 1909 botoi në Shkodër **Gramatika Shqipe** në të cilën, në mënyrë të sintetizuar dhe me kritere shkencore, përmbliiden rregullat më kryesore e më të rëndësishme të strukturës gramatikore të shqipes. Është hartuar mbi bazën e së folmes së Shkodrës dhe është përdorur si tekst mësimor shumë kohë në Shkodër.

Vepra shpaloset me një **Parathënie** të shkurtër, vijon **Morfologjia** më gjërë, ku bën fjalë për emrin, duke dalluar tre lakime.

për gjininë, duke dalluar tri gjini, për nyjet, mbiemrin, përemrin; folja është shtjelluar më gjërë (rreth 60 faqe), duke dalluar tre zgjedhime; ka shqyrtuar parafjalët, ndajfoljet. lidhëzat, pjesëzat, pasthirmat.

Përveç kësaj Gramatike, A.Xanoni pat hartuar edhe disa artikuj me karakter gjuhësor, të botuar në Revistat e kohës, në mes të cilëve mund të përmendim: **Sa janë gramatikat e shqipes? Sa fjalorë ka shqipja?** etj etj.

Ai ka lënë dorëshkrim disa vepra me karakter gjuhësor.

Anton Xanoni ishte njeri i ditur.

Luigj Gurakuqi (1879-1925), publicist, poet dhe aktivist i madh politik.

Nxënës i Jeronim de Radës në Kolegjin e Shën Mitër Koronës, u pajis me kulturë të gjerë për kohën. Ai dha një ndihmesë të madhe në fushën e Albanologjisë. Punën për gjuhën shqipe e nisi që në moshën 20 vjeçare, më 1899, duke marrë pjesë në shoqërinë Bashkimi, ku dha një kontribut për një Alfabet shqip me bazë latine. Në këtë vit shkroi artikullin **Mbi njësimin e alfabetit kombëtar**. Aty thekson gjithashtu mungesën e mësimin të gjuhës shqipe, çka sjell dëme të mëdha, e cila sipas tij, “nuk u msue kurrkund”.

Gjuhën shqipe ai e mbrojti në disa Vjersha, si edhe në disa vepra të tij: **Vargënimi n’gjuh shqype me një fjalorth shqyp-frëngjisht n’marim** (Napol-1906); **Abetar i vogël shqyp mas Abevet t’Bashkimit e t’Stambollit me tregime n’dy dialektet** (Bukuresht -1906).

Luigj Gurakuqi në veprat e tij nënvizon se mjeti më i mirë për Bashkim Kombëtar është gjuha sepse është kusht themelor për ekzistencën e Kombit: **Si t’bjerë gjuhën e vet një popull, shqim mbaron / N’shum çeta ka me u da / Gjuha njerzit e një Kombi i bashkon / I lidh si vllau me vlla**.

Sipas Poetit Gjuha dhe Kombi janë një trup e një shpirt: “Gjuha jonë, Kombësia jonë, të cilët nuk rrojnë njena pa tjetrën, ndodhen në rrezik të madh” - vë në dukje ai.

Mirë thoshte gjuhëtari i madh zvicerian Ferdinand de Sosyr (1857-1913) kur shkruante: “Zakonet e një kombi lënë gjurmë në gjuhë dhe, nga ana tjetër, në një masë të gjerë, gjuha formon Kombin”.

Në Revistën Albania (1905/8) L.Gurakuqi pat botuar një artikull **Gjuha e shkencave**, ku paraqiti konceptet e veta lidhur me kriteret e krijimit të termave të reja, duke u bazuar në kritere shumë shkencore.

Nuk duhet lënë pa përmendur edhe një vepër e tij **Fjalor shqip-frëngjisht dhe frëngjisht-shqip i fjalëve të reja**, me 1400 fjalë, botuar në Napoli më 1907.

Gjatë viteve 1903-1907 ai punoi për hartimin e një **Gramatike** të gjuhës shqipe, dorëshkrimi i së cilës është italisht me titull **Gramatologji**.

Në Fonetikë mbase është i pari që trajtoi përdorimin e zanores ë në artikullin **Oroe përmi e e pazëshme**, ku shtjelloi gjatësinë, diftongun, alternimet e tingujve bashkëtingëllor, flet për klasifikimin e tingujve nga pikëpamja stilistiko-fonetike.

Luigj Gurakuqi u mor edhe me problemin e Drejtshkrimit të gjuhës shqipe, si edhe me problemin e Gjuhës letrare të njësuar. Që në vitin 1905 botoi në Revistën Albania në Londër artikullin: **Për themelimin e një gjuhe letrare**.

Ai mori pjesë në Kongresin e Manastirit, ku u zgjodh Nënkrjetar dhe është ndër themeluesit e Komisionit Letrare Shqipe në Shkodër - Komision gjuhëtarësh e shkrimtarësh që u krijua në Shkodër më 1916, me qëllim që të çonte më tej zgjidhjen e problemeve të gjuhës letrare shqipe pas Kongresit të Manastirit; në të morën pjesë Gj.Pekmezi (kryetar), L.Gurakuqi, Hil Mosi, A.Xhuvani, S.Peçi, Ndre Mjeda, Mati Logoreci.

Do të vëmë në dukje se më 1 Dhjetor 1909 u hap Noprmalja e Elbasanit, e para Shkollë e Mesme Kombëtare Shqipe, me Drejtor Luigj Gurakuqin; në këtë Shkollë Gramatika shqipe ishte lëndë e parë.

Në Qeverinë e Ismail Qemalit të Vlorës u zgjodh Ministër i Arsimit me ç'rast vendosi arsimin e detyruar fillor për djem dhe vajza.

Në përgjithësi L.Gurakuqi trajtoi çështje fonetike, morfologjike, etimologjike, terminologjike, dialektore, drejtshkrimore dhe stilistikore.

Ai ishte për vënien e elbaskanishtes në bazë të gjuhës letrare.

Shahin Kolonja (1865-1919) atdhetar dhe publicist i shquar i periudhës së fundit të Rilindjes sonë Kombëtare dhe i fillimeve të periudhës së Pavarësisë.

Në vitin 1903 në tre numra të Fletores Drita të Sofjes botoi **Shkronjëtorja a Gramatikë Shqipe**, ndërsa në gjashtë numrat e mëvonshëm të kësaj Fletoreje, gjatë viti 1904, vazhdoi të botojë Gramatikën e nisur më parë; është përdorur Alfabeti i Stambollit.

Është me interes të vihet në dukje se të gjashtë rasat i emëron kështu: **Quanjëto**re (emërore), **Pjellto**re (gjinore), **Dhanëto**re (dhanore), **Kallëzonjëto**re (kallëzore), **Pritëto**re (vendore), **Mërgonjëto**re (rrjedhore).

Ai kishte kryer studimet e larta për drejtësi në Stamboll, por interesohej për gjuhën shqipe.

Shahin Kolonja botoi në Sofje gazetën **Drita**, mori pjesë në Kongresin e Manastirit, përktheu turqisht veprën e Samiut: **Shqipëria ç'ka qënë, ç'është dhe ç'do të bëhet**.

Vdiq në Stamboll.

Gaspar Jakov - Merturi (1870-1941), një Shkodran i ditur, i cili në vitin 1904 botoi në Itali **Gramatikë e gjuhës shqipe**, me 217 faqe, me këtë kushtim: **Atdheut dhe Atëdhetarëve**.

Është një Gramatikë e hartuar me kujdes dhe mirë. Në fillim jep alfabetin me bazë latine me 37 shkronja, pastaj vjen një Parathënie italisht; flet më tutje për dy dialektet e shqipes, për njësinë e gjuhës shqipe, çka sjell edhe bashkimin e popullit shqiptar.

Një kapitull i kushtohet **Vërejtje mbi ortografinë shqipe**, ku flet për zanore dhe bashkëtingëllore.

Morfologjia, e cila përfshinë rreth 100 faqe dhe në të cilën është shpjeguar mirë emri (gjini, numër, rasë, lakim), folja (dallon pesë zgjedhime), parafjala, ndajfolja, lidhëza, pasthirrma, është analizuar më imtësisht.

Pastaj janë rreshtuar disa **Bisedime** shqip-italisht, jepen disa **Përralla dhe Këngë popullore**.

Libri mbyllet me një **Fjalorth** shqip-italisht ku ka përmbledhur gjithsej 1344 fjalë.

Boton edhe 6 vjersha të veta.

Autori ka drejtuar edhe organin **Lajmëtari i Shqypnisë** që botohej shqip-italisht në Romë gjatë viteve 1904-1905. Dilte dy herë në muaj me këtë destinacion: **Mbron njësinë dhe pavarësinë kombëtare**.

Ka shkruar edhe në Shtypin e kohës.

Sotir Kolea (1872-1945), i lindur në Berat, ishte atdhetar, leksikograf dhe folklorist i mbaruar. U interesua shumë për gjuhën shqipe, për folklorin dhe për etnografinë, duke sjellë një ndihmesë të mirë sidomos në Leksikografi. Tërë jetën punoi për të mbledhur visar leksikor nga goja e popullit e nga Botimet e ndryshme, si edhe për të hartuar Fjalor - dygjuhësh të shqipes.

Sotir Kolea la dorëshkrim një **Fjalor** të orientalizmave të shqipes dhe një **Fjalor greqisht-shqip**; ndërmoi hartimin e një **Fjalori** të madh frëngjisht - shqip, i cili mbeti përgjysmë. Shumë Fjalë të urta që mblodhi gjatë jetës i botoi në vitin 1944 me titull **Një tufë proverbash**.

Në vitet 1915-1919 pat drejtuar Gazetën L'Albania (Shqipëria) në Lozanë të Zvicrës, ndërsa në vitet 1928-1937 ishte Drejtor i Bibliotekës Kombëtare të Tiranës.

Më 1937 u vendos në Elbasan, ku iu kushtua punës studimore.

Lazër Lumezi (1870-1941), veprimtar për përhapjen e arsimit shqip në Kosovë, metodist i gjuhës shqipe, autor tekstesh shkollore. I quajtur edhe Lazër Shqiptari, ai pat lindur në vitin 1870 në Prizren, ku edhe punoi si mësues.

L.Lumezi përkrahu përhapjen e Alfabetit të Manastirit, ishte organizator i hapjes së Shkollave shqipe në Kosovë dhe dha ndihmesë për themelimin e Shoqërisë **Besa-Besë** të Pejës.

Me veprimtarinë e tij 40 vjeçare, ai dha ndihmesë të madhe për zgjerimin e rrjetit arsimor në gjuhën amtare në Kosovë, për ngritjen e nivelit të punës metodike në shkollë, si edhe për organizimin e veprimtarisë jashtëeshkollore nga mësuesit.

Shkurtazi do të vëmë në dukje ndihmesën që dhanë disa veprimtarë të shquar të Lëvizjes sonë Kombëtare për shkollën shqipe, duke hartuar veçanërisht tekste shkollore e duke botuar edhe artikuj për çështje të ndryshme gjuhësore.

Sali Gjuka, në vitin 1910 ka botuar një **Gramatikë turqisht-shqip**, me 212 faqe, shtypur në Manastir dhe në vitin 1915 në gazetën **Populli**, në Shkodër, publikoi disa artikuj për problemet e gjuhës shqipe.

Thanas Floqi, në vitin 1910 botoi në Korçë tekstin: **Gramatika e gjuhës shqipe për shkollat e mesme**. Është autor i shumë shkrimeve për gjuhën shqipe botuar në gazetatat dhe revistat e kohës.

Nikollaq Lako, më 1910 në Paris botoi librin **Shkronjëtores e gjuhës shqipe**. ka shkruar shumë artikuj për problemet e gjuhës në shtypin e kohës.

Sotir Peci (1873-1932), veprimtar i shquar, megjithëse kishte kryer matematikë, mori pjesë në Kongresin e Manastirit dhe më 1912 botoi në Korçë **Viti Premtar i Gramatikës**, më 103 faqe, tekst për shkollat fillore.

Ai përpiket të krijojë një terminologji gramatikore të re: **Përcjellëse** në vend të termit **Përcjellore**, **Përkryes** në vend të termit **Kundrinë**, **Pronak** e përdor për **Pronor**, **Tregonjës** për **Dëftor**.

Sevasti Qiriazi (1871-1949), **Parashqevi Qiriaz**i (1880-1970), të dyja motra me arsim të lartë, si edhe **Gjerasim Qiriaz**i (1861-1894); **Gjergj Qiriaz**i (1865-1912) të dy vëllezërit e tyre, me

originë kolonjare, dhanë një kontribut të madh në organizimin e arsimit shqiptar, sidomos për femra.

Sevastia më 1912 botoi në Manastir tekstin: **Gramatikë elementare për shkollat fillore**, me 97 faqe dhe më 1916 bëri një botim të dytë në Amerikë.

Motra e saj, **Parashqevi** më 1909 botoi në Manastir tekstin **Abetare për shkollat e para** dhe mori pjesë në Kongresin e Manastirit.

Gjergj Qiriaz që në vitin 1905 flet dhe shkruan për Alfabetin e shqipes dhe jep një ndihmesë të rëndësishme për përgatitjen e teksteve shkollore, duke hartuar vetë tekste. U interesua shumë për dorëshkrimet e K.Kristoforidhit dhe bashkëpunoi në disa organe të kohës, ku trajtoi çështje të ndryshme të kulturës kombëtare.

Edhe **Gjerasimi**, i vëllai i tyre, atdhetar, pedagog, publicist, punoi shumë për përparimin e shkollës shqipe. Bashkë me të motrën **Parashqevin**, hapi shkollën e njohur shqipe për vajza në Korçë më 1891. Organizoi në Korçë shoqërinë **Vëllazëria** për të ndihmuar shkollën e vajzave dhe përhapjen e arsimit në fshat.

Të gjithë këta patriotë të shquar, vëllezër dhe motra, kontribuan shumë edhe në shtypin e kohës me shkrimet e tyre për problemet e ndryshme të kulturës shqiptare.

Mati Logoreci (1867-1941), publicist, gjuhëtar, historian, pjesëmarrës në Kongresin e Manastirit (1908), në atë të Lushnjës (1920) dhe në Kongreset Arsimore të Tiranës (1922, 1924), antor i Komisionit Letrar të Shkodrës (1916-1918). Ai e pasuroi shkollën shqipe me një varg tekstesh, botoi në shtypin e kohës një varg artikujsh për problemet e historisë dhe të gjuhës, publikoi një Fjalorth me rreth 1000 (njëmijë) fjalë, qëntoi dhe mblodhi me zell gjatë tërë jetës visarin leksikor të shqipes, punoi me këmbëngulje për pasurimin e gjuhës shqipe dhe për krijimin e fjalëve të reja.

Pashko Bardhi, prift në Troshan; në vitin 1901 në Borgo Eri-
zo afër Zarës hapi një shkollë të gjuhës shqipe. Ai ka shkruar një **Gramatikë** të gjuhës shqipe (dorëshkrim), si edhe ka botuar disa

artikuj në Revista të ndryshme të kohës për të folmet e Borgo Eri-zos, për veprën e Buzukut, për Alfabetin e shqipes etj.

Jorgji Karbunara (Babë Dudë Karbunara: 1842-1917), bera-tas, atdhetar i flaktë, mësues i parë i gjuhës shqipe në Berat; tërë-sisht iu kushtua çështjes së çlirimit kombëtar, lëvrimit dhe mësim-it të gjuhës shqipe. Me nismën e tij dhe të disa patriotëve të tjerë, u hap në gusht të vitit 1908 Shkolla e parë shqipe në Berat dhe u formua Klubi Bashkimi. Mori pjesë në Shpalljen e Pavarësisë në Vlorë.

Grigor Cilka (1875-1919), veprimtar i shquar i Rilindjes nga Vithkuqi i Korçës; mësues i Shkollës së vajzave në Korçë; ishte një luftëtar i flaktë për arsimin shqip dhe për lërimin e gjuhës sh-qipe, së bashku me gruan e vet **Katerina Cilka**, mësuese në sh-kollën e parë fillore për vajza.

Ai bashkëpunoi në disa organe të shtypit të kohës ku me shk-rimet e tij mbrojti Alfabetin latin të gjuhës shqipe dhe popullarizoi disa nga figurat e shquara të letërsisë botërore.

Sali Nivica (1891-1920), kurveleshas, atdhetar dhe publicist; punoi shumë në fushën e arsimit, krahas veprimtarisë së tij të thellë patriotike dhe publiciste.

Sali Çeka (1892-1925), nga Filati i Çamërisë, publicist demokrat dhe veprimtar i shquar për arsimin kombëtar dhe për Shpalljen e Pavarësisë. tërë jetën u përpoq që arsimit në Shqipëri të jetë laik dhe mbi baza të shëndosha shkencore. Drejtoi Gazetën **Ku vemi?**, dhe pastaj Revistën Pedagogjike (1922-1924); përgati-ti tekste të reja shkollore dhe ishte ndër nismëtarët e Kongreseve arsimore Kombëtare në korrik 1922 dhe në gusht 1924 në Tiranë, ku edhe paraqiti parime përparimtare për ndërtimin e procesit mësi-mor në shkollën e re shqipe.

Milo Duçi (1870-1935), publicist dhe shkrimtar, pjesëmarrës i disa Shoqërive të Kohës së Pavarësisë, themelues dhe drejtues i disa organeve të shtypit; ai shkroi disa artikuj për çështje të gjuhës së përbashkët letrare dhe të zhvillimit të letërsisë dhe të kulturës

shqiptare.

Muço Shqiptari (Mustafa Osman Berberi: 1880-1924), el-basanas, luftëtar për shkrimin dhe mësimin e gjuhës shqipe; kreu drejtësi në Selanik; bëri një punë të madhe për shpërndarjen fshehurazi të librave shqip.

U quajt Muç Shqiptari për aktivitetin e tij të thellë dhe të gjithanshëm në dobi të arsimit në gjuhën shqipe.

Gasper Mikeli, në vitin 1916 botoi në Shkodër **Gramatika e gjuhës shqipe**, mbi bazën e Shkodranishtes dhe më 1923 prapë publikoi po në Shkodër **Ushtrime me mësim të lehta gjuhe**.

Jani Minga (1872-1947), një veprimtar i shquar i Lëvizjes Kombëtare për Pavarësi, me origjinë nga Fieri; është ndër nismëtarët e hapjes së shkollave të para shqipe në Vlorë dhe të hapjes së klubit **Labëria** në vitin 1908; ai është pjesëmarrës, si delegat i Vlorës, atje ku jetoi e punoi, në Kuvendin Kombëtar për Shpalljen e Pavarësisë në vitin 1912.

J.Minga më pas punoi shumë për Shkollën shqipe, duke ngulmuar që ajo të jetë kombëtare, laike dhe e detyrueshme për djem dhe vajza. Ai mori pjesë në mënyrë aktive në Kongreset arsimore, të organizuara gjatë viteve 1921-1924. Për nevojat e Shkollës botoi më 1920 librin **Abetare Kombëtare Shqip** dhe më 1926 **Gramatika e gjuhës shqipe**.

Rexhep Voka (1847-1917), studiues nga Tetova, pat botuar në vitin 1911 një libër me titull **Abe-ja shqipe**, me ç'rast paraqiti një Alfabet me 44 shkronja arabe.

Simon Shuteriqi botoi në Manastir në vitin 1911 librin **Abetare shqip**.

Fadil Bodinaku (1870-1932) ose, siç quhej **Fazili nga Tirana**, publikoi në vitin 1911 një Gramatikë me 32 faqe për shqipen me titull **Gramatika elementare e shqipes** (turqisht), në të cilën përdori alfabetin me shkronja arabe të Rexhep Vokës.

Tekste shkollore botuan gjithashtu në këtë periudhë:

Kiço Konomi (Gramatikë e gjuhës shqipe - Vlorë, 1921).

Koço Tasi (Gramatikë e gjuhës shqipe - Vlorë, 1923).

Abedin Feizi (Gramatikë e gjuhës shqipe - italisht, Napoli, 1929).

Shoqëria **Dija** e Vjenës botoi në Sofje një **Gramatikë** gegërisht në vitin 1912 dhe më 1913 vëllimin e dytë të saj.

Në Shkup gjatë viteve 1911-1912 botohej Gazeta e përjavshme **Shkupi**, drejtuar nga **Jashar Erebara**.

.Kjo Gazetë botoi në vitin 1911 **ABECE-ja Shqype** - një tekst mësimor si Abetare që përdorej në qendrën mësimore, të ngritur nga Klubi shqiptar i Kumanovës; prandaj u quajt edhe **Abece-ja shqype e Kumanovës**. Aty J.Erebara bëri krahasime të shqipes me gjuhët e tjera me ç' rast thotë: "Gjuha jonë është motër me gjuhë të Persisë (të Axhemistanit), me gjuhë të tjera të Evropës si me gjuhë të latinëve e të Allemanjës" (gjermanike).

Kolë Kamsi, mësues në gjimnazin e Shkodrës, ka botuar në Zarë, më 1930: **Manual praktik i gjuhës shqipe** (italisht), me ca njohuri gramatikore dhe me një **Fjalorth** shqip-italisht dhe italisht-shqipl; u ribotua më 1942.

Ai ka publikuar edhe librat: **Fjalor italisht-shqip** (1938), **Jeta dhe vepra e Frang Bardhit**, si edhe ka botuar disa Artikuj me karakter gjuhësor në Revistat e kohës.

Ilia Dilo Sheperi (1875-1945), botoi në Vlorë në vitin 1927 tekstin **Gramatika dhe Sintaksa e gjuhës shqipe**. Vepra ndahet në katër pjesë: Fonetikë, Morfologji, Fjalëformim dhe Sintaksë (me 209 faqe).

Ka vëzhgime me interes dhe zgjidhje origjinale dhe shkencore.

Vepra dëshmon për sensin e hollë gjuhësor të autorit.

Për mendimin tim është ndër tekstet shkollore më të mira, të botuara para Çlirimit.

Justin Rrota (1889-1964), punoi në fushën e Albanologjisë rreth 50 vjet (1914-1964); meritat e tij janë në studimin e autorëve të vjetër.

Më 1930 botoi librin **Monumenti më i vjetër i gjuhës shqipe** (Gjon Buzuku); më 1931 publikoi **Shkrimtari më i vjetër italo-arbëresh, Lekë Matrenga** (1592); në vitin 1942 botoi veprën **Syndaksa e gjuhës shqipe**.

Ka botuar shumë artikuj për gjuhën shqipe në Revistat e kohës.

Osman Myderizi (1881-1973), botoi në vitin 1944 në Tiranë veprën: **Gramatikë e Re e gjuhës shqipe**, ku jep pak a shumë të plotë morfologjinë e dialektit të Shqipërisë së Mesme.

Autori do të vazhdojë të punojë edhe pas Luftës së Dytë Botërore, duke dhënë një kontribut të madh në fushën e gjuhësisë shqiptare.

———— * ————

Tani le të shtjellojmë mendimin gjuhësor që dhanë disa personalitete të shquara të jetës politiko-shoqërore dhe shkencore të vendit tonë, kontributi i të cilëve është jashtëzakonisht i madh në fushën e Albanologjisë.

Ndre Mjeda (1866-1937), patriot, poet dhe studiues i periudhës së fundit të Rilindjes dhe i kohës së Pavarësisë. Ai zë një vend të veçantë në shkencat albanologjike. Kontributi i tij në gjuhësi është i ndjeshëm në shumë fusha, por më tepër në Leksikologji dhe Tekstologji; është një studiues i thellë i shkrimtarëve tanë të vjetër (Bud, Bogdani).

Mjeda pati Letërkëmbim me albanologë të shquar të kohës: Mayer, Pedersen, Lamberg, Nahtigal. Ndoqi me interes studimet e dijetarëve qoftë të huaj, qoftë vendas.

Qëkur ishte student për teologji në Krakovi (Poloni), i çon 12 **Letra G.Mayerit** gjatë viteve 1892-1893, në të cilat e përgëzon atë për studimet albanologjike, por edhe i bën disa vërejtje me takt.

Më 1901, bashkë me të vëllanë, Lazrin, Mjeda themeloi në Shkodër Shoqërinë letrare **Agimi**, në të cilin paraqiti një Alfabet që njihet me emrin **Alfabeti i Agimit**.

Nga data 1-6 maj të vitit 1902 zhvilloi punimet në Shkodër

Konferencën e Ipeshkëve Shqiptar. Nga kjo doli një Broshurë italisht me titull: **Parashtrim i Alfabetit**, e cila është hartuar nga Ndre Mjeda. Në atë Broshurë flitet për rëndësinë e Alfabetit dhe kërkesat shkencore për përpilimin e tij; kërkohet një drejtshkrim i rregullt mbarëkombëtar i shqipes, një afrim i dialekteve dhe një gjuhë e përbashkët letrare kombëtare. Po në vitin 1902 Mjeda hartoi një studim italisht mbi **Alfabetin e gjuhës shqipe**.

Më 22 gusht 1902 ai u nis për në Hamburg për të marrë pjesë në Kongresin e XIII Ndërkombëtar të Orientalistëve, ku mbajti në shtator ligjëratën latinisht: **Mbi shqiptimin e qiellzoreve ndër dialektet e ndryshme të gjuhës shqipe** (q,gj,ç,xh,k-j,g-j).

Aty paraqiti edhe Alfabetin e gjuhës shqipe, i cili u pëlqye nga shumë dijetarë të huaj.

Në vitin 1908 Mjeda mori pjesë në Kongresin e Manastirit si delegat i Shoqërisë **Agimi**, ku u zgjodh antar i Komisionit të Posaçëm që hartoi **Alfabetin** përfundimtar të gjuhës sonë.

Më 1 shtator 1916 filloi në Shkodër **Komisija Letrare Shqipe**, antar i së cilës u zgjodh Mjeda; qëllimi i saj kryesor ishte lëvrimi i gjuhës sonë dhe zhvillimi i letërsisë artistike. Aty u prek edhe çështja e njësisë së gjuhës letrare, bashkimi i gegërishtes me toskërishten, normalizimi dhe kristalizimi i gjuhës letrare të përbashkët, studimi i dialekteve, hartimi i teksteve, përkthimi i veprave nga letërsia botërore.

Si bazë e gjuhës letrare mendohej të vihej **E folmja e Elbasanit**, pasi gjendet në mes të Shqipërisë, në mes të gegërishtes dhe toskërishtes. Pikërisht për të studiuar këtë të folme Komisija dërgoi këtë qytet një Ekspeditë shkencore, të përbërë nga Gjergj Pekmezi (kryetar), Ndre Mjeda dhe profesor Rajko Nahtigal. Komisioni qëndroi aty një muaj; në fund u hartua një Raport të cilin Nahtigal më 17 gusht të vitit 1917 e botoi gjermanisht: **Mbi çështjen e një gjuhe shkrimi të përbashkët**.

Në nëntor të vitit 1932 Ndre Mjeda botoi një artikull shkencor me karakter dialektologjik dhe filologjik. Ai i bëri një **Recension**

kritik artikullit të gjuhëtarit të njohur italian **Bartoli: Reliket e di-alekstit shqiptar në Istria**, botuar në revistën **Studime shqiptare**, e cila botohej nga Insituti i Orientalistëve në Milano.

Dokumenti i botuar nga Bartoli është një pjesë e Ungjillit (Luka XV) me titull: **Djali plangprishës**. Sipas Bartolit ky përkthim është bërë në vitin 1835 nga prifti Dom Zef Korinaldi.

Të sqarojmë disa gjëra: Disa shqiptarë nga krahinat e Veriut, në shekullin e XVI, braktisën vendin e tyre dhe u vendosën në krahinën e Istrias. Më 1835 shqipja flitej akoma në disa fshatra të vogla përreth Parenzos. Ishte koha kur gjuhëtari italian Biondelli (1804-1886), që u mor edhe me shqipen, po përgatiste një Atlas gjuhësor të Evropës. Ai shtiu në dorë një tekst në të folmen arbëreshe të Istrias, përkthyer më 1835, me sa duket nga prifti i Parenzos Giuseppe (Zef) Korinaldi.

Përkthyesi përdor alfabetin latin të përshtatur nga italishtja, me ca ndryshime.

Teksti kishte si titull: **Parabola e Djalit plangprishës** (Luka XV, 11-32).

Pikërisht këtë tekst e botoi Bartoli më 1931. Në fakt ky tekst ka rëndësi sepse **E folmja e Istrias** u shua aty nga fundi i shekullit XIX dhe kjo është e vetmja lëndë gjuhësore që na ka mbetur.

Profesor Idriz Ajeti mendon se shqiptarët në Istria u vendosën nga fundi i shekullit XVII dhe fillimi i shekullit XVIII dhe se e folmja e tyre paraqet veçori të të folmeve veriperëndimore të gegërishtes (Shkodër, Ulqin, Tivar), se shqipja flitej aty deri nga mesi i shekullit XIX, se Korinaldi nuk ishte përkthyes, por Regjistrues.

Tani Recensionin i Mjedës bën fjalë për veçoritë gjuhësore të këtij shkrimi, i cili pasqyron veçori të së folmes së Istrias në fillimet e shekullit XIX, duke e ribotuar tekstin shqip.

Në mars të vitit 1933 Mjeda boton artikullin shkencor: **Një dorëshkrim i moçëm e një kritikë e re**, ku bëhet fjalë për dorëshkrimin e vjetër Perikopeja e Ungjillit e shekullit XV, si edhe një Recension kritik për botimin e këtij dokumenti të moçëm në re-

vistën **Studime Shqiptare** të lartëpërmendur.

Në vitin 1931 Mjeda dha ndihmesë në botimin e manualit italisht-shqip: **Gjuha shqipe** (dialekti gegë) në Milano.

Ai dha kontribut edhe në botimin e **Fjalorit shqip-italisht**, në vitin 1934, në Milano, si edhe të **Fjalorit italisht-shqip**, në vitin 1938 në Shkodër.

Por punimi më i mirë i Mjedës në fushën e gjuhësisë mbetet **Vërejtje mbi artikuj e përemra pronorë në gjuhën shqipe**, botuar në Shkodër më 1934.

Në këtë vepër, botuar më vete, ai hyn në konsiderata të thella teorike, jep mendime origjinale, duke iu referuar shumë dijetarëve. Bie në sy horizonti i gjerë që kishte Mjeda në lëmin e gjuhësisë së përgjithshme.

Ai u mor edhe me onomastikë dhe toponomastikë.

Ndre Mjeda zë një vend të veçantë në mes të lëvruesve dhe të studiuesve të gjuhës shqipe.

Gjergj Pekmezi (1872-1938), i lindur në vitin 1872 në Tushemisht të Pogradecit, mbaroi në Beograd Shkollën Teologjike dhe Pedagogjike më 1890 e në vitin 1894 regjistrohet në Universitetin e Vjenës ku studioi për filozofi dhe filologji, të cilat i mbaroi më 1898.

Gj.Pekmezi ka një veprimtari të gjërë arsimore e shkencore. Në moshë të re përfundoi një punim **Mbi çështjen shqiptare**, si edhe hartoi një studim tjetër **Dialektet e gjuhës shqipe**. Përgjithësisht u mor me çështje gjuhësore dhe i detyrohet inisiativës së tij, hapja e një Katedre të Gjuhës Shqipe në Institutin Oriental të Vjenës që më 1903, ku u caktua profesor për dhënien e gjuhës shqipe.

Më 1908 botoi gjermanisht veprën madhore: **Grammatik der albanesischen Sprache** (Gramatikë e gjuhës shqipe), me 293 faqe.

Më 1909, bashkautor, botoi librin **Bibliografi shqiptare**. Po në këtë vit botoi artikullin: **A do të kemi një të vetme gjuhë letrare shqipe?** (Dituria, Selanik, 1909).

Më 1913, bashkë me Lambercin, botoi një **Manual Mbi gju-**

hën shqipe.

Në vitin 1916 u caktua kryetar i Komissisë Letrare në Shkodër. Më 1924 transkriptoi dhe botoi veprën e Th.Mitkos **Bleta Shqiptare**, në Vjenë, me 304 faqe.

Gjergj Pekmezi vdiq më 24.2.1938 në krye të punës për mbledhjen e dokumentave nga Arkivat e Vjenës për Historinë e Shqipërisë.

Deri që vdiq dha mësimin e gjuhës shqipe.

Të analizojmë pak **Gramatikën e tij**. Ajo është Gramatika më e plotë dhe më shkencore, e botuar para Luftës së dytë Botërore; është përdorur për një kohë të gjatë si tekst mësimor në Katedra të gjuhës shqipe jashtë Atdheut.

Gramatika e Pekmezit ka edhe karakter krahasues: nga një anë në mes të shqipes dhe gjuhëve të tjera (latinisht, greqisht, sllavisht, turqisht), nga ana tjetër bëhen përpjekje për krahasim në mes të gegërishtes e toskërishtes, në mes të gjuhës së gjallë të sotme shqipe dhe periudhës paraletrare, pra është një Gramatikë historiko-krahasuese.

Ai gjithnjë vë theksin te gjuha e Shqipërisë së Mesme (Elbasani), duke u përpjekur ta paraqes tipin normal e të përbashkët të shqipes; këtej synonte për krijimin e gjuhës letrare, duke iu shmanhur veçorive dialektore të gegërishtes e toskërishtes.

Vepra hapet me **Njoftime të Përgjithshme** mbi gjuhën shqipe, për përhapjen e saj, për ndarjen dialektore, etj.

Në Kapitullin e dytë flet për **tingujt** e gjuhës shqipe, duke i analizuar me shumë kujdes.

Morfologjia shtjellohet gjërë; foljet i ndan në dy zgjedhime e në disa klasa. Analizohen mirë emri, mbiemri, përemri, numërori, parafjala, lidhëza, ndajfolja, pasthirrma, pjesëza.

Një kapitull i veçantë i kushtohet **Fjalëformimit** në emra, mbiemra, folje dhe në ndajfolje.

Në fund vepra ka një **Fjalorth shqip-gjermanisht** me 1600 fjalë që zihen në gojë në gramatikë.

Libri mbyllet me disa **Shënime** plotësuese dhe sqaruese.

Gjergj Pekmezi mbetet gjuhëtar i mirë dhe punëtor i palodhur.

Aleksandër Xhuvani (1880-1961), burrë i ndritur i arsimit dhe shkencës shqiptare. I frymëzuar nga idetë patriotike të Rilindjes, i mbështetur në një formim shumë të mirë filologjik, i pajisur me një sens të hollë gjuhësor, ai filloi që herët një punë sistematike e të shumanshme për lëvrimin dhe studimin e gjuhës shqipe.

Që kur ishte student universiteti (1905-1906) e më pas mësues i shqipes në Kolegjin arbëresh të Shën Mitër të Koronës, merr pjesë në diskutimet e hapura në shtyp për problemet e përgjithshme të gjuhës. Kështu në vitin 1905 në Revistën **Albania** (Bruksel) boton artikullin. **Për themelimin të një gjuhe letërore**, kohë kur ishte student në Fakultetin e Filologjisë në Universitetin e Athinës.

Në vitin 1906 në Gazetën arbëreshe **La Nazione Albanese**, prapë boton artikullin **Përmi themelim të një gjuhe letërore shqipe**. Studiuesi i ri dhe me perspektivë në këta artikuj jep mendime për gjuhën letrare kombëtare me objektivitet, larg çdo anësie dialektore dhe krahinore.

Ai shprehet kundër formimit të gjuhës letrare nëpërmjet përzjerjes së dialekteve, mbron tezën se gjuha letrare e përgjithshme formohet në bazë të një dialekti, duke u shuar dialektet e tjera. Mendon për dialektin jugor. Tani e tutje ai gjithënjë vijon të botojë artikuj gjuhësor si: **Çështja e Abesë** te revista **Albania** (1906), **Çështja e Alfabetit**, botuar në gazetën **Shpnesa e Shqipnis** (1907), **Mbi thjeshtësinë e gjuhës**, botuar në revistën **Shkolla e re** (Shkodër, 1921) etj.

Në këta artikuj e në dhjetra të tjerë ai flet për njësimin e alfabetit, për nevojën e një alfabeti të vetëm, për stabilizimin dhe ngulitjen e një drejtshkrimi të vetëm, për kodifikimin e tij, për pastërtinë e gjuhës, për pasurimin me fjalë të reja, për një shfrytëzim të plotë të visarit leksikor të mbarë gjuhës popullore, për luftë kundër fjalëve të huaja.

Një mori artikujsh të shkruara për këtë qëllim i botoi si vëllim më vete **Për pastërtinë e gjuhës shqipe** në vitin 1956.

Ai vetë dha një kontribut të madh në krijimin e një terminologjie të re gjuhësore e jo vetëm në gjuhë por edhe në shkencat pedagogjike dhe psikologjike e në sfera të tjera të dijës.

A.Xhuvan punoi për përcaktimin e rregullave drejtshkrimore në Komisionet letrare të viteve 1917-1918 dhe 1920-1921.

Aleksandër Xhuvani ka dhënë një kontribut të madh edhe në hartimin e teksteve të gjuhës shqipe. Në vitin 1920 botoi **Libri i gjuhës shqipe** (pjesa e parë dhe e dytë), në vitin 1922 publikoi **Njohnit e para të Sintaksës shqipe**, ndërsa në vitin 1934 botoi librin tjetër **Sintaksa shqipe**.

Të gjitha këto shërbyen si tekste mësimore për vite me radhë dhe patën disa ribotime. Tekstet e tij dallohen për cilësitë e tyre pedagogjike, por edhe për një punë prej pionieri. Ato janë hartuar sipas kriterëve dhe kërkesave të një teksti shkollor të rregullt dhe me synime normative.

Formimi i fjalëve do të jetë një nga fushat e gjuhësisë, të cilën do ta studjojë vijimisht Xhuvani. Për të ai do të botojë studime të shumta dhe do të marrë pjesë në shumë punime kolektive. Së bashku me E.Çabejn do të ndërmarrë dhe do të botojë dy monografi të gjëra.: **Parashtesat e gjuhës shqipe, Prapashtesat e gjuhës shqipe** në vitin 1962, duke dhënë kështu një kontribut të madh e të rëndësishëm në studimin e formimit të fjalëve të shqipes si edhe në zgjidhjen e problemeve të kulturës së gjuhës që i përkasin kësaj fushe.

Ai bëri objekt studimi edhe kategori të veçanta morfologjike si: **Pjesoren, Paskajoren, Parafjalët**.

Punimet e tij karakterizohen nga pasuria e madhe e fakteve nga mprehtësia e vëzhgimeve dhe mendimeve, nga një procedim racional dhe metodik i trajtimit dhe nga niveli i ngritur shkencor i realizimit.

Shumë punime dhe artikuj të tij u botuan si vëllim më vete:

Studime gjuhësore, në vitin 1956.

A. Xhuvani është edhe një njohës i mirë i Visarit leksiokor të shqipes. Iu kushtua me pasion gjuhës së gjallë të popullit dhe leksikut të autorëve të vjetër.

Regjistrues i saktë, mbledhës i apasionuar i fjalëve dhe i shprehjeve frazeologjike, ai e filloi këtë punë që herët, që në vitin 1910 dhe e vijoi deri që vdiq. Shumë prej tyre u botuan në revistën **Studime filologjike** pas viteve gjashtëdhjetë.

Ai shkroi edhe artikuj të tjerë të shumtë për çështje të ndryshme leksikologjike dhe leksikografike si: **Puna e fjalorit** (1926), **Kritikë mbi fjalorë të gjuhës shqipe** (1941), **Çështje e fjalorit të gjuhës shqipe** (1954) etj.

A.Xhuvani dha ndihmesë edhe në botime e disa veprave leksikografike si në **Fjalorin serbokroatishbt-shqip** (1947) e në **Fjalorin shqip-hungarisht**.

Fjalori i Kristoforidhit, përgatitja e botimit të dytë (1961), një botim kritik i përmirësuar dhe i plotësuar, mbetet një vepër kolosale e Xhuvanit.

Aleksandër Xhuvani dha kontribut të vyeshtë gjithashtu në studimin historik të gjuhës shqipe, duke dhënë mendime origjinale për çështje të gramatikës historike, për etimologjinë e shumë fjalëve, të botuara herëpashere në shkrimet e tija: **Selectae, Miscellane, Thërmija gjuhësore**.

Pas Luftës së dytë Botërore mori pjesë në të gjitha veprimtaritë shkencore, sidomos në Komisionet e terminologjisë në të tëra fushat e shkencës.

Aleksandër Xhuvani është vlerësuar edhe nga albanologë të huaj.

Më 1927 N.Jokli i shkruante: "...asht një gëzim edhe ma i madh me pa se si për hirë të veprimit të zotnis sate, veprim i palodhur dhe i ngultë, gjuha shqipe përparon e pasurohet".

M.Lamberci e quante Xhuvanin: Njohësi më i mirë i visarit leksiokor të shqipes, gjuhëtar shqiptar me merita të larta.

Aleksandër Xhuvani do të rrojë gjithënjë si ndër figurat më të ndritshme të kulturës shqiptare dhe si një burrë me virtytet dhe me tiparet më të arritshme që mund të jenë.

Në periudhën e tretë, duke filluar që nga mbarimi i shekullit të kaluar, vepruan gjallërisht edhe një mori studiuesish të apasionuar pas gjuhës shqipe, të cilët, me shkrimet e tyre në Shtypin e kohës, vunë në dukje rëndësinë e hartimit të një alfabeti përfundimtar, rëndësinë e mbledhjes së visarit leksikor nga goja e popullit, nevojën e përpilimit të Fjalorëve, domosdoshmërinë e studimit të mëtejshëm të strukturës gramatikore të shqipes dhe të njësimin të gjuhës së shkruar.

Ja një Listë emërore e tyre:

Mithat Frashëri, Mustafa Kruja, Visarion Dodani, Jorgji Meksi, Shtjefën Gjeçovi, Kostaq Cipo, Nikolla Gazuli, Loni Logori, Kristo Dako, Kristo Floqi, Ilo Mitkë Qafzezi, Simon Shuteriqi, Marin Sirdani, Aleksandër Sirdani, Stavri Frashëri, Karl Gurakuqi, Dhimitër Berati, Donat Kurti, Namik resuli, Mihal Sherko, Hasan Reçi, Pano Tase, Tahir Dizdari, Ilia Mitrushu, Bernardin Palaj, Mustafa Uçi, Jovan Ilazari, Stavri Skendi, Filip Fishta, Leonidha Naçi, Hil Mosi, Terenc Toçi, Haki Stërmilli, Qemal Guranjaku, Mehmet Vokshi, Zef Valentini, Zef Arapi, Gasper Gurakuqi, Feti Selenica, Hashim Koplikaj, Hamdi Bushati, Branko Merxhani, Skënder Arrëza, Gjon Ujka, Gjush Sheldia, Andrea Shuli, Hafiz Ali Korça etj.

Në fakt ka edhe të tjerë, por ne po kufizohemi në ata që bënë më emër, që u aktivizua dhe shkruan më shumë.

———— * ————

Gjatë periudhës së Pavarësisë u aktivizuan përsëri në të gjitha sferat e jetës politiko-shoqërore dhe arsimore arbëreshët e Italisë, duke ndjekur kështu vazhden e paraardhësve të tyre të mëdhenj të shekullit XIX.

Këtu ne do të vëmë në dukje studiuesit arbëreshë që dhanë një ndihmesë të madhe në fushën e kërkimeve gjuhësore.

Pal Skiroi (1866-1941), studiues nga Hora e Arbëreshërve (Siçili); ka meritën e gjurmimit të shkrimeve dhe të përmendoreve të moçme të gjuhës shqipe.

Ai punoi rreth tridhjetë vjet për përpunimin dhe përgatitjen për shtyp të librit të Gjon Buzukut, të cilin e gjeti në Seminarin e Palermos, por vepra mbeti e pabotuar.

Pal Skiroi la edhe një vepër të pabotuar: **Kthimi i Fjalorit të Frang Bardhit anasjelltas**, d.m.th shqip-latinisht (në origjinal është latinisht-shqip), çka përbën një kontribut me vlerë për gjuhësinë.

Kozmo Serembe (1879-1938), kryesisht letrar, në vitin 1918 boton Lëndë për Fjalorin shqip.

Në një artikull të botuar në Romë në atë vit vë në dukje mënyrën e mbledhjes së leksikut dhe nevojën e hartimit të një Fjalori të gjuhës shqipe.

Si ndihmesë për këtë Fjalor ai boton 188 fjalë nga arbëreshët, me përkthim italisht, kryesisht nga sfera bimore-shtazore.

Fjalët janë mbledhur në krahinën e Kozencës.

Nilo Borxha (1870-1942), studiues nga Hora e Arbëreshërve (Siçili).

Tërë jetën e kaloi në Manastirin e Grottaferratës afër Romës, duke punuar natë e ditë për të nxjerrë në dritë dokumente historike, gjuhësore të panjohura më parë, tërë jetën punoi për pasurimin dhe pastrimin e gjuhës shqipe.

Në një artikull të botuar në vitin 1927 ai jep këshilla të drejta që, në pasurimin e gjuhës shqipe, Neologjizmat të farkëtohen me masë e me kursim dhe më fort të futen në përdorim fjalët e moçme të gjuhës, duke u dhënë atyre kuptim të ri.

Më 1930 botoi me një koment liturgjik më të vjetrin dokument gjuhësor të toskërishtes: **Një Shkurtore e Ungjillit në gjuhën shqipe e shekullit XIV**.

Mua, autorit të këtyre radhëve, profesor Eqrem Çabej më ka thënë se në vitin 1940 në Romë e kishte takuar N.Borxhën dhe i kishte kumtuar se në Arkivat e Vatikanit kishte zbuluar një Doku-

ment gjuhësor shqip të vjetër, më të vjetër se sa ajo që njihet gjer më sot.

Vdekja e tij e la në heshtje; mbase e mori me vete në varr.

Getano Petrotta (1882-1952), filolog dhe historian i letërsisë nga Hora e Arbëreshërve (Siçili).

Punimi i tij **Sprovë e fonetikës krahasimtare të gjuhës shqipe** (1924), u nderua me një Çmim nga Akademia e Shkencave italiane.

Në veprën e tij kresore **Populli, Gjuha dhe Letërsia Shqiptare** (Popolo, Lingua, e letteratura albanese - 1931), Petrotta parashtroi një Vështrim të përmbledhur të historisë së letërsisë bashkë me një histori të pasur të studimeve albanologjike për çështje të Alfabetit, të Gramatikës, të Leksikografisë, të Historisë së gjuhës, të Et-nografisë dhe të Folklorit.

Ai themeloi në vitin 1932 Katedrën e Gjuhës shqipe e të Letërsisë në Universitetin e Palermos dhe e mbajti deri që vdiq. Petrotta ka botuar studime për letërsinë, ka lënë dorëshkrim një Gramatikë shqipe të së folmes së Horës së Arbëreshërve, si edhe një Fjalor frazeologjik të Arbëreshërve të Siçilisë.

Në vitet 30 foli edhe për formimin e një gjuhe të përbashkët, të njësuar shqipe.

Marko la Piana (1883-1958), gjuhëtar i njohur arbëresh nga katundi Hora në krahinën e Palermos (Siçili). Bashkëpunoi në Revista të ndryshme të kohës, duke botuar studime e artikuj gjuhësore nga fusha e Fonetikës historike, Leksikologjisë historike, Morfologjisë historike, Historisë së gjuhës shqipe, si edhe nga fusha e Letërsisë së vjetër shqipe.

Në vitin 1912 botoi për herë të parë, duke e shoqëruar me një studim kritik hyrës, me shënime dhe komente të pasura gjuhësore, direkt nga dorëshkrimi, veprën **Katekizmi shqip** të Lekë Matrengës të vitit 1592.

Në vitin 1917 vjen në Shqipëri dhe boton në Vlorë librin italisht-shqip: **Gjuha shqipe**, e cila, përveç të tjerash, përmban një

Abetare shqip-italisht me vështrim mbi shqiptimin dhe drejtshkrimin e gjuhës sonë.

Vepra është edhe një traktat i shkurtër i fonetikës së shqipes me shënime të shumta dialektore.

Po në këtë vit boton librin tjetër **Mësime të shkurtëra të Gramatikës shqipe** (dy pjesë), për shkollat fillore.

Më 1931 është profesor i latinishtes dhe i greqishtes së vjetër në Liceun e Palermos. Në vitin 1937 botoi studimin **Rreth refleksit të zanores o të gjatë nga indoeuropjanishtja dhe nga latinishtja në shqip**.

Në vitet 1939, 1949 në veprën **Studime gjuhësore I, II**, ai trajtoi çështje të tilla si: Gjuha dhe dialektet e shqipes, gjuha shqipe sipas hipotezave shqiptare, Elementet Satem dhe Kentum në shqipen e lashtë; Marrëdhëniet e shqipes me rumanishten; Vendi i parë i shqiptarëve dhe i rumunëve në Gadishullin e Ballkanit; Monumentet e vjetra të letërsisë shqiptare.

Më 1952 botoi një punim me vlerë të posaçme: **Mbi një fenomen fonetik të likuideve dhe të hundoreve në shqip**.

Ai ka lënë dorëshkrim dy vepra madhore:

- a) Gramatika krahasuese e gjuhës shqipe;
- b) Fjalor krahasues i shqipes, me rreth 60.000 fjalë (Fjalor etimologjik, historik dhe kritik për gjuhën shqipe).

La dorëshkrim edhe një punim për veprën e Buzukut.

Marko la Piana është burrë i madh në Filologjinë shqiptare.

Gjatë periudhës së Pavarësisë në studimet albanologjike kontribuan edhe arbëreshë letrarë të tjerë si: **Frano Krispi - Gllavjanoi** (1852-1933), **Agostin Ribeko** (1867-1928), **Rosolino Petrota**, **Getano Bazoli**, por sidomos **Zef Skiroi** (1865-1927) me studimin **Della lingua albanese e della sua letteratura** - 1917 (Mbi gjuhën shqipe dhe mbi letërsinë e saj), Lorekjo Anselmo (1843-1924) etj.

— * —

Në këtë periudhë vepron dhe shquhet edhe arbëreshi nga Greqia **Petro Furiqi** (1875-1936), studiues nga Salamina, i cili u mor

thellësisht me çështje të gjuhës, të toponimisë, të folklorit dhe të historisë së ngulimeve shqiptare në Greqi.

Studimet e tij më të rëndësishme janë: **Dialekti i shqipes së Greqisë në Atikë** (1929); **Kontribut për toponiminë e Atikës**(1933).

Ai botoi punime edhe për toponominë historike të Moresë, për kohën e shkuarjes së shqiptarëve në Peleponez, për historinë e qytetit të Prevezës. P.Furiqi publikoi një tok **Përrallash** popullore, të mbledhura në 11 vendbanime, të cilat i shoqëroi me **Shënime gjuhësore**. Ai bëri përpjekje për grupimin e të folmeve të Atikës, duke përcaktuar toponimet shqipe të asaj treve.

———— * ————

Edhe gjatë kohës së Pavarësisë Shqiptare interesi i studiuesve të huaj ishte i madh për kulturën e popullit tonë.

Profesora universitetesh, dijetarë të përmendur i kushtohen me pasion e vullnet studimit të gjuhës shqipe dhe të prejardhjes së popullit shqiptar, duke dhënë kontribute të mëdha në zgjidhjen e çështjeve të marra në shqyrtim.

Le t'i vështrojmë me radhë.

Norbert Jokli (1877-1942), gjuhëtar austriak, indoeuropianist, por që ia kushtoi tërë jetën gjuhës shqipe.

Ai punoi si bibliotekar në Bibliotekën e Universitetit të Vjenës, duke dhënë njëkohësisht mësim në Universitet si pedagog i jashtëm për shqipen dhe për gjuhët baltike.

Lëroi fusha të ndryshme të gjuhës shqipe; në radhë të parë studime për Fjalëformim, Fonetikën, Morfologjinë historike dhe për marrëdhëniet e shqipes me gjuhët e tjera. Ai e nisi studimin e shqipes që në vitin 1907. Punimi i tij **Studime mbi etimologjinë dhe fjalëformimin e shqipes**, u botua më 1911, ndërsa kryevepra e tij **Kërkime gjuhësore-kulturohistorike nga fusha e shqipes** është e vitit 1923.

Historia e fjalëve bashkë me sendin që e emërton dhe Etimologjia zënë vendin e parë në studimet e tij, duke ndjekur kështu Drejtimin (Rrymën) shkencor Fjalët dhe Sendet të linguistit austriak R.Meringer (1859-1931), ku bënte pjesë edhe H.Shuhardt.

N.Jokli u kushtoi vëmëndje gjithashtu lëvrimet të Literaturës shqipe në punimin **Një studim rreth librit të Gjon Buzukut** (1930) dhe një studim për N.Frashërin (1925).

Marrëdhëniet e shqipes me gjuhët e tjera të Ballkanit ishin në qendër të veprimtarisë së Joklit, duke theksuar mirë dhe drejt se ç'ka marrë dhe çka dhënë shqipja nga greqishtja (e vjetër, e mesme dhe e re), nga serbokroatishtja, bullgarishtja, rumanishtja, turqishtja etj.

Në të gjitha punimet dhe studimet e tij u trajtuan me objektivitet shkencor burimet e gjuhës shqipe, duke mbrojtur Tezën iliro-

trake e duke e vendosur vendin e hershëm të shqiptarëve në Dardaninë e lashtë (Kosova e sotme).

Në studimin e tij **Albaner** (Shqiptarët) ai vuri në dukje afri leksikore në mes të shqipes e ilirishtes dhe në mes të shqipes e trakishtes dhe arriti në përfundimin se shqipja ka shumë afri si me ilirishten, ashtu edhe me trakishten.

Fjalët që krahasoi Jokli ishin shqyrtuar edhe më parë nga dijetarë të tjerë; **Delmatia, Delminium** e afroi me shqipen **Dele; Dimalum, Malentium, Maluntum** - toponime ilire e trake, i krahasoi me shqipen **mal; Re** të shqipes së sotme e krahasoi me fjalën e ilirishtes **Rinos** (i errët, re).

Në mesapishten **Bretion** do të thotë **Kokë dreri**; Norber Jokli e përqasi me fjalën e shqipes **Bri, Bri-ri**.

Shkrimtari i vjetërsisë latine Festus tregon se Salentinët mesapikë, Hyznisë së tyre, së cilës i flijonin kuaj, i thonin: **Jupiter Menzana**. Është G.Shtiri (Stieri) që këtë emër e përqasi me shqipen, toskërisht **Mëz** dhe me gegërishten **Maz** e me **Mëzat, Mëzore** dhe me rumanishten **Minz** (mëz). Këtë përqasje e bëri edhe Jokli.

Me trakishten, sikurse kishin pohuar paraardhësit, i afroi fjalët: **Man / Mën** (shqip) - **Mantia, Amantia** (trakisht); **I ambël / I embël** (shqip) - **Amalusta** (trakisht); **Karpë** (shkëmb) - shqip - **Karpatet, karp** (trakisht). **Skiare** (gjëmbaç - te trakasit) - **Shqyer, çjer** në shqip.

N.Jokli solli argumente të shumta se shqipja dhe ilirishtja janë gjuhë Satem; edhe trakishten e pranon si gjuhë Satem.

Ai vuri në dukje edhe evoluime fonetike në parashtesa e në prapashtesa nga ilirishtja, trakishtja në shqip.

Për vendbanimin e hershëm të shqiptarëve dha mendime të vyera, duke e cilësuar atë si “Problemi themelor i parahistorisë së shqiptarëve”.

N.Jokli hodhi poshtë mendimin e dijetarit V.Përvan (1911) sipas së cilit Stërgjyshërit e shqiptarëve midis shekujve III dhe VI të

erës së re, u shpërngulën nga Verilindja nëpër Transilvani drejt Jug-Perëndimit dhe, pastaj, si barinj endacak, pa u vënë re, kaluan në viset në Jug të Danubit.

Atëherë ku është Djepi i Shqiptarëve?

Djepi i Shqiptarëve - pohon dukshëm Jokli - është një vend që u përgjigjet këtyre kushteve: **Është një trevë ku piqeshin Ilirët me Trakasit, trevë brenda sferës së romanizimit e afër djepit të rumunëve, jo fort afër ndikimit të greqishtes por jo jashtë sferës së kësaj gjuhe e kjo i përgjigjet më së miri Dardania (Kosova e sotme).**

Nga ato anë shqiptarët u shkulën për në Atdheun e sotëm në kohën e vonë latine por para ardhjes së sllavëve në Shqipëri.

Kështu kanë menduar edhe P.Skoku dhe Miss Durhami.

N.Jokli, duke menduar se shqipja është e afërt si me Ilirishten, ashtu edhe me trakishten, sepse shumë tipare të tyre shpjegohen me shqipen, çka më vonë e ndoqën edhe Vasmeri, Ribezzo dhe Taliavini, i përjashtoi brigjet e Detit Adriatik dhe Jon si vendin e parë të Shqiptarëve, duke sjellë këto argumente:

1. Disa toponime si **Shkodra, Skodra, Rogame, Ragame** nuk janë zhvilluar në përputhje me rregullsitë fonetike të shqipes, me rregullsitë e evolucionit të sistemit fonetik të shqipes.

2. Termat e lundrimit në shqip paraqiten si një “përsierje laramane huazimesh”

3. Numri relativisht i vogël i huazimeve nga greqishtja e vjetër.

Këto “argumente” i hodhi poshtë me të drejtë E.Çabej, duke theksuar se toponimet e lartpërmendura kanë shkuar sipas ligjeve fonetike të shqipes (Rogam nga Rogë+am), se shumë terma të lundrimit janë shqip, se nga greqishtja e vjetër janë një numër i mirë huazimesh.

Prandaj, thekson N.Jokli; Djepi i hershëm i shqiptarëve, i stërgjyshërve të tyre, duhet të ketë qënë në një trevë ku takoheshin ilirishtja me trakishten afër Djepit të rumunëve, brenda sferës së romanizimit dhe jo shumë larg ndikimit grek.

N.Jokli analizon disa toponime, si **Naissuss-Nish**, çka vërteton - pohon ai - ndërmjetësinë gjuhësore shqiptare dhe çka tregon se Dardania është Djepi i shqiptarëve.

Ai hartoi edhe studime të tjera të shumta që u botuan në Përmbledhje dhe Revista shkencore të ndryshme.

Në mjaft studime u kushtoi vëmëndje të madhe elementeve vendase, në radhë të parë trashëgimit indoeuropian.

Shumë elemente që ishin konsideruar të huaja, iu kthyen shqipës.

Dy kryeveprat e tij: **Fjalori etimologjik i shqipës** dhe **Gramatika krahasimtare e shqipës**, për të cilat punoi tërë jetën, kanë mbetur dorëshkrim e nuk dihet ku gjenden.

N.Jokli, ky mik dhe dashamirës i madh i popullit shqiptar, dha kontribut në të gjitha sferat e gjuhës shqipe.

Georg Shtadtmyler (1901-1985), historian gjerman, në vitin 1941 në studimin: **Forschungen zur albanischen frühgeschichte** (Studim për historinë e hershme shqiptare), botuar në Archivum Europae Centro Orientalis, VII, Budapest - 1941, bëri një Periodizim të historisë së hershme të popullit shqiptar.

Ai u ngrit kundër tezës së Joklit që Dardania është Djepi i lash-të i shqiptarëve.

Historiani në fjalë mendon se Dardania (Kosova e sotme) nuk mund të jetë e tillë sepse kjo trevë në kohën romake dhe bizantine ka qënë krejt e romanizuar.

Ai thekson se shqiptarët janë formuar si komb në një vend që ka qënë nën ndikimin dalmat, prej nga i erdhi edhe krishtërimi, por jo shumë larg ndikimit të gjuhës greke.

Një vend i tillë - vijon ai - është **Shqipëria Veriore**, më konkretisht, Mati me rrethina.

Pikërisht këto vise të rrethuara me male të larta dhe të mbrojtura nga natyra, janë Djepi i shqiptarëve, ku u formua ky popull dhe i shpëtoi romanizimit.

Shtadtmyler vë në dukje se shqiptarët kanë qënë barinj të

vendeve malore të brendshme prej nga u shtrinë edhe në fushat përreth e, më vonë, u përhapën në Shqipëri të Mesme e në atë Jugore dhe, më pas, në Tesali e në krahinat e tjera të Greqisë.

Kundër kësaj teze që ngritur K. Taliavini i cili pohoi se nuk ka asnjë argument pozitiv për ta vërtetuar këtë hipotezë.

Karl Paç (Patch: 1865-1945), arkeolog austriak; në artikullin e tij **Gjurmë trake në bregdet të Adriatikut** (1907) në bazë të materialeve historike dhe toponomastike arrin në përfundimin se në Ballkanin Perëndimor përpara Ilirëve ka pasur një popullsi trake, e cila më vonë u mbulua nga një Mbishtresë Ilire që e shtroi dhe e asimiloi nënshtresën trake.

Ai ka shkruar e botuar disa studime për historinë dhe arkeologjinë e Shqipërisë.

Milan Shuflaj (1879-1931), historian kroat, studiues i historisë mesjetare shqiptare, profesor në Universitetin e Zagrebit.

Ai ka botuar mjaft vepra dhe studime për historinë dhe kalatë e Shqipërisë, sidomos për Balshajt. Mbron autoktoninë e shqiptarëve, prejardhjen ilire të tyre.

Veçanërisht në veprën **Die Kirchenzustande im Vortürkischen Albanien** - 1916 (Rrethanat kishtare në Shqipërinë paraturke), thekson se, edhe sikur të mos ishin lajmet e historisë, siç është ai i Ptolemeut për fisin e **Albanoi-ve**, vetë gjurmët e ndikimit gjuhësor të latinishtes në shqipen do të mjaftonin për të vendosur vendbanimin e shqiptarëve mu në bregdet të Adriatikut.

Siç e kemi cek më lart, ai mendon se emri **Shqiptar** mund të ketë rrjedhur nga emri i një familjeje në Shkodër që del në shekullin e XIV: **Shepudari, Shapudari**.

Pas një udhëtimi në Shqipëri në vitin 1930, u vra barbarisht me sopatë nga policia sekrete jugosllave në Zagreb në vitin 1931.

Shuflaj është bashkautor me **Talocin** (1854-1916) dhe **Jireçekun** në veprën madhore: **Acta et Diplomata res Albaniae mediae aetatis illustrantia**, botuar latinisht, vëllimi I-II, 1913, 1916. (Akte dhe Diploma që ilustronjë çështjet e Shqipërisë mes-

jetare).

Është një botim shkencor themelor i Dokumentacionit historik për Shqipërinë gjatë Mesjetës, i përgatitur nga L.Taloci (hungarez), K.Jireçek (Çek), dhe M.Shuflaj (kroat), nën redaktimin e këtij të fundit.

Vëllimet përfshijnë një Dokumentacion pothuajse të plotë për aq sa njihej deri atëherë, për periudhën 344-1406, me prejardhje latino-perëndimore, greko-bizantine dhe sllave. Autorët mendojnë të botonin edhe katër vëllime të tjera, mirëpo materiali i mbledhur humbi me vrasjen e Shuflajt.

Mario Rok (1875-1961), filolog francez, romanist, i cili dha ndihmesë edhe për Albanologjinë.

Në Shkollën e gjuhëve orientale në Universitetin e Parisit, pas Luftës së parë Botërore, dha për disa vjet mësimin e gjuhës shqipe. Ai u mor me studimin e autorëve të vjetër të Letërsisë Shqiptare. Rezultatet e Kërkimeve i paraqiti në dy vepra: **Kërkime për tekstet e lashta shqipe** - 1932; **Fjalori latinisht-shqip i Frang Bardhit** (1635), të cilin M.Rok e publikoi në vitin 1936.

Në veprën e parë ai dha një përshkrim të plotë të 17 botimeve, dorëshkrimeve më të para shqipe (1462-1710), disa prej të cilave edhe të zbuluara prej tij, duke e njohur kështu botën shkencore me rëndësinë e teksteve shqiptare.

Në veprën e dytë ribotohet i fotokopjuar Fjalori i Bardhit me një Hyrje, ku i bëhet edhe një analizë e mirë.

Gustav Vajgandi (1860-1930) gjuhëtar, balkanolog gjerman, studiues i gjuhës rumune për të cilën hartoi Atlasin e parë; u mor edhe me studimin e shqipes dhe të bullgarishtes.

Dukuritë e përbashkëta të këtyre gjuhëve (rumune, shqipe, bullgare) i lidhi me një substrat (nënshtresë) trak.

Vajgandi ishte dhe mbeti partizan i flaktë i prejardhjes së shqipes nga Trakishtja. Këtë mendim e shprehu në artikullin e tij të famshëm: **A janë shqiptarët pasardhës të ilirëve apo të trakave?**

Këtu parashtroi dymbëshjetë argumente në favor të prejardhjes

trake të gjuhës shqipe:

1) Emrat latinë të vendeve në Shqipëri nuk paraqesin atë trajtë që duhej të kishin po të kishin banuar shqiptarët vazhdimisht në trevat e tyre të sotme, por kanë trajtat e dal;matishtes së vjetër. Sjell si shembull: **Valbonë, Domni, Patosa, Vizitor** (Kjo e fundit në Plavë), **Oblika, Dormitor**.

2) Termat e lundrimit dhe të peshkimit në gjuhën shqipe janë të burimit të huaj: grek, venecian, sllav, turk ose janë krejt të rinj.

Dihet se ilirët ishin një popull detar, prandaj edhe kanë pasur një gjuhë plotë me terma të lundrimit e të peshkimit. Patjetër në gjuhën shqipe duhej të ishte ruajtur një pjesë e këtyre termave. Pra shqiptarët janë të ardhur në anët e Bregdetit, mendon ai.

3) Mungesa e gjurmëve nga dalmatishtja e vjetër dhe prania e gjurmëve të ndikimit italian, përkatësisht venecian në gjuhën shqipe, dëshmojnë se stëgjyshërit e shqiptarëve janë vendosur relativisht vonë në brigjet e Adriatikut.

4) Në gjuhën shqipe ka disa fjalë me burim trak si: **man** (mantia e trakishtes), **i ëmbël / i ambël** (amalusta e trakishtes) etj.

5) Disa emra personash dhe visesh në Traki e Daki shpjegohen me anë të shqipes: **Decebalus**, prijës trak (Dakibal - balli i dakëve); **Burebista**, prijës tjetër trak (burrë bisht, burrë i vogël); **Dardania** (vend dardhash, dard-dardhë); **Drizupara** (qytet, vend drizash), **Besapara** (qytet, vend i Besëve, çka lidhet me shqipen Besë); **Dacia maluensis** (pjesa e dytë, Maluensis, lidhet me shqipen Mal).

6) Emrat e vendeve të trashëguara nga koha e vjetër: **Tomor, Shkumbin, Pojan, Devoll, Durrës, Vlorë, Shkodër** etj, nuk kanë pësuar zhvillimin fonetik të shqipes, pra nuk kanë rrjedhur nga **Tomarus, Scampa, Devolia, Dyrrachium, Aulon, Scodra**; përkundrazi ato tregojnë karakterin sllav e në bregdet karakterin italian - venecian.

G.Vajgandi përmend gjithashtu po këtu një varg emrash fshatrash, duke vënë në dukje karakterin e tyre kryesisht sllav.

Të gjitha këto tregojnë - shprehet ai - se shqiptarët nuk kanë

banuar qysh herët në trojet e tyre të sotme.

7) Shqiptarët nuk zihen në gojë para shekullit XI, sado që vendi i tyre përmendet në shumë dokumente.

8) Lidhjet gjuhësore rumuno-shqiptare të burimit jolatin janë kaq të thella sa të bëjnë të pranosh se shqipja mund të jetë zhvilluar vetëm në një trevë, ku u zhvillua edhe rumanishtja. Kjo trevë nuk mund të ketë qënë në Iliri, sepse këtu lindi dalmatishtja e vjetër, e cila ndryshon thelbësisht nga rumanishtja; ajo trevë ka qënë patjetër në Traki, diku brenda trekëndëshit Nish-Shkup-Sofje.

9) Në rumanisht ka edhe disa elemente latine me trajtë të tillë që dëshmojnë se ato kanë depërtuar në atë gjuhë nëpërmjet shqipes, çka dëshmon për një fqinjësi të gjatë e të ngushtë të këtyre dy gjuhëve. Kjo nuk mund të ketë ndodhur as në Daki, as në Iliri, por në Traki, ku ka qënë edhe djepi i rumunëve.

10) Elementet latine të shqipes e të rumanishtes përkojnë në një mënyrë aq të dukshme, sa dëshmojnë se duhet të jenë përftuar në rrethana kulturore, vendore dhe gjuhësore të barabarta. Dhe këtu ai përmend fjalët latine me **u** të shkurtër, të cilat e kanë reflektuar këtë tingull të pandryshuar vetëm në shqip, rumanishtm sardisht:

latinisht: **lucta**, shqip: **luftë**, rumanisht: **lupta**.

latinisht: **pullus**, shqip: **pulë**, rumanisht: **pula**.

latinisht: **angustus**, shqip: **ngusht**, rumanisht: **ngust**.

11) Folklori i shqiptarëve dhe i rumunëve ka disa bashkëpërkime, të cilat nuk i kanë bullgarët dhe serbët që banojnë midis tyre si: tatuazhin, kulshedrën etj.

12) Edhe mënyra e këndimit të këngëve paraqet bashkëpërkime të dukshme të dy këta popuj.

G.Vajgandi i ka kundërshtuar gjithashtu disa nga argumentat që kishin sjellë disa dijetarë para tij në mbështetje të tezës ilire. për shembull ai nuk e pranon faktin se shqiptarët sot janë në viset ku banonin dikur fiset ilire sepse, sipas tij, popujt i kanë ndryshuar shpesh vendbanimet e tyre.

Në Artikullin e tij të lartpërmendur, botuar në vitin 1927, ai

në mes të tjerash pohon: Shqiptarët janë trakas e konkretisht stërnipërit e fisit të Besëve (prej nga përkon edhe fjala Besë e shqipes) të cilët deri në shekullin e VI të erës së re nuk qenë romanizuar.

Ai nënvizon se Shqiptarët dhe Rumunët u formuan si popuj me gjuhë të veta njëkohësisht në periudhat 600-900 të erës së re në truallin e përbashkët të trekëndëshit: Nish-Sofje-Shkup.

Dijetari i lartëpërmendur më 1913 botoi gjermanisht në Lejpcig veprën: **Albanesische Grammatik im Sudgegischen Dialekt** (Gramatika shqipe e dialektit të gegërishtes jugore) e cila mbështetet në materialet e mbledhura nga vetë ai në Tiranë, Durrës dhe shumica në Elbasan, gjatë vitit 1909. Edhe në vitin 1912 qëndroi pak kohë në Elbasan.

Vepra ndahet në tri pjesë: në të parën trajtohet **Fonetika** dhe **Morfologjia**, në të dytën shtjellohet **Zgjedhimi i foljeve**, kurse në të tretën ka **ushtrime dhe tekste**.

Në pjesën e fundit flet për Alfabetin e shqipes duke parapëlqyer Alfabetin e Shoqërisë Bashkimi.

Në vitin 1904 botoi një **Fjalor shqip-gjermanisht dhe gjermanisht-shqip**, në Lejpcig, me 179 faqe. Ai ka publikuar edhe veprën **Das Albanesische im Atika** (Shqipja në Atikë) - 1926.

Linguisti italian **F.Ribezzo** në vitin 1907 botoi: **La lingua degli antichi Mesapi** (Gjuha e mesapëve antik). Ai, siç e kemi prekur më lart në vendin përkatës, i mblodhi mbishkrimet e mesapishtes në veprën: *Corpus inscriptionum Messappicarum*.

Ka botuar artikuj për gjuhën shqipe te **Rivista d'Albania** në vitet 1940-1941.

F.Ribezzo është pasues dhe mbrojtës i tezës iliro-trake të prejardhjes së gjuhës shqipe.

M.Vasmer në veprën **Studien zur Albanesischen Wortforschung** (Studime mbi fjalëformimin e shqipes), botuar në vitin 1921, paraqiti disa etimologji të reja sllave të fjalëve shqipe, për të cilast e kritikoi rëndë dhe i hodhi poshtë H.Bariçi. Vasmer ka trajtuar

edhe çështjen e ndikimit të shqipes në gjuhët sllave fqinje.

Ai shqyrtoi në studimet e tij edhe përhapjen e Ilirëve në Evropën Verilindore në kohët prehistorike në bazë të Toponomastikës; flet për Ilirët verior në Evropën Veriore dhe Verilindore dhe për Ilirët jugor në Ballkan dhe në Itali.

M.Vasmer bëri krahasime të qëlluara në mes të shqipes dhe trakishtes siç e cekëm edhe më lart: **Karpatët**, këtë emërtim e afroi me shqipen **karpë** "shkëmb"; **Drenis** e përqasi me shqipen **Dre**; **Buridava** e shpjegoi me shqipen **kështjellë burrash**.

Është partizan i tezës iliro-trake të prejardhjes së shqipes dhe të popullit shqiptar.

Stefan Mladenov në studimin e tij **Kontribut në studimin e marrëdhënieve gjuhësore bullgaro-shqiptare**, botuar në vitin 1927, hulumtoi marrëdhëniet bullgaro-shqiptare dhe bëri disa sak-tësime në këtë fushë, duke vënë në dukje prejardhjen bullgare të toponimive sllave në një pjesë të madhe të territorit të Shqipërisë (me përjashtim të Veriut).

Stefan Mladenov ka botuar gjithashtu studime të tjera me shumë vlera shkencore për historinë e gjuhës shqipe si: **Bemerkungen über die Albaner und das Albanische in Nordmakedonien und Altserbien** - 1923 (Vërejtje mbi shqiptarët dhe shqipen në Maqedoninë Veriore dhe Serbinë e vjetër); **Albanisch und Thrako - Illyrisch** - 1928. (Shqipja dhe Trako-Ilirishtja).

K.Sandfeld (1873-1942) gjuhëtar danez; në veprën *Linguistique balcanique. Problemes et Resultats* (Linguistika ballkanike. Probleme dhe Rezultate), botuar në vitin 1930, bëri një shtresëzim më dysh të fjalëve të rumanishtes dhe të shqipes.

Sipas tij njëra **Shtresë** përfshin ato fjalë rumune që përputhen plotësisht me fjalët përkatëse të shqipes e që mund të shikohen si të burimit shqip; tjetra **Shtresë** përfshin disa fjalë të cilat, si nga forma, ashtu edhe nga kuptimi që kanë, duket se rrjedhin prej një burimi të përbashkët për shqipen dhe rumanishten.

Pra - thekson Sandfeldi - duket se të dy gjuhët (shqip, rumanisht) dhe popujt që i kanë folë, gjatë një peiudhe prej disa shekujsh të historisë së tyre, kanë ecur krah për krah në Gadishull të ballkanit.

Ai shqyrtoi edhe bashkëpërkimet e përgjithshme dhe të pjesëshme midis gjuhëve ballkanike në sfera të ndryshme gjuhësore dhe mbrojti pikëpamjen sipas së cilës faktori kryesor për përhapjen e dukurive të përbashkëta në gjuhët ballkanike ka qënë Greqishtja, e cila ishte gjuhë zyrtare e Perandorisë Bizantine si edhe Kisha Ortodokse.

A.M.Selishçev (1886-1942), sllavist rus; në veprën **Sllavian-skoe naselenie v'Albanii** (Popullsia sllave në Shqipëri), botuar në Sofje në vitin 1931, e studioi gjithë kompleksitetin e marrëdhënieve historiko-gjuhësore shqiptaro-sllave, por huazimet sllave në shqipen i tepëroi.

Në fund të veprës së tij paraqiti një Listë të Nomenklaturës topografike sllave në Shqipëri.

Selishçevi shqiptarët i bënë të ardhur në viset e sotme pas sllavëve.

Mendimi i tij është ky: Sllavët erdhën para shqiptarëve në brigjet e Adriatikut e të Jonikut, ku gjetën një popullsi krejt të romanizuar, gjetën një popullsi romane të vendosur në fushat dhe luginat e lumenjve. Shqiptarët erdhën ma vonë nga Lindja ose Verilindja dhe zunë malet.

Ku ishin shqiptarët më parë? - pyet ai. Dhe vetë përgjigjet: **Myj nje znajem** (Ne nuk e dimë).

Ai vijon duke pohuar se Asimilimi dhe Eleminimi i popullsisë sllave në Shqipëri u bë pjesërisht me forcë nga dhuna e ushtruar prej malësorëve shqiptarë.

Sllavët - përfundon ai - pjesërisht u asimiluan dhe pjesërisht u larguan.

Selishçevi e teproi me rolin e ndikimit bullgar në Shqipëri. Edhe fjalët sllave i tepëroi: koritë, vedër, sitë, vädit, maçe, maçok,

sokol, valanicë, kovaç, çekiç, log, rudinë, breg, llom, pod, sanë, pleh etj etj.

Me çështjen e huazimeve sllave në shqipe është N.jokli ai që i vuri pikat mbi i, duke i trajtuar ato me një objektivitet shkencor e duke ia kthyer shqipes shumë fjalë që ishin konsideruar të huaja. Jokli i bëri një Recensë të fortë prej 40 faqesh veprës së Selishçevit në të cilën disa fjalë si huazime sllave, iu kthyen shqipes.

Selishçevi ka trajtuar edhe çështjen e dukurive të përbashkëta të gjuhëve ballkanike.

Po e theksojmë se në vitin 1871 V. Makushev (1837-1883) pat botuar veprën **Sllavët në Shqipëri**.

M.Bartoli (1873-1946), gjuhëtar italian, një nga themeluesit e Neolinguistikës italiane, i ka kushtuar disa studime gjuhës shqipe në mes të cilave perëndimi: **Açordi antichi fra l'albanese e le lingue Sorelle** (Përputhje të hershme në mes të shqipes dhe gjuhëve motra), botuar në "Studi Albanesi", II, 1932; **Ancora la norma dell' Albanese e del greco e la questione del velari ario - europeo** (Akoma norma e shqipes dhe e greqishtes është çështje e velarëve ario-europianë), botuar në "Rivista d'Albania", 1942; **Le rilique del dialetto Albanese nell Istria** (Mbeturina të dialektit shqiptar në Istria) botuar në Studi Albanesi, në vitin 1931.

Në vitet tridhjetë ai shkruan edhe për nevojën e hartimit të një Atlasi për gjuhën shqipe, si edhe artikuj të tjerë, publikuar në Revistat e lartëpërmendura.

Mbron prejardhjen ilire të shqipes.

Petar Skok (1881-1956), romanist kroat,por u mor edhe me çështje të Albanologjisë. Ai ka botuar punime të tilla si: **Konsiderata të përgjithshme mbi lakimin nominal rumuno-shqiptar** (Considerations generales sur la declinaison nominale roumaino-albanaise - 1926); **Hulumtime gjuhësore të popullsisë josllave të Luginës së Shkupit**, si edhe ka publikuar shumë artikuj studimor, sidomos për etimologjinë e disa fjalëve të shqipes; të Revista

e Bariçit **Arhiv za arbanasku starinu jezik i etimologiju**.

Në studimet e tij ai ka trajtuar problemet e bashkëmarëdhënieve të shqipes me gjuhët e tjera të Ballkanit, ndërsa në punimin **Slave et Albanais** (Sllavët dhe Shqiptarët), publikuar në vitin 1924, sjell terma sllave të jetës baritore në gjuhën shqipe, gjoja, me simbiozën (bashkëjetesën) e sllavëve dhe të shqiptarëve.

Në kapitullin **Kontribut për historinë e sllavëve në Epir** të veprës së tij **Studime leksikologjike** (Leksikologiske studije - 1948), duke analizuar toponomastikën e Shqipërisë së Jugut, ku gjen shumë emra fshatrash me prejardhje sllave, pohon se “Në këtë zonë, si edhe në tërë Shqipërinë, dikur kanë banuar sllavët si popullsi e qëndrueshme bujqësore; krahas tyre banonin edhe Shqiptarët si popullsi nomade në male. Me ardhjen e Turqve, Shqiptarët zbritën nga malet, u bënë banorë të qëndrueshëm në fusha dhe e asimiluan (e shkrin) popullsinë e ngulitur sllave, por ruajtën terminologjinë gjeografike sllave, duke ia përshtatur shqiptimit të tyre”.

Me këtë teori ai e shpjegon edhe emrin **Lab** që, ashtu si G.Mayer më parë, mendon se është formuar sipas ligjeve fonetike të sllavishtes, nga rrënja **Alb**, me metatezë sllave të likuideve, çka nuk është e vërtetë.

Gjithashtu mendimi i tij për ndërmjetësinë sllave të emrit të **Durrësit** në gojën e shqiptarëve është kundërshtuar me fakte nga N.Jokli dhe E.Çabej, pasi **Durrës** rrjedh nga emri i lashtë **Dýr-rachium** dhe ka shkuar sipas ligjeve fonetike të shqipes.

Sipas Skokut Djepi i hershëm i Shqiptarëve është një vend ku piqeshin Ilirët me trakët, Ilirishtja me Trakishten, pra në Ballkanin Lindor.

Henri Bariçi (1888-1958), gjuhëtar kroat, indoeuropianist, balkanolog dhe albanolog, me qëndrim dashamirës ndaj botës shqiptare.

Në Revistën që drejtoi gjatë viteve 1923-1929 **Arhiv za arbanasku starinu jezik i etimologiju** (Arkivi i vjetërsisë i gjuhës dhe

i etimologjisë shqipe), u botuan studime, punime, artikuj, recensione nga vetë ai dhe nga shumë dijetarë dhe albanologë të njohur evropianë, nga burra të mëdhenj në fushën e dijes si: N.Jokli, K.Trajmer, W.Mayer - Lybke, P.Skok, Karol Oshtir, Alfredo Trombeti, K.Taliavini, R.Nahtigal, M.Budimir, Gl.Elezović, M.Shuflaj etj etj.

Këto personalitete të mëdha të kulturës evropiane debatuan me thellësi shkencore për problemet e ndryshme të albanologjisë.

Por veprat dhe studimet më kryesore të H.Bariçit janë: **Studime rumuno-shqiptare** (1919); **Në gjurmët e ilirishtes** (1921); **Studime gjuhësore ilire** (1948); **Prejardhja e shqiptarëve në dritën e gjuhës** (1954); **Hymje në historinë e gjuhës shqipe** (1948).

Ai ndërmori një **Fjalor serbokroatisht - shqip**, pjesa e parë e të cilit u botua në vitin 1954.

Çështjet dhe problemet themelore në veprat dhe në studimet e tij janë ato që lidhen me karakterin indoevropian të shqipes, me burimin dhe evoluimin historik të saj, me marrëdhëniet e saj me gjuhët e vjetra klasike dhe me gjuhët e reja ballkanike; në to gjejmë vëzhgime me interes për Fonetikën dhe Morfologjinë historike të shqipes, për Etimologjinë dhe për Leksikologjinë historike.

Henri Bariçi mbrojti tezën Trake të burimit të shqipes dhe të popullit shqiptar, i ardhur, sipas tij, nga Lindja e Ballkanit në fund të periudhës romake dhe në fillimet e dyndjeve sllave.

Këto Fise trake nga Lindja - pohon Bariçi - u shtrinë në Trojet e sotme të shqiptarëve mbi një Substrat (Nënshtresë) ilirësh të romanizuar ose gjysmë të romanizuar; pra, sipas tij, **Gjuha shqipe është Dialekt trak i ilirizuar**.

Ja argumentet e tij:

1. Fakti që shqiptarët banojnë në një pjesë të trojeve të banuara dikur nga Ilirët nuk dëshmon për prejardhjen e tyre nga fiset ilire. Ata kanë shtegtuar në këto troje më vonë.

2. Emrin e hershëm **Arbën / Arbër**, stërgjyshërit e shqiptarëve

e kanë marrë nga banorët e hershëm të trojeve të tyre të reja, të cilët (stërgjyshërit) nga ana e tyre emrin **Alban** e kanë trashëguar “prej popullsisë së lashtë joindoeuropiane” që kanë banuar aty para ardhjes së ilirëve.

3. Shqipja është gjuhë **Satem**, kurse Ilirishtja ka qënë gjuhë **Kentum**.

4. Ka mjaft bashkëpërkime midis shqipes dhe trakishtes, si edhe midis shqipes dhe armenishtes, çka tregon se shqipja rrjedh prej trakishtes dhe kjo e fundit “zë një vend ndërmjetës midis shqipes dhe armenishtes”. Ai përmend disa bashkëpërkime midis shqipes dhe trakishtes e midis shqipes dhe armenishtes.

H.Bariçi themeloi dhe drejtoi Seminarin për Filologjinë Shqiptare në fillim në Sarajevë e pastaj në Beograd, pranë Degës së Studimeve Indoeuropiane.

Mirëpo që në vitet njëzetë etnografi serb **Jovan Erdeljanoviç**, sidomos në veprën **Stara Crna-Gora** (Mali i Zi i vjetër), botuar në Beograd në vitin 1926, kundërshton Shtegtimet e mëdha të Shqiptarëve nga Lindja për në Jug sepse, sipas tij, ndryshimet në punë të gjuhës që kanë Gegët me Toskët, si edhe zakonet, dëshmojnë se Shqiptarët që në lashtësi banojnë në truall të sotëm.

Përqaftimi i krishtëritimit nga populli shqiptar me organizimin e Kishës me terminologji krejt latine, për historinë e popullit shqiptar dhe të gjuhës shqipe flet për një shkallë të hershme të ndikimit të latinishtes në një anë dhe në anën tjetër mbështet tezën e autoktonisë së shqiptarëve edhe në viset e bregdetit të tyre.

Karlo Taliavini (1903-1982), poliglote, romanist, balkanolog, albanolog, studiues edhe i gjuhës hungareze, bile edhe i gjuhëve të indigjenëve të Amerikës e të Afrikës.

Njohës i mirë i shqipes, mbajti gjallë Katedrën e Gjuhës dhe të Letërsisë Shqipe në Padova, duke ligjëruar ligjëratat duke mbrojtur çështjen shqiptare përballë zërave jodashmirëse.

Në Revista të ndryshme të kohës u shqua për shkrime kushtuar

shqipes dhe shqiptarëve, si edhe për kritikë dhe recensues të veprave të autorëve të njohur sidomos në organin Rivista d'Albania të Fr.Ercoles të periudhës së Luftës së dytë Botërore.

Vërejtjet për Fjalorin Etimologjik të G.Mayerit i bëri në studimin e tij **Gjuha shqipe** (La lingua albanese), botuar në Të përkohshmen Studi albanesi VII, 1935 ku në mes të tjerash thotë:

G.Mayeri vlerësoi njëllonj fjalët, pa bërë një dallim cilësor, pasi aty ka fjalë me përdorim të përgjithshëm e fjalë me përhapje lokale, se nga 730 fjalë që i la pa shpjegim, pjesa më e madhe i takojnë shqipes, se shumë fjalë që i mori si sllave, latine, më vonë iu kthyen fondit autokton të shqipes, se në kohën e Mayerit nuk kishin dalë Fjalorët e Kristoforidhit e të Bashkimit, të cilët përmbajnë shumë fjalë autoktone të shqipes e prandaj ai nuk kishte si t'i dinte, se Mayeri përdori shumë fjalë periferike, sidomos nga arbëreshët e Italisë e të Greqisë që janë të burimit të huaj (italiane, greke) e nuk bëjnë pjesë në fondin autokton.

K.Taliavini arrin në përfundimin se elementi vendas i visarit leksikor të shqipes nuk është më i paktë nga ai i disa gjuhëve të tjera indoeuropiane që në rrymë të shekujve kanë pësuar ndikime të forta të jashtme si armenishtja ose anglishtja.

Ai ka botuar mjaft studime për çështje të dialektologjisë, leksikologjisë historike, etimologjisë e të historisë së gjuhës shqipe.

Me studimin **Shqipja e Dalmacisë** (L'albanese di Dalmazia), botuar në Firenze në vitin 1937 dha ndihmesë për njohjen e së Folmes shqipe të Borgo Erizos afër Zarës.

Në monografinë dialektologjike **Të folmet shqipe të tipit të gegërishtes verilindore** (Dardania dhe Maqedonia veriperëndimore), botuar në vitin 1942, dha një parashtrim përshkrues, në bazë të materialit folklorik, të të folmeve shqipe të Kosovës e të Maqedonisë.

Në vëllimin **Shtresëzimi i leksikut të shqipes. Elementët indoeuropiane** (La stratificazione del lessico albanese. Elementi indoeuropei), botuar në Bolonjë më 1942/43 dhe 1965, bëri një punë

të dobishme në fushën e leksikologjisë shqiptare.

Me interes është edhe Letërkëmbimi i tij me N.Joklin. Ka dhënë mendime për etimologjinë e shumë fjalëve të shqipes.

Maksimilian Lamberci (1882-1963), gjuhëtar dhe folklorist austriak, specialist në fushën e gjuhësisë krahasuese dhe të filologjisë klasike; u mor thellësisht me studimin e gjuhës shqipe, të folklorit shqiptar dhe të letërsisë shqipe.

Interesat e tij janë të shumta: **dialektologji, leksikografi, sintaksë, onomastikë, hartim tekstesh, drejtshkrim, folklor, letërsi.** Të gjitha këto janë të pandara në veprimtarinë e tij.

Në dialektologji do të përmendim punimin: **Kumtim për studimet e mia linguistike në Shqipëri nga mesi i majit gjer në fund të gushtit të vitit 1916**, botuar nga Akademia e Shkencave e Vjenës ku tregohen tiparet kryesore të disa ligjërimeve të shqipes veriore dhe ravijëzohen për herë të parë edhe vijat e ndarjes së gegërishtes në nëndialekte. Gjithnjë vuri në dukje njësinë e gjuhës shqipe në larminë e të folmeve të saj.

Vëmëndje të veçantë i ka kushtuar studimit të të folmeve të arbëreshërve të Italisë.

Zë vend të veçantë në krijimtarinë e tij **Onomastika**, temë shumë e dashur për të. Kariera e tij shkencore fillon me botimin **Emrat e Sklevërve grekë**, në vitin 1907.

Lamberci solli argumente të fuqishme nga fusha e Onomastikës për burimin ilir të shqipes. Ai vuri re rëndësinë që kanë emrat vetiakë për hetimin dhe burimin e gjuhës shqipe dhe të popullit shqiptar, duke theksuar gjithnjë se disa emra ilirë vazhdojnë të rrojnë në emrat vetiake shqiptar si: **Dassus, Dasimius, Dazios:Dash; Dida:Dedë; Bardus, Bardylis:Bardhi** etj.

Këto fakte dhe të tjera ai, me të drejtë, i gjykoi si argumente që vërtetojnë birërinë ilire të shqipes.

Në fushën e **sintaksës** ka rëndësi të madhe studimi i tij: **Periudha hipotetike në gjuhën shqipe** që hap rrugë në studimet e sintaksës së gjuhës shqipe, botuar në vitin 1914-1915 në një Re-

vistë gjermane.

M.Lamberci ka hartuar edhe një varg tekstesh praktike për qëllim mësimi të gjuhës shqipe.

Më 1913 Lamberci dhe Pekmezi botuan në Vjenë **Libër leximi e mësimi për shqipen**, që është një Manual për mësimin praktik të gjuhës shqipe. Baza është shkodranishtja.

Ky Manual mbyllet me një **Fjalorth shqip-gjermanisht dhe gjermanisht-shqip** me 3000 fjalë.

Në vitin 1957 ka botuar gjermanisht veprën **Dialektet e gjuhës shqipe**.

Në fushën e **folkloristikës** ka dhënë kontribut të madh. Gjatë Luftës së parë Botërore bëri një udhëtim në Shqipëri ku mbledhi një lëndë të pasur folklorike.

Botoi më 1917 **Poezia popullore shqiptare; Përralla shqiptare; Tekste të folklorit shqiptar** (Vjenë 1922), e cila ka një Hyrje të gjatë për besimet popullore shqiptare.

Me përralla është vëllimi tjetër **Shqipëria rrëfen** (Berlin, 1958).

Pas Luftës së dytë Botërore mbajti kursin e gjuhës shqipe në Universitetin e Lejpcigut.

M.Lamberci ishte mik dhe dashamirës i madh i popullit shqiptar.

Një studiues gjerman **M.A.Godin** ka shkruar veprën **Fjalor i gjuhës shqipe dhe gjermane**, vëllimi i parë i të cilit (gjermanisht-shqip), doli në vitin 1930.

Lyi Dyfur (Luis Dufour) publikon artikuj për gjuhën shqipe në revistën Ylli i Mëngjezit, e cila botohej në Boston të Amerikës në vitin 1918.

Në artikullin **Shqiptarët dhe gjuha shqipe**, në mes të tjerash, autori bën fjalë për formimin e fjalëve me prapashtesa, si edhe për disa kompozita dhe frazeologji, ndërsa në artikullin **Studimi i shkurtër mbi formimin e gjuhës shqipe** flet edhe për analogji strukturore në mes të shqipes dhe frëngjishtes.

Më 1931 botoi në Paris frëngjisht librin **Gjuha Shqipe**, i cili përmban 30 (tridhjetë) mësimë praktike që ndiqen nga një Manual bashkëbisedues.

Me sa duket autori nuk është njohës i mirë i gjuhës shqipe sepse në të ka plotë gabime trashanike dhe pasaktësi shkencore.

Anton Buxeti (Antonio Buseti), një misionar italian, i cili në vitin 1895 vjen në Shkodër ku jep mësimin e shqipes. Më 1910 boton në Shkodër italisht librin: **Gramatikë e shkurtër e gjuhës shqipe**, të cilën e riboton në vitin 1933, me 167 faqe.

Vepra hapet me disa njohuri për Fonetikën, vijon, pastaj Morfologjia, ku shqyrton emrin, mbiemrin, përemrin, foljen etj.

Në vitin 1911 botoi italisht një **Fjalor italisht-shqip** po në Shkodër.

Më 1914 publikon librin **Praktika dhe Gramatika e gjuhës shqipe**.

Anxhelo Leoti (1884-1963), punonjës së Institutin Oriental të Napolit, i cili, që në të ri, iu kushtua shqipes. Në vitin 1915 e botoi italisht në Milano librin: **Gramatika elementare e gjuhës shqipe** (dialekti toskë), me 216 faqe, të cilën N.Jokli e ka cilësuar si më të mirën Gramatikë të dialektit të toskërishtes, shkruar nga një i huaj.

Një vit më vonë publikoi në Milano veprën **Shqipja e folur: Shënime gramatikore, fjalor, proverba, dialogje**, e cila përbëhet nga tri pjesë:

- a) Përmbledhje e rregullave kryesore gramatikore.
- b) Bashkëbisedues.
- c) Fjalor italisht-shqip dhe shqip-italisht, me dhjetëmijë fjalë.

Vepra është shkruar gegërisht.

Në vitin 1937 ka botua veprën **Disionario albanese - italiano** (Fjalor shqip-italisht) me 30.000 fjalë dhe 2500 proverba, të cilën e stolis një Parathënie e N.Joklit.

Vepra ka vlera të mëdha leksikore e gjuhësore dhe është e dobishme për gjuhëtarin, leksikografin, etimologun etj.

Leoti në vitin 1938 u dekorua nga mbreti shqiptar me "Urdhërin e kalorësit të Skëndërbeut".

Karl Shtajnc, inxhinier, më 1913 botoi në Sarajevë në dialektin e Shkodrës një **Gramatikë shqipe**, si edhe një **Fjalor shqip nevoje**.

G.S.Laumen (Lowmen), në vitin 1932 botoi monografinë **Fonetika e shqipes** në një Revistë në Amerikë. Është mbështetur në të folmen e Shkodrës.

Mbron prejardhjen ilire të shqipes.

Fulvio Kordinjano (1887-1952), misionar italian në Misionin Shëtitës Shqiptar; mblodhi nëpër malësi një visar shumë të pasur folklorik, etnografik dhe gjuhësor.

Ai botoi në Milano në vitin 1934 **Fjalorin shqip-italisht** (Dizionario albanese - italiano) me 7500 fjalë dhe në vitin 1938 në Shkodër **Fjalorin italisht-shqip** (Dizionario italiano-albanese) me 9000 fjalë.

Më 1934 ka botuar librin **Gjuha shqipe** (La lingua albanese).

Nikolla Gazuli, leksikograf i shquar i asaj kohe, botues i një vëllimi të veçantë, **Fjalor dialektor**, ishte mik i tij.

Enriko Kremoneze në vitin 1899 pat botuar një libër italisht me titull: **Kuadër fillestar për shkrimin dhe leximin e gjuhës shqipe**, e cila ka edhe disa **Shënime gramatikore**.

Antonio Melro, më 1916 botoi në Shkodër gjermanisht librin **Kurs i shkurtër për studimin praktik të gjuhës shqipe**, me 54 faqe.

Në vitin 1917 botoi gjithashtu një **Fjalor** të shkurtër shqip-gjermanisht dhe gjermanisht-shqip me 3000 fjalë.

Në vitin 1918 i përmbodhi në një vëllim.

Injacio Brezina (Ignazio Bresina) botoi në Firence një **Manual italisht-shqip** (1918) me 111 faqe.

Xhuzepe lo Jakone, në Gjenevë të Italisë publikoi librin **Fjalët e para dhe mendimet e para në gjuhët italisht dhe shqip**, me 146 faqe.

Antonio Aldeghieri, në vitin 1922 botoi në Shkodër italisht tekstin **Sintaksa shqipe**.

Adamo Lakalendola, profesor i gjuhës shqipe në Institutin e Lartë të Shkencave Ekonomike pranë Universitetit të Barit (Dega Tregtare) për afro 20 vjet, është marrë aktivisht me studimin e anëve të ndryshme të gjuhës shqipe. Për disa vjet ka qënë edhe profesor i gjuhës shqipe në Institutin Oriental të Napolit.

Autori i lartëpërmendur ka një veprimtari të pasur në botimet për shqipen, në mes të cilave po përmendim: **Gramatikë e gjuhës shqipe** (italisht - 1930); **Fjalor italisht-shqip** (me 7000 fjalë e frazeologjizma - 1932); **Fjalor shqip-italisht** (1936); **Fraza ushtarake që përdoren në shqip**, me 1400 fjalë të zgjedhura; **Drejtimi për stilin gazetaresk shqiptar** (tekst, përkthim, fjalë dhe shënime); **Ushtrime shqipe**, etj etj.

Lakalendola njihet edhe si autor me botime në anglisht dhe në Esperanto.

Periudha e katërt

A. Në Shqipëri

Pas Luftës së dytë Botërore gjuhësia shqiptare hyri në një Etapë krejt të re. Shteti shqiptar, i formuar në atë kohë, gjatë gjithë ekzistencës së tij, i dha një rëndësi shumë të madhe studimit të gjuhës shqipe, të historisë së popullit shqiptar, të kulturës shpirtërore e materiale të kombit shqiptar, nxjerrjes në pah të të gjitha vlerave të tij për qëllime shkencore, por edhe ideologjike dhe politike.

Veprimtaria shkencore u organizua dhe u përqëndrua në Institucione shkencore e arsimore, me një plan të përpiktë qoftë shkencor, qoftë organizativ, duke i marrë parasysh e duke i shfrytëzuar mirë traditat pozitive të së kaluarës dhe arritjet e gjuhësisë botërore.

Në Fazën e parë Pasçlirimit gjuhësia shqiptare plotësoi nevojat më të ngutshme të arsimit dhe të kulturës me tekste të ndryshme shkollore të të gjitha kategorive.

Struktura gramatikore në fillim u trajtua në kuadrin e gramatikave normative, por edhe u hartuan gramatika të një niveli të lartë shkencor nga autorë të njohur si: **K.Cipo** i cili hartoi tekstet e para të Fonetikës dhe të Morfologjisë së sotme dhe historike, tekste këto për Insitutin e Lartë Dyvjeçar duke i botuar në dy vëllime:

a) Fonetikë - Morfologji (1949)

b) Sintaksa (1952);

Mahir Domi që hartoi dhe botoi Sintaksat për kategoritë e ndryshme të shkollave deri edhe dispencat për Universitet; **S.Prifti** dhe autorë të tjerë.

Me këto tekste u kapërcye dhe u mënjana empirizmi dhe skematizmi i përshkrimeve të mëparshme, cektësia e tyre, duke marrë kështu trajtimi i problemeve një karakter më shkencor.

Në një **Fazë të dytë** u ndërmoren studime të thelluara monografike dhe vepra përgjithësuese e u hapën edhe drejtime të reja studimesh. U shquan për punime e studime të thella shkencore në sfera të ndryshme të gjuhësisë: A.Xhuvani, E.Çabej, A.Kostallari, M.Domi, S.Riza, Sh.Demiraj, L.Dodëbiba etj, etj.

Në fushën e **Morfologjisë**, pas një grumbullimi të një materiali të mjaftueshëm faktik dhe pas përgatitjes së kuadrit të nevojshëm, u hartuan një varg studimesh e monografish për kategori të veçanta morfologjike nga Sh.Demiraj, F.Agalliu, E.Hysa, A.Dhrimo, E.Lika, R.Memushaj, E.Angoni, E.Lafe.

Në fushën e **Sintaksës**, pas një pune disavjeçare (mbledhja e materialit faktik, njohja me literaturën e huaj dhe me rrymat e ndryshme gjuhësore) filloi studimi i anëve të ndryshme të sintaksës së gjuhës shqipe.

Me metodën tradicionale u studiuu **Sintaksa e fjalisë** si: **Tog-fjalëshi** nga S.Floqi, M.Çeliku, Xh.Gosturani, S.Mansaku, L.Buxheli; **Gjymtyrë të veçantë fjalie**, nga M.Domi, S.Prifti, R.Pernaska, M.Totoni; **Rendi i fjalëve në fjali** nga S.Floqi, M.Totoni, Th.Rrushi; **Tipet e fjalive në ligjërim** nga M.Domi, M.Çeliku, Xh.Gosturani.

Arritje të konsiderueshme pati edhe në studimin e **Sintaksës së periudhës** nga S.Floqi, M.Domi, Xh.Gosturani, S.Mansaku, S.Prifti.

Sintezë e gjithë kësaj pune është vepra: **Fonetika dhe Gramatika e Gjuhës së sotme Letrare Shqipe**, hartuar nga një grup autorësh me kryeredaktor prof.M.Domi; vëllimet: **Morfologjia - 1976; Sintaksa - 1997.**

Në këtë vepër është dhënë një vështrim tërësor dhe i plotë, i thelluar i strukturës gramatikore të shqipes, një pasqyrë e gjërë e mundësive shprehëse dhe e mjeteve morfologjike e sintaksore të saj.

Si Gramatikë përshkruese por edhe normative, ajo përgjithëson rezultatet e mëdha të arritura sidomos vitet e fundit nga gjuha letrare me njësimin dhe kristalizimin e saj dhe e shpie më tutje këtë kodifikim dhe njësim, duke dhënë kështu një kontribut të rëndësishëm për njohjen dhe mësimin e gjuhës sonë të sotme dhe ngritjen e kulturës gjuhësore të ne.

Një zhvillim të ri morën studimet në fushën e **Fonetikës**, ku

për herë të parë filluan të zbatohen edhe Metoda eksperimentale. U shquan për punime serioze në këtë sferë J.Gjinari, A.Dodi, R.Ismajli.

Në fushën e **Leksikologjisë dhe Leksikografisë** arritja e parë e rëndësishme është **Fjalori i Gjuhës shqipe**, botuar në Tiranë më 1954 me hartues: K.Cipo (kryetar), E.Çabej, M.Domi, A.Krajni, O.Myderrizi.

Më pas u themelua Kartoteka e leksikut të shqipes, duke u pajisur me një sasi shumë të madhe njësisish leksikore.

Mbi këtë bazë të fuqishme leksikore u trajtuan një varg problemesh teorike e praktike të leksikologjisë e të leksikografisë nga disa punonjës shkencor.

U hartuan Parimet teorike themelore për hartimin e një Fjalori të ri të gjuhës shqipe nga profesor Androkli Kostallari.

Mbi këtë bazë u hartua **Fjalori i Gjuhës së Sotme Shqipe** (1980) me 41 000 fjalë e më pas, mbi bazën e tij, u hartua edhe një **Fjalor Shpjegues** me 34 000 fjalë; të dy me kryeredaktor profesor Androkli Kostallari.

U zgjeruan dhe u vunë në themele më shkencore hartimi i **Fjalorëve Dygjuhësh**, numri i të cilëve u rrit shumë.

Arritje të shënuara pati edhe në **Njësimin dhe Shqipërimin e Terminologjisë**; u hartuan në bashkëpunimi me grupe specialistësh një varg **Fjalorësh terminologjikë** për degë të ndryshme të shkencës e të teknikës.

E theksojmë këtu se që nga shekulli XVII e deri më sot janë hartuar rreth 250 Fjalorë e Fjalorth, të cilët janë botuar si vëllim më vete ose u janë bashkangjitur veprave të tjera, si shtojcë e tyre ose edhe kanë mbetur dorëshkrim.

Në periudhën e Paraçlirimit janë hartuar rreth 80 Fjalorë ose Fjalorth, kryesisht dygjuhësh ose disagjuhësh.

Ndër autorët e hartimit të këtyre Fjalorëve 30 janë shqiptarë, ndërsa të tjerët janë të huaj.

Në periudhën e Pasçlirimit, brenda dhe jashtë Shqipërisë janë

hartuar rreth 170 Fjalorë e Fjalorth, pjesa më e madhe e të cilëve janë botuar. Nga numri i përgjithshëm janë botuar më se 20 Fjalorë Dygjuhësh dhe 40 Fjalorë Terminologjik.

U kryen studime në fushën e **Stileve funksionale** dhe u bënë punime të vyera për veçoritë stilistike të leksikut të shqipes, sidomos nga Xh.Lloshi.

Në fushën e **Fjalëformimit** u bënë një varg studimesh, të cilat zbuluan sistemin e mënyrave dhe të mjeteve fjalëformuese të gjuhës shqipe. U hulumtuan në mënyrë të veçantë Parashtesat dhe Prapashtesat e gjuhës shqipe në veprën e Xhuvanit dhe të Çabejt, Kompozitat e shqipes, veçanërisht në studimet e Kostallartit, si edhe shumë çështje të tjera teorike e praktike që lidhen me Fjalëformimin.

Në fushën e **Dialektologjisë** me të vërtetë u arritën rezultate jashtëzakonisht të mëdha nga gjuhëtarët shqiptarë. Puna filloi me një program të gjerë, të përcaktuar mirë nga Sektori i Gramatikës dhe i Dialektologjisë me drejtues profesor Mahir Domi, ndihmesa e të cilit në të gjitha fushat e gjuhësisë dhe të letërsisë është e tejskajshme.

U kryen kërkime në mbi treqind pika të banuara, duke mbledhur material dialektor qoftë me shënime, qoftë me inçizime; tërë territori i Shqipërisë u mbulua.

U hartuan rreth gjashtëdhjetë skica e monografi dialektologjike të cilat përshkruajnë më tepër veçoritë dalluese, diferencuese të të folmeve në sistemin fonetik, morfologjik e leksikor dhe që u botuan në Revistat shkencore të Institutit të gjuhësisë dhe të letërsisë, por kryesisht në Përmbledhjen **Dialektologjia Shqiptare**, gjashtë numrat e së cilës kanë dalë nga shtypi.

Hetimin e përgjithshëm të **Të Folmeve të shqipes** e plotësojnë edhe kërkimet dhe studimet në Kosovë, në Maqedonidhe në Mal të Zi, ku u mblodh një material i pasur dialektor gjuhësor, me të cilin u hartuan një varg punimesh e monografish nga gjuhëtarë të njohur e të shquar të atyre anëve me profesor Idriz Ajetin në krye.

Për Diasporën shqiptare u kryen kërkime dhe studime për të folmet arbëreshe nga vetë studiuesit arbëreshë, por edhe nga studiues të tjerë.

Pas Hetimit të përgjithshëm nisi faza tjetër për studimin e dialekteve të shqipes: Hartimi i **Atlasit Dialektologjik të gjuhës shqipe** (ADGJSH), i cili, pas një pune pesëmbëdhjetëvjeçare, përfundoi plotësisht në vitin 1990, me autor: J.Gjinari (kryetar), Bahri Beci, Gjovalin Shkurtaç, Xheladin Gosturani.

Problemi themelor që zgjidhi Gjuhësia Shqiptare pas Çlirimit, ishte problemi i **Gjuhës Letrare Kombëtare** të njësuar e të përbashkët.

Së pari u trajtuan dhe u zgjidhën një varg çështjesh teorike e praktike që kanë të bëjnë me procesin e formimit e të zhvillimit të gjuhës letrare shqipe e të normës së saj.

Përfundimisht çështja e gjuhës letrare kombëtare u zgjidh me Kongresin e Drejtshkrimit të gjuhës shqipe, i cili i zhvilloi punimet nga data 20 gjer më 25.11.1972 në Tiranë.

Ky Kongres vendosi Drejtshkrimin e njësuar të gjuhës shqipe të krejtë kombit shqiptar.

Pas këtij Kongresi u hartuan Veprat themelore që kodifikojnë normën e sotme letrare kombëtare drejtshkrimore, gramatikore dhe leksikore, duke u shtjelluar edhe çështje teorike të kulturës së gjuhës. Të gjitha materialet e Kongresit u botuan në dy vëllime: **Kongresi i Drejtshkrimit të gjuhës shqipe, I, II, Tiranë, 1973.**

Në periudhën që po flasim u trajtuan edhe një varg problemesh për **Historinë e gjuhës shqipe.**

Studimet në këtë fushë kanë hedhur dritë dhe kanë çuar në përfundime të argumentuara për çështjet themelore të historisë së lashtë të popullit shqiptar e të gjuhës së tij: autoktonin e këtij populli, prejardhja ilire e gjuhës shqipe.

Këto fakte u argumentuan me studimet shumë të thelluara e serioze të **Eqrem Çabejt.**

Ky kollos i Albanologjisë ka dhënë një kontribut të madh në

Studimet etimologjike shqiptare, në Fonetikën dhe Gramatikën e shqipes, në problemin e Prejardhjes së gjuhës shqipe, në çështjet e Marrëdhënieve të saj me gjuhët motra ballkanike dhe me gjuhët e tjera indoeuropiane, në Dialektologjinë historike, në Toponomastikë dhe Onomastikë, në Folklor, në Etnografi, në Histori të Letërsisë si edhe në Kodifikimin e gjuhës letrare.

Profesor E.Çabej me prova të forta vërtetoi prejardhjen ilire të shqipes e të popullit shqiptar, autoktoninë e tij, vuri në dukje rolin dhënës të shqipes ndaj gjuhëve me të cilat ra në kontakt, unitetin e kulturës materiale dhe shpirtërore të popullit shqiptar.

Veprat themelore ku i trajtoi këto çështje janë: **Studime etimologjike në fushë të shqipes**, në disa vëllime, katër prej të cilave kanë dalë në qarkullim; **Hyrje në historinë e gjuhës shqipe** (dy vëllime), botuar së fundi në vitin 1976; **Fonetika historike e shqipes** (1988); **Studime gjuhësore**, nëntë vëllime, botuar në Prishtinë e dhjetra e dhjetra studime, punime dhe artikuj të tjerë, të botuara në Revista dhe Gazeta të ndryshme.

Për çështjet e cekura më lart, kontribut shumë të madh ka dhënë edhe gjuhëtari i shquar kosovar, autori i disa vëllimeve prof. Idriz Ajeti.

Për historinë e Marrëdhënieve të gjuhës shqipe me gjuhët ballkanike ndihmesë të konsiderueshme kanë dhënë studiuesit: S.Mansaku, S.Hoxha, Xh.Ylli, A.Omari, B.Demiraj.

U kryen studime të tjera të rëndësishme për probleme të ndryshme të Gramatikës historike, për Historinë e gjuhës së shkruar, nga gjuhëtarët e mirënjohur: M.Domi, S.Riza, Sh.Demiraj, I.Ajeti etj.

Studimet kryesore bëhen në Insitutin e Gjuhësisë dhe të Letërsisë pranë Akademisë së Shkencave, në Katedrat e gjuhës shqipe të Universiteteve të Shqipërisë: në atë të Tiranës, të Shkodrës, të Elbasanit dhe të Gjirokastrës.

Me studime të tilla merren edhe kërkues dhe hulumtues të tjerë në të gjithë Shqipërinë.

Punimet e hartuara botohen në Revista dhe Përmbledhje të ndryshme si: **Studime filologjike, Studia Albania, Dialektologjia shqiptare, Gjuha jonë**, etj.

Arritje të shënuara në fushën e Gramatikës së sotme, të Gramatikës historike, në Historinë e gjuhës së shkruar, në Dialektologji, në Fonetikë, Leksik, Fjalëformim, në hartim Fjalorësh dy gjuhësh, në studimin e Marrëdhënieve të ndërsjellta të shqipes me dialektet sllave, në Toponomastikë dhe Onomastikë, ka pasur edhe në Kosovë.

Janë shquar disa gjuhëtarë dhe studiues, në mes të cilëve mund të përmendim: I.Ajeti, veprat e të cilit përfshijnë disa vëllime, R.Ismajli, H.Agani, L.Mulaku, M.Halimi, F.Raka. I.Bajçinca, V.Nuhiu, M.Bardhi, T.Kelmendi, M.Blaku, R.Doçi, I.Goçi, S.Gashi, R.Ushaku, Z.Munishi, B.Kryeziu, etj...

Përveç botimit të veprave të veçanta individuale botohen edhe Përmbledhje studimesh në Kosovë si: **Gjurmime Albanologjike, Studime Dialektologjike** etj.

Rezultate të kënaqshme në fushën e Albanologjisë ka pasur gjithashtu te Shqiptarët e Maqedonisë nga studiues tashmë të njohur si: R.Nesimi, H.Ymeri, Q.Murati, A.Poloska, Z.Osmani (Shkup), F.Sulejmani (Tetovë); po kështu edhe te shqiptarët e Malit të Zi.

Studimet albanologjike në tërë kombin shqiptar vazhdojnë me intensitet të madh.

B) Nëpër Botë

Studimet albanologjike kryhen sot, ashtu siç janë bërë më parë, edhe nëpër Qendrat shkencore dhe në Katedrat e gjuhësisë pranë Universiteteve në vende të ndryshme të Botës; ato kryhen edhe nga studiues të apasionuar në mënyrë të pavarur.

Le t'i shohim me radhë duke filluar së pari me **Italinë** e, më konkretisht, me **Arbëreshët**.

Përpjekjet e arbëreshëve për ruajtjen, lëvrimin, pasurimin, stu-

dimin e gjuhës shqipe kanë një histori të gjatë e të dhimbshme, histori nga ku dolën, siç e pamë, që në shekullin e XVIII, personalitete të ndritura si: Gj.Guxeta, N.Keta, E.Mashi, Z.Krispi, Dh.Kamarda, J.de Rada etj.

Sikurse Rilindasit tanë të mëdhenj edhe Arbëreshët, të cilët edhe këta hyjnë në Rilindasit tanë, i kënduan gjuhës shqipe me dashuri të zjarrtë, duke e konsideruar atë si mjet për çlirim kombëtar dhe si dallojë e kombit.

Edhe sot e kësaj dite ata e përdorin Këngën si mjet për ruajtjen e gjuhës.

Te Arbëreshët e Italisë sot zien një Lëvizje e gjërë kulturore dhe artistike për botime e studime në të gjitha sferat, për ruajtjen e traditave më të mira, për futjen e gjuhës shqipe në shkolla etj. Kudo ndihet përpjekje për hapjen e Kurseve për mësimin e gjuhës shqipe. Këto kurse, të frekuentuara masivisht, luajnë rol të rëndësishëm për të nxitur dashurinë e Arbëreshëve për gjuhën e tyre shqipe dhe për të ngjallur te ata dashurinë që ta ruajnë atë si një trashëgim të vyer, duke u formuar kështu edhe një mori e mirë mësuesish dhe studiuesish të rinj.

Është një Katedër e gjuhës shqipe në Universitetin e Kozencës dhe një tjetër në atë të Palermos nga të cilat kanë dalë studiues të apasionuar për gjuhën shqipe.

Dijetarë të shquar arbëreshë si F.Solano theksojnë se “Ne duam ta mbajmë gjallë e të ndezur traditën letrare arbëreshe, e cila në shekullin e kaluar ka pasur një lulëzim dhe një zhvillim të shkëlqyer dhe t’ua dorëzojmë pasardhësve tanë Vravashkën e De Radës. Duam ta lidhim kulturën tonë me atë të Atdheut se, përndryshe, ne jemi të bindur se ajo do të shuhet dhe do të zhduket përgjithmonë dhe ne do të humbasim” (Zëri i arbëreshëve, viti 1970, nr.12).

Arbëreshët janë të bindur se “Nuk ka rrugë tjetër për ta pasuruar dhe për ta mirësuar gjuhën dhe kulturën arbëreshe përveçse me lidhje sa më të plota me gjuhën dhe kulturën e Mëmëdheut.

Copëtimi i gjuhës është copëtimi i Kombit dhe copëtimi i Ko-

mbit shpie domosdo në zhdukje” (Vija, 1978, nr1).

Arbëreshët kanë krijuar Shoqëri dhe Rrethe Kulturore të shumta qëllimi i të cilave është ruajtja e kulturës dhe e traditave më të mira e studimi dhe zhvillimi i mëtejshëm i tyre. Ja disa prej tyre.

AIADI (Associazione Insegnante Albanese d’Italia - Shoqëria e Arsimitarëve Arbëresh të Italisë).

UCIA (Unione Culturale Italo - Albanese - Lidhja Kulturore Italo-Arbëreshe).

ACIA (Associazione Culturale Italo-Albanese - Shoqëria Kulturore Italo-Arbëreshe).

SHKA (Shoqëria Kulturore Arbëreshe).

Këto Shoqata herëpashere organizojnë diskutime, debate, konferenca për zhvillimin e letërsisë, të kulturës, për problemet e gjuhës etj.

Mendimet, dëshirat e tyre arbëreshët i shprehin në shtypin e tyre: Gazeta dhe Revista të ndryshme. Mund të përmendim: Zëri i Arbëreshëve, Zjarri, Vatra Jonë, Katundi Ynë, Gjuha Jonë e bukur, Lajmëtari i Arbëreshëve, Dita Jonë, Vija, Jeta Arbëreshe, Arëza etj.

Gjithë qëllimi i tyre është t’u shërbejë ruajtjes së gjuhës, kulturës dhe traditave më të mira, si edhe forcimit dhe ngritjes së vetëdijes kombëtare. në shumë prej tyre botohen artikuj, studime shkencore për probleme të ndryshme të gjuhës, të letërsisë, të folklorit, të historisë e të etnografisë.

Në Revistën Zjarri me qëndër në Shën Mitër Koronë janë botuar një numër i madh artikujsh në të cilët trajtohen çështje që kanë të bëjnë me ruajtjen dhe lëvrimin e gjuhës shqipe dhe të kulturës arbëreshe, studime për njohjen e veprimtarisë së figurave të shquara arbëreshe të shekujve të kaluar.

Revista në fjalë u ka bërë jehonë edhe përpjekjeve e nismave të Arbëreshëve për mësimin e gjuhës shqipe në shkolla dhe ka mbajtur gjallë Rubrikat me diskutime rreth këtij problemi.

Në Revistën Zëri i Arbëreshëve me qëndër në fshatin Ejaninë

të Kozencës janë botuar artikuj e kontribute me rëndësi për fushën e gjuhësisë, folklorit dhe historisë. Aty gjen edhe Kronika e Rencione interesante në lidhje me jetën dhe ngjarjet më të rëndësishme qoftë te vetë Arbëreshët, qoftë te Atdheu i parë i tyre, Shqipëria, vetëm e vetëm për ta mbajtur ndezur, në korent të çdo çështjeje masën arbëreshe.

Në të gjithë shtypin e tyre shtrohet çështja e përdorimit të gjuhës letrare shqipe në të tëra sferat e jetës dhe theksohet se “Ne u themi atyre që e njohin mirë gjuhën shqipe letrare se kanë detyrën ta përdorin atë në shkrim, si edhe në të folur, atyre që nuk e njohin mirë (sidomos në se ata janë të rinj) u themi se kanë detyrën ta studiojnë e ta mësojnë më mirë”.

Fr.Solano në numrin e parë të Revistës Vija nënvizonte se “Ne mendojmë që nuk ka rrugë tjetër për ta pasuruar dhe për ta përmirësuar gjuhën dhe kulturën arbëreshe, përveçse me lidhje sa më të plota me gjuhën dhe kulturën e Mëmdheut”.

Ka edhe një numër të mirë Revistash dhe Gazetash nëpër fshatrat arbëreshe.

Prej disa vitesh në disa nga katundet arbëreshe janë hapur edhe Radiostacione lokale.

Në radhët e arbëreshëve shquhen sot studiues të apasionuar në fushën e gjuhësisë kontributi i të cilëve është shumë i madh në shkencën gjuhësore shqiptare si: F.Solano, Fr.Altimari, E.Xhordano, A.Guxeta, M.Shambra, Xh.Farako, Ll.Perrone, H.Belushi.

F.Solano, drejtues i Katedrës së gjuhës shqipe në vitin 1975 në Universitetin e Kozencës, profesor i njohur, aktivist i madh në veprimtarinë shkencore-kulturore, autor i disa punimeve: **Vëzhgime për të folmet arbëreshe** (1960), ku i bën një analizë të imtë atyre të folmeve dhe arrin në përfundimin se ato, si edhe të folmet e Arbëreshëve të Greqisë, i përkasin dialektit të toskërishtes e nuk përbëjnë një dialekt të tretë të shqipes.

Vepra themelore e Françesko Solanos është padyshim: **Manu-**

ale di lingua Albanese. Coriliano Calabro - 1972 (Manual i gjuhës shqipe. Koriliano Kalabro (emri i qytezës në Palermo); ka pastaj edhe studime të tjera si: **Të folmet shqipe të Italisë** (1978); **Të folmet shqipe të S.Bazilës dhe të Platacit** (1979), etj.

Fr.Altimari, studiues i thellë, profesor i gjuhës dhe i letërsisë shqipe në Universitetin e Kozencës, interesat e tij shtrihen në dialektologji, sociolinguistikë, Letërsi, Tekstologji.

Në Dialektologji e filloi punën nën drejtimin e Solanos, theme-luesit dhe drejtuesit të Katedrës së gjuhës shqipe, me disa ndër-marje serioze si ALA (Atlasi Linguistik i Arbëreshëve), së pari si bashkëpunëtor i mjeshtrit të vetë e pastaj si realizues dhe drejtues i kësaj veprë.

Ai ka hartuar mjaft studime sidomos në fushën e Dialektologjisë si: **Sistemi zanor i së folmes arbëreshe të Ejaninës** (fshat 65 km larg Kozencës); **La parlata di machia Albanese: appunti fonologia** (E folmja shqipe e Maqit: shënime fonologjike), në të cilin jep sistemin fonologjik të kësaj të folmeje; **Alcune osservazione sul passato "presuntivo" dell arbëresh** - 1992 (Disa vëzhgime mbi të shkuarën "e hamendësuar" të arbërishtes), kushtuar sistemit foljor të pjesës dërrmuese të të folmeve të Italisë.

Altimari bashkëpunon me gjuhëtarë e sociolinguistë të njohur nga Italia, Gjermania, Amerika etj. Mund të përmendim Përmbledhjen studimore: **I dialetti italo-albanesi** (Dialektet italo-shqiptare), nën kujdesin e tij dhe të Leonardo Savojes, me parathënie nga gjuhëatri italian Tulio de Mauro - 1994. Gjithënjë në aktivitet, qoftë si profesor i gjuhës shqipe dhe i letërsisë shqiptare në Universitetin e Kozencës, qoftë nëpër fshatra për të mbledhur material dialektor, qoftë në organizimin e Seminarëve dhe Kolokiumeve, ai nuk rri pa bërë studime të tjera të një niveli të mirë shkencor si: **La minoranza linguistica albanese in Italia. Profili storicoletterari, antropologici e giuridico-istituzionali** - 1986 (Pakica gjuhësore shqiptare në Itali. Profile historiko-letrare, antropologjike dhe juridiko-institucionale), në bashkëpunim me M.Bolonjarin e

P.Karrocën e me Parathënie nga Tulio de Mauro. Këtu jepet kuadri historiko-kulturor i pranisë arbëreshe në Itali, drejtimet e zhvillimit të letërsisë arbëreshe, situata e sotme e bashkësisë arbëreshe në Itali, duke dhënë edhe të dhëna sociolinguistike e antropologjiko-kulturore me interes.

Një botim tjetër i Altimarit është **Scripta minora albanica** - 1994 (Shkrimet e rralla shqipe), ku përfshihen disa studime gjuhësore e historiko-letrare.

Drejtim i suksesshëm i tij ka qënë edhe Leksikografia Tekstuale e Kompjuterizuar - një metodë e re kërkimore për analizën e veprave letrare.

Me këtë metodë pune ai vazhdon të ketë rezultate të kënaqshme.

E.Xhordano, botoi veprën madhore **Fjalori i arbëreshëve të Italisë** (1963) me 10.000 (dhjetëmijë) fjalë, me shprehje, lokucione dhe shembuj të tjerë të vjelura nga vepra të botuara e të pabotuara të shumë shkrimtarëve arbëreshë, si edhe të marra nga jeta e gjallë e popullit arbëreshë.

Vepra ka vlera të mëdha leksikologjike dhe leksikografike.

Autori shënon se në vitin 1961 jetonin 55 katunde arbëreshe ku flitej shqipja, me një popullsi prej 135811 banorë.

Më 1964 ai botoi edhe një studim të thellë për **Leksikun** e veprave të Jeronim de Radës.

G.Ferrari ka botuar italisht në vitin 1971 **Gramatica albanese** (Gramatika shqipe), ndërsa A.Belushi ka mbledhur e botuar leksik dialektor: **Leksikografi arbëreshe** (Krahina Lukaneze) - 1987, botuar te Lidhja; ai ka bërë edhe atudime të tilla: **Arbëreshët dhe Lidhja e Shqiptarëve me Ilirët** (1973).

Karmine de Padova ka hartuar një studim të gjërë për të folmen arbëreshe të San Markanos.

Italo Kostante Fortino, i lindur në vitin 1947, nga Shën Benedikt Ulano, është aktivist i shquar në gjurmimin e kulturës dhe gjuhës arbëreshe; ai është aktualisht profesor i gjuhës dhe i letërsisë shqiptare pranë Fakultetit të Letërsisë dhe Filozofisë të Insti-

tutit Universitar Oriental të Napolit.

Ai ka mbajtur disa kumtesa në Konferencat dhe Kolokiumet Ndërkombëtare për gjuhën dhe letërsinë shqipe.

Është marrë dhe merret edhe me letërsi, sidomos me transkriptimin e veprave të autorëve arbëreshë, me alfabetin e sotëm shqip, me ç' rast ka pasur rezultate.

Në vitin 1984 publikoi veprën **Jul Variboba: Gjella e Shën Mërisë Virgjër** (Hyrje - Transkriptim - Përkthim - Fjalor - Shënime).

Studiuesi në fjalë boton sot Revistën **Albanistika**, një Përmbledhje letraro-gjuhësore me artikuj të botuar, numri i parë i së cilës doli në Napoli më 1997.

Studiuesi **Françesko Fusha** ka publikuar punimin **Probleme gjuhësore në Shën Dimitër Koronë** (1981) ndërsa **Ll.Perrone** ndjek më tepër fushën e leksikut të të folmeve arbëreshe dhe ka botuar **Fjalori i së folmes arbëreshe të Ejaninës**.

Fr.Jamone në Kozenca ka botuar studimin me interes gjuhësor **Vëzhgime mbi sistemin fonetik të së folmes arbëreshe të Acquaformozës** (Akuaformozës).

G.Marano, studiues arbëresh, ka hartuar një studim të gjërë mbi historinë, traditat dhe të folmen e fshatit të tij **Vaccarico Albanese** në krahinën e Kozencës.

Studiuesi i njohur **Vinçenx G.Baffa**, lindur në vitin 1924 në katundin Çivi të Kalabrisë, njeri i mirëarsimuar, zotërues i disa gjuhëve të huaja, banues sot në Gjermani, ka bërë botime në fushën e Gjuhësisë si: **Alfabeti shqip i programuar** (1971), **Libër këndimi i programuar** (1981), **Gjuha Jonë me hare** (1982) etj.

Ai ka bashkëpunuar me Revistën Katundi ynë dhe gjithënjë merret me gjuhën dhe kulturën arbëreshe.

Mario Brunetti ka punuar studimin **Problemi dell' albanese di Calabria** (Probleme të shqipes së Kalabrisë).

Në Kalabri ka edhe studiues të tjerë si: **Alfio Moça** nga Shën Benedikt Ulano, **Françesko Markiano** dhe **Maritela Marxhole**

nga Specano, **Mateo di Lena** nga Monteçilfone.

Dy studiues të tjerë të rinj janë edhe **Anxhela Kastelano Markiano** dhe **Anita Bafa**.

Në Palermo janë aktivizuar **Antonino (Antonio) Guxeta**, **G.Parrino**, **Mateo Mandala**; ky i fundit tani ka shkuar në Bari ku po përpiqet për të hapur një Katedër të gjuhës shqipe.

Antonio Guxeta, ish shef i Katedrës së gjuhës shqipe në Universitetin e Palermos, punon shumë për të folmet shqipe të atyre anëve dhe ka botuar studimet: **Për një deskriptim funksional të morfologjisë së substantivit në të folmen e arbëreshëve të Kontesa Entelinës; Përshkrimi fonematik i të folmes arbëreshe të Kontesa Entelinës** - 1983.

Te Arbëreshët gjithënjë dalin studiues të apasionuar pas gjuhës dhe kulturës së tyre.

———— * ————

Në **Itali** studimet albanologjike kanë historinë e tyre që zënë fill që në shekullin e XVI, çka vazhdojnë edhe sot e kësaj dite.

Gjatë gjithë kohërave numërohen në Itali rretgh 1734 vepra e punime që flasin drejtëpërdrejt ose tërthorazi për gjuhën, letërsinë dhe kulturën shqiptare.

Një nxitje dhe interesim të veçantë për studimin e gjuhës shqipe padyshim kanë luajtur figurat e ndritura të Arbëreshëve të Italisë e veçanërisht Jeronim de Rada, për të cilin burrat e moshuar të atyre anëve shpreheshin kështu: “kur rronej tatëmadhi inë”, “Tatëmadhi” i letërsisë arbëreshe.

Meritë e këtij burri, e këtij “tatëmadhi”, është hapja e Degës së gjuhës shqipe në Kolegjin e Shën Adrianit në Shën Mitër Koronë (1849) dhe rihapja në vitet 1889-1890. Ai u intersua gjithashtu për hapjen e Katedrës së gjuhës shqipe e të letërsisë shqiptare në Institutin Mbretëror Oriental të Napolit.

Ky problem u ngrit në disa forume shkencore që organizuan Arbëreshët e Italisë në fundin e shekullit XIX, duke u konkretizuar më në fund me sukses përpjekja e tyre në vitet 1900-1901 kur filloi

mësimi i gjuhës shqipe, dhe i letërsisë shqiptare në Institutin Oriental të Napolit, me profesor Zef Skiroi, sinior, nga Hora e Arbëreshërve.

Pikërisht këto situata kulturore e rritën interesin italian për Shqipërinë në të gjitha aspektet.

Kjo do të çojë, sidomos pas Luftës së dytë Botërore, në hapjen pranë disa Universiteteve të Lektoratëve të shqipes dhe një numër Katedrash.

Në këtë periudhë prof. Luigj Marlekaj së bashku me prof.G.Batilioni do të drejtojnë kursin e gjuhës dhe të letërsisë shqipe në Universitetin e Bolonjës.

Në Padova studimet shqiptare do të udhëhiqen nga prof.K.Taliavini, i cili themeloi "Seminarin e gjuhësisë ballkanike", ku mbajti kursin "Gjuha dhe letërsia shqiptare".

Në Romë do të fillojë punën në postin e profesorit Ernest Koliqi, në Palermo prof.Karl Gurakuqi, ndërsa në Napoli prof.Namik Resuli të cilët me veprat që botuan e pasuruan më tej inventarin e botimeve për gjuhën dhe kulturën shqiptare. E njëjta gjë do të ndodhë edhe në Kozenca dhe Bari.

Në Romë me kujdesin e Ernest Koliqit më 2 shtator 1957, me dekret të Presidentit të Republikës italiane, katedra e gjuhës dhe letërsisë shqipe u kthye në Institut të Studimeve Shqiptare, prej së cilës doli edhe Revista Shejzat, 1957-1974.

Shënojmë se në vitin 1991 pranë Universitetit të Leçes u hap një kurs për mësimin e gjuhës shqipe e më pas mësimi i gjuhës shqipe dhe i letërsisë shqiptare u vendos rregullisht në këtë Universitet.

Sot gjuha, letërsia, kultura, qytetërimi shqiptar mësohen në pesë universitete italiane: Kozencë, Palermo, Napoli, Romë, Leçe.

Të gjitha këto përpjekje dhe realizime çuan në formimin e një radhe albanologësh, ndër të cilët në kohën tonë mund të shënojmë: G.Batista Pellegrini, Monika Xhenesi (Padova), Leonardo M.Savoja (Firencë). Adelanda Landi (Napoli), Emanuele Banfi

(Potenca), Jon Trumper (Kozencë), etj, etj; të cilët, kush më shumë e kush më pak, botuan vepra të rëndësishme për gjuhën dhe shqiptarët.

Kështu **Xhovani Batista Pellegrini**, i lindur në vitin 1921, profesor në Padova, njohës i disa gjuhëve, autor i tetëqind titujsh botimi, prej të cilave 40 vëllime dhe 130 recensione, ka dhënë kontribut edhe në studimet e gjuhës shqipe, në rrafshin historik, me publikimin e disa studimeve e artikujve, në Revista të vendeve të ndryshme. Botimet për shqipen i kalojnë 1000 faqet. Punimi i tij **Vështrim mbi elementin latin të shqipes**, ka vlera të shënuara shkencore.

Ai ka botuar si dispencë universiteti veprën **Hyrje në studimin e gjuhës shqipe**, në vitin 1977, me 336 faqe, ndërsa në vitin 1995 botoi në Palermo veprën tjetër **Hyrje në gjuhësinë shqiptare**, me 277 faqe. Këtu mbron tezën e prejardhjes ilire të shqipes e të shqiptarëve dhe trajton gjithë kompleksitetin e problemeve që lidhen me shqipen dhe historinë e saj.

Çështje të gjuhës shqipe ka prekur edhe në veprat e tjera si: **Ricerche linguistiche balkanico-danubiane** - 1992 (Kërkime linguistike ballkaniko-danubiane), ku përfshihen tre kapituj që i përka-sin shqipes.

Xh.B.Pelegrini ka ndjekur nga afër edhe Arbëreshët e Italisë me të cilët ka pasur kontakte dhe u ka kushtuar disa shkrime si: **Leksiku i arbëreshëve të Italisë dhe turqizmat**.

Pelegrini është shumë prodhimtar.

Paolo di Xhiovine, është pedagog në Fakultetin e Letërsisë dhe të Filologjisë të Universitetit "La Sapienza" të Romës. Ka studiuar gjuhën shqipe, dialektet e saj dhe përgjithësisht filologjinë shqiptare në Institutin e Studimeve Shqiptare pranë këtij Universiteti nën drejtimin e profesor Xhuzeppe Gradilonës, filolog dhe tekstolog i njohur arbëresh.

Në vitin 1982, në Romë botoi studimin e thuktë: **Il gruppo et latino in Albanese** (Grupi et i latinishtes në shqip), ku pranon për

shqipen vetëm dy reflekse të grupit latin **ct**, përkatësisht **ct:jt**, **ct:ft**, duke përjashtuar të tretën **ct:t**.

Gjuhëtari që është marrë shumë me Albanologji ka qënë **Vitore Pizani** (Milano), i cili ka bërë disa studime me vlera të shënuara shkencore, botuar qoftë në Revistat tona shkencore, qoftë në Revistat e ndryshme evropiane.

Ndër punimet e tij me thellësi shkencore përmendim: **Shqipja dhe gjuhët e tjera indoeuropjane** (L'albanais et les autres langues indoeuropeennes - 1950); **Mbi gjenezën e shqipes** (1972); **Ilirët në Itali** (1972); **Nyja e prapme e shqipes dhe çështje të lidhura me të** (1962), etj etj.

Mbron prejardhjen ilire të shqipes.

Ndihmesë në fushën e Toponimisë dhe Onomastikës ka dhënë gjuhëtari i njohur italian **G.Rohlfs**, i cili botoi: **Dizionario toponomastico ed onomastico della Calabria** - Ravenna, 1974 (Fjalor toponomastik dhe onomastik i Kalabrië); **Nuovo Dizionario Dialettale della Calabria** - Ravenna, 1977 (Fjalor i ri dialektor i Kalabrisë).

Ai ka publikuar punimet, në të cilat cek anë të ndryshme të gjuhës shqipe si: **Humbja e paskajores në gjuhët ballkanike dhe në Italinë e Jugut** - 1958; **Fjalori etimologjik i greçitetit të Italisë Jugore** - 1964.

Në Revistën tonë Studime filologjike në vitin 1966 botoi studimin **Probleme të gjuhësisë ballkanike dhe marrëdhëniet e saj me Italinë e Jugut**.

Studime kushtuar të të folmeve arbëreshe ka bërë **G.M.Savoia** i cili ka publikuar italisht: **Aspekte morfologjike të të folmeve arbëreshe**.

Gjuhëtari i njohur italian **G.Bonfante** (Torino) në punimet e tij si: **Shqipja dhe ilirishtja** - 1972; **Pozicioni lingvistik i shqipes në mes të gjuhëve indoeuropiane** (La positione linguistica dell albanese fra le lingue indoeuropee - Palermo, 1978), i mëshon idesë se shqipja është pasuese e trakishtes, sepse është gjuhë Satem, ndër-

sa ilirishtja ishte gjuhë Kentum, e, më konkretisht, është pasuese e Dakishtes dhe populli shqiptar është pasues i Dakëve. Për këto çështje flet edhe te punimi tjetër i tij **Premesse e Problemi per un' dizionario etimologico albanese** - 1950 (Premisa dhe Probleme për një Fjalor etimologjik të shqipes).

Karlo de Simone, gjuhëtar italian me banim në Gjermani, merret kryesisht me mesapishten; ai është aktiv në studimet albanologjike dhe ka botuar **Gjendja e sotme e studimeve ilire dhe problemi i gjuhës mesapike; Ilirët e Jugut, tentativë për një përkufizim** (Gli Ilirii del Sud, tentativo di una definizione).

Zef Valentini, lindur në Padova në vitin 1900, erdhi në Shkodër më 1922 dhe qëndroi deri në vitin 1943, me ç'rast u largua përfundimisht. Është autor i Përmbledhjes dokumentare prej 30 vëllimesh **Acta Albaniae Veneta** (shtypur 25 vëllime), e cila ka materiale të shumta për historinë mesjetare shqiptare.

Gjithënjë luftoi për të nxjerrë në pah traditat më të mira të kombit shqiptar.

Studime për sfera të ndryshme të gjuhës shqipe kanë botuar **Xh.Restelli** (Studime të fonetikës shqipe - Milano, 1960); **A.Çirinçone** (Sintaksa shqipe e shkrimtarëve të vjetër - Romë, 1968); **Xhani Bellushio** (Gianni Belluscio) - **Punime dhe projektpunime në fushën e dialektologjisë arbëreshe** - 1996; **Xhuzepina Turano** (Giuzepina Turano) - **Çështje të sintaksës së gjuhës shqipe** - 1996; **M.Durante** e cila që në vitet pesëdhjetë merret me etimologji të fjalëve shqipe.

Ndihmesë në studimin e anëve të ndryshme të gjuhës shqipe, sidomos në studimin e gjuhës së autorëve të vjetër, kanë dhënë edhe studiuesit me origjinë shqiptare, por që jetuan në Itali: **N.Resuli** (i cili ka botuar në vitin 1958 Mesharin e Buzukut, me shënime dhe komentime përkatëse), **L.Marlekaj**, **G.Marlekasj**, etj.

Më 1952 Zef Valentini, G.Marlekaj, R.Petrota themeluan Qendrën Ndërkombëtare të Studimeve Shqiptare në Palermo.

Nerman Falaski - Vlora, mbesa e Ismail Qemalit, e cila jeton

në Romë, amatore e flaktë e historisë së gjuhës shqipe, merret me pasion me etruskishten, duke u përpjekur parreshtur të vërtetojë se Etruskët ishin ilirë; shumë fjalë të Mbishkrimeve etruske është munduar t'i shpjegojë me anën e gjuhës shqipe.

Hipoteza të tilla nuk kanë asnjë bazë shkencore sepse Etruskët kanë qenë një popull krejt tjetër e nuk kishin të bënin fare me ilirët, fakt që ma ka kumtuar gojarisht luani i Albanologjisë, Akademiku Eqrem Çabej.

Në vitin 1984 ajo botoi librin **Qytetërime të lashta mesdhetare** (Pellazg, Ilir, Etrusk).

Nermani ka bërë edhe botime të tjera.

———— * ————

Në **Gjermani** dhe në **Austri**, të çilat në shekullin e kaluar ishin qëndra kryesore dhe shumë të rëndësishme të studimeve albanologjike, sot zhvillohet një veprimtari e gjallë në drejtim të studimeve shqiptare.

Sjellim ndërmend se atje kanë zhvilluar aktivitetin e tyre gjuhëtarët e njohur Fr.Bop, G.Mayer, H.Shuhard, N.Jokl, M.Lamberg e dhjetëra të tjerë.

Do ta fillojmë me **Karl Trajmer** (Treimer), i cili që në vitin 1914 në Vjenë pati shkruar artikullin **Kontribut për historinë e gjuhës shqipe**, ndërsa në vitin 1915 botoi një studim për **Marëdhëniet rumuno-shqiptare**.

Në vitin 1954 në veprën **Etnogjeneza e Sllavëve**, ka shtruar probleme edhe për historinë e shqipes.

Përveç artikujve të tjerë si: **Problemi Ilir - Keltët dhe indoeuropianët** (1957); **Kontributi iliro-shqiptar në kulturën evropiane** (1968), K.Trajmer në studimin **Ilirët, Qënësia dhe Rëndësia e tyre**, mbajtur në Konferencën e parë të Studimeve Albanologjike në nëntor të vitit 1962 në Tiranë dhe pastaj botuar në Përmbldhjen e materialeve të kësaj Konference, ka pohuar se shqipja është mbeturinë e fundit e Botës Ilire, se Ilirishja është gjuhë Satem (lindore); ai te Ilirët pranon një Substrat paraindoeurop-

jan, sikurse pranohet për popujt e tjerë indoeuropjanë dhe se sh-tresën paraindоеuropjane e quan Ortoilire; flet për marrëdhëniet Kelto-Shqiptare duke u kushtuar edhe punime të veçanta.

Hans Krahe ilirolog i përmendur dhe me një veprimtari shkencore të mirë, e konsideron shqipen si gjuhë indoeuropjane më vete, pa e lidhur as me ilirishten, as me trakishten, as me ndonjë gjuhë tjetër të Ballkanit.

Ky dijetar u ka kushtuar vëmendje të veçantë Ilirishtes, Mesapishtes dhe Venetishtes dhe ka bërë dallimin e Venetishtes si gjuhë më vete, e ndryshme nga ilirishtja, duke theksuar se Venetët e Ilirëve që përmend Herodoti nuk ishin Venetët e Italisë së Sipërme të cilët H.Krahe i quan Venetët e Adriatikut, por një fis ilir në kufirin verior të Maqedonisë.

Në dy vepra të tij të viteve 1925 dhe 1929, ai mblodhi emrat gjeografikë dhe emrat e personave të Ilirëve të Ballkanit: **Emrat gjeografikë të vjetër të Ilirëve të Ballkanit** (Die alten balkanillyrischen geographischen Namen - 1925).

Në vitin 1955 ka botuar vëllimin e parë të veprës së tij **Gjuha e ilirëve** (Die Sprache der Illyrier).

Edhe **Antun Mayer** botoi në Vjenë **Gjuha e Ilirëve të vjetër** (Die Sprache der alten Illyer - 1957).

Në Austri në Institutin e Gjuhësisë të Universitetit të Insbrukut, vepron intensivisht në studimet albanologjike indoeuropjanisti **H.Olberg**. Ky gjuhëtar në vitin 1972 paraqiti në atë Institut studimin e gjërë monografik: **Hulumtime për Fjalorin indoeuropjan të shqipes dhe për Fonologjinë diakronike në bazë të sistemit të zanoreve** (Untersuchungen zum indogermanischen Wortschatz des Albanischen und zur Diachronen Phonologie auf grund des Vocal - System).

H.Olberg ka botuar dhjetëra punime për gjuhën shqipe dhe vazhdon të punojë edhe sot; ndër më kryesoret do të përmendim: **Mbi neutralizimin e palatales dhe velares k para likuideve** (1969); **Hulumtime për leksikun indoeuropjan të shqipes**

(1972); **Probleme të historisë së gjuhës shqipe** (në bazë të hundorësisë) - 1971; **Disa mendime për teorinë laringale në bazë të shqipes** (1972); **Lidhjet gjuhësore greqisht-shqip**; **Hulumtime për leksikun e greqishtes së vjetër në shqip** (1972); **Disa mendime për autoktoninë e shqiptarëve në Gadishullin e Ballkanit** (1977); **Kontributi i gjuhësisë për çështjen e Atdheut ballkanik të shqiptarëve** (1982) etj.

Atij i ka intersuar shumë Rindërtimi i shqipes së vjetër që nga koha antike dhe këtë përpiqet ta bëjë me anë të analizës së huazimeve latine e të greqishtes së vjetër, që kanë depërtuar në gjuhën shqipe.

Gjithënjë pohon tezën e E.Çabejt se shqiptarët janë banorë të hershëm autoktonë në trojet e tyre, se Bregdeti banohej që herët, që në antikitet prej tyre, duke sjellë si argument dhe dëshmi nga huazimet e llatinishtes dhe të greqishtes së vjetër. I përmbahet tezës së vijimësisë së shqipes nga ilirishtja dhe shqiptarët i quan vazhdues të ilirëve.

H.Olberg është profesor universiteti, mban lektoratin shqip, është ndër organizatorët kryesorë të Kolokiumit të madh Ndërkombëtar Albanologjik në vitin 1972 në Insbruk me rastin e tridhjetë vjetorit të vdekjes së N.Joklit, si edhe i botimit voluminoz (780faqe) të Akteve të këtij Kolokiumi.

Dy studiues gjermanë janë edhe **O.Buholdz** (Bucholdz) dhe **V.Fidler** (Fiedler), të cilët merren aktivisht me studimin e gjuhës shqipe; ata kanë botuar veprat: **Gramatikë shqipe** (1987) dhe **Fjalor gjermanisht-shqip** (1977) dhe ribotuar në vitin 1997.

Të dy së bashku kanë shkruar punimin: **Mbi pozicionin e shënjesit të kundrinës në gjuhën e sotme letrare shqipe dhe te Gjon Buzuku** (1972). O.Buholdz ka publikuar ndër të tjera, edhe punimet: **Dyfishimi i kundrinës në gjuhën shqipe** (1977); **Modele fjalish të shqipes e të gjermanishtes** (1983); **Aspekte të zhvillimit të leksikut në gjuhën shqipe** etj.

W.Fidler është prodhimtar në veprimtarinë shkencore; ai ka

botuar studimet: **Kërkime për formimin e shumësit në gjuhën shqipe** (1961); **Mbi disa probleme të Admirativit në shqip; Zhvillimi i infinitivit nga aspekti i balkanologjisë.**

Pas vdekjes së M.Camajt është thirrur në Universitetin e My-nihut për të drejtuar Katedrën e gjuhës shqipe, Sektorin e Albanologjisë.

G. Uhlisch (Uhlische), një studiuese e apasionuar pas gjuhës shqipe, ka botuar punimet: **Fjalët e greqishtes së re në shqip** (1964); **Ndikimet greke në fjalorin e dialektit shqiptar në Atikë; Studime mbi përcaktorët emërorë të gjuhës së sotme shqipe** etj.

Në Bohum (Bochum) zhvillojnë aktivitet albanologjik me ndihmesa e kontribute të vyeshme gjuhëtar: **N.Boretzki, L.Dodiç, J.Kristofsen.**

N. Boretzki ka botuar **Nyja shquese pas parafjalëve në gjuhën shqipe** (Der bestimmte Artikel nach Propositionen im

Albanischen-1968); **Në Ndryshime fonetike analoge në hua-zimet e shqipes dhe rëndësia e tyre për rindërtimin e historisë së gjuhës shqipe** (1972); **E kryera dhe e kryera e plotë në një dialekt të shqipes** (1966).

L.Dodiç, i aktivizuar si lektor i shqipes në Bohum që prej vitit 1966, ka publikuar punimet: **Marrëdhëniet e N.Joklit me albanologë bashkëkohorë dhe shkrimtarë shqiptarë në bazë të trashëgimisë së tij;** (1972); **Lektorati shqiptar në Universitetin Ruhr të Bohumit.**

A.Hetzer ka mjaftë kontribute albanologjike; ai është autor i një **Fjalori** xhepi shqip-gjermanisht dhe gjermanisht-shqip me 12.000 fjalë, autor i botimit të **Fjalorit** tregjuhësh të Kavaliotit. Veprimtarinë shkencore e zhvillon në Bremen të Gjermanisë, në Institutin e Gjuhësisë të Universitetit të këtij qyteti, si edhe në Bibliotekën universitare të po këtij qyteti.

Hetzer është zgjedhur Antar nderi i Sektorit shkeencor të Albanologjisë në Universitetin L.Gurakuqi të Shkodrës; ai jep edhe

cikël leksionesh në Fakultetin e Filologjisë në Universitetin e Tiranës.

Në Universitetin e Salzburgut ka qenë aktiv **Oto Has** me studimet: **Kontributi austriak në zhvillimin e gjuhësisë ballkanike dhe të Albanologjisë** (1972) dhe **Mbishkrime mesapike** (Le iscrizione messapiche - 1960).

Në Berlin do të përmendim gjuhëtarët **H.Shmid** (Schmidt) me studimin, ndër të tjera, **Huazimet moderne dhe internacionalizmat në shqip** (1960) dhe **P.Shubert** me punimin; **Mbi zhvillimin e Alfabetit shqip në shekullin e XIX dhe XX** (1961); gjithashtu këtu vepron edhe **Norbert Rajter** (Reiter), sidomos me ndihmesat; **Mbi strukturën e mbaresave foljore në shqip** (1960); **Pjesëza po në gjuhën shqipe**.

Në Bon është dalluar **J.Knobloh** (Knobloch) i cili, në mes tjerash, ka shkruar artikullin shkencor: **Emri dallndyshe në ndërtimet paralele greko-shqiptare** (1972). Këtu bën përpjekje me Lektoratin shqip edhe **R.Këderiç** (Koderitsch).

Në Hamburg, studiuesi **H. Harman** ka kontribuar në studimet albanologjike me punimet: **Leksiku i huazuar latinisht në shqipen; Problematika e dallimit të elementit latin nga ai roman në leksikon e shqipes** (1972). Ky autor është marrë më tepër me latinizmat e gjuhës shqipe.

Studiuesi tjetër në Hamburg **G.Gutshmid** në vitin 1966 botoi studimin me interes shkencor. **Emrat e kafshëve me prejardhje sllavojugore në shqip** (Albanische Tiernamen sudslavischer Herkunft).

Klaus Hebler (Claus Haebeler) në Mynshter (Munster) ka hulumtuar më fort Arbëreshët e Greqisë me studimin **Grammatik des Albanischen Mundart von Salamis** - 1965 (Gramatika e së folmes shqiptare të Salamisë). Ai ka bërë edhe botime të tjera në fushën e Albanologjisë, sidomos Recensione Kritike si për Fjalorin e Kristoforidhit, për veprën e Bopit, për veprën e Lambercit, për Gramatikën e Jeronim de Radës etj.

K.Hebler është një indoeuropjanist i shquar.

Studiuesi **J.Hubshmid** ka kontribuar në bashkëmarrëdhëniet shqiptaro-rumune me punimin: **Interpretimi historik i barazimeve shqiptaro-rumune të fjalëve dhe substrati dako-miz** - 1982.

A.R.Rohr është i prirur drejt studimit të të folmeve të Arbëreshëve të Italisë, si edhe drejt bashkëmarrëdhënieve shqiptaro-rumune.

Ai ka publikuar punimet me vlerë: **Mbi shqipen në Akuaformoza - Kalabri** (Zur Albanischen in Acquaformosa - 1964); **Kontribut për morfologjinë dhe sintaksën e shqipes në Akuaformozë** - 1968; **Mbi barazime fjalësh shqiptaro-rumune** (Zur den Albanische - Rumanischen Wortgleichungen - 1981).

Në Vjenë me Albanologji merret edhe **G.R.Solta** romanist, balkanolog, indoeuropjanist, i cili në vitin 1980 botoi veprën **Einführung in die Balkanlinguistik mit besonderer Berücksichtigung des Substrats und des Balkanlateinischen** (Hyrje në gjuhësinë ballkanike me konsideratë të veçantë për Substratin dhe latinishten ballkanike).

Ai ka shkruar edhe punime për sfera të ndryshme të gjuhës shqipe.

Nuk duhet lënë pa përmendur përkujdesjet për shqipen në Universitetin e Gracit të **Fritz Frhr. Lohner von Hytenbah** (Huttenbach), sidomos me punimin **Kontributi i G.Mayerit për studimin e gjuhës shqipe** - 1972.

R.Shvanke (Schvanke), në Vjenë, më tepër ka vënë në dukje ndihmesën Austro-Hungareze në zhvillimin e arsimit në Shqipëri në punimet. **Kontributi austro-hungarez për formimin e gjuhës së shkruar shqipe** (1972); **Shkolla shqipe dhe Austro-Hungaria gjatë Luftës së parë Botërore; Austro-Hungaria dhe Kongresi i Manastirit** (1969).

W.Dressler në Vjenë në vitin 1972 ka shkruar punimin: **Rezultate fonologjike, morfonologjike dhe morfologjike të shqipes.**

Në Gjermani për Albanologjinë intersohen edhe studiues të tjerë si: **H.J.Sase**, vëmëndja e të cilit më tepër është e prirur në të folmet e arbëreshëve të Greqisë me studimet: **Një dialekt arkaik shqiptar në ishullin e Andros (Greqi) - 1982; Sistemi foljor i dialektit arbëresh Vurkotit (Greqi) - 1983; H.Shaler (Schaler)**, i cili në vitin 1987 botoi punimin: **Vijueshmëria dhe Shquarsia në gjuhën shqipe; A.Shmaus (Schmaus)** që në vitin 1960 ka botuar punimin: **Vështrim rreth kuptimit dhe përdorimit të habitores në shqip; G.Klingenshni** me punimin **Shqipja dhe Lashtindoeuropjanishtja (1981)**.

Në u përqëndruam në studiuesit kryesorë dhe në punimet e tyre më të rëndësishme, sepse në Gjermani e në Austri ka edhe studiues të tjerë me emër, në mes të cilëve po cekim: **V.Brë (Breu), E.Glaser, B.Jonson, J.Kristofsen**.

Kontribut për historinë e vjetër të shqiptarëve kanë dhënë edhe historianët dhe studiuesit e njohur **J.Irmsher, H.Frommer** (me librin Ilirët - 1988), **P.R. Franke** (me veprat: Monedhat e lashta të Epirit, Shqipëria në lashtësi - 1983), **G.Shram** etj, të cilët mbrojnë prejardhjen ilire të shqipes dhe të shqiptarëve.

Pas Luftës së dytë Botërore në Gjermani u shqua për studime në Albanologji edhe letrari shqiptar **Martin Camaj**, i cili u mor më tepër me kërkime për të folmet e arbëreshëve të Italisë me punimet: **La parlata albanese di Greci in provincia di Avellino - 1971** (E folmja shqipe e Greçit në provincën Avellino); **Zur albanischen Mundart von Barile in der Provinz Potenza - 1972** (E folmja shqipe e Barilës në Provincën Potenza).

Ai ka hartuar edhe studime e punime të tjera si: **Lehrbuch der Albanischen Sprache - 1969** (Manual për gjuhën shqipe); **Për vokalin nazal te Buzuku**, etj.

* ———

Në ish Jugosllavi (Beograd, Zagreb, Shkup), studimi i anëve të ndryshme të gjuhës shqipe ka filluar që në shekullin e XIX, ka vijuar gjatë shekullit XX, çka vazhdon edhe sot.

Mjafton të kujtojmë edhe njëherë dijetarët e njohur tashmë: Kopitar, Miklosiq, Bariç, Skok, Shuflaj, Nahtigal, që dhanë një ndihmesë të madhe në studimet albanologjike, për të cilët folëm më lart.

Në **Sloveni** në vitet njëzetë të shekullit tonë, u aktivizua në studimet shqiptare edhe dijetari **Karol Oshtir**, i cili u mor kryesisht me hulumtimin e relikteve mesdhetare në gjuhën shqipe, me ç'rast "zbuloi" një numër të madh të inventarit leksikor mesdhetar në Shqipëri.

Tani vonë, në vitin 1986 në Akademinë Serbe të Shkencave dhe të Arteve u mbajt një cikël Ligjëratash me temë kryesore: **Ilirët dhe Shqiptarët** (Iliri i Albanci), të lexuara kryesisht nga ekspertë të fushave të Historisë dhe Arkeologjisë.

Më pas Ligjëratat u botuan si vëllim më vete me të njëjtin titull, me vit botimi 1988.

Dijetarët pjesëmarrës me ligjëratat e tyre, ishin nga më të dëgjuarit në ish Jugosllavi: **M.Garashanin** (Formimi dhe origjina e shqiptarëve), **Vi.Popoviç** (Shqipëria në antikitetin e vonë), **F.Papazoglu** (Mbretëria ilire e Dardanëve), **B.Ferjanoviç** (Shqiptarët sipas burimeve bizantine), **S.Qirkoviç** (Shqiptarët në dritën e burimeve të sllavëve të Jugut).

Të gjithë kishin një qëllim: **Të rrëzojnë, të hedhim poshtë tezën e prejardhjes ilire të popullit shqiptar e të gjuhës së tij.**

Sipas tyre Shqiptarët u formuan në Antikitetin e vonë, pas përmbykses së sundimit romak në Ballkan, nga mbetjet e etnive të ndryshme ilire, dardane e trake të Ballkanit të hershëm.

Kuptohet se sa rëndësi i kanë dhënë herë pas here këtij problemi Qarqet e caktuara politiko-shkencore në Jugosllavi, veçanërisht në Serbi.

Tani le të shtjellojmë mendimet e disa gjuhëtarëve jugosllavë që dhanë pas Luftës së dytë Botërore, për shqipen dhe shqiptarët.

Në Beograd **Ivan Popoviç**, i vdekur në moshë të re në vitet gjashtëdhjetë, në veprën e tij të njohur **Geschichte der Serbokro-**

atischen Sprache - 1960 (Historia e gjuhës serbokroate) dhe në disa studime të tjera, si në **Albano-Slavica** pohon se Shqiptarët kanë ardhur pas sllavëve në trojet e tyre dhe se ata u vendosën si superstrat (Mbishtresë), duke i asimiluar sllavët. Sjell si shembull emrat e vendeve, emrat e qyteteve mesjetare që, sipas tij, nuk mund të shpjegohen me shqipen.

Ashtu si edhe P.Skok, ai e shpjegon trajtën e emrit të **Durrësit** si zhvillim sllav i emrit të lashtë “Dyrrachium”.

Për origjinën e popullit shqiptar mbron tezën trake, duke theksuar se stërgjyshërit e shqiptarëve kanë ardhur mjaft vonë në Trojet e sotme nga viset më Lindore e duke sjellë si argument: Mungesa e terminologjisë së trashëguar të detarisë e të peshkimit në gjuhën shqipe; Prania e një numri të konsiderueshëm fjalësh të vjetra të përbashkëta në shqip dhe në rumanisht; Elemente latine të përbashkëta në këto dy gjuhë; Prania e disa bashkëpërkimeve midis shqipes dhe armenishtes; Prania e disa fjalëve të vjetra sllave në shqip dhe në rumanisht, **si daltë** etj.

Në punimet e tij ai ka trajtuar edhe ndikimin e shqipes në serbokroatishten, shtrirjen gjeograffike të elementit të shqipes në trevat jugosllave, kronologjinë e huazimeve nga shqipja në serbokroatishten, ndikimet në fonetikë dhe në morfologji në të folmet serbokroate nga gjuha shqipe.

Ai ka trajtuar gjithashtu elementin sllav në gjuhën shqipe, duke mos i konsideruar si huazime të mirëfillta, por si “fjalë relikte”, të mbetura nga asimilimi i sllavëve në Shqipëri, çka nuk është e vërtetë.

Elementin sllav në shqip e ndanë në dy shtresa:

a) Shtresa më vjetër: bullgaro - maqedonase në Shqipëri të Mesme dhe të Jugut.

b) Shtresa e re serbokroate në Veri.

Në veprën **Historia e gjuhës serbokroate** I.Popoviç shkruan: “Për ndikimin gramtikor të sllavishtes mbi shqipen vështirë se mund të flasim; shumë përkime sintaksore midis shqipes e sllavishtes së Jugut janë të ashtuquajtuara “ballkanizma”, zakonisht me burim të

paqartë dhe nuk kufizohen vetëm në shqipen dhe në sllavishten e Jugut por ndodhen edhe në gjuhët e tjera ballkanike.

Në çdo rast në fleksionin e shqipes nuk mund të konstatohet asnjë ndikim sllav” (nënvizimi im - Xh.G.).

Vojislav Dançetoviç (1905-1975) ka kontribuar shumë në hapjen, funksionimin dhe në mbarëvajtjen e Seminarit Albanologjik në Universitetin e Beogradit, duke bërë vetë një punë të madhe.

Ai themeloi edhe Katedrën Albanologjike të cilën e drejtoi vetë nga ku dolën me dhjetëra kuadro shqiptare.

Përveç punës pedagogjike dha ndihmesë të madhe edhe në fushën e studimeve shqiptare: bashkautor i **Fjalorit serbokroatisht - shqip**, botuar në Tiranë në vitin 1947, botues i folklorit shqiptar etj. Por vepra kryesore e tij është **Sufiksi diminutiv i emrave të gjuhës shqipe**, të cilën e botoi Rilindja në vitin 1960, studim i rëndësishëm për Fjalëformimin e shqipes.

Në Beograd sot punon në fushën e marrëdhënieve gjuhësore shqiptaro-sllave edhe studiuesi **Vanja Stanishiç**, i cili ka botuar veprën **Serpsko - Albanski jezički odnosi-Beograd**, 1995 (Marrëdhëniet gjuhësore serbo-shqiptare), ku shumë çështje i shikon me thellësi shkencore.

Olivera Jashar - Nasteva, është ndër studiueset më të njohura të Maqedonisë; është profesoreshë në Fakultetin Filologjik në Universitetin e Shkupit. Ajo ka mbajtur edhe ligjërata për Dialektologjinë shqiptare pranë katedrës së gjuhës shqipe dhe të letërsisë shqiptare në Fakultetin Filologjik të Universitetit të Shkupit, në të cilën gjenden edhe disa gjuhëtarë shqiptar të njohur si: R.Nesimi, H.Ymeri etj.

Olivera është antare e Akademisë së Shkencave dhe Arteve të Maqedonisë.

Duke u marrë më tepër me maqedonistikë ajo kontribuoi edhe në fushë të Albanistikës, të romanistikës dhe të turkologjisë.

Në rreth 30 tituj bibliografikë trajton çështje të sferave të Al-

banologjisë.

Edhe pse këto punime janë hartuar në kontekst të studimeve ballkanistike, ato ndriçojnë mjaft probleme të të gjitha anëve të bashkëmarrëdhënieve në mes shqipes dhe maqedonishtes; veçanërisht kjo duket në studimin me bashkautorë B.Koneski, B.Vidoeski: **Le contacts entre les parlars macedoniens et albanais** - 1974 (Kontaktet në mes të të folmeve maqedonase dhe shqipes).

Ajo ka botuar gjithashtu punimet e mirënjohura: **Albanski zborovi vo makedonskite tajni jazici** (Fjalë shqipe në gjuhët e fshehta të maqedonishtes); **Turskiot govor vo Gostivarskiot Kraj** (E folmja turke në Krahinën e Gostivarit), botuar në vitin 1970.

Olivera është marrë edhe me historinë e gjuhës shqipe, me Diglosinë, Bilinguizmin dhe Interferencat.

Dukuritë e fundit ajo i sheh në lidhje të ngushtë me situatën shumëgjuhëshe që reflektohet si rezultat i diferencimit social politik dhe etnik. Është fjala për një situatë që është rrjedhojë e zhvillimit historik, politik e kulturor të etnive të ndryshme që jetuan dhe jetojnë në këto treva me një të kaluar të përbashkët.

Pra ajo bën studime sociolinguistike. Diglosinë e sheh si simbiozë të variantit dialektor (popullor) dhe të atij letrar, sikurse Fergusoni.

Olivera e mbivlerësoi rolin e Bilinguizmit dhe foli për pasojat negative dhe pozitive të kësaj dukurie në zhvillimin intelektual të fëmijëve bilingual, veçanërisht të nxënësve që nuk shkollohen në gjuhën amtare.

Vëmëndje u ka kushtuar ballkanizmave.

Me shumë interes janë studimet e saj për Toponominë historike.

Shënojmë këtu se **Bozhidar Vidoeski**, i cili merret me shqipen në kuadrin e gjuhësisë ballkanike, ka botuar punimin: **Kontaktet gjuhësore të maqedonishtes dhe të shqipes** (në rrafshin dialektor), si faktor për diferencimin dialektor të gjuhës maqedonase.

Në Maqedoni për fjalëformimin e shqipes ka shkruar **Boris Markov**, i cili disa prapashtesa të gjuhës shqipe i ka parë në përqasje me gjuhët sllave. Në mes tjerash po përmendim këtu dy studime të tij: **Disa vërejtje për prapashtesën -isht në gjuhën shqipe dhe në gjuhën sllave; Prania e prapashtesave - osh, dhe oshe, - ush, - ushe në gjuhën maqedonase** (1986).

Glizha Elezović në vitet 1932/35 pat botuar në Beograd një **Fjalor të dialektit të Kosovës - Metohisë**, kurse në vitin 1950 publikoi studimin **Veçoritë fonetike të dialektit Shqipar të Dibrës e të rrethinave të saj**.

Dijetari i njohur Kroat **R. Katiçiq** në studimet e tij **Ançient languages of thë Ballkans** - 1976 (Gjuhët e vjetra të Ballkanit); **Antroponimia ilire dhe etnogjeneza e shqiptarëve**, botuar në revistën tonë Studimet filologjike (1972/4), mbajtur si ligjëratë në Kuvendin e parë të studimeve ilire, pasi vë në dukje praninë e huazimeve nga latinishtja dhe Greqishtja e vjetër në gjuhën shqipe dhe faktin tjetër që ne burimet historike nuk përmendet ndonjë imigrim (hyrje, ardhje) shqiptar, arrin në përfundim se “Shqipja qysh në kohët e lashta është folur pak a shumë në viset në të cilat flitet sot”, se “Në këtë gjendje të dijes sonë na imponohet përfundimi pothuaj vetëvetiu se shqipja është një formë moderne e ilirishtes”, se “është normale dhe e natyrshme që shqipja të konsiderohet si një pasardhëse moderne e gjuhës ilire”.

Ai vë në dyshim argumentet që sjellin pasuesit e hipotezës së prejardhjes trake të gjuhës shqipe, duke vënë në pikëpyetje, ndër të tjera, edhe pohimin e tyre se ilirishtja ka qënë gjuhë Kentum, ndërsa gjuha shqipe është gjuhë Satem.

Në ish Jugosllavinë e pasluftës së dytë Botërore, u shquan edhe dijetarë të tjerë në fushën e Albanologjisë, në mes të cilëve po përmendim:

Budimir Petroviç; u mor kryesisht me studimin e të folmeve të Arbëreshërve të Zarës (Dalmaçi), duke dhënë një ndihmesë si-

domos me Punimet: **Një vështrim mbi trajtat e së ardhmes në të folmet e Arbëreshëve të Zarës** (1954); **Foljet ndihmëtare në të folmen e Arbëreshëve të Zarës** (1960) etj.

Kruno Kristiç; edhe ky u mor, përveç të tjerash, me të folmet e Zarës, kryesisht me leksikun e saj, duke hartuar një Fjalor: **Fjalori i së folmes së Arbëreshëve të Zarës** (1987).

Milan Budimir; më tepër i ka kushtuar vëmendje historisë së lashtë të gjuhës shqipe, lidhjes së saj me gjuhët e yjetra ilire dhe pellazge; ka trajtuar edhe etimologjinë e disa fjalëve të shqipes.

Probleme të tilla ai shtjellon në punimet: **Vendi i shqipes në kuadrin e gjuhëve indoeuropjane** (1969); **Grekët dhe Pellazgët** (1950); **Problemi ilr...** (1953), etj.

Mbron prejardhjen ilire të shqipes.

Duje Rendiç (1916-1993), një ndër iliologët më të mëdhenj të shekullit, profesor i Arkeologjisë dhe i Filologjisë klasike në Universitetin e Zagrebit. Botoi një varg artikujsh për çështjet ilire në Revista të ndryshme të kohës, por dy veprat e tij në këtë fushë janë: **Onomastika e ilirëve në mbishkrimet latine të Dalmacisë** (Ilirika onomastika na latinskim natpisima Dalmacije) - 1948; **Ilirët dhe Bota antike** (Iliri i Antički Svijet) - 1989.

Të dyja këto vepra janë kontribut i rëndësishëm për onomastikën ilire, për etnogjenezën e shqiptarëve nga ilirët, për raportet e Ilirëve me qytetërimet greke dhe romake.

Dijetari në fjalë ka botuar edhe studime të vyera të tjera qoftë në fushën e Iliologjisë, qoftë në fushën e Balkanistikës së vjetër, ku mundohet të sqarojë vijimsinë e qytetërimit nga Parahistoria deri në Antikitet, gjenezën e popullsisë së Ballkanit, rezistencën kundër romanizimit, duke i shoqëruar me të dhëna onomastike, epigrafike dhe religjioze.

Po përmendim punimet e tij: **Çështje onomastike të territorit të dalmacisë ilir** (1951); **Kontribute të reja epigrafike për onomastikën ilire të trevës dalmate** (1953); **Studime të onomastikës ilire: Emrat e familjeve e të fiseve në onomastikën e**

ilirëve të Ballkanit (1960); Probleme të romanizimit të ilirëve me një vështrim të veçantë mbi kultet dhe mbi onomastikën (1966).

Mate Shimundiq në studimin e tij **Gjurmë onomastike të shqipes në Kroaci dhe Hercegovinë**, hulumton emra me prejardhje shqipe në ato vende.

Danilo Bajraktoroviç është marrë me studimin e anëve të ndryshme të të folmeve të Kosovës dhe ka pasur një prodhimtari të mirë në këtë drejtim: **Kontribut për studimin e theksit në të folmet e Kosovës (1962); Disa veçori të tipit dialektor të Kosovës (1964); Veçoritë e së folmes së Gilanit (1965); Zona foljore e Ibërit të Mesëm (1960); Tipi dialektor kosovar (1971).**

Milivoj Pavloviç në punimin **Humbja e Paskajores në gjuhët e Ballkanit**, cek edhe probleme të shqipes; ai ka trajtuar edhe çështje të toponomisë historike.

———— * ————

Në **Bullgari**, pas Luftës së dytë Botërore, u shquan në studimet albanologjike disa dijetarë ndër të cilët më i dalluari është shoku i Universitetit i profesor Eqrem Çabejt, shok shkolle, akademiku i njohur në të gjitha qendrat shkencore evropjane **Vladimir Gero-giev (1908-1986).**

Në veprat e tij kushtuar albanologjisë si: **Albanisch, Dakisch, Myzisch und Rumanisch** (Shqiptarët, Dakët, Myzët dhe Rumunët) - 1960; **Thrace et Illyrien** (Thrakët dhe Ilirët) - 1963; **Ilirët dhe fqinjët e tyre (1972); Probleme të fonetikës histoike të shqipes. Përfaqësimi i gutureleve indoeuropjane dhe të nazaleve sonante (1972)**, ai i mëshon idesë se shqipja nuk është zhvilluar nga evolucioni historik i ilirishtes, por është pasardhëse e Dako-Mizishtes (Autori e përdor këtë term në vend të termit trakishte), duke u shprehur kështu: Raporti i saj (i shqipes) ndaj Dako-Mizishtes është i njëjtë me atë të një gjuhe romane ndaj latinishtes. Në

shqip ka edhe një komponent ilir, por baza e saj është Dako-Mizishtja.

V.Georgievi thekson se fiset Dako-Mize shtegtuan pak nga pak drejt pjesës qëndrore dhe veriori të Ballkanit, përafërsisht në Dardani, mbase në mijëvjeçarin e dytë para erës së re. Që këtej ata shtegtuan më tej në trevat e Shqipërisë së Mesme.

Për të mbrojtur pikëpamjen e tij se Shqiptarët janë pasardhës të Dako-Mizëve dhe Shqipja bijë e Dako-Mizishtes, ai sjell këto argumente:

1. Shqiptarët nuk janë autoktonë në trevat e Shqipërisë së sotme sepse:

a) Toponomia e vjetër e Shqipërisë së sotme si **Shkodër<Scodra, Tomor<Tomarus** etj në shqip nuk janë trashëguar drejtëpërdrejtë nga goja e shqiptarëve.

Në bazë të të dhënave të fonetikës historike të shqipes këto toponime nuk kanë qënë në përdorim në gojën e shqiptarëve pa ndërprerje qysh nga koha pararomake.

b) Toponimitë latine të Shqipërisë nuk paraqesin pamjen fonetike të shqipes, por atë të latino-dalmatishtes së vjetër, e cila ndryshon qenësisht nga ajo e rumanishtes.

c) Bregdeti Adriatik qysh nga kohët e lashta nuk ka qënë banuar nga shqiptarët për çka dëshmon fakti që terminologjia e lundrimit dhe peshkimit në Shqipëri është e huazuar nga gjuhë të tjera.

d) Në gjuhën shqipe ka vetëm një numër të vogël huazimesh nga greqishtja e vjetër dhe më shumë huazime ka nga greqishtja e mëvonshme.

e) Shqiptarët nuk zihen ngoje para shekullit XI, ndonëse emra vendesh dhe personash nga gjithë treva e Shqipërisë përmenden në burime të shumta që në shekullin e IV e këtej.

2. Atdheu më i vjetër i shqiptarëve ka qënë në fqinjësi të Rumunëve dhe nga ana tjetër jo krejt i veçuar nga ndikimi grek.

Arsyet janë këto:

a) Disa ndërrime fonetike shumë karakteristike të përbashkëta

në shqip, rumanisht dhe dakisht.

b) Elementet më të vjetra latine të shqipes burojnë nga rumanishtja e vjetër, nga latinishtja ballkanike lindore dhe jo nga dalmatishtja e as nga latinishtja ballkanike perëndimore:

latinishtja e vjetër: **Cubitum**, rumanisht: **cot**, shqip: **kut**

latinishtja e vjetër: **caballum**, rumanisht: **cal**, shqip: **kal**

latinishtja e vjetër: **lucta**, rumanisht: **lupta** arumanisht: **lufta**, shqip: **luftë**.

c) Analiza e bashkëpërkimeve të fjalëve latine në shqip dhe në rumanisht dëshmon se shqipja është zhvilluar gjatë shekujve IV-VI në një trevë ku ka lindur edhe rumanishtja dhe kjo trevë është përafërsisht Dardania e Vjetër (afërsisht treva: Nish-Shkup-Sofje)

d) Në rumanisht ka rreth 70 fjalë që kanë edhe gjegjëset e tyre në shqip; janë fjalë të substratit trak në rumanisht, pra edhe gjegjëset e tyre në shqip janë të trashëguara po nga ajo gjuhë, çka, sipas tij, është një dëshmi e rëndësishme për burimin Dako-Mizisht të shqipes.

3. Disa të dhëna konkrete dëshmojnë se shqiptarët më parë kanë ardhur në trevën e Dardanisë së dikurshme:

a) Emri i fisit **Dardanoi** dhe i trevës së tyre **Dardania** mund të shpjegohen nga një fjalë që ruhet në shqip: **Dardhë**.

b) Forma e sotme **Nish** dhe **Naissus**-it të vjetër të Dardanisë dëshmon për ndërmjetësinë e shqipes.

4. Disa fakte të rëndësishme provojnë qart se shqipja është vazhduesja e drejtëpërdrejtë e Dako-Mizishtes, në mes të cilave përmendim:

a) Sistemi fonematik i shqipes përfaqëson zhvillimin e mëtejshëm të sistemit fonematik të Dako-Mizishtes.

b) Megjithëse lënda gjuhësore e Dako-Mizishtes është mjaft e paktë, prapëseprapë ka disa bashkëpërkime shumë të rëndësishme si: **amalusta** - i ëmbël, **Zermi-zerga** (banjo e ngrohtë) - **zjerm**, **zjarr**, **karpates** - **karpë**, **mantia-man**, **mal** (breg lumi) - **mal**, **skiare** - **shqerr**, **çjerr** - **shqeyj**, **uendensis**, **vindensis-vend**.

c) Shtrirja gjeografike e toponimeve tipike Dako-Mize me dava (Buridava) jep një pasqyrë të depërtimit të Dako-Mizishtes dhe të Dako-Mizëve, d.m.th. të stërgjyshërve të shqiptarëve në Gadishullin e Ballkanit.

d) Fjalori i shqipes nga pikëpamja sasiore ka më të shumtat pika takimi me balto-sllavishten, çka tregon se shqipja është bijë e Dako-Mizishtes, e cila ka qenë fqinjë e pandërmjetme e balto-sllavishtes.

Përveç këtyre argumenteve ai sjellë edhe prova të tjera për të vërtetuar tezën e tij.

Në Bullagri (Sofje) janë marrë me studimin e gjuhës shqipe dhe të lidhjeve të saj me gjuhët e tjera edhe gjuhëtarët e njohur: **D.Deçev, J.Duridanov, B.Sokolova, R.Stojkov, P.Asenova, K.Kostov, U.Dukova.**

Akademiku i njohur **D.Deçev**, në veprat e tij kushtuar gjuhës trake, specialist në këtë fushë, trajton probleme lidhur me prejardhjen e shqipes. Në studimin **Shqipja si vazhduese e trakishtes** (1952), dijetari i përmendur përpiket të argumentojë me të gjitha mundësitë tezën e tij, se gjuha shqipe është një bijë e trakishtes dhe populli shqiptar pasues i trakëve.

Studiuesja bullgare **Bojka Sokolova** ka botuar një vepër të tërë me titull **Fshati Mandricë: Studim gjuhësor, folklorik, etnografik dhe historik** (Sofje, 1968).

Në këtë vepër jepet një pamje e plotë e tërë jetës materiale e kulturore të banorëve të fshatit Mandricë, një fshat shumë i madh me origjinë shqiptare; aty shtjellohet tërë sistemi gjuhësor, duke vënë në pah mirë veçoritë fonetike, morfologjike, sintaksore dhe leksikore me shumë interes shkencor, të zonës së marrë në shqyrtim.

Studiuesi **Rusi Stojkov** ka shkruar më tepër për historinë e gjuhës shqipe sidomos në punimet: **Një burim i panjohur për onomastikën shqiptare i mesit të shekullit XV** (1969); **Mbi shfaqjen e shqiptarëve në Ballkan dhe mbi prejardhjen e emrit kombëtar "Shqiptar"** (1969) etj.

Gjuhëtarja e njohur **Petja Asenova**, prodhimtare në fushën e gjuhësisë, më tepër merret me bashkëmarrëdhëniet gjuhësore ballkanike për të cilat ka hartuar edhe një vepër të tërë.

Janë të njohura edhe studimet e saj: **Një ndërtim sintaksor i intensifikimit në shqip dhe greqisht** (1984); **Nocioni i interferencës dhe lidhja gjuhësore ballkanike** (1977); **Rreth funksioneve sintaktike të Nyjës në gjuhët ballkanike** (1982); **Habitorja e shqipes dhe mënyra e Ritregimit e bullgarishtes** (1996) etj.

Joan Duridanov, në studimet e tij kushtuar albanologjisë, më tepër prirret në historinë e gjuhës shqipe; ai ka botuar punimet me interes: **Etimologji ballkanike** (1968); **Emrash ilirë lumenjsh në Serbi** (1963); **Mbi përcaktimin e huazimeve të vjetra sllave në shqip** etj.

Edhe **Kiril Kostov** ka interesa për shqipen dhe ka botuar punime për këtë fushë si: **Rreth tipologjisë së foljeve faktitive dhe inkoaktive me parashtesat n, s në Fjalorin e Kristoforidhit** (1984).

Studiuesja **U.Dukova** në vitet tetëdhjetë ka shkruar për bashkëmarrëdhëniet dhe lidhjet gjuhësore të shqipes dhe bullgarishtes.

Në Bullgari ka kontribuar në studimet albanologjike edhe studiuesi me origjinë shqiptar **Th.Kacori** si në punimin: **Kontribut për studimin e prejardhjes së emrave** (1988); ai, bashkautor me P.Asenova, R.Stojkov, ka botuar studimin: **Emra vendbanimesh, personash dhe familjesh në Peloponezin veriperëndimor në mesin e shekullit XV** (1977), ndërsa bashkë me U.Dukova: **Disa fjalë me prejardhje shqipe në gjuhën bullgare** (1979), një punim me interes për të parë rolin dhënës të shqipes në bullgarishten.

Th.Kacorri në vitin 1995 ka botuar artikullin shkencor **Shpjegime të reja përmbi etnonimin Shqiptar, Shqipëri** (toskërisht); **Shqypitar, Shqypni** (gegërisht).

Studiuesja e re bullgare **Rusana Hristova** ka publikuar punimin **Mbi studimin krahasues të njësive frazeologjike në gjuhën shqipe dhe bullgare në pikëpamje stilistike** - 1995, ndërsa **P. Cankova** po punon për një **Fjalor** bullgarisht - shqip.

———— * ————

Në **Rumani** interesimi i studiuesve për shqipen filloi që kur u vunë re Lidhjet etno-gjuhësore në mes të dy popujve.

Që në shekullin e kaluar (XIX) dijetari i njohur rumun **B.P.Hasdeu** (1836-1907) është marrë dhe ka dhënë mendime për shqipen; ai hartoi në vitin 1892 një **Gramatikë** të gjuhës shqipe, e cila gjendet Dorëshkrim në Bibliotekën e Akademisë së Shkencave të Rumanisë.

Të gjithë studiuesit e mëvonshëm rumunë, të gjuhës, të historisë, të folklorit, të etnografisë, të arkeologjisë janë marrë edhe me problemet e Albanologjisë, pasi marrëdhëniet e shqipes me rumanishten, siç u vunë re që në shekullin e XIX, janë me të vërtetë të ngushta.

Që në shekullin e XVIII, në vitin 1774, H.Tunman shkruante: "Asnjë popull tjetër i pjesës së botës në të cilën jetojmë nuk është aq i panjohur për ne evropjanët e Perëndimit për sa i përket prejardhjes, historisë dhe gjuhës se sa Shqiptarët dhe Vllehët. E, megjithatë, ata janë popujt kryesorë, popuj të lashtë e të rëndësishëm që çdo historian do të dëshironte t'i njihte; historia e tyre do të plotësonte zbrazëti të mëdha në historinë e lashtë dhe të re të Evropës".

Faktikisht Rumania i ka dhënë një rëndësi të madhe këtij problemi, sepse këtu janë ndërthurur edhe çështje nacionale e, si rrethim, ka nxjerrë gjuhëtarë të njohur si: A.Graur, A.Roseti, J.Jordan, A.Mihaesku etj.

Tri Qendra të rëndësishme kërkimore shkencore për këto probleme janë në Rumani: Universiteti i Bukureshtit, i Kluzhit dhe Jas-hit.

Këto tri Qendra, me një traditë të pasur, kanë mbajtur gjithnjë

lidhje të pandërprera me Qendrat shkencore evropjane.

Problemet kryesore të dijetarëve rumunë, që janë marrë dhe merren me shqipen, janë: Djepi i hershëm i shqiptarëve dhe origjina e gjuhës shqipe; Elementët e përbashkëta në shqip dhe në rumanisht; Trajtimi i elementeve latine në shqip dhe në rumanisht.

Pjesa më e madhe e studiuesve rumunë kanë mbështetur tezën se Djepi i hershëm i shqiptarëve, që është i lidhur me atë të rumunëve, ka qënë jo ai ku është sot, por më në Lindje, në afërsi të Rumunëve, në trekëndëshin e njohur Nish-Sofje-Shkup.

Arkeologu **V.Pârvan** (1910) dhe gjuhëtari **S.Puscariu** (1877-1948) i paraqesin Shqiptarët të shpërngulur midis shekujve III dhe VI të erës së re nga Karpatët e, nëpër Transilvani, ranë në drejtim të Jugperëndimit e pastaj u shtynë në krahinat në Jug të Danubit si barinjë endacak.

Historiani i njohur rumun **N. Jorga** (1871-1940) që zbuloi në vitin 1915 në një bibliotekë të Francës dokumentin e parë të shkruar shqip (Formula e Pagëzimit - 1462), mendon se Shqiptarët janë pasardhës të Ilirëve, të cilët patën marrë gjuhën trake.

Aleksandër Filipide, profesor në Universitetin e Jashit që në vitet njëzetë (Originea Romnilor-1928) ka shprehur mendimin se Të parët e shqiptarëve kanë qënë më shumë Panonas, banorë të Panonisë (Hungaria e sotme perëndimore), të cilët, në kohën e shëtejtimit të popujve, kanë zbritur në viset e sotme, gjysmë të romanizuar. Ai shprehet se Vendbanimi i hershëm i shqiptarëve është “diku ne veri”, në malësinë e anëve të Bosnjës, midis lumenjve Vrbas dhe Drina, bile duke i çuar deri në Panoni.

Për të vërtetuar tezën e tij ai parashton këto argumente:

a) Të parët e shqiptarëve mundën t’i shpëtonin romanizimit të plotë vetëm në një zonë pak të prekur nga ky proces.

b) Nuk mund të jenë në truallin e tyre të sotëm që në antikitet, se në antikitet ky truall ka qënë i latinizuar.

c) Mungesa e terminologjisë detare dhe ndikimi i dobët i greqishtes së vjetër dëshmojnë kundër autoktonisë së shqiptarëve.

Pra A.Filipide e mendon zbritjen e shqiptarëve nga Veriu i Ballkanit, çka është kundërshtuar nga vetë dijetarët rumunë.

H.Mihâesku, në studimin **Elementët latine të gjuhës shqipe** (Les elements de la langue albanaise, botuar në Revistën Revue des études sud-est europeennes, tom e IV, nr. 1-2, 1966), ka kundërshtuar tezën e prejardhjes së shqiptarëve nga Veriu dhe nga Lindja e Gadishullit të Ballkanit dhe ka mbrojtur më shumë argumente tezën e prejardhjes ilire dhe të autoktonisë së shqiptarëve në trojet e tyre të sotme.

Dijetari i përmendur elementët latine të shqipes i vështroi në kontekstin e gjërë të ndikimit latin në të gjithë hapësirën e Evropës Juglindore dhe në të gjithë shtrirjen e tyre kohore.

Mihaesku vuri në dukje se elementi latin ka lidhje me latinitetin perëndimor, me latinitetin bregdetar (ose dalmat) dhe me atë kontinental (ose rumun).

Nga shqyrtimi i elementit latin në shqip nxori këto statistika: Sot në shqipen jetojmë 602 fjalë me burim latin, të cilat mund të ndahen në katër kategori:

a) 298 fjalë me përhapje të gjërë që ruhen në shqip, në rumanisht dhe në gjuhët perëndimore.

b) 166 fjalë me burim latin që janë të përbashkëta për shqipen dhe gjuhët romane perëndimore.

c) 41 fjalë latine që ruhen vetëm në gjuhën shqipe dhe rumune.

d) 97 fjalë latine që ruhen vetëm në gjuhën shqipe, ku përmend: **bujk** nga latinishtja: **bubulcus**, **tërfurk** nga latinishtja **trifurcus**.

Ai thekson edhe 151 fjalë prej burimit latin që ndeshen në gjuhën shqipe por nuk gjenden në rumanisht si: **mik**<**amicus**, **kështjellë**<**castellum**, **qind**<**centum**, **mjek**<**medicus**, **mulli**<**molinum**.

Dhe konkludon: Elementet latinë të shqipes na çojnë në një fazë më të vjetër të gjuhës latine, karakteristike sidomos për gjuhën letrare të fundit të Republikës (Romake), se Fjalori i shqipes prej burimit latin dhe toponimia përmbajnë disa elemente që dësh-

mojnë në të mirë të tezës se ndikimi i latinishtes mbi stërgjyshërit e shqiptarëve është zhvilluar përafërsisht në një zonë ku flitet shqipja edhe sot.

Ai vijon se Elementet latine na lejojnë të vërejmë se **Të parët e shqiptarëve** kanë pasur lidhje si me brendësinë e Kontinentit, ashtu edhe me detin Adriatik dhe me Perëndimin.

Elementet latine të shqipes kanë, relativisht, pak ngjashmëri me elementet latine të rumanishtes, çka tregon se Të parët e shqiptarëve kanë qënë fqinjë me Të parët e rumunëve, por nuk kanë jetuar në një simbiozë të ngushtë, siç mendonin shumë studiues. Fjalët me burim latin që kanë mbijetuar vetëm në shqip dhe në rumanisht përbëjnë 7%.

Autori pohon se elementi latin i shqipes dëshmon për karakterin autokton të shqiptarëve në trojet e tyre.

Për të ekzistojnë prova që dëshmojnë se Të Parët e shqiptarëve kanë banuar edhe në Dardani (Kosova e sotme) dhe në Maqedoni, ku kanë qënë fqinjë të latifonëve të Mezisë së Sipërme (Bullgari).

Mendimet e Mihaeskut kanë gjetur mbështetje nga E.Çabej, nga Harman (Studiues gjerman) dhe nga Pogire (studiues rumun), i cili ka shkruar shumë për këto probleme.

Mendime të vyera ka shprehur edhe gjuhëtari i mirënjohur rumun **A.Roseti** në veprën e tij: **Historia e gjuhës rumune**(Istoria limbii Romine - 1964), në gjashtë vëllime ku i kushton disa faqe edhe gjuhës shqipe.

Ai thekson se shqipja është me prejardhje ilire, por në formimin e saj ka edhe një komponent trak; supozon se shqipja është gjuhë Kentum përse u përket elementeve të trashëguara nga ilirishtja dhe Satem nga elementet që shpjegohen me trakishten.

Autori përfundon se shqipja dhe rumanishtja si gjuhë të vjetra të Ballkanit zënë një vend të ndërmjetëm midis grupit të gjuhëve Kentum dhe Satem.

Për të argumentuar tezën e tij Roseti sjell një varg fjalësh që shqipja i ka trashëguar nga ilirishtja: **bar, i bardh, dele, treg, ujk,**

dash, si edhe disa fjalë të trashëguara nga trakishtja: burrë, man, i ëmbël, etj.

Ai është marrë edhe me tiparet e përbashkëta ballkanike të shqipes me rumanishten, siç janë: **nyja, zhdukja e paskajores me me, refleksat e grupit ct të latinishtes** etj.

Që në vitin 1942, në lidhje me huazimet nga greqishtja e vjetër në shqip dhe në rumanisht ai shkruan: “Ndikimi i greqishtes së vjetër në secilën prej këtyre gjuhëve është ushtruar në mënyrë të ndryshme”.

Ky pohim është mbështetje e tezës se Djepi i formimit të shqiptarëve dhe i gjuhës shqipe është i ndryshëm nga ai i rumunëve dhe i rumanishtes.

Siç e kemi parë, problem ka qënë dhe mbetet edhe shpjegimi i origjinës së fjalëve të përbashkëta autoktone të shqipes dhe të rumanishtes. Është fjala për leksema të tilla si: **avull - abur; bullë, bullar - balaur** (kuçedër); **gropë - groapa; bashkë - basca; buzë - buza** etj.

Roseti numëron rreth 100 (njëqind) si të tilla që, sipas tij, nuk shpjegohen as me latinishten, as me greqishten, as me sllavishten, as me turqishten, as me hungarishten.

Jon Rusu numëron rreth 70 të tilla, ndërsa **G.Brenkushi** i llogarit deri 90.

Në vendin përkatës ne folëm për shpjegimin e tyre nga E.Çabej.

Shumica e gjuhëtarëve rumunë, me pak përjashtime, janë të prirur t’i shpjegojnë fjalët e përbashkëta shqiptaro-rumune me burim nga substrati (nënshtresa) trak, dak, trako-dak ose nga substrati trako-ilir.

Pikërisht mbi këtë bazë ata përpiqen të argumentojnë origjinën trake të shqipes ose, në mënyrë të moderuar, origjinën ilire të saj por me një komponent trak në formimin e saj. Po mbi këtë bazë ata e shpjegojnë edhe pozitën e ndërmjetme të shqipes midis grupit të gjuhëve Satem dhe Kentum.

Me tezën e substratit ata kanë shpjeguar edhe tipare të tjera të

përbashkëta midis dy gjuhëve (shqip, rumanisht), në sistemin fonetik dhe morfologjik.

J.Rusu në veprat e tij: **Gjuha trako-dake** (Limba trako-dacilor-Bukuresht 1967); **Ilirët, historia, gjuha dhe onomastika**, botuar në Bukuresht në vitin 1969, mbron tezën se ilirishtja ka qënë gjuhë Satem (dhe jo Kentum), duke i mohuar lidhjet e saj me shqipen. Ai thotë se Ilirët u romanizuan herët dhe në mënyrë intensive, ndërsa trakasit nuk u romanizuan tërësisht dhe në të gjitha trevat e tyre.

Sipas tij një pjesë e trakasve i kanë shpëtuar romanizimit dhe sllavizimit diku në një trevë ku takoheshin ilirishtja me trakishten dhe ku kryqëzoheshin zona e gjuhës latine me atë të greqishtes. E kjo trevë ka qënë diku në Peoni (Maqedoni e sotme) dhe Dardani.

Më pas edhe ka dyshuar në hipotezën e tij kur shkruan: Duket se nga fjalori dhe onomastika e shqiptarëve asgjë nuk mund të identifikohet në mbeturinat fragmentare të ilirëve ose të trako-dakasve. Pra tash për tash është iluzore të thuash që fondi i vjetër leksikor indoeuropjan dhe struktura gramatikore e gjuhës shqipe janë më fort prej burimit trak se sa ilir.

G.Brenkush (Brankus) në studimin e tij **Albano-romanica**, botuar në vitet shtatëdhjetë, thotë se nuk do të merret me problem-in shumë të rrahur të burimit të shqipes pasi “lënda gjuhësore e lashtësisë ballkanike (ilire dhe trake) është aq e varfër sa që lejon të parashtrohet çdo hipotezë”.

Ai vë në dukje se gjuha shqipe përmban fonetizma Satem dhe në të njëjtën kohë edhe Kentum e shton më tutje se “elementët që kjo gjuhë i ka të përbashkëta me rumanishten shpjegohen në lidhje të drejtëpërdrejtë me gjegjëset rumune, d.m.th, i referohen së njëjtës bazë indoeuropjane.

Duke qënë se në rumanishten këto elemente, në origjinë, janë rezultat i ndikimit të gjuhës së trako-dakëve mbi latinishten del, si rrjedhim, që, në mënyrë logjike, duhet të pranojmë ekzistencën e një komponenteje trake në strukturën leksikore origjinare të shqipes”.

Kontribute në studimin e gjuhës shqipe kanë dhënë edhe dijetarë të tjerë rumunë, në mes të cilëve po përmendim: **T.Kapidari**, i cili shqiptarët i bie të ardhur prej viseve veriore të ballkanit; **R.Vulpe** që në studimin e tij **Konsiderata rreth origjinës ilire të shqipes** (1972), mbron origjinën ilire të popullit shqiptar dhe gjuhës së tij; **Al.Graur** (Lidhjet ndërmjet gjuhës rumune dhe shqipe-1957); **A.Vraciu** (Substrati ballkanik në shqip - 1972); **C.Poghire** (Lidhjet ndërmjet gjuhës rumune dhe gjuhës shqipe - 1957); **M.Radulesku** (Ilirishtja, Trakishtja, Dako-Mizishtja); Substrati i rumanishtes dhe i shqipes - 1984.

Mund të përfundojmë se studiuesit rumunë kanë dhënë ndihmesa të mëdha diku me objektivitet e diku pa objektivitet, në ndriçimin e çështjeve gjuhësore shqiptaro-rumune dhe të prejardhjes së popullit shqiptar e të gjuhës së tij.

———— * ————

Në Greqi (Athinë) është shquar në fushën e Albanologjisë **Titos P.Johalas**, veçanërisht në hulumtimet e Arbëreshëve të Greqisë. Ky dijetar ka publikuar studimet e njohura dhe me interes shkencor: **Studimet albanologjike në Greqi** (1972); **Tekstet greko-shqiptare, të botuara e të pabotuara; Konsiderata mbi onomastikën dhe toponomastikën shqiptare të Greqisë** (1977); **Toponime dhe tema emrash familjesh të bashkësisë italo-shqiptare në Greqi; Mbi emigrimet e shqiptarëve në Greqi; Fjalori greqisht-shqip i M.Boçarit** (1980).

Edhe arvanitasi **Aristidh Kola** ka dhënë një ndihmesë të madhe në Albanologji me veprën **Arvanitët dhe prejardhja e shqiptarëve** (Vështirë historik, folklorik, politik dhe gjuhësor). botuar në Athinë në vitin 1983.

———— * ————

Në **Poloni** është dalluar si albanolog i njohur **W.Cimohovski** (1912-1982), i cili ka krijuar një Shkollë të tërë albanologjike me disa studiues të njohur që veprojnë edhe sot si: **W.Pajakowski, J.Mindak, I.Sawicka, L.Bednarezuk, Z.Wasik**, etj.

W.Cimohovski ishte përgjegjës i Katedrës së gjuhësisë së përgjithshme në Universitetin e Poznanit e më vonë edhe në atë të Gdanskut.

Në vitin 1937 erdhi në Shqipëri dhe qëndroi një vit në Shkodër; aty thirri një subjekt nga një zonë shumë e thellë e Dukagjinit, nga Dushmani, prej të cilit mblodhi një material dialektor të bollshëm e, pastaj, mbi bazën e tij hartoi studimin: **Le Dialecte de Dushmani** (Dialekti i Dushmanit), me të cilin mori gradën e Doktorit të Shkencave dhe që e botoi frëngjisht në vitin 1951.

Studimi në fjalë dallohet për rreptësi shkencore, duke u përshkruar mirë sistemi fonetik, morfologjik e sintaksor i së folmes së marrë në shqyrtim.

Në Shqipëri erdhi edhe dy herë të tjera (1958, 1972), i ftuar nga Universiteti i Tiranës.

Përveç veprës në dialektologji, ai ka bërë studime me vlerë për leksikologjinë, fonetikën historike dhe për gramatikën historike të shqipes.

Etimologjive të mjaftë fjalëve shqipe u ka kushtuar disa artikuj si: **Dy etimologji të shqipes** (1949); **Etimologji shqipe** (1951), **Të ndryshme etimologjike** (1963).

Ai ka treguar burimin vendas të më se 30 fjalëve.

W.Cimohovski u mor edhe me problemin e Sandhit në gjuhën shqipe në artikullin: **Recherches sur l'histoire du sandhi dans la langue albanaise** - 1950 (Kërkime për historinë e Sandhit në gjuhën shqipe).

Ai i ka kushtuar vëmëndje edhe çështjeve të **Toponomisë** së lashtë shqipe sidomos në artikullin **Kërkime për toponomastikën e Shqipërisë** (Des recherches sur la toponomastique de l'Albanie - 1960), ku thekson vijimsinë e tyre në gojën e shqiptarëve.

Në punimin **Prejardhja e gjuhës shqipe**, mbajtur në Universitetin e Tiranës në vitin 1958 dhe botuar po atë vit, mbështeti tezën ilire duke përjashtuar tezën trake. Ai arrin në përfundimin: **Gjuha shqipe është dialekt ilir që i ka shpëtuar Romanizimit**

në një vend të izoluar, sigurisht ndër male, ku ndikimi romak ka qenë vetëm i sipërfaqshëm.

Këtë çështje e rimerr prapë në vitin 1972 në Kuvendin e parë të Studimeve Ilire në Ligjëratën e tij **Pozicioni gjuhësor i ilirishtes në rrethin e gjuhëve indoeuropjane**, ku arrin në konkluzionin se Ilirishtja e Ballkanit formon një grup të mëvetësishëm, se ajo nuk ka qënë as gjuhë Satem, as gjuhë Kentum, se edhe shqipja duhet përjashtuar nga ky grupim tradicional, sepse ajo shfaq tipare të ngjashme me historinë e sistemit gjuhësor të saj, me ilirishten.

W.Cimohovski ka shkruar edhe artikuj të tjerë për gjuhën shqipe, ka botuar Recensione në Organet shkencore për gjuhësinë dhe ka plotësuar Zëra në Enciklopeditë dhe në Botime të tjera.

Ai mbetet albanolog i madh dhe dashamirës i popullit shqiptar.

Në Poloni është shquar si studiuese e njohur për gjuhën shqipe **Irena Sawicka** e cila ka bërë disa botime si: **Veçoritë tipologjike fonetike të arbërishtes së Italisë** (1989); **Edhe një herë për grupet e bashtingëlloreve të tipit nazal + okluziv në gjuhën shqipe** (1984); **Liga ballkanike fonetike** (1996).

Në Poloni sot po aktivizohen edhe studies të tjerë që merren me studime shqiptare si **J.Mindak** me punimin **Për zhvillimin e morfosintaksës së shqipes** (1995).

———— * ————

Në **Çeki** (Pragë), ku ishte shquar në shekullin e XIX J.U.Jarnik, pas Luftës së dytë Botërore, u aktivizuan në studimet albanologjike disa studiues, në mes të cilëve po përmendim:

VI.Buben (1888-1956), romanist i shquar çek, profesor i filologjisë romane dhe shef i Katedrës së romanistikës në Fakultetin e Filologjisë në Universitetin e Pragës.

Më tepër u mor me gjuhën frenge, por edhe me albanologji. Botoi studimin **Mbi rasën thirrrore në gjuhën shqipe** (1946) dhe **Mbi fleksionin e pashirmave dhe të pjesëzave imperative në shqip** (1955).

Buben shkroi edhe një artikull **Mbi problemin e gjuhës së**

shkruar shqipe (1955) dhe punimin **Substantivët që bëhen parafjalë në gjuhën shqipe**.

Kudo duket sensi i tij i hollë gjuhësor.

P.Novak, një gjuhëtar i njohur çek, ka shkruar për çështje të ndryshme të gjuhës shqipe, në mes të cilave vecojmë: **Një shënim mbi formimin e shumësit në shqip** (1956) dhe **Mbi dyfishimin e kundrinës në gjuhën shqipe** (1958).

V.Polak, studiues i shquar dhe me prodhim të shumtë në fushën e albanologjisë.

Këtu po vëmë në dukje disa studime më kryesore të tij, si: **Pozicioni gjuhësor i gjuhës shqipe** (1957); **Disa mendime lidhur me raportet leksikore shqiptaro - rumune** (1958); **Sistemi vokalik i shqipes** (1961); **Konteksti ballkanik dhe kërkime etimologjike në gjuhën shqipe** (1962); **Origjina e ndryshimeve dialektore të shqipes** (1963); **Elemente kaukaziane në shqip** (1967); **Shqipja dhe sllavishtja** (1957).

Në studimet e tij, në këto që u përmenden, ashtu edhe në disa të tjera, ai trajton çështje edhe pa objektivitet shkencor. Kështu në punimin **Sistemi vokalik i shqipes** (Systems vocalique de l'Albania), mendon se shqipja nuk njeh gjatësi zanoresh si tipar dallues, se gjatësia është një dukuri sekondare, se shqipja bën pjesë në një domen politonik të mbyllur ku bën pjesë edhe serbokroatishtja dhe sllovenishtja, se dallimi i dy dialekteve të shqipes, për shkak të zanoreve të gjata që ekzistojnë në Gegëri, gjoja, është rezultat i ndikimit të serbishtes në Shqipërinë e Veriut, se, gjoja, nuk ka kundërvënie kuantitative (sasiore), por kualitative (cilësore). Pra në punimin e tij të lartpërmendur si edhe në studimin: **Albanici a slovane** (Shqiptarët dhe Sllavët), shpreh idenë se ndarja dialektore e shqipes në dy dialekte kryesore është rezultat i presionit të dyfishtë sllav; i serbokroatishtes në Veri dhe i bullgarishtes në Jug dhe se në shqiptimin e zanoreve të gjata e të mesme në Gegëri ka ndryshime kualitative në intonacion, se kjo vjen si pasojë e ndikimit të serbishtes në Veri të Shqipërisë, me që theksi tonik është veçori

për dialektet serbokroate.

Është provuar tashmë se gegërishtja nuk karakterizohet nga theksi melodik që është i pranishëm në serbisht. Pikërisht në serbisht është kryesor **melodia**, ndërsa në gegërishten vlerë kuptim-dalluese ka vetëm **gjatësia**, prandaj është i padrejtë edhe mendimi i gjuhëtarit serb P.Iviç kur krahason prosodinë e Gegërishtes me atë të Serbishtes.

Është pohuar me të drejtë nga gjuhëtarë të njohur shqiptarë se në të gjitha të folmet e Veriut ekzistojnë dy shkallë gjatësie që perceptohen qart nga ai që dëgjon dhe nga ai që flet dhe se kundërvënia kryesore me vlerë kuptim-dalluese e zanoreve të gjata dhe të shkurtra, është kundërvënie sipas gjatësisë fizike, se shqipja e Veriut nuk i përdor dallimet melodike për të karakterizuar një fjalë në raport me një fjalë tjetër siç ndodh, p.sh. në serbokroatisht, lituanisht ose edhe në gjuhët skandinave si: suedisht, norvegjisht.

Shtojmë se gjatësinë në gjuhën shqipe nuk e ka vetëm Gegërishtjas, por edhe të folmet e Toskërishtes Jugore, duke përfshirë edhe Diasporën.

Për albanologjinë ka shkruar artikuj të ndryshëm edhe studiuesi **B.Havranek**.

— * —

Në **Hungari** merret me problemet e gjuhës shqipe dhe të historisë së saj dijetari i shquar **Istvan Shutz**. Ky studiues me emër ka botuar punime me vlerë si: **Disa çështje metodike të studimit të fjalëve të përbashkëta të shqipes dhe të rumanishtes**, por fusha e tij më e preferuar është **Dyndja e Komanëve** në trevat shqiptare për të cilët ka shkruar dhe publikuar disa studime si: **Gjurmë gjuhësh turke mesjetare në shqipen e sotme** (1985); **Onomastika e Kosovës - dëshmitare e dyndjeve komane** (1987)etj.

I. Shutz thotë se Komanët, një popull me prejardhje turanike (turke) nga stepat e mëdha të Rusisë, një popull endacak, blegtor, pa vendbanim të përhershëm, por kalorës të patrembur, u dukën

për herë të parë në Evropën Lindore në vitin 1077.

Perandorët bizantinë u ndeshën me ta; më 1094 perandori Aleks Komneni i mundi, duke vrarë 7000 nga ata e duke zënë rob 3000, me gra e fëmijë sepse komanët udhëtonin me gjithë familje.

Perandorët bizantinë i vendosnin në vise të caktuara.

Në vitin 1159 u dukën edhe një herë, por këtë radhë ata luftonin edhe kundër fqinjëve lindorë-Rusëve.

Më 1186 Komanët u dukën përsëri në Gadishullin e Ballkanit; këtë herë ata erdhën si besëlidhës të bullgarëve pasi këta të fundit qenë revoltuar kundër pushtimit bizantin.

Në fushatat e tyre plaçkitëse merrnin pjesë deri 20000 burra komanë.

Më 1201 Komanët sulmuan prapë Trakinë (pjesën perëndimore të Ballkanit), duke arritur deri në muret e Konstandinopojës, çka e përsëritën prapë në vitin 1205, duke arritur deri afër Adrianopojës.

Në vitin 1223 "Shtetin" e Komanëve "terra Cumanorum" (Tokën e Komanëve) e shkatërruan hordhitë mongole; e përsëritën sulmin mongolët edhe një herë fill pas dhe i shkatërruan Komanët përfundimisht në vitin 1239.

Në vitin 1241 Komanët u shpërndan nëpër Hungari e në tërë Ballkanin, pasi "sunduan", si të thuash, 150 vjet.

Përveç kronistëve që na japin të dhëna, gjurmë të tyre - pohon Shutz - gjejmë edhe në Toponimi në tërë territorin shqiptar, bile edhe në Ciklin e Kreshnikëve ku thuhet: **Na po luftojmë me Gugument e Zi** (d.m.th. Komanët).

Po vëmë në dukje se edhe sot e gjithë ditën në Malësinë e Tropojës dëgjohet sharja: **Ik more Guman!**, çka nënkupton Komanët.

Para se të hyjmë në toponiminë me prejardhje komane, po theksojmë se disa fjalë në gjuhët e ballkanit kanë mbetur nga gjuha komane si: **Ujem** (mielli, ose drithi që i jepet mullisit), rumanisht **Oium** serbisht: **Ujam**, bullgarisht: **Yjem**, ka origjinë komane.

Komanët ndërtuan mullinj për të marrë të ardhura nga popullsia vendase, me që nuk ishin bujq.

Fjala **Dushman**, “armik” ka prejardhje komane dhe ka zanafillë para pushtimit turk. Edhe fjala **Çoban**, me përhapje shumë të gjërë, edhe jashtë kufijve të ballkanit, ka prejardhje nga gjuha komane.

Të gjitha emërtimet e vendeve me emrin **Koman** (Koman, Komanovë, Kuman, Kumanovë) janë gjurmë të Komanëve mesjetarë, të cilët u vendosën në vende të caktuara, ku u tretën më vonë me popullsinë vendase. Plotë fshatra dhe vende të tjera me bazë këtë emër ka në Kosovë dhe në Shqipëri deri në Kuman të Fierit.

Para pushtimit turk, Treva Tropojë - Junik - Gjakovë quhej **Altin-ilí**, ku Altin në gjuhën komane, e cila ka ngjashmëri me gjuhën turke pasi kanë një prejardhje, do të thotë **pasuri, bollëk, flori**, ndërsa **Ilí** do të thotë **tokë, nahije**. Këtë emërtim **Altin-ilí** turqit e gjetën kur erdhën si pushtues sepse del që në vitin 1330.

Emërtimi **Shishman** (fshat në rrethinat e Gjakovës), me prejardhje komane, do të thotë **Undyrë, lyrë**; ai tregon, sikurse Altinili, për pasuritë, për kullotat e bollshme të atyre anëve që i mahnitën komanët.

Zona **Shipshan** në Tropojë ka prejardhje nga gjuha komane, por kuptimi i tij akoma nuk është sqaruar.

Emërtimi **Tartar** është emri i një fisi monogol, të cilët u dukën në Ballkan rreth viteve 1240.

* ———

Në **Belgjikë** (në Louvain-Luven) dha një pamje të plotë të studimeve albanogjike në atë vend. **G.Zhyskua** (Guy Jousquois) me punimin: **Studimet albanologjike në Belgjikë shekuj pas shekujsh**, botuar në vitin 1977 te Përmbledhja e Akteve të Insbrukut (30 vjetori i vdekjes së N.Joklit).

Autori në fjalë ka bërë ehe botime të tjera si: **Fati i grykoreve të palatalizuara indoeuropjane në gjuhën shqipe** (1965); **La-**

bërgimi i ndërtimeve leksikore dhe etimologjia e shqipes (1972)
etj.

———— * ————

Në **Danimarkë**, me një farë traditë në studimet albanologjike, vepron sot aktivisht dhe me një prodhimtari të mirë në këtë drejtim **Gunar Svane**, një kërkues i apasionuar pas shqipes, i cili ka botuar punimet e mirëpritura: **Lëvizjet në fushën e sistemit foljor të shqipes (1965)**; **Formimi i gjuhës letrare siç paraqitet në “Pasqyrën e të Rrëfyemit” të Budit; Izoglosa sllavo-shqiptare (1965)**; **Huazimet leksikore sllave në gjuhën shqipe - 1992 (Slavische Lehnwörter im Albanischen)**.

———— * ————

Në **Francë**, pas Luftës së dytë Botërore, u aktivizua në studimin e gjuhës shqipe **Henri Buase (H.Boissin: 1910-1975)**, me punimet: **Format nominale të caktuara dhe të pacaktuara në shqip (Formes nominales determinees et indeterminees en Albanais - 1950)**; **Një fenomen ballkanik kompozitash të parregullta (1957)**; **Sprovë e përkohshme për një klasifikim të emrave të përveçëm (Essai provisoire de classification des noms propres Albanair)**, mbajtur në Konferencën e parë të Studimeve Albanologjike, në nëntor të vitit 1962 në Tiranë.

Në këtë punim ai bën një klasifikim të emrave të familjeve shqiptare, duke dalluar:

- a) Emra familjesh të prejardhur nga emra personash.
- b) Emra familjesh të prejardhur nga toponimia (nga emrat e vendeve).
- c) Emra familjesh të prejardhur nga emërtime profesionale, funksionesh a afiqesh.
- d) Emra familjesh nga “llagapët”.
- c) Emra familjesh të pashpjegueshëm.

Një studim tjetër i tij është **Ekspresiviteti në shqip (L'expressivité en Albanais)**, por vepra më e madhe dhe më e mirë e tij mbetet **Gramatika e shqipes moderne (Grammaire de**

l'Albanais Moderne), botuar në Paris, në vitin 1975.

Robert d'Anzheli (R.d'Angely: 1893-1966), është autor i një vepre interesante: **Enigma....e burimeve të racës dhe të gjuhës së shqiptarëve... e zgjidhur**, nga e cila kanë dalë pesë vëllime (1990-1991). E bija **Solanzh d'Anzheli** (Solange d'Angely) ka botuar në Paris në vitin 1998, veprën e tij **Grammaire Albanaise Comparée** (Gramatika e krahasuar e shqipes).

Studiuesi tjetër francez **Kristian Gyt** (Cristian Gut), profesor në Paris, ka dhënë ndihmesë të mirë në studimet albanologjike me punimet. **Gjendja e tanishme e studimeve albanologjike në Francë** (L'etat present des etudes albanologiques en France - 1972); **Kontakte linguistike midis shqipes dhe maqedonishtes** (1973); **Burimet në gjuhën shqipe për historinë e Shqipërisë nga origjina deri në fillim të shekullit XIX; Sa rasa ka gjuha shqipe?** (1994); **Mësimi i gjuhës shqipe në Francë dje edhe sot** (në revistën Gjuha Jonë, 1-4 1995).

Anjes Bryne (Agnes Brunnet), bija e studiuesit të lartpërmendur, pedagogë e njohur, ka botuar studimet e mirënjohura: **Rreth teorisë së togfjalëshit në gjuhën shqipe** (1980); **Mbi disa struktura që shprehin fillimin e veprimit në shqip** (1981); **Rimarrja përemërore e kundrinës në gjuhët ballkanike** (1981); **Rreth një konkordance kohore në shqipen** (1982); **Disa mendime për A. Xhuvanin si studiues i sintaksës së gjuhës shqipe** (1986).

Gijom Bone (Guillaume Bonnet), ka mbrojtur tani vonë Doktoraturën me temë: **Huazime dhe Përshtatje të fjalëve latine në shqip. Fonetika dhe Morfologjia**.

Duhet përmendur këtu edhe kontributi në studimet albanologjike të profesorit të njohur francez **Lui Zhan Dyshe** (Louis Jean Duchet) me studimet: **Forma emërore të shquara dhe të pashquara në shqip, Disa konkordanca ndërmjet serbokroatishtes dhe shqipes** (1964); **Fjalorë i gjuhëve të Jugosllavisë dhe të Shqipërisë** (1965).

Studiuesi në fjalë ka përfunduar një **Fjalor** shqip-frëngjisht

me 50.000 fjalë dhe në veprën e tij **Fonologjia** (1981) bën krahasime të shumta me shqipen, me ç'rast sjell fakte me interes për fonetikën e shqipes.

Historiani **Alen Dyselié** (Alain Ducellier), në veprën **Arbërit dhe Arbëreshët në shekullin XI** (Paris, 1968), ka kontribuar, në mes tjerash, edhe për çështjen e prejardhjes së shqipes dhe të shqiptarëve nga Ilirët.

Një çifut i ditur në Francë **Z.Majami** (Mayami) ka botuar veprat **Etruskët filluan të flasin** (1961); **Fundi i misterit etrusk** (Paris, 1972), në të cilat përpiqet të dëshifrojë Mbishkrimet etruske me anë të shqipes dhe të vërtetojë se etruskishtja ishte dialekt ilir, çka nuk është aspak e vërtetë.

———— * ————

Në **Angli**, studiuesi anglez, me një veprimtari të gjatë dhe të bollshme, **Stuart Men**, u mor me shqipen më se dyzetë vjet. Ai ka qenë në Shqipëri në vitet 1929-1931, ku edhe e mësoi shqipen.

Dijetari në fjalë është i apasionuar pas studimeve albanologjike, si rezultat i të cilave ka botuar: **Gramatikë e shkurtër e gjuhës shqipe** (1932); **Alternimi n-r** (1938); **Fjalor historik shqip-anglisht** (1496-1938), me 70000 fjalë botuar në vitin 1948; **Gjysmëzanoret indoeuropjane në gjuhën shqipe** (1952); **Bashtingëlloret indoeuropjane në gjuhën shqipe** (1952); **Fjalor anglisht-shqip** (1957); **Shqipja si gjuhë indoeuropjane** (1962) etj.

Veprat janë botuar në Londër ku ishte profesor.

———— * ————

Në **ish Bashkimin Sovjetik** (sot Rusi), pas Luftës së dytë Botërore, u krijua një traditë e mirë në fushën e studimeve albanologjike.

Në këtë drejtim u shqua për veprimtarinë e saj shkencore të shumanshme **A.V.Djesnickaja** (1912-1992).

Me nismën e saj pranë Institutit të Gjuhësisë në San-Petërburg (ish Leningradi) u ngrit dhe funksionon edhe sot një **Sektor** i rëndësishëm **albanologjik** me një grup studiuesish të njohur në këtë

sferë si: A.P.Sitov, A.V.Zhurga, L.A.Llapashov, L.V.Sharapova, I.I.Voronina, A.Y.Rusakov etj.

Kuptohet se më e madhja në këtë grup dhe ndër albanologët më të mëdhenj pas Luftës së dytë Botërore është A.V.Djesnickaja.

Interesi për gjuhën shqipe zë fill në vitet pesëdhjetë dhe vazhdon deri në vdekjen e saj.

Ishte disa herë në Shqipëri gjer më 1960 dhe për herë të fundit në vitit 1991.

Mori pjesë gjatë jetës së saj tetëdhjetëvjeçare në shumë Konferenca, Kolokiume, Simpoziume, Kongrese Ndërkombëtare me kumtesa për gjuhën shqipe.

Interesat e saja shkencore përfshijnë Fonetikën, Morfologjinë, Sintaksën, Leksikologjinë, Historinë e gjuhës, Marrëdhëniet e shqipes me gjuhët ballkanike, me gjuhët baltike, me latinishten, me turqishten, me gjuhët gjermane etj.

Ajo ka trajtuar probleme të shumta gjuhësore si: kategoria e numrit, gjinisë, rasës, kategoria e mbiemrit, çështje të kohëve të foljes dhe të mënyrave të saj, çështje të fonetikës, si palatalizimi i zanoreve etj. Gjithënjë mbrojtë pikëpamjen se Faza vendimtare e formimit të sistemit morfologjik të shqipes përfshin Periudhën nga shekujt e fundit para erës së re e shkon deri në fund të mijëvjeçarit të parë të kohës sonë; në këtë periudhë u bë riorganizimi i plotë i tërë sistemit morfologjik të gjuhës shqipe.

Në vitin 1968 botoi veprën **Albanskij jazik i jevo dialekty** (Gjuha shqipe dhe dialektet e saj).

Jashtë vëmëndjes saj nuk mbetet as problemi i gjuhës letrare shqipe së cilës i ka kushtuar disa artikuj e punime si: **Rreth premisave të formimit të gjuhës letrare shqipe** (1973); **Roli i koineve gojore në historinë e formimit të gjuhës letrare shqipe** (1974).

Më se dhjetë studime të thella janë kushtuar historisë së gjuhës shqipe, ndër të cilat përmendim **Parashqipja dhe përkatësia e saj në arealet gjuhësore veriore të indoeuropjanishtes** (1972); **Mbi periodizmin e historisë së gjuhës shqipe** (1975); **Bazat his-**

torike të ndarjes dialektore të shqipes.

Me shumë interes shkencor janë punimet kushtuar bashkëmar-rëdhënieve të shqipes me gjuhët e tjera siç janë: **Lidhjet gjuhë-sore të hershme gjermano-shqiptare në dritën e problemeve të gjuhësisë areale indoeuropjane** (1980); **Edhe një herë për çështjen e prejardhjes veriore të shqipes; Marrëdhëniet e vje-tra gjuhësore shqiptaro-balte dhe shqiptaro-gjermane** (1981); **Marrëdhëniet e vjetra ballkano-baltike dhe gjuha sh-qipe** (1983); **Rindërtimi i elementeve të shqipes së vjetër dhe problemet gjuhësore të përbashkëta ballkanike** (1968); **Pale-oballkanistika dhe gjuha shqipe** (1983).

Djesnickaja në studimin **Huazimet sllave në shqipe** (1963), si edhe në punimin tjetër **Marrëdhëniet gjuhësore sllavo-shqiptare**, ka përcaktuar elementin serb në Shqipërinë Veriore dhe atë bull-garo-maqedonase në Shqipërinë e Mesme dhe të Jugut, duke përcaktuar vendin që zënë sllavizmat në leksikun e shqipes.

Një vepër e rëndësishme e saj, në të cilën ka material edhe për shqipen, është **Gjuhësia Krahasuese dhe historia e gjuhës**, botuar në vitin 1984.

Për gjuhën shqipe janë me vlerë edhe punimet: **Mbi kategorinë e numrit në gjuhën shqipe; Kuptimi i kategorisë së Admirat-ivit në shqipen** (1987).

A.V.Djesnickaja, me rreth 73 artikuj, studime e monografi për gjuhën shqipe, për folklorin dhe letërsinë shqiptare, mbetet një personalitete e shquar në studimet albanologjike.

Një tjetër studiues prodhimtar në fushën e Albanologjisë, në ish Bashkimin Sovjetik është **M.A.Gabinskij**, i diplomuar në San-Petërburg (Leningrad), por që punon e jeton sot në Kishinjev.

Ai kryesisht është marrë me **infinitivin** (Paskajorja) në gjuhën shqipe, duke mos lënë pas dore edhe çështje të tjera albanologjike. Ndër studimet më të njohura të tij janë: **Lindja e infinitivit si proces i dytë gjuhësor ballkanik** (Vozniknovenic infinitiva kak vtariçnyj ballkanskij jazikovej proces); **Çfaqja dhe humbja e**

infinitivit të parë shqip (1970); **Mbi prejardhjen e infinitivit të vjetër shqip**; **Mbi infinitivin në gjuhën shqipe**; **Mbi format pavetore në shqip** (1960); etj, etj.

Studime të thukta për probleme të veçanta të gjuhës shqipe ka hartuar **A.P.Sitov**: **Nga historia e fleksionit foljor të shqipes** (Iz istorii albanskij glagolnoj fleksii - 1968); **Kategoria e admirativit në gjuhën shqipe dhe bashkëpërgjegjëset e saj ballkanike**; **Disa çështje të derivatit foljor në gjuhën shqipe, parë në aspektin historik** (1983); **Opozicionet aspektore në gjuhën shqipe** (1986); **Elemente indoeuropjane temëformuese në strukturën foljore të gjuhës shqipe** (1989) etj.

A.Sitov bashkë me **A.V.Zhurga** në vitin 1990 botuan **Albanskij Jazik** (Gjuha shqipe).

J.Llapashov botoi ndër të tjera edhe punimet: **Mbi shkaqet e lindjes së nyjës** (sipas materialeve të gjuhës shqipe - 1987). **Çështjet e mënyrës kushtore në grammatikat e shqipes** etj.

Këta autorë të lartpërmendur, si edhe disa të tjerë, me botimet e tyre të shumta dhe të larmishme në fushën e albanologjisë, kanë kontribuar në shkencën gjuhësore shqiptare.

Këto kohët e fundit në Shkup (Maqedoni), më konkretisht në vitin 1996 u botua monografia e gjërë **E folmja e shqiptarëve të Ukrainës** (200 faqe) nga **I.Voronina**, **M.Domosileckaja**, **L.Sharapova**.

Në atë vepër përshkruhet mirë sistemi fonetik, morfologjik, sintaksor dhe leksikor, me disa tekste në fund, në të katër fshatrat me popullsi shqiptare me 4402 banorë, në Ukrainë.

Shqiptarët që jetojnë në Ukrainë veten e quajnë **Arnaut**, ndërsa gjuhën e tyre **Arnautçe**; emrat e vjetër Arbën/Arbër, Arbënesh/**Arbëresh**, si edhe emrat **Shqiptar**, **Shqipëri/Shqipni**, nuk i njohin fare.

Të folmet shqipe të Ukrainës janë bërë objekt studimi që në vitet tridhjetë nga akademia **N.S.Derzhavin**, por studimi më i thellë i tyre u bë pas Luftës së dytrë Botërore nga **I.I.Voronina**,

L.v.Sharapova, L.J.Demko, E.O.Esina, J.V.Ivanova, N.V.Kotova, A.P.Sitov, O.S.Shirokov, etj.

Gjithnjë botojnë për sferat e ndryshme të gjuhës shqipe Qëndrat gjuhësore në ish-Bashkimin Sovjetik, por sidomos San-Petërburgu dhe Moska.

———— * ————

Studimet albanologjike në SHBA kanë nisur që para Luftës së dytë Botërore, por hov morën në vitet e Pasluftës, kur shqipja u vendos në disa Departamente të Gjuhësisë pranë Universiteteve Amerikane. Si rezultat i rritjes së interesit shkencor për shqipen dolën disa studiuës me emër si: **L.Njumark** (Newmark), **G.Bevington**, **J.Bajron** (Byron), **V.Fridman** (Friedman), **M.Huld**, **P.Hubbard**, **G.Kiç** etj.

Këta studiuës dhe të tjerë kanë dhënë dhe vazhdojnë të japin kontribute në studimin e sferave të ndryshme të gjuhës shqipe, sidomos në sferën e Sociolinguistikës, në Fonetikë, në Hartim fjalorësh etj.

Po cekim titujt e disa veprave themelore të tyre: **Standart Albanian** (Shqipja letrare); **Structural grammar of Albanian** (Gramatika strukturale e shqipes), të Njumarkut. Kjo e fundit botuar në International Journal of American Linguistic, vol.23, nr.4 (Revista Ndërkombëtare e Linguistikës Amerikane); Në vitin 1998 Njumark botoi **Albanian English Dictionary** (Fjalor shqip-anglisht); **The syntax of the Albanian verb** (Sintaksa e foljes në shqip) nga P.Hubbard; **Basic Albanian Etymologies** - 1984 (Etimologjitë bazale të shqipes) nga M.Huld; **Selection among alternates in languages standartization; the case of Albanian** (Zgjedhje në mes alternativave në standartizimin e gjuhëve: Rasti i shqipes) nga J.Bajron.

Le të vëmë në dukje mendimet e disa albanologëve amerikanë, tashmë të njohur, për anë të ndryshme të strukturës së gjuhës shqipe dhe të prejardhjes së popullit shqiptar.

E.Hemp (Hamp), 76 vjeçar, e kanë tërhequr më shumë veçoritë

e sistemit fonologjik të shqipes, prandaj edhe teza e Doktoraturës së tij është: **Vaccarizzo albanese (Emri i fshatit). Sistemi tingullor i një dialekti kalabro-Shqiptar** (1958). Në Punimin e tij Hemp del si indoeuropjanist, balkanolog, dialektolog dhe historian i gjuhës duke tërhequr vëmendjen për probleme të zhvillimit të sistemit fonologjik të shqipes në kushtet e gjuhëve në kontakt dhe të diasporës.

Ai ka bërë edhe punime të tjera dialektologjike për të folmet e kolonive shqiptare të Italisë e të Greqisë. Gjithashtu H.Hemp është i njohur në studimin e disa gjuhëve botërore si: greqisht, bullgarisht, maqedonisht, rumanisht, armenisht, serbokroatisht dhe të gjuhëve balto-sllave.

Lista e punimeve të tij i kalon 1200 tituj.

Studimet gjuhësore për shqipen të Hempit mund të përmbliohen në këto drejtime: Etimologji e gjuhës shqipe, Histori e shqipes; Vendi i saj si gjuhë indoeuropjane dhe si gjuhë ballkanike; Marrëdhëniet e shqipes me simotrat e saj; Shënime onomastike e toponomastike; Dialektet e gjuhës shqipe; Bibliografi dhe Plotësim zërash për gjuhën dhe letërsinë shqipe.

Studimi i tij i parë për gjuhën shqipe është një **Recension** kritik që i bëri veprës së Cimohovskit **Dialekti i Dushmanit** recension i tillë që përmbledh shumë çështje të lartëpërmendura.

Pikëpamja e tij më e plotë për vendin e shqipes në rrethin e gjuhëve indoeruropjane del në punimin **Vendi i shqipes**, botuar në vitin 1966 në të cilin trajton tri çështje themelore: Vendndodhja e shqiptarëve në Ballkan, marrëdhëniet me ilirët, me trakasit, si edhe me simotrat e saj indoeuropjane.

Për t'i shtjelluar këto çështje ai i referohet balkanistikës, gjuhësisë krahasuese, indoeuropjanistikës.

Hemp kundërshton tezën që i vendos shqiptarët më në Lindje për shkak të mungesës së termave të detarisë, si edhe tezën që i vendos shqiptarët më në Veri për shkak të mungesës së huazimeve greke dhe sjell shembuj nga Çabej e të tjerë, duke u përpjekur

kështu të vërtetojë se Shqiptarët janë aty që në antikitet.

Përkimet shqiptaro-rumune i vështron mbi bazën e një substrati (nënshtresë) të përbashkët, si edhe mbi bazën e huazimeve nga i njëjti burim: latinishtja vulgare, por edhe si zhvillime të pavaruar.

Ai ka botuar edhe studimin **Treguesi i gjinisë në gjuhën shqipe** me vlerë në këtë fushë.

Hemp ka dhënë ndihmesë të madhe në kërkimet e toponimisë shqiptare të arbëreshët e Greqisë, në hulumtimin e të folmeve të ngulimeve shqiptare; është recensues i studimeve mbi gjuhën, letërsinë, kulturën shqiptare në botimet e ndryshme shkencore.

Në Çikago studiuesi **G. Bevington** merret më tepër me çështjet e fonologjisë së gjuhës shqipe, duke kontribuar në këtë fushë me studimet e njohura të tij: **Theksimi në shqip në dritën e fonologjisë gjernerative; Fonologjia shqipe** (Albanian Phonology - 1974).

V. Fridman (Friedman) mban kursin e gjuhës shqipe pranë Universitetit të Çikagos, por është edhe një studiues i thellë qoftë i gjuhës shqipe, qoftë i gjuhëve sllave.

Fusha e kërkimeve të tij është përqëndruar kryesisht në lidhjet gjuhësore ballkanike, duke i trajtuar ato në planin sociolinguistik.

Interesat e tij shkencore janë shtrirë në tërë Ballkanistikën.

Në Sllavistikë ai ka prekur çështjet gjuhësore në serbokroatisht, rusisht, bullgarisht, maqedonisht.

Në Ballkanistikë ai ka vështruar kontaktet gjuhësore ballkanike, ndikimin e latinishtes në Lidhjet gjuhësore ballkanike, ndikimin e turqishtes, problemet e standartizimit gjuhësor në gjuhët e Ballkanit etj.

Kërkimet e tij gjuhësore për shqipen janë të prirura në planin krahasues ballkanik, ku të dhënat që ai sjell për shqipen në kundërvëniet ballkanike, luajnë një rol të madh në shpjegimet e dukurive të këtyre gjuhëve në kontakt.

Janë tema të preferuara të tij: **Kontaktet gjuhësore, Marrëdhëniet gjuhë-komb, Identiteti kulturor i popujve etj.**

Rasti i marrëdhënieve të shqipes, maqedonishtes, bullgarishtes, serbishtes e turqishtes e ka tërhequr mjaft.

Është marrë edhe me problemet e gjuhës letrare, formimin e tyre, duke përfshirë edhe shqipen.

Botimet e tij shkencore janë publikuar në Revista gjuhësore ballkanike e të sllavistikës, si edhe në ato të gjuhësisë së përgjithshme.

Ndër botimet e tij të bollshme po citojmë tituj: **Admirativity and confirmativity** - 1981 (Habitorja dhe Pohorja); **Gjorgji Pulevski, Fjalorët e tij dhe Rilindjet Kombëtare Shqiptare dhe Maqedone** - 1978; **Variation and Grammatikalization in the Developement of Balkanisms** - 1994 (Varirimi dhe Gramatikalizimi në zhvillimin e Ballkanizmave); **Dialectal base, variation and Codification of the Balkan literary languages: Albanian, Bulgarian, Macedonian and Romanian** (Baza dialektore, variationet dhe kodifikimi i gjuhëve letrare të Ballkanit: shqip, bullgarisht, maqedonisht dhe rumanisht); **Turkisms in a comparative balkan context** (Turqizmat në një kontekst krahasues ballkanik).

Autori vazhdon të jetë një prodhimtar i mirë pasi edhe në vitin 1995 botoi punimin **Mënyra habitore në gjuhën arumune dhe në gjuhën shqipe - paralele dhe ndikime**, kurse në vitin 1996: **Habitorja e shqipes dhe "Presumtivul" i rumanishtes**.

———— * ————

Interesi për të mësuar gjuhën shqipe dhe për ta studiuar atë ka arritur deri në Kinë.

Do të theksojmë se në Universitetin e Gjuhëve të Huaja të Pekinit mësohen 30 gjuhë të huaja, në mes të cilave edhe shqipja.

Dega e gjuhës shqipe u krijua në vitin 1961, shefe e së cilës është **Shiao Kujfen** që ka kryer studimet në Universitetin e Tiranës (1965-1969); aty japin mësim **Kë Gjini** që ka kryer studimet e gjuhës shqipe në Universitetin e Prishtinës (1990), **Cha Linhui** që ka krye studimet për gjuhën shqipe në vitin 1967 në Insitutin e Gjuhëve të Huaja të Pekinit. (Tani Universiteti i Gjuhëve të Hua-

ja).

Nga Dega e gjuhës shqipe në Universitetin e Gjuhëve të Huaja të Pekinit janë diplomuar 70 studentë.

Shefja e Katedrës së gjuhës shqipe **Shiao Kujfen**, e cila në vitin 1997-1998 bëri një specializim në Katedrën e gjuhës shqipe në Universitetin e Tiranës, ka hartuar dhe botuar disa punime për gjuhën shqipe si: **Disa pika dalluese midis gjuhës shqipe dhe gjuhës kinezë**, kumtesë e mbajtur në Seminarin Ndërkombëtar për gjuhën, letërsinë dhe kulturën shqiptare të vitit 1987 në Prishtinë dhe e botuar në numrin 13 të Përmbledhjeve të punimeve të këtij Seminari.

Në këtë Kumtesë u dhanë njohuri të përgjithshme fonetike dhe gramatikore të gjuhës kineze, të përqasura me gjuhën shqipe.

Ajo është autore edhe e punimeve: **Rëndësia e Kongresit të Manastirit për formimin e gjuhës së përbashkët letrare shqipe** (1988); **Mbi alfabetin e gjuhës shqipe** (1988); **Një Kongres i rëndësishëm në historinë e gjuhës shqipe**, kushtuar Kongresit të Drejtshkrimit të gjuhës shqipe; **Mënyra të jetuarit të shqiptarëve**; **Disa nga zakonet shqiptare**; **Shqiptarët në botë** - të gjitha shkruar në gjuhën kineze dhe botuar në Revistën Periodike të Fakultetit të gjuhëve të vendeve të Europës Lindore (Dong Ou) në vitet 1988, 1994, 1991, 1992 në Pekin.

Studiuesja në fjalë ka botuar në Pekin edhe librat mësimorë **Gjuha shqipe I,II** për të mësuar gjuhën shqipe studentët kinezë.

Studiuesi kinez **Shen Shun Shy** në artikullin **Disa mendime lidhur me fjalët e huaja në gjuhën shqipe**, mbajtur në Seminarin Ndërkombëtar për gjuhën, letërsinë dhe kulturën shqiptare, në vitin 1986 dhe botuar te numri 12 i Përmbledhjeve të punimeve të atij Seminari (1987), arrin në përfundimin se nga gjuha kineze kanë hyrë në shqipen fjalët **mandarinë, kaolinë**; nga gjuha malajzane fjalët, **bambu, gong**; nga indianët e Amerikës, pra nga Kontinenti amerikan **kakao, çokollatë, domate, patate**; nga Kontinenti australian **kangur**, nga Kontinenti afrikan **banane**, nga In-

dia **pizhame**.

Autori shpjegon historinë e hyrjes dhe të domethënies së disa fjalëve.

Mandarinë - në fillim kjo fjalë shprehte titullin e funksionarëve të lartë të Dinastisë Çing të Kinës. Kjo Dinasti ka qënë një regjim feudal që e krijuan aristokratët e kombësisë Mançure kineze në vitin 1616.

Qeveria e atëhershme kineze quhej Man Çing, me ç'rast disa të huaj e quanin Kinën Çina Man Çing (Çinmaçini) dhe, sipas gjuhës hane kineze, funksionarët e lartë kinezë i quanin **Man da ren**, që do të thotë "Njerëz të mëdhenj mançur". Të huajt (jokinezë) pak nga pak e shndërruan këtë titull nga togfjalësh Man da ren në fjalën e bashkuar **Mandaren** ose **Mandarin**, duke krijuar me të shumë togfjalësha të tjerë si: **Mandarin kout** (kostumet e funksionarëve të lartë kinezë), **Mandarin fish** (një lloj peshku kinez), **Mandarin lënguizh** (Mandarin language - gjuha zyrtare kineze), **Mandarin dialekt** (dialekti kinez, i Pekinit), **Mandarin dak** (Mandarin duck - një lloj zogu kinez). Por një agrume kineze të huajt e quajtën **Mandarin orindzh** (Mandarin orange) një lloj portokalle. Ky emër me kohë u thjeshtua, duke u hequr fjala orindzh (orange) e duke mbetur vetëm fjala **Mandarin**.

Kështu fjala **Mandarinë** u bë fjalë polisemantike, me shumë kuptime, e më vonë u shndërrua në fjalë homonime, prandaj sot më shumë Fjalor të Evropës gjenden dy fjalë Mandarinë.

Pra nga një togfjalësh që dikur shprehte titullin e njerëzve, sot është shndërruar me evolucione, me emërtimin e një lloj agrumeje në shumë gjuhë.

Porcelan - është fjalë evropjane, por sendi që shpreh ajo është kineze.

Porcelanin si lëndë së pari e krijuan kinezët në shekullin e VII, të cilin e quanin Ciçi.

Që në Mesjetë në disa gjuhë evropjane ekzistonte fjala Porcelan, e cila shprehte Margaritarin, Xhevahirin dhe sende të tjera

të çmuara.

Në shekullin e XVI portugezët e sollën atë send kinez (çiçi) në Evropë; në disa gjuhë evropjane ai send u emërtua Porcelan sepse ishte diçka shumë e shtrenjtë dhe e çmuar.

Në vitin 1710 evropjanët arritën ta imitonin atë send. Gjatë imitimit në teknikë u mor fjala kineze **Kaolinë**, e cila sot shpreh lëndën kryesore për prodhimin e Porcelanit. Shënojmë se në fillim fjala **Kaolinë** ishte një emër gjeografik kinez. Afër qytetit **Xhindexhan** (në Kinë) i cili në kinëzçe do të thotë **qyteti i porcelanit**, ndodhet një zonë me emër **Gaolin** që do të thotë Kodra e lartë.

Në fillim kinezët prej andej e merrnin Argjilin si lëndë për prodhimin e Porcelanit dhe më vonë banorët e krahinave të ndryshme ia vunë argjilit të atij lloji lëndë për prodhimin e Porcelanit emrin e zonës **Gaolinë**.

Në shqip dhe në gjuhët e tjera evropjane hyri trajta **Kaolinë**.

Këtu ne po theksojmë se edhe fjala **Çaj** është me burim kinez.

Këtë bimë kinezët e kultivuan që në shekullin e VI. Kina e Jugut e quante **Tea** nga ku Anglezët e morën dhe e sollën në Evropën Perëndimore me këtë emërtim.

Në Kinën Veriore po e njëjta bimë quhej **Ça**, nga ku Rusët e morën dhe e sollën në Evropën Lindore me këtë emërtim. Prandaj në tërë Evropën Perëndimore sot quhet **Tea**, (Te, Ti), ndërsa në Evropën Lindore quhet **Çaj**.

Studiuesi kinez i lartëpërmendur thekson në artikullin e tij se ndonjë fjalë ka lindur edhe nga keqkuptimi.

Fjala **Kangur** emërton një kafshë gjitare barngrënëse që jeton në Australi. Evropianët nuk e kishin parë kurrë këtë lloj kafshe. Në shekullin e XVIII një anglez bëri një ekspeditë në Australi, ku e pa këtë lloj kafshe. Ai gjeti një burrë vendas dhe e pyeti se si quhej kjo kafshë.

Vendasi, i cili nuk e dinte anglishten, nuk e mori vesh se çfarë po thoshte e prandaj iu përgjigj **Kan ga ru** që do të thotë: **Nuk po të kuptoj**.

Anglezi kujtoi se **Kan ga ru** ishte emërtim i kafshës e, si pasojë, e shënoi menjëherë në bllok, çka më vonë u përhap gjërësisht në tërë Evropën **si kangur**.

Studiuesi tjetër kinez **Hau Y Pin** mbajti kumtesën **Mbi kohën dhe aspektin e foljeve në gjuhën kineze** (duke bërë një krahasim me gjuhën shqipe) në Seminarin Ndërkombëtar për gjuhën, letërsinë dhe kulturën shqiptare, mbajtur në Prishtinë në gusht të vitit 1988 dhe botuar te numri 14 i Përmbledhjeve të atyre kumtesave, në vitin 1989.

Mësimi dhe studimi për qasës i gjuhës shqipe vazhdon në Kinë.

———— * ————

Në **Izrael** sot aktivizohet në studimet albanologjike **Vladimir Orel**, një hebraik, çifut i ditur, i lindur në Moskë në vitin 1952. Ai, pasi kreu studimet pranë katedrës së Gjuhësisë së Përgjithshme në Universitetin e Leningradit (sot Sankt-Petërburg), punoi në Insitutin e Studimeve Sllave dhe Ballkanike në Moskë, ku edhe ishte si Lektor për gjuhën shqipe, e, më pas, në vitin 1990, emigroi në izrael.

Gjithnjë ngulmon në periudha shumë të hershme të prehistorisë së gjuhëve, por veçanërisht në shqipen e lashtë a në protoshqipen.

Interesat e tij janë: Gjuhësia historike shqipe dhe indoeuropjane; Etimologjia sllave dhe shqipe; Lidhjet areale sllave-balteshqipe.

Nga dyqind botime që ka bërë njëqind i zënë ato për shqipen. Ja disa nga më kryesoret: **Përemrat vetorë në shqipen në përjasje me vetorët e gjuhëve sllave dhe të gjuhëve të tjera indoeuropjane; Rreth origjinës së përemrave reflektiv të shqipes; Çështje të gramatikës historike krahasuese të shqipes; Leksiku origjinar i shqipes; Leksiku indoeuropjan në gjuhën shqipe; Fleksioni nominal i shqipes. probleme të origjinës; Etimologji shqipe; Folja protoshqipe. Probleme të rindërtimit etj.**

Këto studime, si edhe dhjetëra të tjera, ai i ka botuar anglisht gjatë viteve tetëdhjetë e nëntëdhjetë në Revista të ndryshme sh-

kencore.

VI.Orel ka përgatitur edhe një **Fjalor etimologjik të gjuhës shqipe** të cilin në vitin 1998 e botoi në Hollandë (Leiden): **Albanian Etymological Dictionary** (Fjalori etimologjik i shqipes).

Në vende të ndryshme të Botës, qoftë në Qendra Shkencore, qoftë në mënyrë të pavarur, sot dalin studiues të rinj të apasionuar pas gjuhës shqipe dhe traditave të mrekullueshme etnokulturore të popullit shqiptar.

Ne jemi përqëndruar në më Kryesorët.

BIBLIOGRAFI.

E.Çabej:

1) Studime etimologjike në fushë të shqipes;

vëll.I Tiranë - 1982

vëll.II Tiranë - 1976

vëll.III Tiranë - 1987

vëll.IV Tiranë - 1997

2) Studime gjuhësore, vëll I-VI Prishtinë 1975, 1977.

3) Hyrje në historinë e gjuhës shqipe, vëll I,II, Tiranë, 1976

Dh.Shuteriqi, Shkrime shqipe në vitet 1332-1850, Tiranë, 1976

I.Ajeti: 1) Shqiptarët dhe gjuha e tyre Prishtinë, 1994

2) Studime gjuhësore në fushë të shqipes; vëllimi I, Prishtinë, 1982; vëllimi II, Prishtinë, 1985; vëllimi III, Prishtinë, 1985.

M.Domi, Morfologjia historike e shqipes (Konspekt leksionesh) - Tiranë, 1961

Sh.Demiraj, Gjuha shqipe dhe historia e saj, Tiranë, 1988.

J.Kastrati, Histori e Gramatologjisë Shqiptare (1635-1944) Prishtinë, 1980.

Autori i kësaj vepre, **Xheladin Gosturani**, ka botuar dhjetëra studime dhe artikuj në Revistat gjuhësore dhe në Shtypin e kohës, me ç'rast ndër Botimet e tij më kryesore përmendim:

I LIBRA

1. **Atlasi Dialektologjik i gjuhës shqipe** (ADGJSH), vol.I-II (bashkautor) - në shtyp.
2. **Jakup Ferri dhe Lufta për mbrojtjen e Plavës dhe të Gucisë** Tiranë, 1982.
3. **Ramë Sadri Metaliaj** (bashkautor), Tiranë, 1985.
4. **Historia e Gjuhësisë Botërore gjatë shekujve dhe disa çështje teorike të saj**, Tiranë, 1998.

II MONOGRAFI

1. **Periudha me fjali të varur lejore në gjuhën shqipe**, në revistën "Studime filologjike", nr.1, 1972; në përmbledhjen "Studime për nder të Aleksandër Xhuvanit", Tiranë, 1986.
2. **Mohim dhe Mënyrat e shprehjes së tij në gjuhën shqipe**, në revistën "Studime filologjike", nr.1, 1975; nr.2, 1976; nr.4, 1976; nr.1, 1977; nr.4, 1977; nr.3, 1979; në revistën "Studia Albanica", nr.2, 1985; në revistën "Jehona"(Shkup), nr.3, 1995; në revistën "Gjuha Jonë", nr.1, 1981; në përmbledhjen "Gjuha letrare shqipe dhe epoka jonë", Tiranë, 1988 në revistën "Shqyrtime albanologjike" (Shkup), 4.1998
3. **E folmja e Hasit**, në "Dialektologjia shqiptare", vol III, Tiranë, 1975.
4. **E folmja e Çeremit dhe Valbonës**, në "Dialektologjia shqiptare", vol IV, Tiranë, 1982.

5. **E folmja e Ragamit**, në “Dialektologjia shqiptare”, vol VI, Tiranë, 1990.

III STUDIME

1. **Sistemi i fonemave bashkëtingëllore në të folmen e qytetit të Elbasanit**, në revistën “Studime filologjike”, nr.3, 1981.

2. **Dukuri fonetike në sistemin e zanoreve të së folmes së qytetit të Elbasanit**, në revistën “Studime filologjike”, nr.1, 1983.

3. **Veçori gjuhësore të Gegërishtes Verilindore** në “Studime filologjike”, nr.4, 1983.

4. **E pakryera në të folmet e Gegërishtes Verilindore**, “në “Studime filologjike”, nr.3, 1985.

5. **Mbi disa ndërtime të periudhës në të folmen e qytetit të Elbasanit**, në “Studime filologjike”, nr.4, 1986.

6. **Togfjalëshi në të folmen e qytetit të Elbasanit**, në “Studime filologjike” nr.2, 1987.

7. **Gegërishtja Verilindore dhe disa tipare karakteristike të saj**, në “Studia Albanica”, nr.2, 1986.

8. **Vëzhgime për ndikimin e gjuhës letrare në të folmet e Gegërishtes Verilindore**, në “Studime filologjike”, nr.2, 1988.

9. **Mbi disa ndërtime togfjalëshash foljorë në të folmet e Gegërishtes Verilindore**, në “Studime filologjike”, nr.3, 1990.

10. **Mbi disa tipa fjalëformuese në të folmet e Gegërishtes Verilindore**, në “Studime filologjike”, nr.1-4, 1992.

11. **Format e pashtjelluara të foljes në të folmet e Gegërishtes Verilindore**, në “Studime filologjike”, nr.1-4, 1994.

Shënojmë se Autori ka mbrojtur me shumë sukses dy grada shkencore:

a) **Kandidat i Shkencave Filologjike**, me temë: **Struktura**

gramatikore e së folmes së qytetit të Elbasanit (Vështrim historiko-gjuhësor) - 300 faqe (dorëshkrim).

b) **Doktor i Shkencave Filologjike** me temë: **Gegërishtja Verilindore** - Kosova (600 faqe - Vështrim historiko-gjuhësor).

Të dyja këto vepra presin ditën e botimit

PASQYRA E LËNDËS

1. Parathënie.....	5
2. Gjuha shqipe gjatë shekujve.....	8
3. Nga historia e studimit të gjuhës shqipe.....	72
a) Periudha e parë.....	75
b) Periudha e dytë.....	104
c) Periudha e tretë.....	192
d) Periudha e katërt.....	237
A. Në Shqipëri.....	237
B. Nëpër Botë.....	243
4. Bibliografi.....	301

CIP - Katalogizmi në botim - B.K.Tiranë
Gosturani, Xheladin
Historia e Albanologjisë / Xheladin Gosturani.-
T.:Albin, 1999.

306 f.; 21cm

Bibl. -ISBN 99927 - 32 - 19 - 9

1. Gjuha shqipe - Historia, 2. Gjuha shqipe -
Studime krahasuese, 3. Albanologjia dhe
balkanologë, 4. Gjuha shqipe - Biografi

809.198.3-53+

809.198.3-52+

929:008 (=919.83:4/9)+

929:809.198.3

Shtypshkronja

MNS

Rr."Bajram Curri, Nr 53

Tel: 475 99